

HALIL RAMA

Fluturon shqipja mbi Korab

- Reportazhe, portrete, kritikë letrare -

Tiranë 2021

HALIL RAMA
Fluturon shqipja mbi Korab
- *Reportazhe, portrete, kritikë letrare* -

Redaktor:
Shefqet MEKO

Recenzent:
Dr. Hajri MANDRI

Arti grafik:
Agron SEJAMINI

ISBN 978-9928-353-12-2
© Autori

Ua kushtoj mbesave të mia,
KEIDËS dhe ALESIAS

PASQYRA E LËNDËS

SHËNIMI I REDAKTORIT

- Një panoramë publicistike që nxit mendime.....7

I. DIBRA DHE DIBRANËT NË PANTEONIN E VLERAVE

- Në vëndorigjinën e Kastriotëve..... 17
- Dritëro Agolli në Parkun "Dine Doda"25
- Berishët e Muhurrit, si rast unikal në historinë Skënderbegiane.....35
- Fisi Bruçi i Lukanit të Dibrës.....42
- Fluturon shqipja mbi Korab.....51
- Historia e një spektakli kushtuar Hazis Ndreut
- ikonë e artit dhe kulturës kombëtare.....56
- Bujar Kapexhiu dhe Ansambli artistik
"Hazis Ndreu" - "Nderi i Kombit"64
- Shatku - plejada e burrave
të shquar dibranë në historinë e Tiranës.....68
- Ismail Shulku dhe Muharrem Gjoka "Nderi i Qarkut Dibër"74
- Dibra, "zemra" e Kombit..... 83
- Mirënjohje Çamërie për Dibrën dhe dibranët.....90
- Mevlud Buci - Mësues, publicist dhe poet i talentuar.....97
- Na ishte dikur... miniera e mermerit, "Guri i Kuq", Muhurr.....104

II. PERSONALITETE QË NDEROJNE KOMBIN

- Rrahman Parllaku - Heroi që fitoi duke merituar
lavdinë dhe pavdekësinë.....115

• Dali Ndreu, strategu që udhëhoqi luftën për çlirimin e Tiranës.....	122
• "Dekorata e Artë e Shqiptarëve"	
për kolonelin veteran Myfit Guxholli.....	135
• Flora, historia tragjike e bashkëshortes së Dr.Ymer Dishnicës.....	146
• Marlin Tushe, krenari Shqiptare në SHBA.....	151
• Kolonel Sotir Budina, ish-partizani, ushtaraku dhe veprimtari shembullor.....	155
• Si më shpëtoi Dr.Illir Peposhi nga kthetrat e Covid-19.....	160

III. ANALIZA-KRITIKE LETRARE

• Një palë “opinga” për Hrushovin?!	167
• Dashuria njerëzore dhe plagët sociale në romanin "Anja" të Ahmet Prençit.....	176
• "5 Skenarë" nga Bujar Kapexhiu.....	187
• Shefki Karadaku, poezi kushtuar vendlindjes dhe vendlindasve.....	195
• Vepër shkencore me vlera të jashtëzakonshme etnokulturore.....	200
• Atdhe - dashuria në prozën dhe publicistikën e Shefqet Mekos.....	211
• Metamorfoza e negociatave për çështjen e detit.....	219
• "Kritikë" për kritikën letrare të Shpendi Topollajit.....	224
• Koha kur shkriheshin akuajt në librin e Kamber Farukut.....	232
• Vepra krijuese e Dr.Hajri Mandrit në tri dimensione.....	241
• Publicistika dhe prirjet letrare e artistike të Isuf Rashës.....	247
• Filozofia popullore dibrane në rrëfimet e Sakip Camit.....	255
• Pësia e mendimit lirik-filozofik në poezinë e Hamdi Skejës.....	260

IV. KOHË PËR T'U KUJTUAR...NË VETËN E PARE

• Katër ngjarje kulmore në "sitën" e kujtesës.....	267
• Dekorimi me Titullin "Mjeshtër i Madh".....	289

Shënim i redaktorit

NJË PANORAMË PUBLICISTIKE QË NXIT MENDIME

Halil Rama vjen në tregun e librit shqiptar me botimin e tij të 18-të. Është një përmbledhje publicistike, sa modeste aq edhe mbresëlënëse. Thjesht dhe bukur, me gjuhë të pasur dhe me një ndjesi njerëzore, autori rrëfen, përshkruan, tregon fakte, ngjarje, jetë heronjsh, kontribute njerëzore, karaktere dhe viktima, të vërteta rrëngjethëse të dekadave të shkuara. Ai "ngjyen" penën e vet tek e vërteta historike se si një sistem që iu afrua shqiptarëve si shpresë dhe shpëtim i kalvarit historik të vuajtjeve dhe zhgënjimeve pa fund, hap pas hapi, ditë për ditë, u kthye në një "humnerë njerëzore". Fati i ish-kontribuesve të fillimeve komuniste dhe luftës antifashiste në Shqipëri, si Rrahman Parllaku, Dali Ndreu, Liri Gega, Gjystina (Flora) Sata - Dishnica etj, u kthyen në tragjedi ose dhimbje e torturë pa fund... Autori rrëfen qetë, ai nuk bën "gjykatësin" as "prokurorin", por mbetet tregimtar publicistik i së vërtetës dhe realitetit që fshihej, retushohej, shtrembërohej dhe qëllimisht mbulohej nga heshtja që

dhunshëm dhe "pa ba za" diktohej nga zyrat e pushtetit të kohës. Jeta e atëhershme kishte vetëm "një korsi": me pushtetin ose në ferr. Për ne që mbijetuan dhe u bëmë "stëngëza" të asaj kohe që trumbehej si "demokraci e vërtetë" (shënomëni dhe mua), duket se aplikuam heshturazi thënien amerikane "Gjithkush do që të shkojë në parajsë, por asnjë nuk dëshiron të vdesë...". Ata që nuk e pësuan nga ajo kohë, ata që nuk shkuan në gjyqe, në kampe internimi, burgje apo më keq, pra "ishin kaluar", por tani flasin ndryshe duke u vetshpallur "kundërshtarë të sistemit", veç gënjejnë, veç mashtrojnë pafytyrësisht duke u vetofruar si "heronj rezistence" të asaj rezistence që realisht nuk ndodhi...Ne të gjithë duhet të pranojmë "mëkatën e heshtjes" duke u kërkuar falje atyre që vërtet guxuan dhe e pësuan. Kurrë nuk është vonë të kërkoj falje. Singëriteti është virtutet i shpirtit, por jo e analistëve shqiptarë. Ky është si një "fill qëndisës" në botimin që ofron për lexuesit autori.

Në librin që po shfletoni, Halil Rama vjen si një "marathonomak" i publicistikës së singërtë, duke treguar aq shumë për Dibrën, dibranët, historinë, traditat dhe Muhurrin e tij të dashur, për heronj dhe idhuj personalë, për veteranë e njerëz që duan të jenë në dobi dhe shërbim të vendit për aq sa janë gjallë. Si kryeredaktor i gazetës kombëtare "Veterani" autori nuk e fsheh dashurinë për luftën, sakrificat dhe triumfin partizan, për ata veteranë që deri në fund duan të shërbejnë...Për gati dy çerekshekulli ai ka shënuar në fletoren e vet të gjitha ngjarjet, momentet, heronjtë dhe viktimat e Dibrës, që ai e do aq shumë dhe krenohet,

dhe po aq, pa ngurrim dhe me mburrje, duke e quajtur si "zemra e kombit". Është një meritë e merituar. Dibra me djemtë dhe bijat e veta, me heronjtë e artistët, me politikanët dhe gazetarët, me traditat dhe historinë, me këngët dhe legjendat, me Skënderbeun dhe luftëtarët, me "kunjat" ironike që deshifrohen jo lehtë dhe "odat e mençurisë", ka marshuar me ego dhe ambicje në poltronin historik duke u ulur këmbëkryq e pak fodullçe, por me krenari të fituar nga të vërtetat që rrëfehen edhe në faqet e këtij botimi.

Prof. Dr. Eshref Ymeri, poliglotti dhe eruditi shqiptar, ka një bindje të vetën: "E humbëm Shqipërinë e tërë, sepse nuk ditëm ta mbanim. U tkurrëm nga Danubi gati deri në Shkumbin, sepse historikisht u "grindëm mes vedit" duke harruar misionin e kombit që është qëndresa dhe qeveribërja, jo tkurrja e kaosi...". Ymeri, ky nacionalist modern nga Vlora e flamurit, e thotë këtë me dhimbje, sepse në enciklopedinë ruse të 2-3 shekujve më parë ka gjetur faktet historike për "sinoret reale shqiptare". "Humbëm dhe po humbasim", gati bërtet përkthyesi dhe eruditi vlonjat që jeton në Amerikë, duke qënë "ikanak" si unë. E sjell këtë detaj sepse, nëse nuk do ishim tkurrur siç na dënoi historia "sipas festes", Dibra do ishte "Konstadinopoja" shqiptare, as Tirana, as Prishtina, as Lushnja nuk do ishin kryeqendra administrative shqiptare. Vetëm Dibra do ishte. Vetëm ajo. Sepse është në zemrën e lashtë të atdheut shqiptaro-ilir. Vetëm Dibra është si Berlini gjerman, e ndarë më dysh: Dibra e Madhe dhe ajo e këtejmeja. Dhimbje por e vërtetë. Historia dhe fati na ofroi shansin e të "qënit perandori", por

nuk ditëm e nuk mësuam. Në vend të arrinim këtë, mbetëm "jeniçerë" perandorish.

Në librin e vet me përmbledhje publicistike Halil Rama i mëshon pikërisht kësaj: fatit të madh të Dibrës, që ishte "zemra e atdheut", por nuk u bë kurrë. Ndaj ai sikur "ngushëllon" veten kur thotë "Fluturon shqipja mbi Korab"... Por autori nuk mund të jetë faktor "gjeo-politik", ai është publicist që thjesht "mban shënime dhe rrëfen". Ai ofron "odën dibrane" si variantin e parë të "demokracisë moderne" që mbeti për fatin tonë "brenda mureve të veta" dhe sikur u fsheh nën minderet dhe qilimat e bukurpunuar nga duart e arta dibrane, dhe "humbi" diku duke u kthyer në mallkim dhe dëshpërim. Autori përpiqet të jetë sërish optimist kur anashkalon këtë "tragjedi shqiptare" dhe na rrëfen për Skënderbeun dhe "sofrën e tij", për vendlindjen dhe krenarinë që la, për trashëgiminë që sikur na turpëron kur vështrojmë historinë. Muhurraku Rama nuk fsheh krenarinë kur shkruan për Hazis Ndreun, këtë popullor të Dibrës, ai shpalos pasionin për Mjeshttrin e Madh, Bujar Kapexhiun (utopistin që ngriti dolli "për të bukurat sinjorina" (Sa keq, përsëri ikje, braktisje, dorëzim e "arratisja" e Kapexhiut me anije ishte "shembulli i parë" paçka se dëshpërues...), e zbret në "sofrën dibrane" duke na sjellë aq shumë njerëz të tjerë të spikatur të kulturës dhe artit dibran popullor dhe "kaladibrances" së famshme... Halil Rama shpalos hapur krenarinë e vet si "muhurrak Dibre", por po aq zellshëm reçensionon libra përtej naxisë së tij duke futur në lupën e vet Besnik Mustafain, Shefki Karadakun, Fatmir Terziun,

Shaban Muratin, Shpend Topallajn etj.

Libri është një "mozaik publicistik", shkruar thjesht, pa bujë dhe bërtitje, me gjuhë të thjeshtë, të kuptueshme qartë dhe rrjedhshëm. Halil Rama e përdor fuqinë shprehëse të shqipes si "antikorp" gjuhësor ndaj çdo huazimi të huaj, që ka çibanizuar lemeritshëm shtypin, rrjetet sociale, median dhe ekranet shqiptare. Në këtë plan nuk mund të hesht pa thënë "Faleminderit Rama" si një ikanak që e vetmja pasuri shqiptare përtej Atlantikut, më mbetet gjuha shqipe. Pikërisht me këtë gjuhë të shëndetshme ai portretizon karakteret e veta, rrëfen me pasion bëmat dhe ëndrrat dibrane, tregon për Muhurrin dhe mermerin e tij, për mësuesit që e edukuan dhe ata të thjeshtët e fshatit të vet, që i dhanë jetë një miniere unike në Ballkan: Minierës së mermerit të kuq "Guri i kuq". Ai nuk ndruhet për kritikën që mund t'i vijë, por thjesht si ato "thuprat e Skënderbeut" para vdekjes, sikur i bashkon të gjithë e flet për të gjithë. Vetëm kur të mësohemi të respektojmë veten dhe cilindo, cilindo nga ne, vetëm atëherë do ringrihem në vlerat që dëshirojmë. Kjo është arsyeja që Halil Rama nuk harron askënd. Ai rrëfen edhe për organistët, buldozieristët, magazinierët, brigadierët, kuzhinierët dhe portjerët e minierës, që e rriti dhe i dha shkëlqim në shpirt, një shkëlqim mermeri që e gjen vetëm tek ai produkt - thesar i Muhurrit. Nëse Arçibald Kronin do të kishte jetuar "brenda" Halil Ramës, me siguri do të kishte shkruar romanin tjetër "Dhe yjet shkëlqejnë mbi mermerin e kuq"...

Duke qënë i rritur me mbresat e një miniere qymyrguri,

ku më 1980 gati, më "përpinë blloqet e zeza" në thellësitë e errëta të tokës, në vendlindjen time, Pretushë, ku punoja për një kostum studenti, ndihem jo pa zili për këtë përshkrim të saktë, të detajuar e të vërtetë të Ramës, por nuk e konkuroj dot. Ai ka folur bukur edhe për mua "Ikanakun shqiptar", ish-punëtor miniere në pushimet e verës studentore. Faleminderit Halil Rama. Ti je si unë, unë jam si ty.

Personalisht nuk shquhem si recensent. Jam thjesht një ikanak nga Shqipëria. I tillë jam, me fat dhe pa fat, aty dhe jo aty, i pranishëm dhe fantazmë, sërish kam emrin tim si "pirmsidë" të ekzistencës sime: Shefqet Meko. Miqtë dhe kolegët e mi amerikanë e kanë veshtirë të ma artikulojnë qartë emrin, por unë miqësisht qesh alla dibrançe dhe u them: "Më thërrisni Meko, Albanian Meko".

Halil Rama dhe unë jemi ngritur nga hiçi dhe gati mosekzistenca. Ne të dy, në dy cepa sa të afërt dhe të largët dëshmojmë se e shkuara jonë nuk ishte thjesht ferr, errësirë "rrethuar me klon", burgje e gjyqe, por edhe mundim, përpjekje, dëshira, dashuri, luftë me shpirtzinjtë dhe shpresë". Kjo nuk është nostalgji apo dobësi ndaj të shkuarës. Është thjesht e vërtetë. Lexo shënimet në "vetën e parë" të Ramës. Ai sikur ka "kopjuar" ditaret e mia që i kam këtu në Minneapolis... Unë në mes të Amerikës çdo mëngjes, ndërsa bëj përditë "fiskulturën e mëngjezit", si dikur kur ishim pionierë dhe betoheshim në kor "Gjithmonë gati!", më shfaqet e shkuara si mallkim dhe shpresë, si fat dhe identitet e nuk kam kohë ta shaj, se ajo ka ikur. Shyqyr

që iku. Ta kujtosh atë nuk është mëkat, por një reflektim privat. Ndaj "monumentet publicistike" të Halil Ramës në këtë libër, sikur janë "kollonat" e fatit tim, ata luftëtarë si Parllaku me shokë, janë "gurë" të ekzistencës sime dhe në heshtje i nderoj. Për fatin tim, im atë, Feim Meko ishte bashkëluftëtar me Rrahman Parllakun, ndërsa vjehrrin im (Zhani Balli), do ishte shofer i Gjeneral Parllakut. Sa fije të çuditshme e lidhin jetën e individit në Shqipëri, aty ku sapo del nga shtëpia me dhjetra ta japin "vaktin me emër"...(!).

Libri i Ramës është një prurje e singertë publicistike ku gjejnë veten edhe heronjtë, edhe viktimat, edhe artistët me emër dibranë, edhe ata që ikën anonimë e pa u shfaqur kurrë në publik. Të bën për vete singëriteti rrëfyes i autorit dhe besnikëria publicistike, sepse siç shënuam më sipër, për Halil Ramën të gjithë janë të rëndësishëm, secili ka peshën e fjalës dhe të pasionit të vet krijues. Kjo do të thosha është edhe veçantia e këtij botimi përmbledhës publicistik.

Rastësisht jam redaktor i këtij libri. Ishte nder dhe dëshirë, por edhe një "vullnet diktatorial" i autorit të rritur nën "diktaturën e proletariatit", që u njohëm mbi 4 dekada të shkuara në koridoret e "Zërit të Rinisë". Halil Rama ngeli në kujtimet e mia ai muhurraku i singertë, që si "monument" të brendshëm ka mirënjohjen dhe respektin që nuk shuhet, por si pishtar cilësor, me inkadeshencë konstante ndrit shpirtin e të gjallit. Këtë lloj shansi përsëri ja dedikoj një dibrani tjetër që quhet Ahmet Prençi, i cili mbetet "ambasador i padekretuar" i mirësisë e shoqërisë dibrane, së paku në një hark të konsiderueshëm të jetë sime.

Unë prej dekadash nuk jetoj në Shqipëri, por "spirancat" e mallit gjithmonë "ankorojnë" shpirtin e "ikanakut shqiptar" në atë bregdet perëndimor të atyshëm, në Durrës, Shëngjin, Vlorë apo Sarandë. Kudoqoftë, shlodhja mbetet ndjeshmërisht e njëjtë, shlodhje në perëndim të Shqipërisë, ku gjumi pushtohet nga ëndrrat!

Sa e vogël është kjo Botë. Sa e pafundme është Gjithësia.

SHEFQET MEKO
Minneapolis, SHBA,
1 Mars, 2021

I.

DIBRA DHE DIBRANËT
NË PANTEONIN E VLERAVE

Të bëhet zemra mal,
kur sheh djemtë dhe vajzat e Dibrës
të lartësojnë traditat dhe vlerat tona
duke na bërë të ndihemi krenarë!
Thelbësore që rinia jonë të njohë rrënjët
kombëtare, për të mbrojtur më mirë të
ardhmen europiane të Shqipërisë.

ILIR META
President i Republikës

Në vendoriginën e Kastriotëve...

*Ripërtërritja e traditës, 35-vjet pas inaugurimit
të Muzeut të Kastriotëve në Sinë,
Kreu i Shtetit viziton Dibrën dhe nderon dibranët*



Tridhjetepesë vjet pas inaugurimit të Muzeut të Kastriotëve në Sinë të Dibrës, (paradite e 18 shtatorit 2020), ndodhi një vizitë impresionuese këtu në vendoriginën e Heroit tonë

Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Ardhja e Presidentit Ilir Meta në këtë vendngjarje, do të shërbente për ripërtëritjen e traditës së kësaj zone. Një ditë historike kjo, pasi referuar pikërisht veprës madhore të prof. Kristo Frashërit "Historia e Dibrës", që qëndron hijerëndë përkrah busteve të Gjon, Pal e Gjergj Kastriotit në hyrje të Muzeut, presidenti Meta, ashtu si edhe elita historike e kombit që vizituan këtë muze para dy vitesh, do të legjitimonte tashmë këtë fshat si vëndorigjinë e Kastriotëve.

Historiani i njohur dibran Haki Përnezha, në rolin e ciceronit, ndër të tjera do t'i bënte të njohur vizitorit më të rëndësishëm të këtij muzeu, atë që ka lënë si testament Gjon Muzaka që në shekullin e 16-të: "Ta dini se gjyshi i Zotit Skënderbe quhet Pal Kastrioti dhe nuk pati më shumë se dy fshatra të quajtura Sinë dhe Gardh i Poshtëm..." (Gardhi i Poshtëm ndodhet në Muhurr).

Besnik Këbej, ish-drejtor i shkollës 8-vjeçare Sinë, autor i librit "Origjina dibrane e Skënderbeut", që kishte ardhur pas tridhjet vitesh në vendin ku shërbeu dekada të tëra dhe që dha kontribut të çmuar në ngritjen e këtij muzeu, do të sillte në kujtesë kohën kur këtu erdhën për të parën herë profesorët e nderuar të historisë, Stefanaq Pollo e Kristo Frashëri. "Pasi i kisha njoftuar me telegram për gjetjen nga nxënësit e shkollës të një medalioni bronxi me diametër 9 cm, me emblemën e Skënderbeut, profesorët Pollo e Frashëri udhëtuan më këmbë 6 orë, që nga Lura për në Sinë, për të bërë ekspertizën e këtij medalioni. Më pas, nën ndikimin e tyre, do të ishte kryetari i komitetit ekzekutiv të Dibrës Skënder Dema që do të

urdhëronte ngritjen e këtij muzeu",-thotë ndër të tjera Besnik Këbej. Ndërsa, Presidenti Meta shprehet se njohja e trashëgimisë dhe rrënjëve kombëtare është thelbësore për të ardhmen europiane të vendit. "Sot (18 shtator 2020) në Sinë, në truallin e Kastriotëve, vendin e origjinës të Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Kënaqësi të vizitoja Muzeun Historik dhe të njihesha nga afër me të dhëna interesante për betejat heroike të zhvilluara për mbrojtjen e kombësisë, territorit dhe identitetit tonë europian. Të bëhet zemra mal kur sheh djemtë dhe vajzat e Dibrës të lartësojnë traditat dhe vlerat tona duke na bërë të ndihemi krenarë! Thelbësore që rinia jonë të njohë rrënjët kombëtare, për të mbrojtur më mirë të ardhmen europiane të Shqipërisë",-deklaroi Presidenti Meta, ndërsa "bekon" veprën madhore të Prof.Kristo Frashërit "Historia e Dibrës" që legjitimon origjinën dibrane të Kastriotëve.

Kjo vizitë jashtë axhende e kreut të shtetit shqiptar në Sinën e Kastriotëve, në fakt u ideua nga këshilltari i tij për Mbrojtjen Civile, Shemsi Prençi, një nga personalitetet shqiptare që e ka bërë të njohur Muhurrin dhe gjithë Dibrën në rang kombëtar, jo vetëm për detyrat e funksionet e rëndësishme që ka mbajtur, (nga komandant i pikës së Kalimit të Kufirit Hani i Hotit - Shkodër, Drejtor i Përgjithshëm Policie në disa qarqe si Korçë, Elbasan, Berat, Fier, Dibër, Drejtor i Përgjithshëm Emergjencave Civile e deri Këshilltar i Presidentit të Republikës), por para së gjithash për potencialin intelektual, përgatitjen profesionale, vizionin bashkëkohor dhe dimensionin e tij njerëzor.



Shemsi Prençi është ndër të rrallët që shfaq në çdo rast dëshirën e tij të madhe që t'i mbajë gjallë lidhjet me miqtë e farefisin. Jo vetëm rikonstruksionin që ai bashkë me vëllezërit e tij i bënë shtëpisë së prindërve në vendlindjen e tyre, në Muhurr, por edhe plot shembuj të ndihmës e mbështetjes që bujarisht u ka dhënë dhe u jep dibranëve, të njohur e të panjohur, tregojnë se Shemsi Prençi ishte dhe mbetet një fisnik i vërtetë, nëse kjo fjalë ka ende ndonjë rezonancë. Patriotët dhe punëtorët e mendjes si ai janë shembëlltyra e asaj ç'ka kemi më të mirën si komb...

Shpopullimi i Dibrës është i dhimbshëm

Bahçja e fermerit Shefki Prifti në Sinë të Dibrës, një parajsë e vërtetë! Në këtë vend të begatë, perlë e natyrës, vetëm dy kilometra sipër luginës pjellore të Drinit të Zi, që ka përballë Korabin dhe sipër Runjën hijerëndë e kreshnike,

për herë të parë në këto tridhjet vjet, vjen Presidenti i Republikës. Shefki Prifti, një ndër kuadrot e njohur në gjithë Dibrën e pret atë sipas traditës dibrane. Në oborrin mahnitës të shtëpisë së tij, janë mbledhur dhjetra fermerë të kësaj zone. Kuvendojnë ata shtruar me kreun e shtetit për "braktisjen qeveritare" të kësaj zone me histori të lavdishme. Ndër të tjera, më i moshuari, Besnik Kaloshi, përçues i denjë i mençurisë dhe filozofisë popullore dibrane do të shprehej se "Skënderbeu e ka lënë të hapur që prej gjashtë shekujsh rrugën e tij nga Sina për në gjithë Shqipërinë, por kjo copë udhë (vetëm dy kilometra nga ura e Arrasit) ka nevojë të asfaltohet e mirëmbahet që këtu të mund të vijnë vizitorë nga e gjithë bota". Dhe ndërsa ka provuar shijen e rakisë, rrushit, dardhës, kumbullës e të mjaltit të sapo dalë nga hojet e bletëve të Shefki Priftit, gjatë kuvendimit me vendasit, Presidenti Meta tha se "shpopullimi i Dibrës është i dhimbshëm, pasi sipas tij braktisja e këtyre krahinave tradicionale që kanë qenë burim i identitetit tonë kombëtar



e kulturor, mund të jetë fatal për të gjithë kombin". Dhe vërtetë ndjen dhimbje kur sheh të braktisura këto vise me bukuri të rrallë natyrore, të cilat me pak investime mund të kthehen në një destinacion turistik tërheqës për vizitorë të shumtë vendas e të huaj.

Zall Dardha, djep i artistëve



Shtatë dekada më parë, në Zall Dardhë, në këto troje të burrave të mençëm, trima, të besës e bujarë nisi udhën e gjatë, të bukur e plotë suksese, grupi folklorik i Zall Dardhës martire, që bëri emër e zuri vend denjësisht në fondin e kulturës sonë kombëtare. Jo rastësisht, këta burra, simbole të urtësisë, trimërisë e mençurisë dibrane do ta pagëzonin ansamblin folklorik të tyre me emrin aq kuptimplotë "KUVENDI". Ka kaluar më shumë se një gjysmë shekulli dhe këngët e vallet e kësaj krahine kanë ushtuar e janë kërcyer jo vetëm në festivale kombëtare, por edhe në ato

ndërkombëtare. Zall Dardha quhet djepi i artistëve. Mund të duket e çuditshme, madje e pabesueshme, por ndryshe nga e gjithë bota ku fëmijët lindin duke qarë, në Zall Dardhë, fëmijët lindin duke "kënduar". S'ka si të shpjegohet ndryshe fakti që në këtë vend ka aq shumë artistë në raport me numrin e popullsisë. Ndodh kështu, jo vetëm për efektet e trashëgimisë historike qëndrestare ndaj armiqve, por edhe për efektet e trashëgimisë kulturore folklorike. Por, Muharrem Gjoka, president i ansambllit "Hazis Ndreu," thotë se në Zall Dardhë nuk ka shtëpi që nuk ka vegël muzikore popullore, çifteli, fyell, dajre etj. Në këtë zonë lindën dhe u rritën njerëz që lanë gjurmë në muzikën etnike shqiptare si kompozitori i shquar Muharrem Xhediku -themelues i filarmonisë shqiptare, koreografi, studiuesi dhe poeti i këngës Hazis Ndreu, artistët Skënder Cala, Lirie Rasha, Qerim Sula, Caje Poleshi, Xhelal Çerpja, Sherif Dervishi, etj. Nuk është rastësi që vetëm nga krahina e Zall Dardhës, janë katër artistë të dekoruar me Titullin "Mjeshtër i Madh", përkatësisht: Hazis Ndreu, Skënder Cala, Liri Rasha dhe Qerim Sula.


Siç është shprehur Presidenti i Republikës, Ilir Meta: "Emrat e artistëve Haziz Ndreu, Muharrem Xhediku, Liri Rasha, Qerim Sula, Caje Poleshi, Ramadan Selmani, Shaban Mziu, Sherif Dervishi, Xhelil Ymeri, Xhelal Çerpja dhe shumë të tjerë janë të dashur për gjithë shqiptarët dhe janë bërë zëri i kombit në shumë aktivitete kombëtare e ndërkombëtare".

Janë me dhjetra muzikantët, instrumentistët, valltarët, këngëtarët popullorë nga Zall Dardha që me kontributin e

tyre jo vetëm kanë dhënë shfaqje në Zall Dardhë e Dibër, por edhe në mbarë Shqipërinë, madje edhe në skenat më prestigjioze të Amerikës dhe Europës. Dhe historia riciklohet. Atë që bënë burrat e shquar të Dardhës, para shtatë dekadash, duke themeluar ansamblin "Kuvendi", me në krye të shumëtalentuarin Hazis Ndreu, po e ripërtërin Neshat Ndreu-president i shoqatës "Ansambli Kuvendi Zall Dardhë". Janë të rrallë burrat si ai, që edhe në këto kohë të vështira kontribuojnë për ringjalljen e traditës. Në këtë vizitë të Presidentit Meta në Zall Dardhë ku u vlerësuan me dekorata të larta artistët më të mirë të kësaj treve: Xhelal Çerpja, Qerim Sula e Sherif Dervishi (pas vdekjes), si dhe Liri Rasha, Saje Poleshi, Xhelil Imeraj, Lutfi Ndreu, Shaban Mëziu, Neshat Ndreu e Agim Cani, Neshati, mbetet shembull frymëzimi për të gjithë ata që duan të promovojnë e trashëgojnë traditat e shkëlqyera të Dardhës. Presidenti Meta duke dekoruar personalitete të etnografisë, folklorit dhe muzikës popullore shqiptare në Zall Dardhë vlerësoi Dibrën si simbol të qëndresës së shqiptarëve, që ka qenë përherë djepi i luftërave patriotike për liri dhe identitet kulturor. Në ceremoninë solemne të organizuar me këtë rast kreu i shtetit vuri në dukje se ndihet i lumtur që gjendet në Zall Dardhë, në fshatin me histori të madhe të luftërave për liri, por dhe në krahinën e artistëve, rapsodëve dhe valltarëve të famshëm për mbarë kombin! Nder dhe krenari për Hazis Ndreun, të cilit Presidenti Meta i akordoi dekoratën "Nderi i Kombit". Mirënjohje të thellë për Neshat Ndreun e Avni Ndreun që i dhanë jetë Ansamblit "Kuvendi".

Dritëro Agolli në Parkun "Dine Doda"

- *Kur patriarku i letrave shqipe do të shkruante romanin e më pas skenarin e filmit "Njeriu me top"*
- *Erdhi sërisht në Muhurr i madhi Dritëro, një ditë gushti të vitit 1989. Ishte koha kur nomenklatura e sistemit monist, në rrënim e sipër po zbatonte të famshmin projekt të tufëzave e arçave dhe kur Dritëroi pyeti të pranishmit se a ishin të kënaqur fshatarët me këtë projekt, aty për aty Dine Doda iu përgjigj me alegorinë therëse dibrane: "Po o Dritëro, me pulat mbyllur në kotec e të gjitha lopët në një stallë, na kanë shpëtuar gratë që po bëjnë sehir!". Ndërsa këtyre zyrtarëve tanë u shkon për shtat "Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo". Dritëroi që e kuptoi gjendjen se ku ishte katandisur fshatari i mjerë, nuk nguroi t'ia bëjë atë prezant kupolës partiake e shtetërore të asaj kohe.*

**Dine Doda****Dritëro Agolli****Hazis Ndreu**

Patriarku i letrave shqipe, Dritëro Agolli, nxitjen për të shkruar romanin “Njeriu me top” (Tiranë 1975) e ka marrë nga një bisedë me miq të shquar dibranë, në ish - parkun “Dine Doda”, Muhurr. Në një nga vizitat e tij të verës së nxehtë të vitit 1974, i madhi Dritëro, atëherë kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, erdhi në Dibër, i ftuar nga miku i tij Hazis Ndreu - “Nderi i Kombit”. Për t’ia bërë pritjen sa më të ngrohtë e miqësore ikonës së letërsisë sonë, Hazisi kishte ftuar në pritjen në hotel “Korabi” edhe burrin e urtë Dine Doda nga Muhurri. Ishte një darkë vërtet e paharruar (siç ma ka rrëfyer, ndjesë pastë daja Hazis) dhe Dritëroi ishte mahnitur me alegorinë therëse dibrane që përdorte gjatë muhabetit, i mençuri dhe i urti Dine Doda. Dhe nisi ta thumbojë Hazisi, Dinen: “Muhurri ka dy Dine me emër, or Dritëro: Dine Hoxhën që ka xhaminë në rrugën e Kavajës në Tiranë, që njihet edhe si filozofi popullor dibran, dhe këtë Dine Dodën që kemi në këtë sofër. E ky i dyti, në gjurmët e të parit, nuk ka ndërtuar xhami se nuk ia mban, por ama emër ka lënë. Ka ndërtuar një park të bukur në një luginë që të mahnit me bukurinë e hijeshinë e saj, pikërisht aty ku

bashkohen Murra me Drinin. Dhe jo më kot, ata që e frekuentojnë bar-lulishten e këtij vendi, ia kanë ngjitur emrin ‘Parku Dine Doda’.

Aty për aty, Dritëroi ishte shprehur: “E po, u tha u bë....Nesër drekojmë tek ky parku ‘Dine Doda’”. Unë kam qenë atëherë vetëm 14 vjeç, në klasë të shtatë, por e mbaj mend harenë e asaj dreke të paharruar. Meqë kisha interpretuar në skeçe në shfaqjet e shtëpisë së kulturës me Dinen, më mori që të recitoja në ndonjë moment pauze vargje nga poema e famshme “Nënë Shqipëri” e Dritëroit. Në një tavolinë, veçmas të tjerave, pranë një shelgu ku dëgjohej gurgullima e ujit kaltërosh të Murrës, ishin ulur Dritëro Agolli si mysafir e bashkë me të burrat e mexhelisit dibran Hazis Ndreu, Xhemal Berisha e Dine Doda.

Ndërsa ia kishin shtruar për shtatë palë qejfe me raki “penestia”, mish të pjekur qengji e sallatë me zarzavate nga bujqit e Muhurrit, Dinja tregon historinë e plakut Mera të Luznisë, i cili në kohën e luftës kishte strehuar një italian të zënë rob pas kapitullimit të Italisë, si dhe për topin që kishte fshehur në stanin e bagëtive. Kaq iu desh Dritëroit që të fiksonte fabulën e romanit të tij “Njeriu me top”, që pas disa vitesh do të bëhej edhe subjekt i një prej filmave më të arrirë të kinostudios “Shqipëria e Re”, që i ka rezistuar kohës, pikërisht për ngjarjet interesante që trajton e përcjell. E kishte shoqëruar Dinja të nesërmen shkrimtarin e madh edhe në Luzni, nga ku do të mblidhnin fakte për romanin e saposkicuar.

Pas vizitës së Dritëro Agollit, parkut “Dine Doda” iu shtuan dukshëm vizitorët. Për tetë muajt e vitit, nga fillim prilli e

gjer në fund të tetorit, vinin këtu për të drekuar e për të shijuar natyrën magjepsëse të Muhurrit dhe për të marrë rreze në plazhin e Drinit, qytetarë të shumtë nga Peshkopia.

Vizionar, largpamës e bashkëkohor siç ishte Dine Doda, përveç shërbimit me korrektesë ndaj popullit nga njësitë tregtare të zonës që drejtonte si përgjegjës i degës së tregtisë Muhurr (që mbulonte edhe zonat e Luznisë e Katër Grykët), me intuitë e fantazi të rrallë, kishte projektuar edhe ndërtimin e një bar lulishteje, pikërisht përtej urës pasarelë, përballë zyrës së tij, në luginën me plepat e mbjellë nga nxënësit e shkollës para shumë viteve, por që ishin rritur e bërë gjigandë dhe krijonin një luginë me freski e gjëlberim mahnitës. Vinin këtu edhe funksionarë të lartë të rrethit e të dërguar nga Tirana dhe largoheshin me mbresa të pashlyera. Gumëzhinte parku nga zërat gazmorë të nxënësve, tek kalonin urën pasarelë për të blerë nga një akulllore apo aranaxhatë të freskët, që Evzi Lala ua servirte me delikatesë.

Erdhi sërish këtu, pas 15 vitesh i madhi Dritëro, një ditë gushti të vitit 1989, i shoqëruar nga ish-sekretari i parë Xhelil Gjoni. Dhe u takua sërish me Dine Dodën, Hazis Ndreun e Xhemal Berishën, por edhe me funksionarët e Muhurrit të asaj kohe, Sami Balla e Besnik Këbej. Një drekë gazmore, me gatimet tradicionale të kuzhinierëve me përvojë Xhavit Balla e Haxhi Xhani, por dhe shërbimi tejet i kulturuar i banakierëve Evzi Lala e Halit Xhani dhe i kamarierëve si flutura, Drita Kurti e Natasha Berisha, do ta linin pa mend Dritëroin. Në tavolinën ku shkëlqenin shishet me raki “Penestia” e “Shliva”, patriarku i letrave shqipe do të shfaqte

admirimin e tij, jo vetëm për peisazhin e gjelbëruar anash Murrës kaltëroshë, por edhe për bagazhin jetësor e zgjuarsinë natyrale, si dhe për mprehtësinë e gjykimit të Dine Dodës për çështje të ditës. Ishte koha kur nomenklatura e sistemit monist, në rrënim e sipër po zbatonte të famshmin projekt të tufëzave e arzave dhe kur Dritëroi pyeti të pranishmit se a ishin të kënaqur fshatarët me këtë projekt, aty për aty Dine Doda iu përgjigj me alegorinë therëse dibrane: “Po o Dritëro, me pulat mbyllur në kotec e të gjitha lopët në një stallë, na kanë shpëtuar gratë që po bëjnë sehirl”. Ndërsa këtyre zyrtarëve tanë u shkon për shtat “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”. Dritëroi që e kuptoi gjendjen se ku ishte katandisur fshatari i mjerë, nuk nguroi t’ia bëjë atë prezent kupolës partiake e shtetërore të asaj kohe.

Qe një nga ato momente, kur Dine Doda shfaqti jo vetëm zgjuarsinë e talentin e tij në rrëfimin e ngjarjeve e situatave, por edhe formimin e tij kulturor nëpërmjet leximit të librave të shumtë (nuk kishte lënë asnjë libër të Dritëro Agollit pa lexuar), emri i tij u bë legjendë, ndaj i referohen edhe sot e kësaj dite. U bënë 14 vjet që ka ikur për në botën e përtejme, por në bisedat mes miqsh, shpesh thuhet “Siç ka thënë Dine Doda...”!

Kush ishte Dine Asllan Doda?

Njeriu legjendë i Muhurrit e gjithë Dibrës kishte lindur në Vajmëdhej më 1933 dhe ishte rritur jetim. Kur ishte vetëm 11 vjeç do të shërbente si korrier i komandës partizane të vendit, pa përfillur rreziqet e vështirësitë e luftës së ashpër

kundër pushtuesit nazifashist. Nga kontakti me organizatorët e asaj lufte, do të mësonte e do të burrërohej para kohe. Veçanërisht tregonte interes të jashtëzakonshëm për bisdedat që bëheshin në odat e burrave, nga ku mësonte për ngjarje e bëma të trimave muhurrakë në luftërat me kraljtë e Serbisë, të cilat më vonë i përjetësoi në këngët e tij, si rapsod popullor. Menjëherë pas çlirimit, merr pjesë në aksionin e rinisë për ndërtimin e të parës hekurudhë në Shqipëri, Durrës-Peqin (1947), ku u miqësua me vullnetarë nga e gjithë Shqipëria. Ndërkohë, i etur për arsimin e dije, si edhe dhjetëra të rinj të tjerë, krahas punës vullnetare, kryen kursin kundër analfabetizmit për të mësuar shkrim e këndim. Tashmë më i rritur e i pjekur, por edhe nga kontakti me intelektualë të kohës, e kishte kuptuar se pa u arsimuar nuk mund të çante në jetë. Ndaj dhe kur nevojat për kuadro në vitet e para pas çlirimit ishin të mëdha, zgjodhi për të ndjekur studimet në shkollën tregtare ekonomike në Durrës, të cilën e mbaroi me rezultate të shkëlqyera.

I përgatitur për të shërbyer në një nga sektorët më jetikë të asaj kohe, siç ishte sektori i tregtisë, e nis punën në bazën e këtij sektori si shitës fshati. Përballoi me dinjitet vështirësitë e kohës kur popullit i mungonin artikujt më të domosdoshëm ushqimorë e industrialë dhe kur përveç tregtimit kryente njëherësh edhe detyrën e grumbulluesit të prodhimeve bujqësore e blegtorale (misër, grurë, fasule, vezë, mish etj.) nga fshatarët. Ndonëse punoi për një kohë të shkurtër si shitës-grumbulles, kjo kohë i shërbeu si përvojë në funksionet e mëvonshme organizuese e drejtuese për zgjerimin e rrjetit të

tregtisë në zonën e Dibrës. Me përgjegjësi maksimale, kompetencë e përkushtim qytetar, Dine Doda ia ka dalë të drejtojë e t'i ngjitë në pararojë degët e tregtisë Fushë-Alie, Maqellarë, Muhurr e Peshkopi (dega fshat). Falë aftësive organizative e komunikuese të tij, këto degë qenë shembull për realizimin e treguesve ekonomikë e financiarë. Ndaj dhe në vlerësim të punës së tij organizuese e drejtuese është dekoruar me Urdhrin “Për shërbim të mirë ndaj popullit”, me Dekret Nr.7044, datë 26.6.1986.

Talenti, zgjuarsia dhe fisnikëria e Dine Dodës

Talentin, zgjuarsinë dhe fisnikërinë e tij, Dine Doda i ka shfaqur edhe në jetën shoqërore. Në raste dasmash e gëzimesh të tjera familjare, por edhe në raste fatkeqësish të fisit e të miqve të shumtë, jo vetëm në Muhurr, por në gjithë Dibrën, ku ai do të merrte rolin e drejtuesit e të organizuesit, sipas zakoneve të vendit. Gjithnjë në koherencë me realitetin e atyre ngjarjeve do të evidentohet si njeriu që i zinte vend fjala dhe i kishte duk puna. Dhe jo vetëm kaq. Dine Doda, ishte mjeshtër i interpretimit të rapsodive popullore e i kërcimit të valleve tradicionale në festivalet zonale. Po i tillë do të shfaqej edhe në dasma e fejesa, duke ua shtuar atyre bukurinë e gjallërinë.

Siç shkruan Sami Doda në librin e tij: “Në kërkim të jetës” (faqe 90-91), Dine Doda ishte i pranishëm dhe i ftuar kudo në raste gëzimesh në fshat e në zonë, sepse i kishte lezet muhabeti, kënga dhe vallja. Ai dinte të përdorte me vend e



Shtator 1987. Ekipi i Degës së Tregtisë së Muhurrit: Nazif Dida, Halit Xhani, Fiqiri Lela, Setki Balla, Dine Doda, Halit Berisha, Xhemal Mziu

me kulturë alegorinë dibrane. Pasi i kënaqte të pranishmit me shaka e muhabet, kapte çiftelinë dhe këndonte si një rapsod i vërtetë këngë tradicionale të folklorit të zonës. Pastaj linte çiftelinë e hynte në valle duke ia shtuar bukurinë gëzimit familjar...”.

Këto veti të karakterit të tij, i trashëguan dhe i shfaqën mjeshtërisht edhe djemtë: më i madhi Fadili (që fatkeqësisht u nda para kohe nga jeta) mjeshtër i fjalës e i punës, por edhe rapsod; Petriti në fushën e biznesit që e ka ngritur me punë e përkushtim; Iljazi me djemtë me studion e tij audiovizive e si telekronist këtu në Tiranë; ushtarakët e talentuar Hamdiu e Shpëtimi, si dhe Atliu e Myslimi.

Edmond Zhulali dhe Hajri Mandri, këngë për Dine Dodën !


Djemtë e Dine Dodës, krenarë për babain e tyre që e deshi dhe e respektonte gjithë Dibra, për fjalën e urtë e të mençur në kuvende, oda, dasma e mexhelise dhe për zërin e tij brilant kur këndonte në festivale e dasma, do ta përjetësonin atë edhe nëpërmjet një kënge.

Veçanërisht Iljazi, që me djemtë e tij: Izmirin, Ilirjanin e Iglin ka krijuar edhe një studio të mirëfilltë diskografike, duke punuar si mjeshtër të kameras e montazhit, por edhe me talent të rrallë në këtë fushë e me shpirt krijues, e kërkonin këngën sa më të arrirë artistikisht. Kontaktuan disa autorë të njohur dhe pas konsultimesh nisën bashkëpunimin me Dr.Hajri Mandrin, i cili hulumtoi shumë për jetën dhe veprën e Dines, por frymëzimin (siç pohon ai vetë) e gjeti tek reportazhi i mësipërm me titullin “Dritëro Agolli në Parkun Dine Doda”.

E kështu, poeti i këngës H.Mandri shkroi këngën kushtuar Dine Asllan Dodës, vargjet e së cilës përcjellin jehonën e

valëve të Drinit të Zi që ishin frymëzim për zëbilbilin Dine Doda, kur ia thoshte bukur këngës në kullat me shumë poda, këngë kjo që u kompozua mjeshtërisht nga Edmond Zhulali - “Mjeshtër i Madh” dhe “Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut”. Në vargjet e kësaj kënge ndjehet gurgullima e burimeve, një simfoni tingujsh të përcjella nëpërmjet zërit brilant të artistit popullor Dine Doda, i cili sa që gjallë pati mahnitur spektatorët në festivalet folklorike dhe dasmorët në qindra e qindra dasma. Kësisoj, kompozitori i mirënjohur Edmond Zhulali dhe poeti Hajri Mandri, nëpërmjet kësaj kënge e legjendarizuan të pavdekshmin Dine Doda.

Berishët e Muhurrit, si rast unikal në historinë Skënderbegiane



Barleti, Franku, Sokoloski, Pall, Stort, Stojanovski dhe shumë të tjerë biografë dhe studiues vendas dhe të huaj të Skënderbeut, evidentojnë Berishët e Muhurrit të Dibrës, si një rast unikal në historinë skënderbegiane.

Madje Marin Barleti te "Histori e Skënderbeut" - (faqe: 314, 315,) shkruan se "Ndër fisnikët më të mirë të atij vendi (në Dibër,) ka qenë familja e lashtë e Berishëve. Dy vëllezërit, gjeneralë të Skënderbeut dhe, njëherësh, kryetrima të rinisë dibrane, Dhimitri dhe Nikolla, ndihmën e të cilëve Skënderbeu e kishte të dendur dhe të shënuar, kur dëgjuan për fatkeqësinë

e ushtrisë sonë dhe për përfundimin e rrethimit të Beratit, kur morën pastaj vesh për rebelimin dhe pabesinë e Moisiut, nuk u vonuan aspak, por vrapuan fluturimthi për tek roja dhe kryeporta e mbretërisë, të trembur se mos roja atje shpërndahej nga frika apo ngaqë s'kishte kush e frenonte dhe se mos vendi mbetej pa mbrojtës, sidomos kur vinin lajmet se Sebalia ndodhej, ende, në Epir. Dhe kështu Dhimitër dhe Nikollë Berisha me plot arsye, u kujdesuan, së pari, për të kërkuar ushtarë dhe, kështu, e rritën rojën, u dhanë zemër burrave me fjalë dhe me vepra, duke ua shtuar, me çdo mënyrë, dashurinë për Skënderbeun, si dhe duke shfaqur simpatinë e tyre për fatin e tij dhe urrejtjen për pabesinë e Moisiut ...".

Duke shkruar për këtë familje, (filloj: "Familja e Lashtë e Berishëve" sepse në gjithë librin voluminoz të tij për Skënderbeun, Barleti, çuditërisht, vetëm këtë familje, në ndryshim nga gjithë të tjerat, e specifikon kështu: "të lashtë") është e pamundur të mos përmendësh Kastriotët dhe Skënderbeun.

Kjo sepse, këto dy familje, u ngjizën në të njëjtën trevë të origjinës, në Masrekat e Dibrës së Poshtme, për të cilën kanë shkruar jo pak historianë vendas dhe të huaj. Edhe nga burimet arkivore, edhe nga ato gojore vërtetohet se këto dy familje qenë jo vetëm bashkëkohës dhe bashkëfshatarë, por, njëkohësisht, dhe bashkëluftëtare.

Qyshse Kastriotët u shfaqën për herë të parë në skenën luftarake të kohës, Berishët bëjnë krushqi me ta dhe që nga ajo kohë, familja e lashtë e Berishëve, do të mbetet në

historinë skënderbegiane si njëra nga familjet bashkëluftëtare më besnike e kauzës së Kastriotëve.

Masrekat dhe Gardhi, treva në të cilat, ekskluzivisht, identifikohet Muhurri

Të shkruash për Berishët, më së pari, do të thotë të shkruash për Masrekat, të Epërmet dhe të Poshtmet, si dhe për Gardhin e Poshtëm (të Dibrës së Poshtme), treva në të cilat, ekskluzivisht, identifikohet Muhurri, ky shtrat i rrallë shtrëngatë i origjinës së lashtë të Kastriotëve.

Të shkruash për Berishët e kohës së Kastriotëve do të thotë të hedhësh një dritë të re mbi qytezën e lashtë ilirike të Hurdhë-Muhurrit dhe Mazrekave të Epërme vend ku u ngjizen dhe u formuan në shekuj Kastriotët, të cilët i dhanë kombit shqiptar lavdinë dhe pavdekësinë. Të shkruash për Berishët e Skënderbeut do të thotë të farkëtosh dhe një të vërtetë më shumë se Gardhi i Poshtëm, (vendlindja e dy gjeneralëve të Skënderbeut, Dhimitër dhe Nikollë Berisha), ishte ashtu siç pohon Gjon Muzaka, njeri prej dy katundeve që pati në zotërim Pal Kastrioti, gjyshi i Skënderbeut.

Së fundi, të shkruash për Berishët e Skënderbeut do të thotë të shkruash për një rast unikal në historinë skënderbegiane që dëshmon shumë. Pra, kemi dy vëllezër, njëri më i zoti se tjetri, që të dy gjeneralë të Skënderbeut, luftëtarë të ekselencës, njerëz të elitës ushtarake skënderbegiane, nënkomandantë nga më të rreptët e Skënderbeut dhe, njëherësh, nga më të besuarit e tij,

personazhe historike të veprës së madhërishtme të Skënderbeut shkruar nga Barleti, vepër e përkthyer në shumë gjuhë evropiane dhe që qarkullon prej më shumë se 500 vitesh në gjithë botën.

Kur shkruhet dhe flitet për Berishët e kohës së Skënderbeut, s'do mend që flitet e shkruhet për Berishët e Muhurrit të Dibrës së Poshtme. Asnjë historian apo kronikan, asnjë burim arkival apo gojor nuk na bën të njohur ekzistencën e ndonjë fisi a familjeje tjetër "Berisha" në gjithë trevën autentike arbërishte të epokës së Kastriotëve.

Nëse ka sot familje Berishësh, gjithkund, në hapësirat etnike shqiptare, ato, dihet, kanë divergjuar përgjatë harkut kohor të këtyre pesë shekujve të fundit, pra, fill pas MOTTIT TË MADH nga e vetmja pikë: Familja e Lashtë e Berishëve të Masrekave dhe Gardhit të Poshtëm, përndryshe, nga Muhurri i sotëm i Dibrës së Poshtme, pikërisht, aty ku e kanë gjenezën, aty kanë dhe trojet e tyre të vjetra e të pakontestueshme Kastriotët tanë monumentalë.

Referuar këtyre kolosëve të historisë sonë kombëtare, por dhe në të dhëna arkivore e gojore, poeti, romancieri, përkthyesi dhe, njëherësh, kantautori muhurak Naim Berisha, autori i më shumë se 30 librave artistikë, (vetëm në këta 23 vitet e fundit), ka botuar së fundmi romanin e tij të gjashtë, të cilit i ka vënë titullin e bukur dhe kuptimplotë, "TË JETOSH NË PAQE". Ndryshe nga pesë të parët, ky i fundit i përket zhanrit historik.

Në këtë libër, ai trajton temën e qëndresës së popullit të arbërit në kohën e Skënderbeut. Duke glorifikuar familjen e

lashtë të Berishëve të Mazrekave në Gardh të Poshtëm, dmth, në Muhurrin e sotëm të Dibrës së Poshtme dhe të dy gjeneralëve të Skënderbeut, vëllezërve Dhimitër dhe Nikollë Berisha, djem të Gjergj Berishë Mazrekës dhe Majra Kastriotit) ai, në të njëjtën kohë, glorifikon gjithë qëndresën heroike të Arbërisë nën udhëheqjen e Skënderbeut kundër tiranisë së pashembullt turke.

Fryma polemizuese e autorit dhe besueshmëria në përshkrimin e personazheve

Duke vazhduar me vlerat e romanit, nuk mund të mos nënvizoj frymën polemizuese të autorit me ata që u përpoqën të anashkalojnë qëllimisht Muhurrin dhe Berishët, edhe pas mbledhjes së dëshmive të pleqve të urtë muhurrakë, Lam Mziu e Fali Rama. Ndërkohë që ka edhe të tjerë që ndonëse botuan libra rreth gjurmëve të kastriotëve në Sinë e Muhurr, megjithë kontributin studimor nuk arritën të orientohen nga figurat e kryetrimave Nikollë e Dhimitër Berisha, siç bëjnë H.Koltraka, S.Mziu e F.Daci.

Romani historik i N.Berishës bëhet më i besueshëm kur



iu referohet studjuesve të mirëfilltë të historisë së Muhurrit, Hilmi Sadikut e Ilvi Shehut, apo edhe Hysni Bruçit e Hysni Milloshit si promovues të vjershës së tij të parë dhe të studimit për Berishët e Muhurrit të botuar në revistën "10 korriku".

Një figurë interesante është dhe ajo e Liman Berishës, për bëmat e të cilit në betejat kundra turqve e serbëve, deri në kryengritjet e viteve '20-21 unë kam shkruar që para 30 vitesh reportazhin "Muhurri në breg të Drinit", botuar në gazetën "Ushtima e Maleve", dhe ku ndoshta për herë të parë sjell referenca nga Barleti e Noli për gjeneralët trima të Skënderbeut, Dhimitër e Nikollë Berisha

Tërheqës janë edhe profilet e Xhemalit, Osmanit e hallë Miles, që Gjorgu, hero i kryesor i librit, mjeshterisht i viziton, qoftë dhe vetem si inkurajues të krijimtarisë së tij. Po në këtë këndvështrim përfshihen në romanin historik "Të jetosh në paqe" dhe xhaxhallarë e autorit, Ramazani, Haliti e Lika si dhe kushërinjtë, Arbeni, Limani e Bardhyli, si pasardhës të denjë të Dhimitrit e Nikollës. Pikërisht edhe për hedhjen dritë rreth këtyre figurave e personaliteteve të shquara, ky roman i N.Berishës zë vend të veçantë në larminë e botimeve kombëtare.

"TË JETOSH NË PAQE" **një roman i zhanrit historik**

Duke u mbështetur në mendimet e konsulentëve dhe të recenzentëve, emrat e të cilëve janë të shkruar në faqen e parë të librit, kemi mbërritur në një akord se ky libër i veçantë

i Naimit, më shumë se një libër monografik për familjen a fisin, është një roman i zhanrit historik, sepse i gjithë libri është nën ndikimin e parimit artistik dhe estetik të historisë.

"Të jetosh në paqe" që i dedikohet familjes së lashtë, të vjetër dhe të re të Berishëve të Muhurrit dhe jo vetëm atyre, është një kontribut i ri si në thesarin e historiografisë skënderbegiane, ashtu dhe për letërsinë që i korrespondon asaj periode legjendare e të papërsëritshme.


Romani në fjalë që është fantazi me baza historike e të vërteta, të tërheq në linjat e veta dhe mbetet disi intrigues, duke ngallur interes dhe kureshtje. Si i tillë, ai lexohet me një frymë. Dhe ne besojmë se do lexohet kështu për shumë e shumë kohë, si brenda, edhe jashtë kufijve të atdheut dhe në bibliotekat personale të shqiptarëve.

Për shkrimtarin, poetin, përkthyesin, hajkistin, romancierin dhe kantautorin, bashkëfshatarin tim të dashur muhurrak, Naim Berisha, uroj nga zemra veç të mira në jetë dhe suksese të mëtejshme në krijimtarinë e tij të bukur artistike.

Fisi Bruçi i Lukanit të Dibrës

Një monografi shumëvlerëshe për historinë e fisit e të fshatit që pati dhjetra luftëtarë në luftën për çlirimin e Shkodrës

Në historinë e zhvillimeve epokale botërore dhe lokale, fiset e mëdha identifikohen me emrat e personaliteteve që ata kanë nxjerrë në kohëra e rrethana të ndryshme. Kështu



ka ndodhur edhe me fisin Bruçi të Lukanit të Dibrës, për historinë e lavdishme të të cilit është shkruar dhe botuar një monografi interesante nga studiuesi dhe sipërmarrësi i mirënjohur Faik Bruçi.

Nëse Muhurri, njëri nga Nandë Malet e Dibrës identifikohet me emrin e filozofit popullor Dine Hoxha, një nga

këshilltarët më të afërt të Mbretit Zog i I-rë, emër ky i përjetësuar në xhaminë e Rugës së Kavajës në Tiranë, (financuar prej tij në vitin 1930), Lukani i Katër Grykëve të Dibrës, i njohur për prijësit e mendimtarët Hoxhë Buci e Lam Tahiri (Bruçi), në kohët e sotme moderne identifikohet edhe me një emër mjaft të njohur në metropolin shqiptar. Ky është Faik Bruçi, ndër sipërmërrësit më të suksesshëm (pronar i "Capital Tirana Hotel" tek Pazari i ri i Tiranës, fare pranë selisë së Prokurorisë së Përgjithshme), promovues i vlerave atdhetare, historike dhe kombëtare.

Në këtë kontekst, treguesi më i qartë është botimi me autorësinë e tij i librit "Fisi Bruçi i Lukanit të Dibrës", (monografi) një botim special me 230 faqe.

Ky botim shkencor i Faik Bruçit dëshmon për arritjen e një niveli të lartë në artin e të shkruarit. Kjo për faktin se Faiku, ashtu si në çeshtje të sipërmarrjes, edhe në këtë libër dëshmon se din të përveçojë me inteligjencë, fakte dhe ngjarje, si pjesë substanciale e karakterit të personazheve, duke e bërë librin e tij me vlera njohëse, edukuese dhe estetike.

Pak nga vështrimi gjeografik e historik i Lukanit me histori të lavdishme

Në morinë e detajeve dhe fakteve interesante nga historia e vendlindjes së tij, F. Bruçi e bën ndalesën e parë tek vështrimi gjeografik e historik i Lukanit me histori të lavdishme.

Kështu, nëse përcakton saktë pozicionin gjeografik të fshatit në zemër të maleve që kufizohet: në veri me Lurën,

në lindje me Muhurrin, në jug me Selishtën dhe Kacninë, në Perëndim me Qafë Murrën, (ndërsa ka si mburojë Runjën hijerëndë e kreshnike, 2048 metra mbi nivelin e detit), po aq bindës është edhe në vështrimin etimologjik për emërtimin e fshatit Lukan, që vjen nga fjala "lug" - luginë, dhe që në gjuhën dibrane shqiptohet "luk". Pra, nga fjala "luk" erdhi emri i fshatit Lukan. Për këtë autori i kësaj monografie i referohet periudhës historike të shekullit XV. Por kjo sipas tij nuk do të thotë se Lukani nuk ka prejardhje më të herëshme, siç kanë shkruar dhe lënë dorëshkrime historianët Hysen Lala e Bajram Totraku.

Parë nga ky këndvështrim, Faik Bruçi argumenton se edhe në aspektin ushtarak Lukani është katundi më strategjik i Katër Grykëve - një nga Nandë Malet e Dibrës që luftoi dhe nuk u mposht në lufta me pushtuesit turq, serbë, austriakë etj (Mal në Dibër dhe bajrak në Mat).

Në këtë mori faktesh, meritë e autorit është përshkrimi në pak rreshta i prejardhjes së herëshme të fisit BRUÇI, nga Dardania-Kosova e sotme.

"Kjo prejardhje është treguar gojariisht brez pas brezi deri në ditët e sotme. Përmes faktesh bindëse për ekzistencën prej 250 vjetësh të fisit Bruçi në Lukan të Katër Grykëve të Dibrës, Faik Bruçi ndër të tjera shkruan se: "Burime të herëshme gojore tregojnë se fisi Bruçi ka ardhur nga Kosova, është vendosur në Shkodër, nga Shkodra në Domgjon e Fan të Mirditës. Stacioni i parafundit ka qenë Fushë Lura". (fq.14).

Kuvendi i kullave

Mjaft bukur shkruan autori i kësaj monografie për institucionin e kuvendit të kullave. Në Lukan nuk ka shtëpi, por kulla. Çdo shtëpi është një kullë, është një kala trimërie që ka brenda saj burra të mençur dhe trima të vendosur. Në këto kulla të bekuara nga Zoti dhe të uruara nga Dede Bruçi, Hoxhë Bushi, Hoxhë Buci e Dede Ndregjoni kanë lindur, janë rritur e burrëruar qindra e mijëra djem petrita. (Djemtë dhe vajzat e tyre gjenden sot në disa vende të Europës, Amerikës, Kanadasë e Australisë, si sipërmarrës, mjekë e artistë me emër).

"Në muret e këtyre kullave u varën qindra armë miqsh e trimash, bujtës nga Katër Grykët, Muhurri, Luznia, Lura, Dibra e Madhe, Mati, Kruja etj. Nga krismat e pushkëve të këtyre kullave u bekuan qindra dasma dhe lindje djemsh. Njerëzit ndër vite u dhanë jetë kullave dhe kullat ndër vite mbrojtën njerëzit. Në kullat e Katër Grykëve bujtën Abdyl Frashëri, Iljaz Pashë Dibra dhe udhëheqësit e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Këtu mori jetë jeta jonë, rruga jonë", - shkruan F.Bruçi në monografinë "FISI BRUÇI I LUKANIT".

Në këtë libër, faqe pas faqeje hidhet dritë mbi luftimet e trimave të Lukanit e të krejt Katër Grykëve në betejat kundër turqve e serbëve, ndërkohë që mjaftë bukur autori e përshkruan Lukanin si strehë të njerëzve të shpërngulur nga raprezaljet serbe. Kësisoj karakteret humanë shfaqen si shëmbëlltyra të përzgjedhura nga dora e një studjuesi të

zellshëm dhe me talent, duke të bërë për vete me stilin e të shkruarit.

Dhe ajo që e bën të veçantë librin "FISI BRUÇI I LUKANIT", në raport me disa botime tjera në formë monografie apo enciklopedie për fshatra tjerë të Dibrës, është fakti se ai rrok brenda tij një periudhë të gjatë, gati një shekullorë, duke derdhur dashuri dhe mirënjohje për personazhe dominantë të historisë sonë kombëtare. Kështu ai sjell për lexuesin profilin e Bajram Bucit, i njohur ndryshe si Hoxhë Buci, i cili si njeri i zgjuar, i arsimuar dhe atdhetar ishte i pranishëm në të gjitha ngjarjet e mëdha historike që kaloi vendi ynë në vitet 1860-1913, veçanërisht si përfaqësues i Lukanit në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit më 10 qershor 1878.

"Veprimtaria e Hoxhë Bucit është shumë e gjerë. Për të kanë shkruar historianët Kristo Frashëri, Kristaq Prifti, Selami Pulaha, Stefanaq Pollo, Bajram Xhafa etj. Për veprimtarinë e tij, përveçse në Arkivin Qëndror të Shtetit Shqiptar ka të dhëna e dokumenta edhe në arkivat e Turqisë, Austrisë etj",-nënvizon autori F.Bruçi në këtë monografi kushtuar fisit të tij emërndritur në historinë tonë kombëtare.

Një tjetër personazh interesant i këtij libri është Islam Tahiri (Bruçi), simbol i zgjuarsisë dhe trimërisë dibrane. Duke e profilizuar si një njeri bashkëkohor, autori shkruan se: "Lami njihet si njeri i kohës, i muhabetit, me zgjuarsi natyrale dhe i zoti. Jetoj në periudhën e sundimit otoman, kohën e pushtimit serb, Luftën e Parë dhe të Dytë Botërore, në periudhën e regjimit komunist, dhe kurdoherë diti të

orientohej drejt dhe të mbijetonte". Më tej autori i kësaj monografie shkruan për Tofik Xhafer Bruçin që ishte lezeti i odës së burrave, i odës dibrane por dhe arkitekt i unitetit të fshatit, si dhe për Bajram Totrakun që ia ngiti lart emrin Lukanit dhe Katër Grykëve të Dibrës.

Lavdi burrave të Lukanit që luftuan për çlirimin e Shkodrës

Një shembull frymëzues atdhedashurie janë 14 burrat e Lukanit, nga të cilët katër të fisit Bruçi, që shkruan faqe heroizmi në luftën legjendare për çlirimin e Shkodrës.

Gjatë rrethimit që iu bë nga 28 tetori 1912 deri më 23 prill 1913, në kuadrin e Luftës së Parë Ballkanike, prej forcave aleate të Malit të Zi dhe Serbisë kundër forcave të Perandorisë Osmane, Shkodra qëndroi e pamposhtur, falë edhe mbështetjes prej forcave rezerviste dibrane.

Studiuesi F.Bruçi, referuar dokumentave arkivore shkruan në këtë monografi se në luftën për çlirimin e Shkodrës, ndër 17 batalionet rezerviste të rezistencës, njëri ishte Batalioni i Dibrës. "Udhëheqësit kryesorë të forcave vullnetare të Katër Grykëve kanë qenë Hoxhë Buci dhe Smajl Nika. Lufta zgjati 6 muaj. Në këto luftime dhanë jetën 114 dibranë, midis tyre edhe disa luftëtarë nga Lukani dhe Katër Grykët", shkruan F.Bruçi në këtë monografi (fq.38). Madje sipas tij, Smajl Nika prej Qafë Murre, shpëtoi përveç flamurit (bajrakut) të Katër Grykëve edhe bajrakun e Lurës dhe të Matit. Gjithashtu në respekt të kontributit të të parëve të

fisit e fshatit të tij të lindjes, ai rendit emrat e disa burrave të Lukanit që luftuan për çlirimin e Shkodrës, si: Hoxhë Buci; Islam Tahir Bruçi, Shaban Ali Bruçi; Xhafer Can Bruçi, Shaban Xhafer Dervishi; Ali Lik Dervishi; Selman Dervishi; Mustafa Buci; Sali Totraku; Llan Koka; Ibrahim Ndregjoni, Destan Ndregjoni, Zeqir Ndreka etj.

Pjesë e kësaj monografie shumëvlerëshe është edhe kontributi i Dine Hoxhës e Llan Destan Ndregjonit në mobilizimin e trimave të Lukanit përballë qëllimeve shoviniste të Serbisë, si dhe mbështetja që Katërgrykasit i dhanë qeverisë së Arrasit më 1920. Këtë monografi e bëjnë tërheqëse kapitujt "Njerëz të thjeshtë që ja kushtuan jetën Lukanit", "Nderim dhe respekt për luftëtarët dhe veteranët e Luftës së Dytë Botërore", "Fisi Bruçi, fis me tradita të shquara bujarie", sidhe artikujt: "Lukani, fshat arsimdashës"; "Përkrahës të kulturës dhe qytetërimit", "Intelektualët e rinj", "Plejadë burrash që siguruan mbijetesën e fshatit", dhe "Bijtë e Lukanit, biznesnenë të fuqishëm në shkallë vendi".

Brenda faqeve të kësaj monografie gjen plot emra të spikatur të fisit Bruçi e të gjithë fshatit Lukan të Dibrës që qëndrojnë me dinjitet në panteonin e vlerave.

Faik Bruçi, "Mjeshtër i Madh" dhe "Nderi i Qarku Dibër"

Autori i kësaj monografie, Faik Bruçi është dekoruar nga Presidenti i Republikës me titullin e lartë "Mjeshtër i Madh" me motivacionin "Në vlerësim të kontributit të çmuar në



ndërtimin e veprave hidroteknike në mbarë vendin. I dalluar si humanist dhe kontribues në dobi të bashkësisë dhe promovues i vlerave atdhetare, historike dhe kombëtare."

(Dekret Nr.11272, datë 12.09.2019).

Po ashtu, Këshilli i Qarkut Dibër, me vendim Nr.5, datë 13 mars 2018, e ka nderuar Faik Bruçin me titullin më të lartë "Nderi i



Qarkut Dibër", me motivacionin: "Në vlerësim të veprimtarisë së tij, për mbështetjen financiare, në ruajtjen dhe promovimin e vlerave për historinë, artin, sportin dhe kulturën dibrane".

Këto tituj të lartë nderi janë vlerësim i kontributit të tij të dukshëm si një nga sipërmarrësit shqiptarë më të suksesshëm. Për shumë vite ai ka themeluar dhe drejtuar Kompaninë "Bruçi" shpk, Kompaninë "Jon 2002" si dhe ka qenë aksioner i rëndësishëm dhe i suksesshëm në "Bankën Popullore", Kompaninë e Sigurimeve "Albsig", Hidrocentralin e Gjançit, Korçë dhe njëkohësisht sot është pronar i vetëm i "Capital Tirana Hotel". Biznesi dhe aktiviteti i tij çdo vit ka njohur vetëm ngritje dhe suksese. Për këtë, kompanisë që ai drejton dhe personalitetit të tij angazhues, me aftësi të mira menaxhuese, i janë akorduar tituj dhe simbole vlerësuese nga institucione brenda dhe jashtë vendit tonë.

Fluturon shqipja mbi Korab

*Kompozitori Edmond Zhulali bashkon zërat dibranë:
Kapexhiu, Methasani e Ismail Keta
në këngën himn "Kjo është Dibra maja-maja",
së bashku me zërat e këngëtarëve
Altin Sulku, Muharem Borova dhe Lundrim Paçuku*



Televizioni News 24 prezantoi në javën e parë të marsit 2020 (kur sapo kishte filluar pranvera pandemike Covid-19) një kompozim në një mënyrë ndryshe të këngës "Fluturon Shqipja mbi Korab", të kompozitorit Edmond Zhulali -

"Mjeshtër i Madh" dhe "Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut". Vetë Zhulali pohoi se ideja për risjelljen e këngës në këtë formë, ishte e gazetarit Dëfrim Methasani, ndërsa të gjithë personalitetet që këndojnë janë nga Dibra.

Ikona e gazetarisë sportive, Dëfrim Methasani që ka bashkuar zërin me interpretuesin virtuoz të kësaj kënge, Dritan Jashari në sa e sa promovime, si dhe kur ka moderuar takime kombëtare edhe me praninë e personaliteteve politike e shtetërore, pasi e kishte "bluar" për muaj të tërë në mendjen e tij, ia propozoi këtë variant Zhulalit, dhe ai nuk nguroi të hedhë në notat e pentagramit një rikompozim të tillë.

Bashkëpunimi që i frytshëm. Kënga himn që ka ngritur peshë zemrat e artdashësve, jo vetëm në sallën e pallatit të Kongreseve në Tiranë, por edhe në dhjetëra takime të diasporës në hapësirën mbarëshqiptare në botë, tashmë përcillet fuqishëm edhe në YouTube, e risjellë në një mënyrë ndryshe me artistë dhe personalitete të Dibrës, në këtë kohë pandemie. Zërit të Defrimit, të demonstruar në sa e sa transmetime ndeshjesh, në dokumentarë e spektakle televizive, i bashkohet ai i një tjetër ikone të artit skenik: Bujar Kapexhiu!

Bujar Kapexhiu - "Nderi i Kombit", unik, i veçantë, i rrallë në çdo krijimtari të tij, ku ka tërhequr vëmendjen e shumë artdashësve e të shkrimtarëve me mënyrën e veçantë të interpretimit e të të rrëfyerit, duke qenë një nga pasuritë më të mëdha në rrafshin e ligjërimit, jo vetëm kombëtar, por ndoshta edhe europian, këtë radhë, në moshën 75 vjeçare, por me një vitalitet të rrallë, prezanton edhe zërin e tij

melodios në këtë këngë kushtrimi.

Pas tij, një tjetër zë i njohur, ai i kampionit të botës në kikboks, Ismail Keta, një rast i rrallë, ndoshta unikal në historinë e sportit. U rrit me lavdinë e kombit, tani kombi lartësohet me lavdinë e tij. Ai ka një histori interesante edukimi dhe rritjeje. Karshi fshatit Koçaj, vendlindja e tij, vendi i luftërave legjendare të Skënderbeut, do të ishte modeli mendor udhëheqës në koshiençën e kampionit të botës. Në galeritë e kromit, në shpat të malit do të shfaqej imazhi epiko-heroik i minatorëve, karvani i të cilëve ngjitej në kollonat e puseve për të zbritur në nëntokë me kilometra, në kërkim për të nxjerrë nga barku i malit, kromin e florinjte, duke të ngjarë si heronj legjendash. Ky mjedis që bashkon legjendën me të vërtetën, do të farkëtojë tek Ismail Keta virtyte të mëdha. Gjithkush është ndërë krenarë tek e ka parë atë t'i demonstrojë këto virtyte në arenën e ndeshjeve, por edhe në intervista brilante nëpër televizione të vendit e të botës dhe në takime me presidentë, kryeministra e kryebashkiakë të Mynihut, Tiranës, Dibrës e Bulqizës. Dhe ja, tani na shfaqet edhe si këngëtar, i thjeshtë gjer në madhështi, mbresëlënës për qindramijëra shikues e teleshikues, falë bukurisë fizike e shpirtërore, por dhe aftësive komunikuese me publikun, njësoj si përballë rivalëve shumë të fortë nga vende të ndryshme të botës, kur e kanë bërë edhe Mynihun të flasë shqip.

Të tre të përzgjedhurit e kompozitorit Zhulali: Methasani, Kapexhiu e Ismail Keta, në akordancë të plotë me këngëtarët profesionistë Dritan Jashari, Altin Sulku, Lundrim Paçuku

e Muharem Borova. Kësisoj, libohoviti Edmond Zhulali, të cilin e lidhin shumë gjëra me Dibrën, këtë rikompozim të këngës "Fluturon shqipja mbi Korab" (që siç pohon vetë është ndër më të dashurat e tij), e bëri me shumë pasion.

"Audio e çdo interpretuesi është bërë në shtëpi me celular dhe editimi i zërit ishte shumë i vështirë, por më dha shumë kënaqësi. Teksa shikoja Bujar Kapexhiun të këndonte me shumë pasion, më dha një ndjesi shumë të bukur. Edhe Ismail Keta kishte një pasion të jashtëzakonshëm, që tregon se nuk është thjesht një sportist kampion bote, por edhe një patriot i madh", shprehet kompozitori Zhulali. Sipas tij, realizimi i klipit ishte pak i vështirë, pasi audiot janë regjistruar nga shtëpia e secilit artist me celular. Një punë për tu lavderuar është montimi në studio "Igli", e cila i ka dhënë shumë emocion, jetë dhe larmi këngës. Idesë sime dhe Tanit iu përgjigjen me dashamirësi të gjithë. Një grupi artistësh si Lundrim Paçuku, Altin Sulku dhe Remi Borova, iu bashkuan këtij interpretimi.

Teksti i këngës është shkruar nga i paharruari Naim Plaku, të cilin kritika letrare, si poet të këngës, e radhit përkrah Gjokë Becit e Lefter Çipës. Kjo edhe për faktin se tekstet e Naim Plakut janë lënda e parë e standardit më të lartë për këngëtarët e mirënjohur Arif Vladi, Shkurte Fejza, Haxhi Maqellara, Skënder Cala, Liri Rasha, Qerim Sula, Ilir Shaqiri, Selami Kolonja, Caje Poleshi, Sherif Dervishi, Vera Laçi, Dritan Jashari etj. Mjafton të kujtojmë se si janë ngritur peshë zemrat e mijëra artdashësve, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në skenat e botës, kur kanë përjetuar zërin melodioz në interpretimin e teksteve të këngëve të N. Plakut: "O prite Azem Galicën",

"Një gërsшет u la me gjak", "Na kjojnë pushkët nëpër kulla", "O i madhi Skënderbe", "Përcolla ylberin", "Mine mori Mine", "Tinguj krenarie", "Fluturon shqipja mbi korab", etj. Refreni i kësaj të fundit: "Sillu shqipe nga kalaja/Kjo është Dibra maja-maja/Dibra pushkën e ka zanat/Për Shqipërie për bajrak..." të ngjall emocione të forta e të bën për vete në çdo çast. Është një këngë që të ngjall shumë dashuri dhe krenari, me të cilën nismëtari Methasani, si dhe kompozitori i shquar Zhulali synojnë të promovojnë Dibrën, historinë dhe vlerat e saj. Ata, si dhe Kapexhiu - "Mjeshtër i Madh" dhe "Nderi i Kombit", skenarist, regjisor, aktor e prezantues, dhe Ismail Keta, karriera e të cilit përmban ndershmëri e realizëm pa asnjë manipulim e përgënjeshttrim, me këtë këngë përcjellin mesazhin e dashurisë për atdheun.

"Fluturo shqipe mbi Korab", është një këngë që sjell diamante të vërteta nga folklori i zonës së Dibrës. Kjo këngë e interpretuar më parë me virtuozytet nga Dritan Jashari ka ngritur peshë zemrat e mijëra spektatorëve në koncertet recital të tij në Peshkopi, Tiranë, Dibrë të Madhe, Selanik, Austri, Gjermani, Belgjikë, Itali etj.

Gjatë prezantimit të klipit të ri të kësaj kënge nëpërmjet një interviste me gazetaren Ola Bruka të Tv News 24, Edmond Zhulali i dërgoi dhe një mesazh të fortë gjithë politikës shqiptare, teksa i kërkoi të kthejë vëmendjen nga artistët, pasi janë pikërisht këta të fundit që bëjnë krenar vendin dhe popullin. Artistët e vërtetë mbeten në memorjen e kombit, ndërsa politikanët kujtohen vetëm në konferenca apo mbledhje partish.

Historia e një spektakli kushtuar Hazis Ndreut, ikonë e artit dhe kulturës kombëtare

DRITËRO AGOLLI:

"Hazis Ndreu, miku im, mjeshtër i humorit dibran. Sot e kësaj dite si ai nuk gjen më. I papërsëritshëm, i papërtuar, modest dhe shpirtmirë"

MOIKOM ZEQQO:

"Hazisi është unik. I veçantë, i rrallë në çdo krijimtari të tij, ku ka tërhequr vëmendjen e shumë shkrimtarëve me mënyrën e veçantë të rrëfyerit, duke qenë një nga pasuritë më të mëdha në rrafshin e ligjëritimit, jo vetëm kombëtar, por ndoshta edhe europian"

AGRON TUFA:

"Hazis Ndreu ishte 'magu', i cili me prekje të tij magjike e ngre peshë zemrën e çdo dibrani, pasi arti i tij i flet atij për gjërat më të vryera të pajës më të vyer shpirtërore... Thjesht, Hazis Ndreu arriti shumë shpejt ta ngrejë në nivele kombëtare e ndërkombëtare emrin e artit dhe mençurisë së Dibrës. Ne kemi pasur fatin që jemi përfaqësuar si kulturë përmes një artisti si ai"



Pesëmbëdhjetë vjet më parë, u realizua një spektakël madhështor në përkujtim të "Artistit të Merituar" Hazis Ndreu - "Mjeshtër i Madh" dhe "Nderi i Kombit". Skenarist, regjisor dhe prezantues, prof. Bujar Kapexhiu - "Mjeshtër i Madh" dhe "Nderi i Kombit". Një spektakël për një artist dhe njeri të madh, ku interpretuan artistë dhe mjeshtër të mëdhenj të botës së artit, kulturës e shkencës. Në formë gjysmëharku, në skenën e sallës së madhe të ish-SHQPUP-it,

me sfond portretin e madh të Hazisit, qenë ulur të gjithë pjesëmarrësit e spektaklit.

Artistët, aktorët, këngëtarët, valltarët të radhitur në krah të njëri-tjetrit. Përballë, spektatorët, ashtu siç ulen në formë harku, në shiltetë e Odës Dibrane. Skena me artistët dhe salla me spektatorët, tamam një Odë Dibrane gjigante, e mbushur plot e përplot.... Një kompozim perfekt i një spektakli mesazh, produkt i "Artistit të Merituar" Bujar Kapexhiu, që jo vetëm në aktrim e karikaturë, por edhe si skenarist e moderator, mbetet një Mjeshtër i Madh. Për të arritur deri te ky spektakël iu deshën muaj të tërë parapërgatitje... Dhjetëra takime me studiuesit e Institutit të Folklorit, prof.dr. Ramazan Bogdani, Agron Xhagollin, Skënder Sallakun, Skënder Calën, Inajet Shehun etj. Të gjitha takimet të monitoruara besnikërisht nga Avniu, djali i madh artist, i Hazisit, sipas të cilit: "Baba interesohej për të gjithë, të njohur e të panjohur, që ishin në hall apo që kishin ndonjë problem me zyrtarët. Interesohej për ata që hynin në burg, që i pushonin nga puna, për ata që s'kishin triskë fronti, për të futur dikë në shkollë, për vizitë te ndonjë mjek i zoti.... Ishte me një fjalë, derë e hapur për popullin, njoft e panjoft... e dinin që Hazisi të mbaron punë se është i njohur dhe e duan të gjithë... deri në Tiranë... te qeveria".

Pjesë e skenarit të spektaklit, ishte edhe studiuesi i mirënjohur Moikom Zeqo, i cili rrëfen se i ka bërë përshtypje të veçantë studimi i Hazis Ndreut për Skënderbeun, nëpërmjet toponimeve, legjendave dhe përgjithësisht studimit të terrenit... Me hulumtimin e të gjitha toponimeve

që lidhen me Skënderbeun. Sipas tij, "Studimi i Hazis Ndreut në këtë pikë është diçka e re, është diçka serioze...". Më pas, një tjetër artist i njohur dibran, Dervish Biba, ka zgjedhur të recitojë rapsodinë e Hazis Ndreut, "Dibrës sime". Para recitimit, ai shprehet se ka qenë fare i ri kur ka dëgjuar dhe është mrekulluar me këngët, rapsoditë e kërcimet e tij. Hazisi, si kërcimtar, në shumë festivale kombëtare e ndërkombëtare, qe fitues i shumë çmimeve, sidomos në vallen dyshe dibrane me kërcimtarin e mirënjohur Besim Zekthi. Vlerat e tij si koreograf e valltar i evidentoi më së miri prof.dr.Ramazan Bogdani. Studiuesi Agron Xhagolli, veç të tjerash, flet për Odën Dibrane si institucion dhe për burrin e saj, Hazis Ndreu.

"Një universitet që ua kalon shumë universiteteve me emër, për nga forca e riprodhimit të ngjarjeve, interpretimit, për nga mençuria dhe ironia e hollë, aspak fyese për mikun, por shumë favorizuese edhe për t'u formuar në të...". Këtë e pohon artistikisht edhe "Artisti i Popullit" Reshat Arbana, me fjalë, por edhe me interpretimin e poezisë së Hazisit, të titulluar "Pajtimi". Më pas, "Artisti i Popullit", Skënder Sallaku, pohon meritën e padiskutueshme të Hazis Ndreut, i cili duke eksploruar në rrënojat e lashtësisë, si një historian i mirëfilltë, e futi Historinë e Dibrës në shina të sigurta për të ecur me dinjitet në fushën e madhe të Historisë sonë Kombëtare.

"Kemi qenë shumë miq të afërt me Hazis Ndreun. Një artist i rrallë, por mbi të gjitha një shok e mik i rrallë. I qeshur, fisnik, i mençur, muhabetçi, korrekt, punëtor, i papërtuar, talent. I shoqnisë, por jo i rakisë!". Pikërisht këtu "ndalon"

Skënderi për të interpretuar më pas dy barsoleta, një tiranase dhe një dibrane (nga krijimtaria e Hazisit). Kështu vijoi spektakli, me interpretime të krijimtarisë së Hazis Ndreut nga Veli Rada, Luftar Paja, Behar Mera, Skënder Cala, Llesh Nikolla si dhe nga këngëtarët Arif Vladi, Lirie Rasha, Qerim Sula, Vera Laçi, Saje Poleshi...

Një festë për njeriun. Nderohet Hazis Ndreu në 80-vjetorin e ditëlindjes së tij, me një spektakël madhështor të ideuar, inskenuar e realizuar nga prof.dr.Bujar Kapexhiu, emri i të cilit, (edhe si kryetar i shoqatës "Bashkësia Dibrane") spikat më së miri, sidomos në tubime intelektualësh dibranë, përvjetorë ngjarjesh e individësh të shquar apo dhe në promovime librash të autorëve dibranë, ku ky korife i mendimit dhe veprimt krijues po i lartëson kaq shumë, Dibrën dhe dibranët.

Burri i Odës Dibrane

Pesëmbëdhjetë vjet më vonë, pikërisht në 90-vjetorin e ditëlindjes së tij, lexuesi ka në dorë profilin e "Burrit të Odës Dibrane" në një libër shumëvlerësh, të stilit dhe llojit të veçantë. Autor, Bujar Kapexhiu - "Mjeshtër i Madh" dhe "Nderi i Kombit", regjisor, skenarist dhe aktor i mirënjohur shqiptar. "Historia e një spektakli", pas qindra karikaturave të botuara në shtypin e përditshëm që janë përmbledhur në tre libra "Ngërç", "Për një karrige" dhe "Kthesë", është libri i B.Kapexhiut, ku "Burri i Odës Dibrane", përveçse si profil i skalitur mjeshtërisht, të bën për vete edhe me karikaturat

tejet miqësore për Hazis Ndreun e miqtë e tij të shumtë.

"Historia e një spektakli" është një realizim origjinal, në formën e një udhëtimi në vite me krijimtarinë e të madhit Hazis Ndreu, ku gjithçka është e dokumentuar në librat e tij me këngë e rapsodi, tregime alegorike e studime të mirëfillta historike. Gjithçka është e ilustruar me tregimet fantastike të këtij krijuesi e mendimtari të shquar. Gjithçka është e komentuar nga personazhe reale, biografia e të cilëve është historia e vërtetë e vendit tonë. Në tërësinë e tij, libri sjell Odën Dibrane, që në gjuhën popullore përfaqëson dhomën e pritjes së mikut. Kjo odë, si pjesa më e veçantë e vatrës ku jeton familja dibrane, është një solemnitet dhe nderim i kujdesshëm për mysafirin, mikun e shtëpisë, ku do gjesh aromën e freskët të mikpritjes, minderet e pastra, qilimët shumëngjyrësh, perdet e mëndafshita, sendet e simbolet më të mira, duke krijuar atë mjedis të ngrohtë ku kuvendohet me mikun. Është traditë dhe vlerë popullore.

E përkufizuar në mënyrë sinjifikative nga Bujar Kapexhiu, "Ajo është simbol i vatrës bujare, besa e burrit, qëndresa e trimit, mençuria e fjalës, kënaqësia e muhabetit, sheshi i përplasjes së opinioneve, urtësia e më të moshuarve, këshilla e prindit, përkrahja e mikut, shpërthimi i këngës, sheshi i kërcimit, jehona e të qeshurit, kuadrati i lodrave, dashuria e respekti midis njerëzve, zanafilla e ngjarjeve, fundi i armiqësive, tempull për pleqtë, shkollë për të rinjtë, çerdhe e patriotizmit, burim i humorit. Oda është grumbullim njerëzish, miq, të afërm, farefis, komshinj, për arsye gëzimi,

sebeq hidhërimi, mikpritjeje të të ftuarve apo udhëtarëve nga larg. Këtu lindi dhe u rrit Hazis Ndreu...".

Autori vjen në këtë përfundim, pasi ka evidentuar vlerësimet e dhjetëra personaliteteve të letrave, artit, kulturës e shkencës për figurën dhe personalitetin e Hazis Ndreut, të cilat i ka përfshirë si kapitull më vete në librin "Burri i Odës Dibrane".

Mjaftojnë qoftë dhe vetëm disa perifrashime nga Dritëro Agolli, Kol Jakova, Moikom Zeqo, Agron Tufa, Tonin Çobani, Xhezair Abazi, Lutfi Turkeshi, Vasil Tole, Përparim Tomçini, Afërdita Onuzi, etj, për të konkluduar për një libër të bukur e për më tepër, shumë origjinal. Gjer më sot nuk është botuar një libër i tillë, me humor, studime, dialogë, anekdota e të gjitha këto të ilustruara me karikatura.

Një libër që nxjerr në pah madhësinë e këtij artisti të rrallë, origjinal, duke e përqendruar këndvështrimin në zhanrin e humorit.

"Disertacion" me vlera shkencore

Dhe kur gjatë gjithë leximit të këtij libri, je munduar të evidentosh esencien në profilizimin e Mjeshtrit të Madh, Hazis Ndreu, për të shkruar qoftë edhe pak radhë për të, në ndihmë të vjen vetë autori, me kapitullin përmbyllës, "Kanë thënë për Hazis Ndreun", në faqet 386-393. Dhe nëse për Dritëro Agollin, "Si Hazis Ndreu, mjeshtër i humorit dibrane, sot e kësaj dite, si ai nuk gjen më, i papërsëritshëm, i papërtuar, modest dhe shpirtmirë", për Moikom Zeqon

"Hazisi është unik. I veçantë, i rrallë në çdo krijimtari të tij, ku ka tërhequr vëmendjen e shumë shkrimtarëve me mënyrën e veçantë të të rrëfyerit, duke qenë një nga pasuritë më të mëdha në rrafshin e ligjërit, jo vetëm kombëtar, por ndoshta edhe europian".

Shkrimtari i mirënjohur Agron Tufa vlerëson se: "Hazis Ndreu ishte 'magu', i cili me preken e tij magjike e ngre peshë zemrën e çdo dibrani, pasi arti i tij i flet atij për gjërat më të vyera të pajës më të vyer shpirtërore...Thjesht, Hazis Ndreu arriti shumë shpejt ta ngrejë në nivele kombëtare e ndërkombëtare emrin e artit dhe mençurisë së Dibrës. Ne kemi pasur fatin që jemi përfaqësuar si kulturë përmes një artisti si ai".

Me botimet e tij, "Dibra në udhën e historisë", "Kastriotët dhe Skënderbeu në trojet arbërore", "Ushtima e Maleve", "Dibra dhe etnokultura e saj", "Alegori dibrane" etj., Hazis Ndreu ka hyrë me dinjitet në fondin e artë të letërsisë shqipe.

Le ta kujtojmë, nderojmë e respektojmë si të tillë Hazis Ndreun, si simbolin e Odës Dibrane, gati-gati si një institucion lëvizës ndërshekullor i traditës, të cilin, shumëformësia e qasjes, ribërja letrare e evenimenteve historike, aftësia vrojtuese, kultura e begatë e shkathtësia përpunuese e lëndës së trevës së vendlindjes, me gjithë gamën përjetuese, e bëjnë të kapërcejë nga Dibra në vizionin e botës shqiptare në përgjithësi.

Në këtë këndvështrim, libri i Bujar Kapexhiut, "Burri i Odës Dibrane", është një ikonë dibrane plot vlera, është "disertacion" me vlera shkencore.

Bujar Kapexhiu dhe Ansambli Artistik "Hazis Ndreu" - "Nderi i Kombit"



Vlerat dhe madhështia e një personaliteti publik konsistojnë para së gjithash në marrëdhëniet me njerëz të moshave e profesionave të ndryshme, nga më të vegjlit e deri tek më të moshuarit. Tek respekti dhe admirimi i tyre. Më së miri këto mishërohen në veprimtarinë e artistit të mirënjohur Bujar Kapexhiu, "Nderi i Kombit". E kemi parë

aktorin e shumë roleve në disa filma shqiptar, edhe si regjisor, edhe si moderator spektaklesh, edhe si skenarist, karikaturist, edhe në juri të ndryshme festivalesh dhe emisionesh radiotelevizive, por edhe si basketbollist në rininë e tij të herëshme. Të gjithë e njohin këtë personazh shumëdimensional. Por ajo që e dallon nga të tjerët është karakteri shumë popullor i Bujar Kapexhiut. Nëse në jurinë e spektaklit "Në kurthin e Piter Pan" të Tv Klan, Kapexhiu jep verdiktin e tij për fëmijën më të talentuar, këtë nuk nguron ta bëjë edhe për një shfaqje festive të Ansambllit Artistik të Kamzës, të pagëzuar me emrin e "Artistit të Merituar" Hazis Ndreu - "Mjeshtër i Madh", "Nder i Kombit", i cili nderohet e kujtohet si ikonë e artit dhe kulturës kombëtare.

Në nderim të kujtimit për mikun e tij të hershëm, i cili për dekada të tëra ka mrekulluar artdashësit tanë e ata të huaj (në festivalet ndërkombëtare në Moskë, Kajro, Stamboll e Prishtinë) me këngët, rapsoditë e kërcimet e tij, Prof. dr. Bujar Kapexhiu ka forcuar miqësinë me ata që po trashëgojnë vlerat e një artisti e shkrimtari që e futi historinë e Dibrës në shina të sigurta për të ecur me dinjitet në fushën e madhe të historisë sonë kombëtare. Ndaj nuk është rastësi që në përgatitjet dhe konkurimet brenda e jashtë vendit të ansambllit "Hazis Ndreu", të themeluar e drejtuar nga i biri i tij, koreografi i talentuar Avni Ndreu dhe mbesa, Earta Ndreu, të jetë i pranishëm edhe Bujar Kapexhiu. Autori i librit "Burri i odës dibrane", njëherësh skenarist dhe regjisor i spektaklit me të njëjtin titull në 80-vjetorin e lindjes së Hazis Ndreut, prej vitesh ndjek nga afër edhe veprimtarinë

e ansamblit artistik të bashkisë Kamëz. Ndjen krenari për sukseset e këtij ansambli, të nderuar me çmime të para në festivalin "Kënga dhe vallja na bashkoi" në Plavë dhe Guci; në festivalin Folk-Fest në Shkup, në festivalin "Kënga jehon" në Strugë, në festivalin Ana-Drinit, Rahovec si dhe në festivalin Ndërkombëtar të Fëmijëve në Stamboll. Po ashtu mori pjesë dhe u vlerësua shkëlqyer në Fest-Folk në Buzgan, Rumani.


Pas këtyre sukseseve ata performuan me nivel të lartë artistik në takimin festiv me rastin e festave të fundvitit 2019, në pallatin e kulturës Kamëz. Ndaj dhe duke shfaqur krenari të rrallë, Kapexhiu veçon vlerat e rralla që mbart programi i këtij ansambli, buqetën me këngë e valle të interpretuara mjeshtërisht prej artistëve amatorë, nga mosha parashkollë deri maturantë të shkëlqyer. Këto vlera evidentohen më së miri nga presidenti i këtij ansambli, Muharrem Gjoka. Në 10-vjetorin e ansamblit "Hazis Ndreu" për të cilin sponsorizoi një spektakël madhështor, Muharremi do të spikaste si kryesori në vallen epike të burrave të kësaj krahine, i karakterizuar nga forca, burrëria, trimëria, karakteri luftarak, madhështia etj.

Pasi vlerëson repertorin e ansamblit artistik "Hazis Ndreu", presidenti Gjoka thotë se brenda elementit kombëtar, vallet e këtij ansambli kanë mjaft veçori krahinore. Si një ekspert shumëvlerësh ai pohon se veçantia e valleve vërehet në motivet, formacionin dhe trajtën. Në këtë aspekt ai vlerësoi vallen me motive të Jugut të kërcyer aq mjeshtërisht nga grupi i fëmijëve të vegjël, vallen me

motive të Matit, si dhe ato me motive arbëreshe e nga Tropoja, të luajtura me virtuozytet nga grupi prej më se 30 kërcimtarësh, djem e vajza të rritura, ku veçon si më të mirët: kompozitorin Xhelil Imeraj, administratoren Earta Ndreu, asistent koreografen Erida Stana, njëherësh valltare dhe këngëtare shumë e talentuar si dhe këngëtarin Zaim Tollja. Mbresëlënës është edhe një zë i veçantë i vokalit shqiptar, tenori Dardan Pepkolaj, i cili ka kënduar në dhjetra skena, por dhe në stadium kur kombëtarja jonë ka zbritur në fushë. Valltarët e këtij ansambli sjellin para publikut, në mënyrë origjinale një dasëm tiranase si dhe vallen tropojane nën ritmet e këngës "Kuq e zi". Muharrem Gjoka që i ka mbështetur me shumë dashuri të gjitha aktivitetet e këtij ansambli, njeri human dhe me zëmer të madhe, por dhe veteran i folklorit, me modesti falenderon dhe kontributorët e tjerë në këtë ansambël, bashkinë Kamëz e veçanërisht nënkryetarin, avokat Hasan Bara si dhe gazetarin e mirënjohur sportiv, njëherësh moderator i dhjetra veprimtarive, spektakleve e promovimeve, Defrim Methasani.

Shatku - plejada e burrave të shquar dibranë në historinë e Tiranës

- *Sagë e lavdishme sfidash të atdhetarëve Shatku.*
- *Ndjesia që përjeton pasi lexon librin historiko-biografik të bashkëautorëve Dr.Saimir Shatku dhe Qatip Mara*



Plejadës së burrave të shquar që bënë emër në historinë e kryeqytetit shqiptar të gjysmës së parë të shekullit të kaluar i përkasin edhe patriotët nga Dibra e Madhe: Izet Shatku-Dibra (ish prefekt i Tiranës 1927-1928), Faik Shtaku, ish - Ministër i Drejtësisë në Qeverinë e fundit Mbretërore të kryesuar nga Koço Kotta, Shefki Shatku, ish - komandat i

Përgjithshëm i Xhandarmërisë Mbretërore nga tetori 1931, si dhe disa emra të shquar të këtij fisi me histori të lavdishme.

Pikërisht, për kontributin e këtyre burrave të shquar, bashkëautorët: Dr.Saimir Shatku dhe Qatip Mara, pas një punë të mirëfilltë studimore dhe mbi burime arkivore shumë bindëse shkruan dhe botuan librin historiko-biografik "Atdhetarët Shatku".

Procesi i hartimit, përgatitjes, sistemit dhe botimit të një libri, nuk është një punë e lehtë dhe aq më tepër e kuptueshme për këdo, por në këtë libër, katalizatori kryesor u bë rëndësia ndihmëse dhe historike e vlerave dhe figurave kombëtare, në krijimin, zhvillimin dhe konsolidimin e shtetit Shqiptar dhe institucioneve tona.

Konkretisht, libri është i ndarë në pesë kapituj, tema dhe nënkapituj, i paisur me një bibliografi të pasur botimesh të cilat fillojnë nga periodikët e kohës, antikuarët dhe revistat e viteve 1919-1944; Dokumente arkivore nga fondi i arkivit të shtetit me nr. 803, 804 dhe nga fondi jetëshkrimor i disa personaliteteve në këtë botim, si dhe qindra e mijëra dokumente të tjera shteruese e bibliografike retrospektive të kohës, janë një burim i rëndësishëm për këtë libër.

Burime të fondit arkivor e atij familjar

I një rëndësie të veçantë është përdorimi gjithashtu si pjesë e studimit i materialeve dhe dorëshkrimeve të fondit të arkivit familjar si dhe ditaret e tyre.

Një kontribut të veçantë në lidhje me pasurimin e

informacionit në botim, kanë dhe fondet e fotografive nga fonoteka Marubi, Shkodër, arkivi fotografik, Insituti Lucce, Romë, foto-studio Ristani, Tiranë, foto Dajti si dhe foto Sport.

Periodha e studimit mbi trungun genetik të familjes Shatku, fillon që me datimin e tyre në qytetin e Dibrës së Madhe në vitin 1671, pra para 350 vitesh, si pjesë e Sanxhakut të Manastirit e duke përfshirë rrugëtimin historik të rrjedhës së kohës, dhe depërtimin e tyre në Tiranë pas eksodit masiv të shtatorit të 1913. Në libër përshkruhet me vlerësime dhe mirënjohje roli dhe kontributi i kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Zyber Hallulli, i cili sëbashku me familjet e tjera të pasura të Tiranës si, Bargjini, Kërçiku, Vorpsi, Karapici, Bakalli, Fagu, dolën dhe pritën kolonat e para të eksodit masiv të genocidit sllavo-serb të 1913.

Më pas, në libër, bëhet një detajim më i gjerë i fëmijërisë, arsimimit, edukimit kulturor e shoqëror, studimeve shkencore dhe deri në funksionet dhe detyrat politiko-juridike, të disa prej figurave më eminente të kësaj familje.

Pjesë e rëndësishme e librit, janë veprimtaritë dhe kompetencat që ato kanë ushtruar nga periudha 1916-1939, si guvernator rajoni në, Çall, Allasonjë, Manastir e Gramsh, prefekt i qyteteve, Durrës, Berat, Elbasan, Tiranë, Deputet i Dibrës, Tiranës dhe Elbasanit, Ministër i Punëve Botore, i Ekonomisë Kombëtare, si dhe Drejtor i Përgjithshëm i Reformës Agrare dhe Zyrës së Emigracionit, Ministër i Arsmit Kombëtar dhe i Drejtësisë dhe Komandant i Përgjithshëm i Xhandarmërisë, ndërsa periudha më me trysni e kohës, ishte ajo e dëbimit dhe urbanizimit të tyre, pas vitit 1947.

Libër që pasuron letërsinë tonë dokumentare

Padyshim që botimi i këtij libri që pasuron dukshëm letërsinë tonë dokumentare është meritë e shtëpisë botuese "M&B me administrator Bujar Karoshi. Gjithsesi në promovimin që iu bë këtij libri në sallën e madhe të Presidentit të Republikës në kuadrin e 101 - vjetorit të Tiranës kryeqytet, autori Saimir Shatku vlerësoi rolin e redaktorit shkencor Remzi Zeqja, dhe redaktorin letrar, Lumturi Prizreni, recezentin e librit, Tofik Jegeni, si dhe Gazmend Bakiu për parathënien e librit dhe pasthënënien nga prof.dr. Bujar Kapexhiu- Nderi i Kombit.

Falenderimi dhe mirënjohja shkojnë gjithashtu për Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivit, Bibliotekën Kombëtare, Institutin e Historisë, Institutin e Monumenteve të Kulturës, Fonotekën "Marubi", si dhe Arkivin Historik të Institutit Luce, Romë për fotografitë e tyre.

Ngazëllim dhe ngutje e brendshme për të hedhur dritë mbi aktivitetin patriotik të personaliteteve të tilla

Duke lexuar këtë libër, përjetimet janë të shumta dhe historia e dyerve dhe fiseve më në zë, që e kanë mbartur atdheun si një peng dashurie të përjetshme, në udhëkryqe kohësh dhe epokash, duket se konvergjon në një pikë: në shpirtin e sakrificës, që i ka udhëhequr dhe motivuar në shekuj këto familje të mëdha fisnikësh, për të bërë shumë

më tepër se detyra ndaj familjarëve, derës, fisit, farefisit dhe trevës së tyre. Duke u bërë modele të sjelljes atdhetare e dinjitozë të kohës që i lindi dhe i ushqeui me pasionin e etshëm të lirisë...

Madje siç shkruan Gazmend Bakiu "Mjeshtër i Madh" në parathënien "...kur merr në dorë një libër si ky, që autorët Dr. Saimir Shatku dhe Qatip Mara po i japin lexuesit, ndjen një ngazëllim të brendshëm dhe një ngutje të brendshme e të beftë, për të hedhur diçka në letër.

Impresioni i parë, kur kthen faqen e fundit të librit, është ballafaqimi me njohuritë tona, për kohën kur bëhet fjalë në këtë histori dhe përtej kësaj, fakti kokëfortë se sa të vërteta kanë mbetur në hije për dyert dhe familjet më fisnike të kombit, në një kohë të pakohë"..

"Atdhetarët Shatku" i autorëve, Saimir Shatku dhe historianit Qatip Mara, është një libër i shkruar me përgjegjësi krijuese dhe realizëm, për njërën nga familjet më me kontribut në historinë e Dibrës së Madhe.

Libri paraqet një sagë të lavdishme përpjekjesh dhe sfidash atdhetare, të burrave më në zë të fisit Shatku, që në përballje me vetveten, për të tejkaluar unin e tyre dhe rrethin e interesave të ngushta, ngrihen në lartësinë e vizioneve kombëtare. Bëhen pjesë e udhës së vështirë, plot kthesa të rrezikshme dhe honesh, ku është vërtitur koha e shqiptarëve, në një nga periudhat më dramatike të historisë sonë, kur kërcënoheshim nga lakmia shovene, nga njëra anë, dhe nga dritëshkurtësia e orekseve të kolltukofagëve, nga ana tjetër.

Evidentimi i vlerave morale, njerëzore, diturore të

pinjollëve të derës Shatku, Izet Shatkut, Faik Shatkut, Shefki Shatkut etj, nxjerrja në pah e qëndresës së tyre përballë lakmisë, dredhisë dhe korrupsionit administrativ, që edhe atëherë, si dhe sot, ka qenë më se i pranishëm në jetën politike dhe administrative shqiptare, jepet nga autorët me një kolorit të gjerë dhe të detajuar ngjyrash emocionale.

Ky libër është një ftesë për të reflektuar mbi ndalesat dhe vakumet historike. Për të parë përtej fasadave të servirura nga kohë dhe shoqëri të devijuara qëllimshëm në udhëkryqe epokash të trishta, siç ishte epoka ku ne kaluam në gjysmëshekullin absurd.

Ismail Shulku dhe Muharrem Gjoka “NDERI I QARKUT DIBËR”

*Kryesia e OBVL falenderon Këshillin e Qarkut
Dibër dhe kryetaren, Valentina Haliti Doda, që
konsideruan propozimin e saj për të nderuar dy
figurat e spikatura me kontribute të
mëdha në shërbim të Dibrës dhe Shqipërisë*





Me propozimin e Kryesisë së Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të LANÇ (OBVL), Këshilli i Qarkut Dibër ka nderuar me titullin “NDERI I QARKUT DIBËR”, kolonel Ismail Shulkun dhe nënkryetarin e OBVL Muharrem Gjoka. Dy burra të nderuar, dibranë dinjitoz, kontribues dhe të përkushtuar në vite, profesionist të vërtetë në punën e tyre, njëri si ushtarak dhe tjetri si mjeshtër në kantjeret e rrugëve dhe hidrocentraleve, janë nderuar kështu të premten më 17 prill në një ceremoni festive të organizuar në Peshkopi nga këshilli i Qarkut Dibër.


Kolonel Ismail Shulku, ish-komandant i Frontit Veri-Lindor, zëvendës i shef i Shtabit të Përgjithshëm dhe nënkryetari i OBVL Muharrem Gjoka, u vlerësuan për kontributin e tyre mbi 50 vjeçar, me titullin “Nderi i Qarkut Dibër”. Kryesia e OBVL i përgëzon dy figurat e spikatura dhe falenderon Këshillin e Qarkut Dibër, kryetaren, Valentina Haliti Doda, që konsideruan propozimin e saj për të nderuar dy njerëz me kontribute të mëdha në shërbim të Dibrës dhe Shqipërisë.

Këtu në Dibrën e “Nandë Maleve” historike, me një pozitë shumë të mirë gjeografike, që shtrihet në luginën e Drinit të Zi nga Gjorica deri në Reç, në hapësirën mes Korabit e Runjës, këto dy burra të shquar të saj ndjehen si në shtëpinë e vet. Gjithsesi krenarë për historinë e lavdishme të Dibrës, ata kanë nostalgji për tokën pjellore, fushat, malet si dhe bjeshkët e larta të vendlindjes së tyre, ashtu si edhe për lumenjtë që e përshkojnë si Drini, Murra e Seta dhe disa lumenj të vegjël, por të rëndësishëm.

Paraditen e 17 prillit, koloneli i mirënjohur Ismail Shulku dhe promovuesi i vlerave etnokulturore dibrane Muharrem Gjoka do të ishin të rrethuar nga personalitete të Qarkut Dibër (që përfshin tri rrethet: Dibër, Bulqizë e Mat), si nga kryetarja e këshillit të Qarkut Valentina Haliti Doda, prefekti Nexhbedin Shehu, nga ikona e gazetarisë sportive dhe e dokumentarit televiziv Defrim Methasani, nga familjarë, miq e të afërm të tyre. Ata janë nderuar edhe herë të tjera, por titulli i dhënë nga autoriteti më i lartë vendor i vendlindjes së tyre, “Nderi i Qarkut Dibër” i bën të ndjehen më krenarë se kurrë.

Nderimi për komandantin e Frontit Verilindor, zv/shef i Shtabit të Përgjithshëm të FA të RSH

Kolonel Ismail Nazif Shulku, u vlerësua me titullin “Nderi i Qarkut Dibër” me motivacionin: “Për kontribut të shquar në reformimin konsolidimin e strukturave të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe forcimin e aftësisë



mbrojtëse të Atdheut”.

Ismail Shulku lindi në Peshkopi më 10 shkurt 1943. Në qytetin e Peshkopisë kreu arsimin 7-vjeçar, si dhe shkollën e mesme. Në vitin 1961, Isamil Shulku nisi studimet në Shkollën e Bashkuar, për t’i përfunduar ato me rezultate shumë të mira.

Me përfundimin e shkollës e caktuan komandues po në atë shkollë ku qëndroi dy vite edhe si komandues, edhe pedagog. Aty mësoi më shumë për t’u orientuar në jetë në detyrat ushtarake. Pas kësaj eksperience të mirë, emërohet komandant kompanie në brigadën e Peshkopisë, ku pas një viti bëhet shef i shtabit të batalionit dhe shumë shpejt edhe komandant batalioni, për punë të organizuar dhe për marrëdhënie shumë të mira me kuadrot dhe ushtarët.

Në vitin 1974 shkoi për studime në Akademinë e Shtabit

të Përgjithshëm, e cila përgatiste shtatmadhorë dhe drejtues të lartë të ushtrisë. Ismaili mbrojti diplomën shumë mirë dhe në shtator filloi punën si komandant i Brigadës së Gramshit.


Kur mbushi 5 vjet në detyrë, u transferua në detyrën e shefit të Shtabit të Korpusit të Burrelit. Deri në mars 1983, kreu dhe detyrën e komandantit të Korpusit, por ato u suprimuan dhe mori detyrën e komandantit të divizionit të Burrelit, që shtrihej në katër rrethe në Librazhd, në Peshkopi, në Burrel dhe një pjesë në Tiranë.

Ky divizion kishte një detyrë të vështirë pasi mbronte drejtimin Dibër e Madhe, Kaptina e Martaneshit dhe Tiranë. Në vitin 1985, Këshilli i Mbrojtjes e pa të arsyeshme që ushtria të ndahej në tre Fronte. Për çdo front u caktua nga një komandant, ku Ismail Shulku, mbulonte Frontin Veri-Lindor dhe ishte zëvendës Shef i Shtabit të Përgjithshëm. Kështu, filloi punë në Shtabin e Përgjithshëm, duke drejtuar Frontin Veri-Lindor që ishte më i vështirë, pasi mbulonte vijën kufitare prej 474 km nga Qafë Thana deri në Velipojë të Shkodrës dhe kishte në drejtim 6 divizione.

Ismail Shulku është autor i mjaft shkrimeve e kumtesave në shtypin ushtarak, si dhe i disa metodikave që kanë shërbyer për zhvillimin e disa stërvitjeve të Shtabit e Komando-Shtabi me shumë njësi të forcave të armatosura. Ai ka drejtuar e udhëhequr disa stërvitje të mëdha me trupa, me njësi taktike dhe operative, me pjesëmarrjen e të gjitha llojeve të armëve e shërbimeve. Deri në fund të

karrierës ushtarake mbajti me dinjitet gradën e Kolonelit. Në të gjithë veprimtarinë e tij për merita pune e shërbimi është vlerësuar me urdhra e medalje të ndryshme nga Presidiumi i Kuvendit Popullor, nga Ministri i Mbrojtjes dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA.

Muharrem Gjoka, promovues i vlerave etnokulturore dhe atyre të LANÇ



Nënkryetari i OBVL Muharrem Mehdi Gjoka u vlerësua me titullin “Nderi i qarkut Diber”, me motivacionin: “Për për mbajtjen gjallë të vlerave etnokulturore, për kontributin e çmuar në mbështetjen dhe promovimin e vlerave të LANÇ, dhe si ish-drejtues në fushën e ndërtimeve dhe infrastrukturës rrugore në të gjithë vendin”.

Muharremi lindi në vitet e luftës, në Zall-Dardhë, Diber

më 16 qershor të vitit 1943. Kaloji një fëmijëri të vështirë, por kjo e bëri më të fortë dhe të vetëdijshëm për të çarë rrugët e jetës. Që në vitet e rinisë së tij u inkuadrua në kantierët e ndërtimit të rrugëve, fillimisht në Kurbnesh dhe më pas në Skuraj, duke afirmuar cilësi të jashtzakonshme, të njeriut punëtor, korrekt, kreativ, por edhe drejtues i aftë.

Vitet e shërbimit ushtarak e largojnë prej këtu dhe mbrojtja e atdheut e kërkon në Bilishtin e largët, në kufirin me Greqinë. Prej aty, ai shërben syshqiponjë edhe në Poçarin e largët në Leskovik, duke lënë gjurmët e mira të një patrioti të guximshëm dhe të një ushtari e djali të mirë.

Sërish pas shërbimit ushtarak në kantieret e ndërtimit, nga njëri fshat në tjetrin, si në Spaç, Shupal, Reps, Arrëz, Miliska, Fierzë, Gropa, Haprripe etj, Muharrem Gjoka stamponte çdo ditë me punën dhe sjelljen e tij, emrin e mirë, duke krijuar një personalitet të padiskutueshëm. Veçanërisht aftësitë e tij organizuese dhe drejtuese spikatën në vitet 1965-1955 në ndërtimin në një kohë rekord të rrugës Qafë Bari – Fierzë dhe në vitin 1972 për asfaltimin e rrugës nacionale Peshkopi-Bulqizë.

Më pas, cilësitë e tij dhe vrulli i punës e afirmojnë edhe në Vaun e Dejes, madje aty kreu edhe studimet e shkollës së mesme në teknikumin e ndërtimit, duke rritur më shumë nivelin e tij jo vetëm profesional, por edhe intelektual. Tashmë shkollimi i jep mundësinë që të zgjidhet në detyra të rëndësishme, duke qënë edhe drejtuesi i transportit. Jo rastësisht ai mori përsipër mjaft punë të mira në asfaltimin e rrugëve të Pukës, Shkodrës, Kukësit, Bulqizës, Rrëshenit,

etj. Viti 1979, solli një shpërblim të gjithë këtij angazhimi dhe pune titanike, duke u pozicionuar në qytetin e Laçit, ku zgjedh edhe të banojë me familjen e tij të re dhe aty vijon të jetojë e kontriboj për shumë vite.

Këtu kryen edhe shkollën ekonomike, çka i mundësoi ngjitje në shkallët e karrierës deri shef i transportit të ndërmarrjes së asfaltimit, që mbulonte gjithë Veriun e Shqipërisë.

Pas viteve 90, kantieri ku ai punonte, rruga-ura u privatizua, konkretisht në vitin 1994, por Muharremi vijoi të ishte sërish aty, si drejtues kantieri deri në vitin 2002. Dy vjet më pas, pra në vitin 2004, ai del në pension, por kjo shkëputje, asnjëherë s’e ndali atë në vrullin e përjetshëm të angazhimeve dhe punëve të mira në dobi të familjes, vendlindjes dhe Shqipërisë.

Muharrem Gjoka, mbetet në ajkën e njerëzve të mirë dhe burrave të ndershëm e të përkushtuar, që përmes punës fjalës, sjelljes, por mbi të gjitha veprave të mëdha në shërbim të komunitetit, kanë një vend të merituar në shoqëri dhe komunitet.

Prej më shumë se dhjetë vitesh Muharrem Gjoka kryen funksionin e presidentit të grupit artistik “Hazis Ndreu” – “Nderi i Kombit”, i cili ka konkuruar dhe fituar çmime të para në festivale ndërkombëtare si në Ulqin, Tetovë e Prishtinë.


Po ashtu, që nga Kuvendi i shtatë i OBVL është zgjedhur nënkryetar i kësaj organizate, funksion të cilin e kryen me përkushtim të rrallë. Aktiviteti i tij i mësipërm është vlerësuar

me çertifikatë nderi nga shoqata kombëtare e miqësisë dhe bashkëpunimit Shqipëri-Itali; me mirënjohje nga qendra për kulturë në Ulqin; me çertifikatë “Mirënjohje” nga ansambli artistik “Kuvendi” Zall Dardhë, ndërkohë që mban edhe Titullin “Ambasador i paqes” nga Federata e Paqes Universale.

Vlerësimi i kontributit të zotërinjve Ismail Shulku dhe Muharrem Gjoka, - anëtarë të kryesisë së OBVL me titullin “Qytetar Nderi” të qarkut Dibër, parasëgjithash është vlerësim për organizatën e Bashkuar të Veteranëve të LANÇ, e cila prej 26 vitesh që nga krijimi i është përkushtuar edukimit atdhetar të shoqërisë dhe të brezave.

Dibra, zemra e kombit.....

Në 2016, Hysen Dervishi botoi librin "Krenaria" i cili jo vetëm që u promovua bujshëm, por edhe u mirëprit nga lexuesi. Me krenari të ligjshme për vendlindjen, në 75-vjetorin e ditëlindjes, (më 28 tetor 2018) dhurata e tij më e çmuar për ne është libri - enciklopedi "Dibra zemra e



kombit". Pikërisht në ditën e promovimit të këtij libri, në praninë e qindra intelektualëve, jo vetëm nga Dibra, por edhe nga Tërana, Mati, Durrësi, Kukësi e Elbasani, këshilli i bashkisë Bulqizë i dha titullin "Qytetar Nderi" ish-drejtorit të kinoklubit "Minatori" (prej më shumë se dy dekada), Hysen Dervishi, ndërkohë që Prof.Dr.Bujar Kapexhiu-

Kryetar i Shoqatës "Bashkësia dibrane", e nderoi atë me një "Mirënjohje" në emër të kësaj shoqate. Gjithsesi në epiqendër të kasaj veprimtarie promovuese në sallën e madhe të Muzeut Historik Kombëtar në Tiranë, ishte libri prej 745 faqesh "Dibra, zemra e kombit", të cilin unë pata fatin ta kisha që në dorëshkrim, dhe pasi ma besoi autori edhe ta redaktoja me përgjegjësi. U befasova që në leximin e parë për qasjen e Hysen Dervishit, që e konsideron Dibrën si zemrën e kombit, jo vetëm për vendin që ajo zë në hapësirën gjeopolitike shqiptare, por parasëgjithash për historinë e saj të lavdishme, për personalitetet e shquara që zënë vend parësor në elitën e kombit shqiptar.

Libri i Hysen Dervishit "Dibra, zemra e kombit" që u promovua më 27 tetor 2018 në sallën e madhe të Muzeut Historik Kombëtar në praninë e qindra intelektualëve dibranë (dhe ku autorit iu dha titulli "Qytetar Nderi i Bulqizës", nga Këshilli Bashkiak i qytetit minator), është një mal historie, është kryqëzimi i ngjarjeve dhe fakteve. Është lapidari i personazheve që kanë ecur përmes epokave në rrjedhjen e vazhdimësisë, është pasqyrimi i vërtetësisë historike të vjetër dhe të re, është simboli i një rrjedhshmërie ku renditen me art dhe vërtetësi figura të mëdha dibrane, të cilët ishin dhe mbeten gurët vendimtarë të themeleve të odave-shtet dhe në vazhdim të shtetit shqiptar.

Në libër ka dendësi ngjarjesh e faktesh që pasqyrojnë në nivelet e larta individë, fise, fshatra dhe epoka, me të cilët Dibra e kombit tonë ka formuluar në trashëgiminë e Nëntë Maleve trimërinë, dinjitetin, bujarinë dhe zgjuarsinë e saj,

duke u bërë e veçanta e Shqipërisë. Në libër renditen mjeshtërisht ngjarje e fakte që flasin për luftëra e individë, për figura politike e patriotike që kanë bërë historinë përmes mendjes dhe pushkës, për burra e heronj që vunë mbi gjithçka atdheun e kombin shqiptar. Në të gjitha ngjarjet e rëndësishme duke përfshirë shekuj e epoka e deri në Luftën e Dytë Botërore renditen figura historike që iu ndizej shpirti për vatanin e pushtuar, ku Dibra e dibranët mbeten malet e mëdhenj dhe lapidarët e yjeve të pashuar të historisë së vjetër e të re...

Autori, një studiues i zoti dhe njohës i mirë i ngjarjeve dhe fakteve

Pa pretenduar aspak monopolin e së vërtetës, autori me ndjenjën e përgjegjësisë së tij si një studiues i zoti dhe njohës i mirë i ngjarjeve dhe fakteve, duke depërtuar përmes kulturave dhe zakoneve të Dibrës, i rendit rrjedhshëm, pastër e me vërtetësi individët, figurat qendrore, të parët e Dibrës, komandantët, gjeneralët, veteranët, mësuesit, agronomët, artistët, shkencëtarët, heronjtë, ministrat, deputetët, njerëzit e thjeshtë, duke krijuar një tablo të saktë e reale të Dibrës, e cila gjithnjë nxorri burra me virtyte të mëdha, heronj e mendimtarë që i dhanë kombit besën dhe dëshirën për të jetuar me nder.

Në libër "parakalojnë" figura të rëndësishme historike të parisë së Dibrës, të atyre burrave që sot ka apo s'ka një në njëmijë, ecën koha e socializmit e përshkruar me vërtetësi si dhe epoka pluraliste. Me një gjuhë të bukur, me

retrospektiva e art, me një skalitje artistike të figurave të shumta të brezave, pasqyrohet vërtetësia dhe dashuria, urrejtja dhe përçmimi, solidariteti dhe heroizmi në luftë dhe në paqe. Përmes këtij libri me shumë vlera për të tanishmen dhe të ardhmen, vijnë tek lexuesi personazhe të reja e të vjetra nga të gjitha fushat e jetës, duke formuar një tablllo të plotë e reale të Dibrës, e cila në shekuj ka qenë e mbetet balli i historisë kombëtare. E veçanta dhe bukuria e librit është se përmes tregimit, përshkrimit, portretit, pasqyron të shkuarën, të tanishmen, dhe të ardhmen dhe bën vërejtje, thirrje, kritika, aludime, sugjerime, duke zgjuar tek lexuesi mendime. Të gjitha këto përshkruhen përmes një arti të hollë, i cili të bën përshtypje për botëkuptimin dhe zemërgjerësinë e autorit me përvojë e dinjitet, i cili bën thirrje për një aleancë me moralin e ri, për tolerancë, falje, mirëkuptim, me qëllim që shoqëria e tanishme të "mbjellë" shpresën e ringjalljes dhe të korrë frytet e epokës së re...

Në libër trajtohen portrete heronjsh, artistësh, kooperativistësh, mësuesish e mjekësh, trajtohen figura të veçanta të sistemeve e klasave, bazuar tek e drejta e autorit, sepse libri është i tij, veçanërisht tani në epokën e pluralizmit, e cila është koha e respektimit të mendimeve të njëri-tjetrit. Në këtë libër të përshkruar fund e krye përmes artit e kulturës, autori i thur hymne Dibrës, kësaj nëne të madhe e fisnike, e cila ka skalitur në daltën e kohëve personazhe me emër e lavdi të madhe, duke ia rritur famën e prestigjin nënës së saj, e cila lindi dhe mëkoi trima, mendimtarë, bestarë. Në libër përshkruhet saktë jeta e gjallë me të mirat dhe dobësitë

e saj, njeriu, individi që bën historinë, populli, klasat, rrymat, fiset, paria e Dibrës, ushtarët e gjeneralët... Mbi të gjitha në libër është spikatur dashuria, mirënjohja, fisnikëria, tradita për njerëzit, të cilët kanë bërë e bëjnë historinë. Përmes këtij libri të shkruar me shumë ndjenja dhe kompetencë, del në pah roli i autorit si publicist e historian, duke evokuar data, vite, ngjarje, personazhe të cilët mund të jenë burim shumë i pasur referencash për të ardhmen.

Përmes librave të tij, përmbledhje poezish, radiodramave, skenareve, studimeve, të këtij autori, evidentohet një prej figurave të rëndësishme të letërsisë dhe artit dibran përkrah shkrimtarëve dhe artistëve të tjerë të cilët me punën e tyre të dinjitueshme kanë rritur vlerat e veta dhe të Dibrës prej së cilës vijnë. Përdorimi i një metodologjie moderne në kapërcimin e paragjykimeve, ilustrimi i figurave historike të djeshme dhe të sotme dhe gjykimi për kohën e tyre tregon se Hysen Dervishi e njeh historinë dhe të vërtetën që beson. Ai, duke qenë edhe një hulumtues i burimeve arkivore me një qëndrueshmëri të ekuilibruar, i qëndron fort idesë se "askush nuk e ka monopolin e vërtetësisë absolute". Inteligjenca, transparenca dhe ekuilibri përshkon fillin e mendimit dhe i jep lexuesit një vepër dinjitoze në përshkrim të ngjarjeve, datave, fakteve, emrave duke vënë në ballin e veprës së tij faktorin njeri. Në këtë libër-enciklopedi shkëlqen si një fill i kuq gjaku, atdhedashuria, dashuria për vendlindjen, për Shqipërinë, për shqiptarët kudo që janë.

Pa asnjë mëdyshje, jeta dhe vepra e 163 personaliteteve dibrane, që nga ajo e Heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti

Skënderbeu, Qemal Atatürkut, Ahmet Zogut, Elez Isufit, Iljaz Pashë Dibrës, Dine Hoxhës, Sheh Bulqizës, Tafë Kaziut, Haki Stërmillit, Haxhi Lleshit, Ahmet Camit e deri tek dhjetra akademikët, mjekët, gazetarët e shquar dibranë, si: Prof. Dr. Luan Hajdaraga, Prof. Dr. Bujar Kapexhiu, Prof. Dr. Fehmi Abdiu, Prof. Dr. Shaban Sinani, Prof. Dr. Qemal Disha, Prof. Dr. Petrit Bara, Prof. Dr. Myqerem Tafaj, Bashkim Dedja, Safet Zhulali, Lulzim Basha, Jashar Menzelxhiu, Xhelil Gjoni, Monika Kryemadhi, Ismail Lleshi, Naim Plaku, Defrim Methasani, Sakip Cami, Fatos Daci, Shemsi Prençi, artistët dibranë Hazis Ndreu, Agim Krajka, Skënder Cala, Edmond Zhulali, Perparim Tomçini, Arif Vladi, Liri Rasha, Vera Laçi e Avni Ndreu, sipërmarrësit e mirënjohur, mbështetës të artit, kulturës, librit e sportit: Faik Bruçi, Latif Miha, Musa Riçu e dhjetra të tjerë, të profilizuar aq bukur në këtë libër, shërben që t'u themi më të rinjve se ka edhe vlera të mira ky vend, kjo krahinë, që duhen njohur, që duhen ndjekur, pa folur dhe për lartësinë e vlerave që ka dhe duhet të ketë një komb, pavarësisht se sa popull ka ai në sipërfaqen që mbulon flamuri i tij.

Libër racional, emocional, dokumentar, arkivor

Miku ynë i nderuar, Hysen Dervishi, sjell kështu për lexuesin një libër racional, emocional, dokumentar, arkivor - burim inkurajuesi për brezin e sotëm e për ata që do vijnë.

Një libër që na sjell një shpirt të madh, gati parajsor të personaliteve dibrane me kontribute madhore për kombin, ku spikat pjesa e portretizimit të tij. Në këtë libër mësojmë për ngjarje historike, sheshbeteja dhe dashuri përmes tyre; data dhe vende, fusha dhe male, rrugë e kodrina me plot dashuri mbuluar, emra njerëzish, të njohur dhe më pak të njohur, heronj të së shkuarës dhe të ditës me mirënjohje dhe dashuri mbështjellë; shpresë për të ardhmen dhe përsëri dashuri përmes saj.


Në këtë rrugëtim të gjatë prej më shumë se pesë dekada në vendlindje, në Peshkopi, Bulqizë, Mat e Tiranë, Hysen Dervishi ka progresuar duke mbajtur në konsideratë kërkesat e kohës, duke konfirmuar marrëdhëniet e tij ndaj vlerave shpirtërore të njeriut. Si i tillë ai nderohet e respektohet në këtë 75-vjetor të ditëlindjes së tij.

Ky libër-enciklopedi, sipas mendimit tim, veç të tjerash shton emra të spikatur në "arkivat" e vlerave shqiptare, ku dibranët janë pjesë ekzistenciale. Duke sendërtuar vlerat shpirtërore, duke qenë gjithnjë, ashtu si dhe në familje afër ngadhnjimit të së mirës ndaj të keqes, dritës ndaj errësirës, të vërtetës ndaj të pavërtetës, nuk është zor të ndjesh se dashuria është ai motiv që ka rrokullisur njëra pas tjetrës faqe të tëra të këtij libri që frymëzojnë cilindo që atdhedashurinë e ka lajtmotiv të jetës së vet.

Si përfundim, do të thoja se libri i Hysen Devishit "Dibra-zemra e kombit", është një vlerë e shtuar në letërsinë tonë dokumentare dhe si i tillë ia vlen të jetë në bibliotekat tona.

Mirënjohje Çamërie për Dibrën e dibranët

*"Nëse Bujar Kapexhiu - "Nderi i Kombit"
është pasqyra më e bukur e shpirtërave njerëzorë,
të asaj që e duam si fabul, si gjendje shpirtërore,
të punëdashjes e artdashjes,
"Nderi i Kombit" Hazis Ndren, vjen si një shpirt lirie
i derdhur në një këngë -simfoni*



Pena e artë e poetit, studiuesit, eseistit e publicistit të mirënjohur Namik Selmani "shtegton" kësaj radhe në Dibrën e "Nëntë Maleve" kreshnike, duke sjellë prej andej vlera të rralla natyrore e njerëzore, ende të panjohura për lexuesin në një libër mjaft të veçantë. Një libër për mirënjohjen, në hyrje të cilit autori shpreh "Një falënderim Çamërie e mbarëkombëtare për atë që krahina e Dibrës i ka dhënë kombit". I ndërtuar mbi një treshe magjike, ky libër sjell për lexuesin recensione, portrete njerëzore, poezi dhe ese poetike, të frymëzuara nga Dibra dhe dibranët.

"Kur hyra në shkollën dibrane, isha nxënës dhe dola prapë nxënës", shprehet autori Selmani, i cili më tej vlerëson pa asnjë mëdyshje se DIBRANIZMI është një portë rrezatuese të cilën, të gjithë në Shqipëri e në diasporë, duhet ta bëjnë atë pjesë të kulturës së tyre. "E dibranizmi na jep mjaft zemër e shpirt, themi se ai jeton e do të jetojë tashmë edhe në urtinë e tij. Mbase nuk është e rastësishme që nga kjo krahinë kanë dalë mjaft ushtarakë e intelektualë të fushave të ndryshme të jetës... Nuk është e rastësishme që dhe boksierët më të mirë të kombit e me kurora bote (Ismail, Gjetan e Ferit Keta), të kenë lindur në këto troje. Është emocion të dëgjosh këngët, elegjitë dibrane si perla të muzikës së kombit tonë, të interpretuara mjeshtërisht nga Arif Vladi, Hazis Ndreu, Liri Rasha, Qerim Sula, Vera Laçi, Sherif Dervishi e Dritan Jashari... Nuk është e rastësishme që lojërat e fëmijërisë i burrëronin më shpejt se mosha fëmijët e saj siç ishte "kalaja dibrançe". Mbase edhe manushaqet, ashtu si dardhat, kumbullat, mollët kanë atje një aromë që

nuk e shijon në ndonjë vend tjetër... Nëse diku keni dëgjuar e keni përsëritur shprehjen "Mat shtatë herë e prit një herë!" për Dibrën bashkë me këtë urtësi popullore, duhet të keni kaluar Shkollën e Dashurisë për Shkronjën. Madje dhe mirë. Duhet të keni kaluar e të jeni përballur me një ujëvarë mentarie. Nëse nuk je i stërkaluar i tëri me atë ujëvarë, duhet me e pasë njomur me të penën tuaj, sytë tuaj!", - shprehet ndër të tjera autori i këtij libri.

Dhuratë për Dibrën e dibranët nga Bostoni

Në këto 30 vitet e fundit, po edhe më herët janë shkruar me qindra e qindra libra për Dibrën. Kjo temë dhe liria e fjalës ka nxitur mjaft shkrimtarë, historianë, poetë. Ky libër, i botuar nga shtëpia botuese prestigjioze "M&B", i shkruar për Dibrën, është krejt i veçantë.

Është shkruar nga një njeri i mirë i Çamërisë që quhet Namik Selmani. Më shumë se fjala e tij është një mirënjohje që një krahinë plot tradita e plot dhimbje si Çamëria, duket se ia bën Dibrës, por edhe vetë këtij shkrimtari.

Ai jeton prej disa vitesh në Boston e, siç e thotë dhe ai vetë, e ka shumë të dashur këtë libër për të cilin ka punuar gati 20 vite. Është një dhuratë që ai ia bën Dibrës në një përvjetor të veçantë siç është 70-vjetori i lindjes, ndërkohë që vetë Dibra, miqtë e tij dibranë dhe unë personalisht e uroj nga zemra për shëndet e për vepra sa më të arrira. Edhe për faktin se ky libër i tij vjen si një "dhuratë" nga Bostoni për Dibrën e dibranët. Para një të vërtete të prekur, unë do

të thosha se libra të tillë janë të rrallë e për këtë, mirënjohja e lexuesve dibranë e më gjerë është e madhe. Kam pasur disa raste të bashkëpunimit konkret me Namikun, si në librat për Rrahman Parllakun, për Skënder Calën, etj. Madje nuk duhet të çuditeni se në gazetat dibrane si "Rruga e Arbërit" e "Bulqiza" ai boton herë pas here poezi dhe ese që pëlqehen nga lexuesit.

Në katër kapitujt e këtij libri ka recensionë (parathënie librash), portrete, ese poetike dhe poezi të autorit Namik Selmani. Kështu në kapitullin e parë gjejmë recensionë për librin tim "Në panteonin e vlerave"; Refleksione mbi librin e dr. Islam Canit "Rrënjët historike të Kastriotëve të Çidhnës"; Mendime për librin e Abdurahim Ashikut "Rrëfimet e Komshiut"; Mendime për librin me poezi "Ura e Fjalës" të poetit Demir Rusi....

Vlerat intelektuale, morale e materiale

H.Rama shkruan për Shuaip Methasanin, intelektualin dibran që rrezaton mirësi dhe vlera, duke vlerësuar dy librat e tij - testament për brezat ku përshkruhen më së miri vendlindja, historia e lavdishme, personazhe e personalitete që kanë bërë historinë e traditat më të mira.

Po në kapitullin "Portrete", autori shkruan për Muharrem Gjokën, si mishërues dhe përçues të fjalës së mençur dibrane. Shkruan për këtë dibran të shquar që u "diplomua" në kantieret e ndërtimit e asfaltimit të rrugëve në gjithë vendin, ku implementoi suksesshëm dijet e marra në "Universitetin e Dibrës", leksionet e të cilit i përvetësoi nëpër odat e kuvendet

dibrane...., shkruan për vitet e jetën e Doktores së Shkencave Mjekësore Suzana Zhuka - Nuellari që si okuliste e talentuar e sheh jetën me sytë e dashurisë për profesionin e njerëzit.....,shkruan për intelektualin dhe biznesmenin e suksesshëm Latif Miha, i cili ka përvojën, moshën, fuqinë intelektuale, morale e materiale që t'i përkushtohet sipërmarrjes.... Në këtë libër autori "rrugëton" në gjurmët e jetës dhe veprës së Shemsi Prençit - muhurrakut që ka qenë dhe mbetet në garën e madhe dhe të ndershme me forcën dhe motivin për t'i shërbyer kombit...Më tej ai shpreh fjalë zemre për gazetarin Defrim Methasani, që si ikonë e gazetarisë sportive dhe e dokumentarit televiziv jeton dhe punon brenda mençurisë dhe humanizmit dibran. Nën titullin "Lum kush njeh vëllezërit Rusi", autori shkruan për Demir e Baftjtari Rusin, duke ua "peshuar" fjalën ndershmërisht!

I gdhendur mjeshtërisht është në këtë libër edhe portreti i Prof. Dr. Bujar Kapexhiut, Mjeshtër i Mjeshtërave - "Nderi i Kombit". "Mirënjohje për mirënjohjen" është titulli i profilin të artistit Skender Cala, ikonë e artit dhe kulturës kombëtare. Në këtë kapitull, autori shkruan edhe për urtakun e përjetshëm Azis Keta, për të cilin shprehet se ka të paktën rreth 30 vite që e njeh nga afër....Kështu, nëse Bujar Kapexhiu - "Nderi i Kombit" është pasqyra më e bukur e shpirtërave njerëzorë, të asaj që e duam si fabul, si gjendje shpirtërore, të punëdashjes e artdashjes, "Nderi i Kombit" Hazis Ndreu vjen si një shpirt lirie i derdhur në një këngë -simfoni. Referuar vargjeve të kësaj kënge (kënga e "Hajredin Pashës"), autori pohon se që prej gati 300 a 400 vitesh ka ardhur në ditët tona ajo urti dibrane

që e solli koha, që e vulosi koha atëherë dhe sot: "Nëse do të humbë Stambolli, Dibra do ta ndërtojë atë e nëse humbet Dibra, Stambolli nuk mund ta ndërtojë më atë"... Dhe e dini se cili është gjoksi që mban këtë vrundullimë të egër? Janë vetë malet. Jo male të zakonshëm, se kudo në botë ka male, ka lumenj, ka gryka, ka kroje dhe dete, po këtu malet kanë shpirt qëndrese që dinë të bëjnë edhe BESË. E pas besës vjen BELAJA. Nuk e dimë se sa e njeh fjalorin e ushtrive këngëtari popullor, apo ai rapsod që ka bërë vargjet e saj. Po fjala BELA është më e mira që e tregon humbjen, disfatën, sfidën e fituar. Përballë BESËS është vdekja. Këtu nuk ka diplomaci sallash të fshehta, nuk ka traktate, nuk ka marrëveshje të firmosura me një lloj ceremoniali të rrallë. Këtu flet vetëm pushka. Jeta dhe vdekja për liri nuk rrinë në asnjë vend të Ballkanit më afër se në këtë grykë të Radikës....

Një model i bukur gjuhësor i shkrimit të gjuhës amtare

Në kapitullin e tretë "Ese të zgjedhura", si redaktor i librit do të veçoja esetë poetike me tituj:

- "Amaneti i këngës" (Në kujtim të këngëtarit dibran Qerim Sula - "Mjeshtër i Madh" dhe "Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut);

- "Simfonia" për Çamërinë" (Në gjurmët e këngës së Arif Vladit - "Mjeshtër i Madh" dhe "Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut);

- "Një shpirt lirie i derdhur në një këngë" - simfoni duke

ndjekur këngën "Kënga e Hajredin Pashës";


- "Moj Fusha e Korabit, o e mjera unë-oooo" (Në vend të një mirënjohjeje publike për këngëtarët e shquara dibrane Liri Rasha dhe Vera Laçi - Meditim për këngën "Oj Fusha e Korabit");

- "Ylberi nuk shuhet, edhe pse shekujt ecin me revan të pandalur" (Për këngën "Kur e përcolla ylberin").

Libri "Jehona e urtësisë dibrane" mbyllet me kapitullin me një tufë poezi të frymëzuara nga Dibra. Me një gjuhë letrare dhe rrëfim të admirueshëm ato të emocionojnë për detajet e stilin që ai ka zgjedhur dhe që e bën original. Ky libër është një vlerë për historinë e Dibrës që mund të ushqente mjaft muze të saj, atë të luftës, të arsimit, të teatrit, të ushtrisë, të shkencës, etj. Është një model i bukur gjuhësor, para të cilit mësuesit e gjuhës amtare do të shihnin modelin e mirë të shkrimit të gjuhës amtare. Dhe këto nuk janë pak që edhe vetë libri, ashtu si personazhet e tij, të vihet në "vitrinën" e kulturë së shkruar shqiptare të viteve të fundit.

Mevlud Buci - mësues, publicist dhe poet i talentuar

46 vite mësues i gjuhës dhe letërsisë, drejtor e nëndrejtor në disa shkolla në Dibër e Tiranë. Si rrallë kush në Dibër, Tiranë e gjetkë, Mevlud Buci njihet edhe për produktin e tij publicistik e letrar, të konkretizuar në 27 libra me poezi epiko-lirike, fabula, epigrame, fjalë të urta e shprehje frazeologjike, monografi e publicistikë letrare



Dyzetegjashtë vjet mësues, drejtor e zëvendës drejtor në disa shkolla të Dibrës e Tiranës, si dhe 27 librat e tij me poezi, epigrame, fabula e monografi, e kanë bërë Mevlud Bucin një emër të spikatur të elitës intelektuale dibrane e asaj kombëtare. Më 2 mars 2021, ai festoi 70 vjetorin e ditëlindjes. Plot shtatë dekada jetë, ndër të cilat, pothuajse gjashtë të tilla janë të mbushura me ngjarje që kanë lënë gjurmë në personalitetin e tij krijues. Sepse Mevlud Buci nisi të shkruajë e të botojë që në moshën 15 - vjeçare, kur ishte nxënës i shkollës 7-vjeçare në Lunarë të Katër Grykëve, të cilën e kreu me rezultate të shkëlqyera. Më pas do ngjiste shkallët e dijes si nxënës shembullor në shkollën pedagogjike "Luigj Gurakuqi" në Elbasan, në fakultetin e Gjuhë - Letërsisë dhe specializimin për stilistikë dhe letërsi me rezultate të larta, po ashtu të gjitha kategoritë e kualifikimit të mësuesisë. Nga CV e tij mësojmë se në vitet 2011-2013, Mevlud Buci përfundon studimet pasuniversitare në fakultetin e shkencave Humane të Zbatuara të Edukimit dhe mori gradën për Drejtim dhe Administrim në Arsim.

Karrierë e shkëlqyer profesionale si mësimdhënës e drejtues i talentuar shkollash

Mevlud Buci ka një karrierë të shkëlqyer profesionale si mësimdhënës e drejtues i talentuar i disa shkollave. Plot 46 vite ka shërbyer si mësues i gjuhës dhe letërsisë, si drejtor e nëndrejtor në shkollat, ndër më të mëdhatë e të vështira, në Dibër e Tiranë. Breza të tërë nxënësish e mësuesish të

shkollave 9-vjeçare e të mesme: "Kadri Abdihojha", Qafë Murrë, Selishtë, "Kolë Jakova" në Laknas, "Ataturk" e "Sandër Prosi", "Sadi Nuri", Yrshek, e "Murat Toptani" në Tiranë, ku ai ka përhapur dritën e diturisë, e vlerësojnë Mevludin si mësuesin e zellshëm e me talent, për përkushtimin e rrallë dhe profesionalizmin e lartë, si organizator dhe drejtues vizionar. Ai është vlerësuar nga institucione, gazeta, revista, fondacione e shoqata me tituj nderi, medalje e mirënjohje. Mban titullin: "Mësues i dalluar", dhënë nga Ministria e Arsimit dhe "Anëtar Nderi i Diasporës" dhënë nga gazeta "Emigranti".

Më 26 nëntor 2016, mori "Mirënjohje" nga shkolla e Sohodollit të Dibrës, ku dhuroi 700 libra dhe 128 revista shkencore. Më 28 shkurt 2018, u nderua me "Mirënjohje" nga Komuniteti Mysliman për ndihmën në shtypin e vëllazërimit fetar. Mevlud Buci mban çmimin "Pena Budi", 2014, akorduar nga revista "Emathia", Burrel.

Më 30 tetor 2019, nderohet me "Mirënjohje" nga shkolla 9-vjeçare Vranjt e Kastriotit të Dibrës për arritje në mësimdhënie dhe për botimin e librave të tij. Më 12 shtator 2020, ka marrë "Çmimin e Karrierës" në konkursin "Muza Budiane 5" (organizuar në shkallë mbarëkombëtare).

Produkti letrar i Mevlud Bucit, i pasur e cilësor

Si rrallë kush në Dibër, Tiranë e gjetkë, Mevlud Buci njihet për produktin e tij publicistik e letrar, të konkretizuar në 27 libra me poezi epiko-lirike, fabula, epigrame, fjalë të urta e shprehje frazeologjike, monografi e publicistikë letrare. Mbi

50 vite, ka shkruar në mjaft organe shtypi, lokale dhe qendrore, mban vlerësime në shtypin publik, ushtarak dhe nga revista shkencore. Ka shkruar me qindra artikuj në revistën "Hosteni" me pseudonimin "Runja"; në revistën "Obelisk", "Humor shkodran", "Kunji", "Mësuesi", "Humor e satirë", "Urtësia", "Gjuha jonë", "Emathia", "Arsimi sot dhe nesër", "Rreth e rrotull" etj. Për shumë vite ka qenë bashkëpunëtor i Radio "Kukësi" e Radio "Tirana", si dhe bashkëpunëtor shkencor i Akademisë së Shkencave (Instituti i Folklorit).

Mjaft produktiv e me krijime cilësore shfaqet Mevlud Buci sidomos në librat "Alegoria e Dibrës-filozofia e shekujve", "Dritë jete, dritë vlerash" libër publicistiko-letrar me shkrime, skica, krijime për vlerat njerëzore; "Qesh e qaj me lot", libër me poezi satirike, fabula, tregime, aforizma; "Shenjtëria", libër liriko-epik, poezi me krijimtarinë e 50 viteve të botuara në shtypin letrar; "Udha e mirësive", libër me poezi lirike - filozofike, "Metafora e Shpirtit", libër me një mijë aforizma të krijuara si dhe me disa libra tjerë të tij.

Ndërkohë ai ka në proces botimi librat: "Molla Bajram Buci (Hoxhë Buci i Dibrës, dritëshenjtori për atdhe e flamur", (monografi); "I përfalem mirënjohjes", libër monografik; "Përvojë dhe tradita nga mësimdhënia, veprimtaritë dhe arti i drejtimit të shkollës në demokraci"; "Testamenti i përjetësisë", libër me poema; "Ndrit Kaftalli në at' Kashnjet" (Libër publicistiko-letrar për kullën e Gjokës, fisin Gjoka dhe traditat e brezave, atdhetarët Ndue Mark Gjoka dhe Llesh Ndue Gjoka).

Krenar për traditat dhe origjinën e tij

Mësuesi, poeti, publicisti e radiokronisti i talentuar Mevlud Buci ka të drejtë legjitime të krenohet me origjinën dhe traditat e vendlindjes së tij. Ai është stërnip i Hoxhë Bucit (Molla Bajram Bucit) i cili njihet në histori si sekretar i Lidhjes së Prizrenit, shok i Iliaz Pashë Dibrës, zotërues i shtatë gjuhëve të huaja. Me babanë e me të birin, Hoxhë Buci u vra për atdhe në shtator 1913, me të birin Mustafanë e Hoxhë Bodinin, në malin e Petralës (Petrino) në mësymjen e dytë kundër serbëve. Kulla e Bucit, historikisht, ishte bazë e patriotëve të Dibrës e më gjerë. Xhaxhai, Bajram Buci (I riu) ishte luftëtar i lirisë qysh në njësitin e parë të çetës së Dibrës; shtëpia ishte bazë e luftëtarëve të lirisë të Dibrës, Matit, e më gjerë.

Mevlud Buci është nip i kullës atdhetare të Manukëve të Luznisë: Hazi e Demir Manuka, burrave të shquar e mentarë: Rrem, Destan, Naim, Sakip, Fetah, Maliq, Seit e Veli Manuka. Më 1920, dajat qëndrestarë e shndrruan kullën në kala qëndrese ku, në rrethim, u vra edhe komandanti serb, gjeneral, - thotë muza popullore.

Besnik i origjinës dhe traditës, Mevlud Buci, ndoshta si rast unikal në historinë e lëvizjeve masive të tri dekadave të fundit, pasi jetoi e shërbeu për afro 25 vite në shkollë të ndryshme të Tiranës, si drejtor e zëvendësdrejtor, rikthehet për të banuar e jetuar në kullën e tij të vendlindjes në Lukanin malor të Katër Grykëve të Dibrës, fshati që ka si mburojë Runjën hijerëndë e kreshnikë 2048 metra mbi nivelin e detit. Me bashkëshorten e tij shembullore, Shahen, këtu i gëzohen

gjithshkaje, ajrit të pastër që rigjeneron mushkëritë e tyre, freskisë së maleve, zërit të bilbilave dhe unitetit të atyre pak banorëve që kanë vendosur ta vazhdojnë jetën në këtë fshat me histori të lavdishme, në zemër të maleve. Këtu frymëzimi i tij është i pashtershëm. Në atë votër të ngrohtë familjare ia merr këngës me çifteli dhe valles, si dikur kur debutonte shkëlqyer në festivalet folklorike lokale e kombëtare.

Pëlqimet e tij mbeten: Dashuria për njeriun, traditat, folklorin, misteret e psikikës e të pedagogjisë, mjeshtëria dhe takti në mësimdhënie dhe drejtimin arsimor. Këto pasione të tij i gjejmë të shprehura edhe në vëllimin e tij më të fundit poetik "Shenjtëria", në parathënien e të cilit, poeti dhe kritiku i mirënjohur letrar, Qazim Shehu, duke e vlerësuar Mevlud Bucin si poetin e ngjyrave të vendlindjes, të dashurisë dhe patriotizmit brilant, ndër të tjera shprehet se: "Vëllimi poetik më i ri i Mevlud Bucit shenjtëron, përmes një verbi të singertë e plot ndjenjë vendlindjen; vendlindjen si natyrë me male, gryka, përrenj, shkëmbenj, thepa, kreshta, lëndina, lule; vendlindjen përmes një zëri epik, me traditat, luftërat për liri, kullat, qëndresën dhe mbijetesën, për të ngritur lart virtytet e malësorit, të cilat u shenjtëruan nëpër shekuj dhe mbajtën gjallë karakterin e etnisë; poeti shenjtëron e shpalos dashuri, mall, përkushtim dhe mirënjohje edhe për sa e sa njerëz të cilët i ka njohur, njerëz të thjeshtë po edhe të përmendur".

Mevlud Buci, mbetet pjesë e spikatur e plejadës së mësuesve shqiptarë, që për vite të tëra i shërbyen ndriçimit

të mendjes së brezave që përtërinë Shqipërinë. Ai kujton se të qëniti mësues, ishte nderi dhe shërbimi më i madh që mund të bënte duke njohur nga afër sa e sa botë njomëzakësh, që etja për dije i mblidhte në shkolla rreth mësuesve.

Mevlud Buci i shërbeu dijes, edukimit qytetar dhe të mirës shoqërore. Duke qënë përherë mes njerëzve dhe sidomos midis brezit që rritet dhe sjell shpresë e vijimësi, mësues Buci kurrë nuk harroi penën si një "urë" pavdekësie që përcjell mendimet dhe ndjenjat në letër, duke radhitur fjalën e shpirtin e vet krijues si një "testament" që nuk ka nevojë të noterizohet në zyrat e shumta të avokatësisë shqiptare. Emri i tij është "avokati" falas për Mevlud Bucin që sapo shënoi shtatë dekadat e para të jetës së vet...

Na ishte dikur... miniera e mermerit, Guri i Kuq, Muhurr

Pak histori...

Në mozaikun prej dhjetëra mijëra pllakash guri, të trashësisë 10-12 cm, që u përzgjedhën nga të gjitha trevat



shqiptare për të shtruar sipërfaqen prej 41 mijë m² të sheshit të ri "Skënderbej" të Tiranës, inauguruar në qershor 2017, një sy i vëmendshëm mund të dallojë edhe ato të minierës së dikurshme të mermerit Muhurr, Dibër. Po ashtu, në hyrje të këtij sheshi, nga pjesa veriore, në ngushticën midis Muzeut Historik Kombëtar dhe hotel "Tirana Internacional", janë vendosur disa blloqe mermeri, njëri prej të cilëve, ai me ngjyrë të kuqe e damarë të bardhë, është marrë po nga kjo minierë. Blloqe më të mëdhenj, të përmasave deri 2x3x1.5 m, me peshë deri 20 ton, qëndrojnë prej 30 vitesh në disa vende të portit të Durrësit. 60 vjet më parë, me pllakat e këtij mermeri do të vishej edhe pjesa fundore e mureve të Pallatit të Kulturës në Tiranë.

Në ditarin tim të dates 10 shtator 1984, gjej edhe këtë shënim: "pensionisti Rustan Mëziu, teksa shpreh keqardhjen pse po i dëmtohet zabeli që e pretendon si të vetin, në zonën e re të minierës, më tregon se, kur po ndërtonin rrugën Muhurr - Selishtë, në punë e sipër, pikërisht këtu (ku është sot miniera e mermerit) hasën në gurin e bukur me ngjyrë të kuqe e damarë të bardhë, për të cilin, inxhinieri italian i zbatimit të projektit të rrugës tregoi interes të jashtëzakonshëm!"

Ka qenë viti 1935 atëherë, kur italianët i ranë në gjurmë kësaj pasurie të çmuar dhe siç doli më vonë, në legjendën e hartës së tyre kishin shënuar: "Mermer, tip Muhurri - i pari në botë, vetëm 4.5 km sipër Muhurrit, në drejtim të Selishtës!".

Vitet rrodhën si ujët e Murrës... Në vitin 1962, fillimisht në varësi të ish-kombinatit "Josif Pashko", u krijua një



sektor për nxjerrjen dhe përpunimin e blloqeve të mermerit në Muhurr të Dibrës, me drejtor Bilal Halilin. Blloqet nxirreshin në mënyrë primitive, transportoheshin për në Tiranë dhe këtu priteshin në pllaka mermeri të formave të ndryshme, më të mirat e të cilave u përdorën edhe për fasadën e Pallatit të Kulturës. Vazhdoi kështu të funksionojë ky sektor i prodhimit të blloqeve të mermerit në sasi të pakët, me pak punëtorë e me një shkallë shumë të ulët mekanizimi, deri më 1 mars 1968, kur miniera e Muhurrit u zyrtarizua si ndërmarrje më vete...

Por, zanafilla e saj është shumë më e hershme. Për më shumë se 20 vjet u prodhuan mijëra tonë blloqe mermeri, kryesisht për eksport, duke siguruar të ardhura të konsiderueshme për ekonominë kombëtare... Më konkretisht, gjatë viteve 1968-1991, nga kjo minierë u prodhuan 46 mijë metra kub blloqe mermeri, duke i siguruar ekonomisë së asaj kohe 9.2 milionë dollarë. Mjafton kaq për të kuptuar koston që na solli fryma shkatërruese e tranzicionit.

Dhjetëra muhurrakë, specialistë, minatorë, kuadro e punëtorë të dalluar në këtë minierë

Në një katalog të vitit 70-të, midis të tjerash lexojmë atë që kishte shënuar si legjendë të hartës së tij, ish - inxhinieri zbatues i punimeve të rrugës Muhurr-Selishtë më 1935: "Mermer tip Muhurri-i pari në botë....".

Italianët, si më të interesuarit për mermerin e Muhurrit, qenë të parët që në fillim të viteve '70 përgatitën specialistët e parë të prerjes së blloqeve me tel helikoidal. Qenë jovendas, ata që shkuan në një kurs të tillë në Itali, si Zenel Hida e Zija Piku, të cilët pasi mësuan "sekretin" e prerjes horizontalisht të masiveve shkëmborë me tel helikoidal, ua mësuan atë edhe specialistëve vendas. Dhjetëra mijëra tonë blloqe të këtij mermeri u prodhuan nga minatorët e specialistët duarartë të kësaj miniere dhe u eksportuan gjatë 20 viteve në Itali, Austri e Turqi.

Këtu, në prehër të maleve, në një qytezë minatorësh, për tri dekada organizohej dhe niste puna për prodhimin e blloqeve të këtij mermeri të çmuar.

Rëndësia e tyre për muhurrakët qëndronte jo vetëm tek leverdia ekonomiko-financiare e shtetit, por para së gjithash për punësimin e tyre. Kështu, nëse në vitet e para, kur ishte sektor në varësi të Kombinatit "Josif Pashko", ishin punësuar kuadrot e njohur nga Muhurri: Halit Laci, Xhetan Ismria, Halit Mikli e Bajram Lleshi, pas '70-tës, në administratën e kësaj miniere punojnë për 20 vite: Hit Berisha si shef plani i ndërmarrjes; Ramadan Lika e Setki

Balla si financierë, Tahir Mëziu si brigadier e si përgjegjës i sektorit të prodhimit, Elez Lleshi e Nazmi Çiku, si teknik, normist e kryenormist, Gani Laci si furnitor etj.

Por ata që i dhanë jetë qytezës minatore qenë martelistët: Tahir e Xhemal Mëziu, Osman Kaleshi, Adem e Hysni Tanushi, Islam e Tahir Rina, Faik Deva, Tahir Krrashi, Hamit Sina, Selim Prençi, Rasim Laci, Jonuz Çiku, Nazif Mikli e ndonjë tjetër, të cilët me martelët e rëndë, që ua bënë gjokset plagë në dimrat e acartë me borë, akull e suferinë, por edhe në zhegun e verës, shpuan kilometra të tërë vrima me baromina në masivët e gurëve të ashpër.

Mushkëritë e tyre u bënë blozë nga pluhuri që thithnin për çdo ditë e që ua shkurtoi jetën. Por ata edhe në këto kushte ndjeheshin të kënaqur sepse siguronin të ardhura të mjaftueshme për familjet e tyre. E njëjta gjë duhet thënë edhe për specialistët e prerjes së masiveve të blloqeve me telin helikoidal, si: Destan Farruku, Islam e Isuf Çiku, Rustem Veshi, Mexhit Bushi, Ramazan Veshi, Hakik Losha, Selim Rama, Nazmi Çiku, Hajredin e Halim Dobi, Liman Qoka e Qamil Lleshi (disa prej tyre patën fatin të kryenin edhe një kurs 9-mujor kualifikimi me pagesë nga drejtoria e ndërmarrjes).

Në atë volum të madh pune është munda e djersa e atyre që kryenin zbulimin e blloqeve, duke larguar dheun me lopatë, e që quheshin punëtorët e zbulimit, siç ishin: Xhetan e Shefki Deva, Hasan Çiku, Veli, Jonuz e Muharrem Veshi, Dervish Ballazhi, Tofik e Halit Visha, Fisnik Mëziu, Fali e Halit Hoxha, Ibrahim Voka, Dilaver Lleshi etj. Miniera e Mermerit

shërbeu si burim punësimi e të ardhurash edhe për të punësuarit në repartet ndihmëse, siç ishin magazinieri Daut Çiku; Hysni Doda si numërues, ustallarët Destan Visha e Beqir Hoxha dhe rojet me tre turne: Mustafa Fishti, Sefer Balla, Hamit Balla, Tofik Zhuzhi e Aqif Prençi.

Drejtorët e kësaj miniere në vite, si Skender Kuçi, Besim Sadiku, Rustan Loka, Hekuran Domi e Skënder Leka; ish - kryeinxhinierët e inxhinierët Nikolla Seferi, Mustafa Seferi, Kujtim Kaçkini, përgjegjësit e sektorëve Hysen Nika e Qerim Shehu apo edhe teknikët e prodhimit Azem Nela, Surja Tafa, Petrit Bardhi e ndonjë tjetër, edhe sot të flasim me respekt të veçantë për kolegët e tyre në administratë, minatorët, specialistët e punëtorët muhurrakë, të kësaj miniere që përballuan volumin më të madh të punëve.

Tek ua përmend dhe shkruaj emrat për këtë reportazh, ndjej keqardhje dhe dhimbje, pasi shumë prej tyre nuk rrojnë, por gjithësesi le të shërbëjnë këto radhë edhe si homazh, përkujtimore dhe vlerësim për jetën, punën e kontributin e tyre.

Ofiçina mekanike, shoferët dhe mekanizatorët e minierës

Kjo minierë nuk do të kishte suksesin e saj të dokumentuar, nëse nuk do të kishte edhe infrastrukturën ndihmëse, ku kryesorja ka qenë ofiçina mekanike. Këtu u formuan dhe u specializuan dhjetëra mekanikë, tornitorë, motoristë e kompresoristë që mbajtën gjallë makineritë e

rënda të kësaj miniere, vinçat e eskavatorët gjigandë, arganellot e makinat e transportit. Ndër ta, Shaban Tanushi mbahet mend si më i spikaturi, jo vetëm si mekanik, por edhe si përgjegjës i oficinës dhe si frekuentuesi më i rregullt i bibliotekës e lexuesi i librave të shumtë shkencorë e artistikë. Po ashtu kujtojmë edhe vëllain e tij, Hazizin, një tornitor duarartë për të cilin, ashtu si edhe për elektroutin Myrteza Lala, thonin se "çfarë u sheh syri, ua bën dora".

Por nuk duhet harruar edhe kontributi i motorristit Jonuz Lika (i cili dha jetën në krye të detyrës për shuarjen e flakëve kur u dogj salla e motorëve), si dhe i kovaçit Dash Dashi. Falë shpirtit krijues e sakrificës së tyre u mirëmbajtën: eskavatori që drejtohej nga Idriz Lika si edhe mjetet e transportit, saurela e zisa, të drejtuara nga shoferët e palodhur: Xhavit Lala, Ferit Visha, Cek Balla, Setki Lala, Aqif Lleshi, Sami Kaleshi, Selman Leka, Petrit Prençi etj.

Në këtë oficinë ishin punësuar gjithashtu, sapo kishin mbaruar shkollën e mesme mekanike, edhe Marie Voka e Suzana Pira, njëra tek kompresorët e tjetra si tornitore. Ato mirëmbanin edhe arganellot që shërbenin për lëvizjen e blloqeve të mermerit, nga sheshet prodhimit për në rrugët nga do të ngarkoheshin për t'i transportuar drejt Durrësit.

Kavot e trasha të çelikut që përdorehin në këto arganello, njiheshin si "kavo e mermerit të kuq në zonën e Muhurrit në Peshkopi", i cili, për shkak të cilësisë së lartë dhe periudhës njëzetë vjeçare të shfrytëzimit, ishte bërë i njohur veçanërisht në Itali, Francë, Poloni, Hungari dhe në vendet Arabe.

Rrjeti i objekteve social-kulturore

Me fuqizimin ekonomiko-financiar, në qytezën e Minierës u ngritën edhe objektet social-kulturore. Të standardeve bashkohore qenë kino-klubi me bibliotekën dhe vatrën e kulturës, infirmieria, lokali bar-restorant e furra e bukës, nën administrimin e NFP (Ndërmarrjes së Furnizimit të Punëtorëve) Bulqizë.

Në këtë sektor që kishte përgjegjës Halit Kurtin, shërbenin me kulturë e inteligjencë, me tre turne: kuzhinierët e përgatitur profesionalisht Sadik Hoxha, Selim Leka e Farie Visha, banakierët Sinan Mani, Shaban Balliu, Can Zogu e Baftjar Xheleshi, shitësi shembullor i dyqanit me artikuj të përzier Xhetan Xhani, si dhe pjatararëset e sanitaret Naxhie Prençi, Shame Çiku, Xhevrie Krrashi, Hike D. Mëziu e Zenepe Sula.

Për shërbimin e tyre të kulturuar ata gëzonin respektin e masës së minatorëve e të punëtorëve të kësaj miniere, duke ndikuar në inkurajimin e tyre për të përballuar vështirësitë e tejkaluar planin e prodhimit të blloqeve të mermerit. Nga këtu e nisi karrierën e tij edhe Osman Hoxha, si infirmier i minierës, duke u shërbyer me përkujdesje maksimale minatorëve. Në vitet e mëvonshme e deri aktualisht, ai do të bënte karrierë si shef i shëndetësisë në drejtoritë e policisë të qarqeve Dibër e Tiranë.

Keqardhje për shkatërrimin e pasurisë së kësaj miniere gjigande pas '90-tës

Miniera e mermerit Guri i Kuq, Muhurr funksionoi në të gjithë parametrat deri në fillim të vitit 1991. Por ky aset

i çmuar i ekonomisë sonë kombëtare, pas '90-tës u braktis dhe u la në mëshirë të fatit.

Dora shkatërrimtare e disa eksponentëve kriminalë u vërsul mbi të si në mall pa zot. Në të ashtuquajturën periudhë likujdimi drejt shëndrrimit në shoqëri aksionere, u shkatërruan e u dërguan për skrap deri edhe makineritë e rënda të kësaj miniere (vinçat gjigandë, eskavatorët, arganellot, mjetet e oficinës mekanike si tornot, etj), me të cilat ishin prodhuar e nxjerrë dhjetëra mijëra metra kub blloqe të eksportuara në disa vende të botës.

Pati disa tentativa për privatizimin e saj, madje edhe nga ndonjë vendali, por u penguan në iniciativën e tyre nga konjunkturat dhe pazarllëqet e qarqeve mafioze.

Me gjithë përfoljet, ende nuk ka dalë në dritë emri i zyrtarit të lartë që thuhet se e ka marrë me koncension, por që në fakt mban peng zhvillimin e këtij sektori të rëndësishëm për Muhurrin e krejt Dibrën, ndërkohë që mermeri i Muhurrit është i kërkuar në gjithë tregun e brendshëm e atë ndërkombëtar.

II.
PERSONALITETE
QË NDEROJNË KOMBIN

...Nëse nuk do të ishim tkurrur
siç na dënoi historia "sipas festes",
Dibra do ishte "Konstadinopoja" shqiptare,
as Tirana, as Prishtina, as Lushnja
nuk do të ishin kryeqendra administrative
shqiptare. Vetëm Dibra, do të ishte.
Vetëm ajo. Sepse është në zemrën e lashtë
të atdheut shqiptaro-ilir.
Vetëm Dibra është si Berlina gjerman,
e ndarë më dysh: Dibra e Madhe
dhe ajo e këtejme. Dhimbje, por e vërtetë!

SHEFQET MEKO

Rrahman Parllaku - hero i që fitoi duke merituar lavdinë dhe pavdekësinë



Më 15 shtator 2019, pushoi së rrahuri zemra e heroit legjendar Rrahman Parllaku - "Hero i Popullit" dhe "Nderi i Kombit". Një ditë më pas, ai u përcoll për në botën e përtejme me të gjitha nderimet që meritonte një burrështetas si ai, me arkivolin mbi shtratin e topit dhe me 22 të shtënat në çastin e lamtumirës së fundit. Tashmë ai s'është fizikisht mes nesh, por shpirtërisht është me ne në çdo çast, pasi vepra e tij heroike e veshi atë me pavdekësi. Për të përjetësuar emrin dhe veprën e

tij, duke konsideruar propozimin e Kryesisë së OBVL-së (Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ-it), **Këshilli i Bashkisë Tiranë ka vendosur që segmenti rrugor që bashkon rrugën "Ali Demi" me rrugën "Petro Nini Luarasi" të emërtohet rruga 'Gjeneral Rrahman Parllaku'".** Banorët, së bashku me ndërlidhësit me komunitetin, kanë shprehur mirëkuptim dhe kanë dëshiruar këtë vendim. Ky është vlerësimi më i mirë që iu bëhet qytetarëve të metropolit shqiptar në kuadrin e 100- vjetorit të shpalljes së Tiranës kryeqytet i Shqipërisë.

Më 17 prill 2019, me rastin e 100-vjetorit të lindjes, Bashkia e Tiranës e nderoi atë me titullin "Simbol i qytetit të Tiranës". (Në 95-vjetorin e lindjes, gjeneral Parllakut i është dhënë nga Presidenti i Republikës dekorata e lartë "Nderi i Kombit"). Kryebashkiaku Veliaj e vlerësoi Parllakun si një nga figurat emblematike të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, që sfidoi edhe regjimin e diktaturës komuniste, si simbol i gjallë i kujtesës patriotike, qytetare dhe historike.

Dhe në të vërtetë, ai qe kthyer në simbol të gjallë të kujtesës patriotike, qytetare dhe historike. Shqiptarët ndihen krenarë me jetën dhe veprën e "Heroit të Popullit" dhe "Nderit të Kombit" Rrahman Parllaku, që bëri gjithçka në shërbim të atdheut, luftës për liri e rimëkëmbjen shqiptare. Prandaj, edhe vlerësimet dhe nderimet ndaj veprës së gjeneralit janë plotësisht të merituar.


Me gjeneral Parllakun ndihemi krenarë të gjithë. Ai ishte dhe mbetet përmendore e gjallë e traditës dhe e virtytit



familjar të trashëguar ndër shekuj. Opinioni publik ka mirëpritur edhe librat e ndryshëm të shkruar nga gjenerali, siç është ai me titull "Mirënjohje familjeve vlonjate që më mbajtën si birin e tyre", "Kosova, ëndrra e jetës sime", dhe librin me shtatë kapituj në 466 faqe "Një shekull në memorie". Me një kujtesë të jashtëzakonshme, me një mendjemprehtësi të madhe, gjeneral Parllaku ka bërë analiza brilante të situatave të vështira e delikate që ka kaluar vendi, politika dhe ushtria jonë.

E veçanta e gjithë ligjëratave të tij në shtypin e kohës dhe në veprimtari promovuese të librave kushtuar Luftës Nacional-Çlirimtare, si moment më lavdiplotë i popullit shqiptar, e heronjve të saj, ka qenë gjykimi i tij tepër i saktë, konciz, realist, pa mllafe, pa paragjykime... Ai e ka vlerësuar gjithnjë lart Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, arritjet dhe përpjekjet e popullit jo vetëm në rindërtimin e Shqipërisë së pasluftës, por edhe ato në fushën e arsimit, shërbimit shëndetësor, zhvillimit në tërësi të vendit, përfshirë edhe arritjet në mbrojtjen e fuqizimin e ushtrisë... si dhe këto vite të demokracisë e pluralizmit.

Nga jeta e këtij Matuzalemi na ulet "këmbëkryq" historia



Nga lufta dhe përkushtimi i tij atdhetar na vjen një model për t'u ndjekur, një figurë që ndrit e frymëzon, nxit dhe entusiazmon...

Nga veprimtaria e gjeneral Parllakut si veteran në këtë çerek shekulli të demokracisë mund të mësojmë se kurrë nuk është vonë për njeriun që të bëhet mbështetës aktiv i proceseve demokratizuese të shoqërisë. Heroi i Popullit

Rrahman Parllaku, si askush tjetër i brezit të vet, me shembullin, gjykimin, kontributin dhe objektivitetin e analizave, debateve e mendimeve të veta, me mbrojtjen që i bëri LANÇ, mendoj se "skaliti" para vdekjes monumentin e vet. Gjeneral Parllaku, u ringrit nga hiri, ferri dhe "mallkimi" i diktaturës që ai kurrë nuk e mendoj se do ishte e tillë.

Siç shkruan ai vetë "devotshmëria e rinisë shqiptare u keqpërdor deri në krim". Ai është një "viktimë e ëndrrave që besoi" si jo pak ushtarakë të shquar të luftës. Presidenti i Republikës, Ilir Meta, nëpërmjet një ceremonie të veçantë të zhvilluar në sallën "Skënderbeu" të institucionit të kreut të shtetit shqiptar, duke i uruar ditëlindjen e 100 - të "Heroit të

Popullit", veteranit të Luftës Nacional-Çlirimtare dhe të përndjekurit politik gjatë diktaturës komuniste, ndër të tjera tha se "i ngjizur në urtinë e odave lumjane dhe i burrëruar në Labëri, përgjatë një shekulli, gjeneral Rrahman Parllaku mbetet 'dëshmitar i gjallë' për të gjitha ngjarjet e një shekulli".

Kjo, sipas kreut të shtetit, për faktin se rrugëtimin 100-vjeçar, gjeneral Parllaku e ka përshkruar përmes fjalës e veprës së tij, duke mbetur një monument e pasuri kombëtare e paeksploruar plotësisht. "Ne nderohemi me ty, gjeneral! Pasi në jetën dhe veprën tuaj janë ulur këmbëkryq urtësia e burrit të malësisë, trimëria, shpirti i lirisë dhe atdhedashuria e luftëtarit antifashist dhe e komandantit partizan, si dhe angazhimi qytetar plot përkushtim. Si uji i kristaltë i lumit të bjeshkës ka rrjedhur jeta e këtij njeriu që sfidoi kohët dhe regjimet, me përkushtimin ndaj kombit, i pathyeshëm në betejat që iu imponuan apo i zgjodhi që të bënte përgjatë 100 viteve", është shprehur Presidenti Meta.

Në spiralet e historisë, gjeneral Parllaku ka ditur të lakohet me dinjitet, duke pasur si kolonë bazë përkushtimin kombëtar shqiptar dhe progresin shoqëror, si thelb i motivimit që gëlonte shpirtin e tij progresist e liridashës. Vështirë të përmbledhësh në pak radhë, në kuintesencë, motivimin e personalitetit të tij, zhvillimin konjitiv e psikomotor të këtij djaloshi që ngjitej nga Novosej i Kukësit në tribuna të larta shtetërore, në hero të popullit të tij, në drejtues madhor ushtarak, duke ndryshuar variablat në kontekste politike në funksion të mbijetesës dhe qëndresës, nga udhëheqës i shquar në të dënuar me burg, nga triumfator në grigjë të rrezikut për jetën, nga piedestali i kuadrit

të dobishëm në stigmën e "njeriut të rrezikshëm", ekstreme këto që provokuan në personalitetin e tij qëndrime dhe vlera të larta politiko-shoqërore në raportin e ndjenjave të forta estetike midis dashurisë dhe urrejtjes.

Këtë volum ideor dhe estetik e përcjell përgjatë shekullit të jetës së tij një burrë shtetar, një organizëm vital, një mendje koherente dhe një vizion largpamës dhe perspektiv.

Frymëzimi dhe dashuria për atdheun

“Retrospektiva dhe perspektiva kanë një prerje të artë në personalitetin e gjeneral Parllakut. Atë e përshkon frymëzimi dhe dashuria për atdheun e tij, si lajtmotiv vijues mbikohor, që çliron në rrethana tipike energji shpirtërore pozitive në luftën e jetës. Jeta e tij është një shëmbëlltyrë e rrallë që na fton të kuptojmë se jeta meriton të jetohet kur luftohet fort dhe fitohet.

Si një ushtarak, korrekt, i shquar, ai mbështetej në skrupuj të fortë të moralit kombëtar, me pikëvështrim të qartë dhe të kthjellët, duke ngjitur një nga një shkallët e karrierës ushtarake, si një gjigant hijerëndë që ngjitet i sigurt në bedenat e kalasë. "Kalaja" e pushteteve në kohë të ndryshme dhe situata të ndryshme, pati edhe shembje morale e politike, por këto nuk e dobësuan dhe pësulën gjeneral Rrahman Parllakun, këtë soj të fortë shqiptari, që me mençuri diti të manovrojë në spiralet e rrezikshme të historisë shqiptare”, shkruan Dr. Hajri Mandri.

Heroi i luftës në terren, i luftës dhe përballjes në gjyqe ushtarake, përballoi burgje e privime dhe fitoi duke merituar

lavdinë dhe pavdekësinë. Jeta iu afrua heroit herë me tufa me lule, herë duke u derdhur mbi të me tërë egërsinë e saj. Rrallë gjen shembuj të tillë të personalitetit, ku të jenë ngjizur e plazmuar në mënyrë aq mjeshtërore vetitë e karakterit të një intelektual patriot, të një drejtuesi e komanduesi të aftë ushtarak, të zgjuar dhe trim, të thjeshtë dhe të ndershëm, të bukur në trup, shpirt dhe mendime. Ai është një model i ardhur nga gjenocidi komunist si dëshmitar i gjallë për të kuptuar dhe vërtetuar peripecitë dhe traumat që kaloi ky popull i orientuar dhe i ideologjizuar gabimisht nga rryma dhe korrente të huaja. Mbi 20 vjet në krye të Organizatës të Bashkuar të Veteranëve të Luftës, me ndershmëri dhe principe të larta morale, ka kontribuar në ndriçimin e mjaft skenave dhe protagonistëve, të vërtetave dhe kërkimeve historike, duke dhënë edhe në moshë pensioni një ndihmesë të vyer në emancipimin politiko-shoqëror e demokratik të shoqërisë. Si një lundërtar i shquar, ai e drejtoi varkën e shpëtimit duke kapërcyer me sukses tallazet e historisë deri në brigjet e paqta të demokracisë që po jetojmë.

Jo vetëm gjatësia kohore e jetës, por dendësia dhe përmbushja e saj me veprime, qëndrime dhe vlera në përmbajtjen e saj, e bënë këtë figurë të lartësohet në nderimin tonë shoqëror, ku zëri dhe mesazhet e tij dëgjohen deri në organizata famoze ndërkombëtare. Në këtë vështrim, gjeneral Rrahman Parllaku përbën një shembull frymëzimi për atdhedashurinë dhe përkushtimin qytetar. Ai mbetet "monument" në memorjen e kombit, që nuk ka stuhi ta rrëzojë apo zvetënojë. Heroi i Popullit Rrahman Parllaku, jetoi duke fituar e merituar lavdinë dhe pavdekësinë.

Dali Ndreu, strategu që udhëhoqi Luftën për çlirimin e Tiranës

• Nga 18 gusht 1944 drejtoi Korp-Armatën e I-rë të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Shqipërisë, i pari dhe më i madhi i formacioneve ushtarake



• Në krye të Korp-Armatës së I-rë, gjeneral major Dali Ndreu drejtoi veprimet e njësiteve luftarake për çlirimin e Tiranës, njëherazi ato për çlirimin e Lezhës dhe të Shkodrës etj, deri në çlirimin e plotë të të gjithë Shqipërisë

Historiografia e sistemit monist për tri dekada (1960-

1990) shtrembëroi të vërte-tat e një prej epopeve më të lavdishme të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, siç ka qenë beteja për çlirimin e Tiranës. Nën diktatin e nomenklaturës së kohës që synonte shbërjen e familjeve të mëdha, siç qe ajo e patriotit Elez Isuf Ndreu e Sllovës së Dibrës, u fshi qëllimisht nga historiku i asaj lufte heroike emri i gjeneral - major Dali Ndreut si drejtues i saj.

Në jubileun e 75-vjetorit të çlirimit të Tiranës, ishte prof.dr.Paskal Milo ai që pohoi të vërtetën e pamohueshme të drejtimit të betejës legjendare për çlirimin e kryeqytetit shqiptar prej pushtuesit nazifashist nga gjeneral major Dali Ndreu. Pas shtrembërimeve të qëllimshme nga historiografia komuniste ky është ndoshta rasti më konkret ku hidhet dritë për një akt kaq madhor. Gjatë një interviste televizive, historiani Milo ndër të tjera tha se: "Urdhri për të realizuar betejën për çlirimin e Tiranës, u dha në fundit e tetorit të vitit 1944 nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare, për t'u zbatuar nga Korp-Armata e I-rë me komandant Dali Ndreun, ku në përbërjen e saj ishin disa brigada. Lufta për çlirimin e Tiranës ishte pa dyshim një luftë shumë strategjike, se çlirimi i kryeqytetit ishte simbol i çlirimit të gjithë vendit".

Duke argumentuar më së miri këtë të vërtetë historike të pamohueshme, historian i mirënjohur, Milo e vlerëson luftën për çlirimin e Tiranës si betejën më të madhe të Luftës Nacionalçlirimtare, që kurorëzoi atë fitore, e cila 12 ditë më pas do t'i vinte vulën çlirimit përfundimtar të Shqipërisë. Dita kur trupat gjermane tërhiqeshin drejt Tiranës dhe u

zunë në pritë nga forcat partizane, duke ndezur një betejë gjaku e zjarri për 24 orë rresht, përfundoi me bilancin tragjik të humbjes së jetëve të 2000 ushtarëve gjermanë dhe të afërsisht 300 partizanëve.

Ndaj dhe duhet të kujtojmë me nderim e respekt të veçantë ata që ideuan, drejtuan dhe realizuan fitoren e asaj betejë legjendare, heronjtë dhe dëshmorët e saj. Dhe padyshim edhe strategun e kësaj lufte, komandantin legjendar Dali Ndreu.

Dali Ndreu, figura numër dy e luftës partizane



Për vetë postet drejtuese, gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare deri zëvendëskomandant i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral major Dali Ndreu njihet si numri dy i ushtrisë partizane. Kjo edhe për faktin se ka drejtuar me

guxim, trimëri e largpamësi disa beteja duke trimfuar ndaj pushtuesit nazifashist të vendit.

Ai ka lindur në Sllovë të Dibrës më 10 mars 1912 në familjen e madhe të patriotëve Elez Isufi e Sufë Xhelili, të njohur si prijësit legjendarë të luftës nëntë vjeçare (1913-1921) të dibranëve kundër shovinistëve serbë. I biri i Isufit dhe Xhevrijes, i lindur, rritur dhe edukuar në këtë mjedis atdhetarësh do të krijonte një karrierë të shkëlqyer intelektuale e akademike. Më 1931, pasi kreu studimet në Shkollën Ushtarake të Plotësimit si oficer artilerie u gradua nëntoger. Fillimisht shërbeu në degën e rekrutimit në Përmet, më pas në artilerinë e divizionit "Kosova", deri më 1933. Pasi kishte rënë në kontakt me lëvizjen komuniste të asaj kohe, u anëtarësua në Grupin e Tiranës të themeluar dhe drejtuar nga arsimtari Hasan Reçi, ku merrnin pjesë shumë oficerë. Ai është në radhën e atyre përparimtarëve të asaj kohe që u dënuan si organizatorë dhe përkrahës të Kryengritjes së Fierit më 1935. Pikërisht atëhere u shkarkua si oficer.

Dali Ndreu rridhte nga familja e ndritur e Elez Isufit. Ai ishte i zellshëm për të avancuar nivelin e vet arsimor duke shprehur interesim ndaj dijes dhe shkollimit si hap i rendësishëm në rininë e tij. Pas daljes nga burgu, vijoi studimet për shkencë ekonomike në Firence. Në vitet 1940-1941 inkadrohet në radhët e formacioneve partizane. Ai dha kontribut të veçantë në ngritjen e strukturave të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, pasi kishte aftësi të spiktatura organizuese dhe drejtuese. Madje, siç shkruan dr.Vangjel

Kasapi: "Në prill të 1942-shit, para Konferencës historike të Pezës, në Sllovë të Dibrës, formohet njësitë luftarak, që u rrit në çetë me komandant Dali Ndreun. Kudo në aksione shquhet për trimëri dhe aftësi drejtuese ushtarake.

Falë origjinës së familjes, për kontribute të spikatura atdhetare-luftarake, dije profesionale, trimëri, drejtësi, gjakftohtësi dhe aftësi komunikuese me njerëzit, prej nga gëzonte ndikim të ndjeshëm në popull, në mbledhjen për krijimin e Shtabit të Përgjithshëm të UNÇ-së, Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar e zgjedh Daliun anëtar dhe zëvendëskomandant të këtij institucioni strategjik ushtarak. Pas major Spiro Moisiut (komandant), Dali Ndreu vinte figura numër dy ushtarake në Shtabin e Përgjithshëm të Luftës dhe Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Kjo u vlerësua si një ngjitje e madhe e dibranit 31-vjeçar. Gjatë përzgjedhjes u vlerësuan aftësitë e shumanshme ushtarake, karakteri i paepur, maturia dhe pjekuria për gjykimin e situatave, në përpunimin dhe marrjen e vendimeve".

Për meritat e tij, bazuar edhe te kontributi historik i familjes, Dali Ndreu që me krijimin e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare caktohet zëvendëskomandant i shtabit, pra figura numër dy e luftës partizane. Por njëherësh shquhet si një komandant i zoti me aftësi dhe reputacion. Brigada e III-të Sulmuese ishte formacioni ushtarak që ai drejtoi në fillimet e Luftës Nacionalçlirimtare. Pas 24 Majit 1944 drejtoi Divizionin e I-rë Sulmues. Me vendimin nr.11, të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar, propozuar me shkresën nr.226, datë 16.8.1944, Dali Ndreu gradohet nga

"kolonel" në "gjeneral-major". Nga 18 gusht 1944 drejtoi Korp-Armatën e I-rë të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Shqipërisë, i pari dhe më i madhi i formacioneve ushtarake deri atëherë. Në krye të këtij formacioni ushtarak të kohës, ai drejtoi mjeshtërisht dhe me sukses strategjik veprimet e njësiteve luftarake të shumta për çlirimin e Tiranës, njëherazi ato për çlirimin e Lezhës dhe të Shkodrës etj, deri në çlirimin e plotë të të gjithë Shqipërisë.

Si udhëheqës i lartë ushtarak, një nga personalitetet e Luftës e të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, ai zgjodhi e mbajti një qëndrim shumë të arsyeshëm në marrëveshjet me aleatët ushtarakë të Koalicioni Antifashist Botëror. Anëtari dhe zëvendësi i Shtatmadhorisë, komandanti strategjik, gjeneral-major Dali Ndreu mund të konsiderohet në historiografinë ushtarake të LANÇ-it e të UNÇSh-së autori i parë i përgjithësimit shkencor dhe i botimit në shtypin ushtarak (gazeta "Luftëtari", 1945-'47, sidomos i tri operacioneve më të mëdha operative-strategjike: thyerja e mësymjeve të përgjithshme naziste të dimrit (1943-44) e të verës (1944) dhe të operacionit mësymës për çlirimin e kryeqytetit - Tiranës, kur autorë të tjerë, gjeneralë e studiues nuk ishin shfaqur në mënyrë kaq sintetizuese në opinion publik, ndonëse më vonë ata i zgjeruan e i thelluan ato operacione madhështore të historisë moderne ushtarake të popullit dhe ushtrisë shqiptare.

Daliu Ndreu ishte një fenomen ushtarak, një "Napoleon" në sulm për çlirimin e atdheut nga pushtimi nazist gjerman. Emri i tij sikur u njëhua me fitoren dhe suksesin në ato vite të para të pasluftës. Por "kuçedra", që menjëherë pas çlirimit

filloj të hajë bijtë e vetë, do t'i vërsulej pabesisht dhe egërsisht edhe drejtuesit të luftës partizane, Dali Ndreu.

Strategu që kishte shërbyer në formacionet e Dibrës dhe të Tiranës, ish - anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë NAÇL dhe numri dy i saj; ish komandant i Brigadës së Tretë, komandant i Divizionit të Parë dhe komandant i Korpusit të Parë deri në çlirimin e vendit dhe pas çlirimit, komandant i Prapavijës në Ushtri, ish-deputeti i parë i Dibrës në legjislaturën e vitit 1945, ndërsa në administratën shtetërore të pasçlirimit zëvendësministër - njëri nga tre gjeneralët e asaj kohe (përveç E.Hoxhës dhe Spiro Moisut), pikërisht Dali Ndreu, që në korrik të vitit 1945 ishte dekoruar me medaljen më të lartë të asaj kohe, "Ylli Partizan" të Klasit I-rë, dhjetë vjet më vonë, në vitin 1956 arrestohet në bahçen e tij në Sllovë, për t'u dënuar dhe pushkatuar pas një procesi të montuar politik më 25 dhjetor 1956, sëbashku me Liri Gegën, bashkëshorten e tij. Kishte filluar kaskada e shfarosjes të të zotëve që tregoi lufta. Dali Ndreu ishte viktimë e "shpatës komuniste" që vit pas viti do priste koka drejtuesish dhe intelektualësh që krijonin hije ndaj "shkëlqimit" që kërkonte absolutisht për vete dhe vetëm për vete, Enver Hoxha. Asgjësimi familjar i Dali Ndreut ishte si të thuash "parathënie" e kokave të prera që natyrisht do arrinte kulmin e "shkatërrimin familjar" të ish-kryeministrit më jetëgjatë Mehmet Shehu më 1981. Fati tragjik i Dali Ndreut ishte ndër "kambanat e para" që askush nuk i dëgjoi, askush reagoi, askush nuk protestoi në "demokracinë popullore", por gjithkush heshti apo duartrokiti vdekjen.

Ishin netët e para të errësirës që vinte. Dali Ndreu mbase nuk e priste atë egërsi vdekjeprurëse nga ata që u besoi se luftohej për atdhe dhe të ardhme, për "liri dhe barazi" siç ishin sloganet e kohës që mobilizuan vegjëlinë shqiptare. Heshtën të gjithë në ato vite. Kjo heshtje kobzezë, ky pajtim i heshtur, nga ky mosreagim në kohë i "shokëve të partisë", solli kultin dhe pushtetin absolut të Enver Hoxhës.

Liri Gegën e pushkatuan shtatzënë dhe i dogjën eshtrat me acid

Kanë kaluar dekada që nga dita më e kobshme e jetës së saj, por Lavdie Merlika-Ndreu, vajza e vetme e Dali Ndreut e Liri Gegës, që aktualisht jeton në Laprakë, e ka të ngulitur në memorie ndarjen tragjike me prindërit e saj: çastin e arrestimit, lajmin për vdekjen e tyre dhe pushkatimin e nënës shtatzënë. E rritur me brengën dhe dhimbjen e tyre, kujton se ka qenë vetëm tetë vjeçe atëherë, por i mban mend me detaje rrethanat e tragjedisë dyfishe.

"Sa kishim shkuar te xhaxhai në Sllovë, kur erdhën dhe i arrestuan papritur. Thanë se i kapën në kufi duke u arratisur. Pas tre muajsh mbërriti lajmi se i dënuan me vdekje si armiq të popullit", kujton ajo. Ndërsa në dokumentet e sigurimit të shtetit shqiptar rezulton se prindërit e saj, dy nga personazhet e njohura të lidershipit komunist, janë pushkatuar në të njëjtën ditë, me akuzën për "tradhti ndaj atdheut dhe tentativë arratisjeje" për të kaluar kufirin për në Maqedoni. Lavdia thotë se ky është një mashtrim i

paskrupullt. "Ata janë arrestuar në oborrin e shtëpisë së xhaxhait, në Sllovë të Dibrës. A mund t'i thuash kufi shtetëror portës së gjyshit ku kishim shkuar për të qëndruar disa ditë?! Marrëzi, marrëzi pa fund... Atë skenë e kam parë nga afër. Atëherë isha tetë vjeçe. Arsyeja që kishim shkuar në vendlindjen e prindërve në Sllovë lidhej me shëndetin e vëllait, Sokolit. Ai ishte dy vjeç dhe vuante nga një sëmundje kronike. Ishte kuruar në spitalin e Tiranës dhe mjekët kishin rekomanduar të frekuentonte klimë malore. Ndaj, prindërit vendosën të shkonim në Sllovë. Aty kemi mbërritur një natë para se t'i arrestonin", kujton Lavdia me sytë e përlotur. Sot ajo është bërë gjyshe dhe kujton gjithë genocidin e pashembullt që kaloi familja e saj dhe gjithë fisi emërndritur Ndreu i Sllovës. Me prindërit është ndarë kur ishte tetë vjeçe. Asokohe jetonin në katin e dytë të një shtëpie private te Rruga e Kavajës. Dali Ndreu e Liri Gega kishin ardhur aty fill pas luftës. "Babai, me sa mbaj mend, ishte drejtor i ndërmarrjes së ndërtimit, po shpesh e thërrisnin 'gjeneral'. Mamaja punonte mësuese në shkollën pedagogjike te Rruga e Elbasanit.

Unë vazhdoja shkollën te 'Hasan Vogli'. Si fëmijë, kuptohet nuk kisha si t'i dija peripecitë që kishin kaluar prindërit deri atëherë. Ajo që ndieja ishte rrallimi i vizitave të miqve dhe shokëve të tyre, të cilët dikur hynin e dilnin shpesh,-është shprehur Lavdia në një intervistë para disa vitesh. Por gjithsesi, nga memoria e saj nuk shqitet momenti i arrestimit të prindërve.

"Teksa rrija e shtangur para gruas së xhaxhait, dëgjova zërin e mamasë që i thoshte: "Amanet djalin, Sokolin!"

Sakaq, u hodh babai qortueshëm: "Amanet Lavdijen, se ajo do t'i mbajë mend të gjitha"! Kaq ishte gjithçka. Ku ta dija se ai do të ishte komunikimi i fundit me ta. Tek u ndamë, i ndoqa me sy derisa i futën forcërisht në makinë. Deri në fund mamaja nuk i shkëputi sytë nga unë...".

Rrëfim vërtetë tronditës i vajzës së një prej gjeneralëve më të shquar të LANÇ-it, Dali Ndreu dhe bashkëshortes së tij Liri Gega, të eliminuar nga diktatori E. Hoxha me skenarin ogurrzi të "tradhtisë ndaj atdheut". Diktatori shihte ëndërra me skenarë të sajuar për rrëzimin e tij nga fronti, ndaj dhe nuk nguroi të shpallë armiq e të eliminojë një nga një ish - gjeneralët që organizuan dhe udhëhoqën Luftën e lavdishme Nacionalçlirimtare. Vetëm një mendje e çmendur mund të shpallte "agjent të Beogradit" dhe me këtë akuzë absurde të ekzekutonte një gjeneral të shquar si Dali Ndreu, bir i një fisi të madh dhe të njohur për tradita patriotike. Dhe për më tej, të arrinte deri në krimin makabër të ekzekutimit të nënës shtatzënë (me fëmijë në bark) Liri Gega dhe të djegies së eshtrave të saj me acid...

Dali Ndreu - nga "armik i diktaturës", sot "NDERI I KOMBIT"

Më 15 gusht 2007, në Qendrën Kulturore të Ushtrisë Tiranë (ish-SHQUP-i), u organizua ceremonia e dekorimit të Gjeneral Dali Isuf Ndreu, me Urdhërin e lartë "Nderi i Kombit" (pas vdekjes), akorduar nga ish-Presidenti i Republikës Alfred Moisiu, me dekret Nr 5403, datë

17.07.2007. Ceremonia u organizua nga Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ. Në këtë ceremoni ku morën pjesë personalitete të larta politike të asaj kohe, deputetë e oficerë madhorë, miq dhe të afërm të familjes Ndreu, mbi jetën dhe aktivitetin e gjeneral Dali Ndreut foli Heroi i Popullit, gjeneral-lejtënant Rrahman Parllaku. Mbi të gjitha, Parllaku evidentoi rolin determinant të gjeneral-major Dali Ndreut në organizimin, drejtimin dhe fitoren e luftës për çlirimin e Tiranës.

"Drejtimi i Operacionit iu ngarkua komandës së Korp-Armatës së Parë me komandant gjeneral Dali Ndreun, e cila krijoi një grup operativ për drejtimin e luftimeve në kryeqytet. Për zhvillimin me sukses të operacionit, Komanda e Përgjithshme i dha në vartësi Korp-Armatës së Parë, përveç tri brigadave: I, IV dhe III, edhe brigadat e XV dhe XXIII",- tha ndër të tjera gjeneral Parllaku në atë ceremoni mbresëlënëse, ku me propozimin e tij, Dali Ndreu, i dënuar dhe ekzekutuar tragjikisht nga diktatura komuniste, tashmë do të shpallej "Nderi i kombit". Dhe duke rrëfyer të vërtetat e LANÇ-it Parllaku vijoi: "Kush e ka drejtuar këtë luftë?! Mos vallë "jashtëtokësorët", pasi nuk ka asnjë emër komandanti nga Korp-Armata, grupi i drejtimit direkt të luftës në qytet dhe të asnjë komandanti të 11 brigadave! Për mua nuk përbën ndonjë çudi, por ndonjë i ri ose persona që e dinë se njësitë e repartet në luftë komandohen, duan të dinë se kush ka qenë në krye të këtyre reparteve. Prandaj, nuk përmenden emrat e gjeneral Dali Ndreut - komandant i Korp-Armatës I, që drejtoi operacionin për

çlirimin e Tiranës, Mehmet Shehut - komandant i divizionit dhe drejtues i shtabit të këtij operacioni, si dhe emrat e drejtuesve të tri brigadave që vepruan direkt dhe drejtuan me mençuri, largpamësi, guxim e heroizëm luftimet e kryeqytetit, si: Muhamet Prodani, Arif Hasko, Nexhip Vinçani, Pëllumb Dishnica, Qazim Kondi e Bajram Sinojmeri. Të tillë kanë qenë edhe drejtuesit e 8 brigadave të tjera, po edhe emrat e tyre nuk përmenden".

Do të duhej kjo dëshmi e legjendarit në kufirin e dy kohëve, Rr.Parllaku (i cili fatmirësisht jetoi një shekull dhe la të shkruar të vërtetat e pamohueshme të LANÇ), për të hedhur dritë mbi të vërtetën e organizimit e të drejtimit të betejës për çlirimin e Tiranës dhe për vlerësimin e komandantit të kësaj beteje Dali Ndreu, duke i dhënë atij dekoratën e lartë "Nderi i Kombit". Dali Ndreu ishte një yll që shkëlqeu në vargun e personaliteteve ushtarake shqiptare, por që, për fat të keq, u fik shpejt, atëherë kur mund të ndriçonte më tepër.

Nderimi i jetës dhe kontributit real të viktimave të "Kultit Enver Hoxha", është përgjegjësi e një shoqërie të lirë dhe të emancipuar. Natyrisht ky nderim nuk bëhet thjesht me një dekret apo dekoratë sado e lartë qoftë ajo. Ky nderim bëhet duke rishkruar historinë e luftës dhe pasluftës ashtu siç ka qënë, e saktë, e vërtetë, me fakte, me heronj realë dhe me "gllabërues" të heroizmave të të tjerëve. Lufta Antifashite Shqiptare nuk ishte thjesht një luftë e fitore e "Komandantit Enver Hoxha" siç propogandoi shteti i dominuar nga Enver Hoxha. Jo! Ajo, ishte një luftë e një

populli të tërë, ishte luftë dhe fitore e partizanëve që dhanë jetën, gjeneralëve që organizuan sulme dhe beteja, e komandantëve të çetave dhe brigadave që ishin të shumtë, shumë më shumë se një emër që vodhi të gjitha meritat dhe sukseset e të tjerëve duke krijuar "Xhaxhin e Madh", e duke gruposur të vërtetat.

Jeta, kontributi dhe ekzekutimi i Dali Nderiut është vetëm një shembull nga "Tragjedia komuniste". Një shoqëri e lirë duhet të mësojë të vërtetat që tragjedia të mos përsëritet më kurrë. Kurrë!

"Dekorata e Artë e Shqiponjës" për kolonel Myfit Guxhollin

Myfit Guxholli ishte pjesë e brezit që kryen dhe fituan luftën kundër fashizmit e nazizmit, duke rreshtuar Shqipërinë në krahun e fitimtarëve botërorë. Mbas çlirimit të vendit nga pushtuesit nazifashistë, me hapjen e shkollës "Skënderbej" mbaron me rezultate të mira dy vite mësimore të kësaj shkolle dhe më pas mbaroi Shkollën e Lartë të Topografisë Ushtarake në Leningrad (ish-Bashkimi Sovjetik). Ai ka kryer detyra të rëndësishme në ushtri.

Koloneli 91-vjeçar Myfit Guxholli, një nga personalitetet e shquara të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe të Ushtrisë Shqiptare, më 25 mars 2021, humbi betejën me SARS-CoV-2. Kryetari i OBVL-së, i rezistoi për disa ditë pandemisë të sëmundjes së koronavirusit (COVID-19),

fillimisht në Spitalin Amerikan të Tiranës dhe më pas në shtëpi, nën përkujdesjen e mjekëve e veçanërisht njerëzve të familjes, vajzës së tij, prof.dr.Zana Guxhollit, djalit Artanit, nipërve e mbesave, deri sa të premtën e 25 marsit 2021, para dite zemra e tij pushoi së rrahuri. Ai u përcoll për në banesën e fundit me të gjitha nderimet që meritonte.



Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta dergoi një mesazh ngushëllimi për Familjen Guxholli dhe Kryesinë e OBVL-së, ku vlerësoi kontributin e jashtëzakonshëm të Kolonel Guxhollit në shërbim të Shqipërisë, i cili do të mbetet i paharruar dhe burim frymëzimi për gjeneratat e ardhshme, si shembull i shkëlqyer i patriotizmit dhe atdhedashurisë.

Ndërsa, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, Gjeneralmajor Prof. Asoc. Bajram Begaj, në telegramin e ngushëllimit, që ia dorëzoi familjes së të ndjerit Gjeneral

brigade Manushaqe Shehu, zv/Shef i Shtabit të Përgjithshëm të FA të RSH, ndër të tjera shprehet se: "Myfiti të gjithë karrierën e tij ushtarake e ka në fushën e mësimdhënies me një kontribut të jashtëzakonshëm në përgatitjen e brezave të tërë oficerësh topograf në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve, por edhe në Akademinë e Mbrojtjes e deri në detyrën e tij më të lartë si kryetopograf në degën e topografisë në Ministrinë e Mbrojtjes. Myfiti është autor e bashkautor i dhjetëra artikujve shkencorë, rregulloreve të ndryshme, si dhe pjesëmarrës me referate e kumtesa cilësore në disa simpoziume e konferenca shkencore"

Po ashtu, familjarë, të afërm, veteranë e pasardhës, bënë homazhe në nderim të jetës dhe veprës së kryetarit të OBVL-së. Në emër të Kryesisë së OBVL-së vendosën një kurorë me lule nënkryetarët Maksim Vinçani dhe Mirjana Ohri. Fjalën e lamtumirës e mbajti nënkryetari i OBVL-së, Maksim Vinçani.

"DEKORATA E ARTË E SHQIPONJËS"

shkëlqen në gjerdanin e artë të titujve të nderit

Lajmi i hidhur për ikjen e papritur për në botën e përtejme të kolonelit me kontribut madhor në LANÇ e në Ushtrinë shqiptare si oficer, pedagog e dekan i Shkollës së Bashkuar tronditi mbarë opinionin publik mbarëshqiptar. Kjo edhe për faktin se vetëm para një viti ai festoi 90-vjetorin e lindjes në një ceremoni shtetërore, ku u dekorua nga Presidenti i Republikës me "Dekoratën e artë të shqiponjës". Ai u shfaq




në këtë ceremoni plot vitalitet dhe me mendje e trup të shëndoshë, premtues se do ta drejtonte edhe për shumë vite Organizatën e Bashkuar të Veteranëve, themelues i së cilës ai ishte që në 18 korrik 1944, sëbashku me emra të spikatur të historisë sonë kombëtare.

Në më shumë se dy dekada veprimtari intensive, kolonel Guxholli dha

kontribut maksimal në konsolidimin e strukturave të OBVL-së, si nënkryetar dhe kryetar i saj, krahas themeluesve, ish- veteranë të LANÇL, drejtues të spikatur të formacioneve partizane dhe më vonë të ushtrisë shqiptare, si Dr.Ymer Dishnica, gjeneral Rahman Parllaku, Skënder Malindi, Edip Ohri, Hamit Keçi, Tahir Voshtina, Shaban Reçi, Liri Belishova, Sotir Budina, Jorgji Terca, Genci Ballanca, Fluturak Vinçani, Isuf Imeraj etj, si dhe me pasardhësit: Maksim Vinçani, Muharrem Gjoka, Xhemal Meçi, Sakip Cami, Ali Demushi, Kol Deda e dhjetra figura të tjera të shquara.

Një personalitet i përmasave të tilla, padyshim që ishte vlerësuar me Urdhëra, Tituj e Medalje të ndryshme, por me të drejtë ai vlerësonte si primare në gjerdanin e artë të këtyre vlerësimeve "Dekoratën e Artë të Shqiponjës" që

iu akordua nga Presidenti Meta në 90-vjetorin e ditëlindjes së tij. Kjo edhe për faktin se "Dekorata e artë të shqiponjës" (e njohur si "Medalja e Artë e Shqiponjës" në vitet 1996-2013), është një dekoratë nderi e Republikës së Shqipërisë, që u jepet qytetarëve shqiptarë dhe të huaj për trimëri në luftën e armatosur dhe për veprimtari ose akte të guximit qytetar në kohë paqeje. Kolonel Myfit Guxholli e meritonte plotësisht dekorimin me këtë Urdhër të Artë. Kreu i shtetit vlerësoi kështu kontributin e ish-partizanit, kolonelit veteran Myfit Guxholli, i cili ka kryer me sukses detyra të rëndësishme



në Ushtrinë Shqiptare dhe si bashkëthemelues i OBVL-së, me dr.Ymer Dishnicën, gjeneral Parllakun, Liri Belishovën, Edip Ohri, Skënder Malindin e dhjetëra personalitete tjera të LANÇ-it e të Ushtrisë Shqiptare. Myfit Guxholli drejtoi me përkushtim Organizatën e Bashkuar të Veteranëve të LANÇ-it, deri në çastin e fundit të jetës së tij.

Kush ishte kolonel Guxholli

Kolonel ing. Myfit Guxholli ka lindur në Pogradec, më 7 qershor 1930. Ishte vetëm 9 vjeç kur iu bashkua lëvizjes së rinisë pogradecare, që kërkonte armë për të shkuar në Durrës, që të luftonin kundër pushtimit fashist të vendit. Po ashtu, pas një viti, nga urrejtja për inxhinierin italian që ishte major i SIM-it dhe që punonte në minierën e kromit "Guri i Kuq", e qëllon atë me një gur në bel. Myfiti i shpëtoi arrestimit, pasi e fshehu rinia pogradecare ndërmjet protestuesve. Shkollën fillore e kreu në vendlindje dhe më pas studioi për dy vjet në liceun e Korçës. Myfiti rrjedh nga një familje e pasur atdhetare dhe patriotike. Gjatë okupimit nazifashist të vendit, familja e tij u përfshi e tëra në luftën kundër okupatorit, madje babai i tij u burgos për aktivitet antifashist.

Myfiti, megjithëse në moshë fare i ri, që në shkurt 1944, u rreshtua në radhët e Ushtrisë partizane në Brigadën e IV Sulmuese, si kuadër i kësaj brigade. Mbas çlirimit të vendit nga pushtuesit nazifashistë, me hapjen e shkollës "Skënderbej" mbaron me rezultate të mira dy vite mësimore të kësaj shkolle dhe më pas mbaroi Shkollën e Lartë të Topografisë Ushtarake në Leningrad (ish-Bashkimi Sovjetik). Pas diplomimit u emërua në degën e topografisë në Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë. Krahas detyrës së tij funksionale, ai vazhdoi studimet edhe në fakultetin e inxhinierisë së Universitetit të Tiranës, në mbarim të të cilit u titullua "Inxhinier topograf".

Ai ka kryer detyra të rëndësishme në ushtri. Pasi u gradua nëntoger u emërua kryetopograf, më vonë shef seksioni dhe

nënkryetar dege të topografisë pranë Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare. Gjatë viteve 1952-1961 ka marrë pjesë në organizimin, projektimin dhe zbatimin në terren të të gjitha punimeve topogjeodezike për sigurimin topografik të ushtrisë në të gjithë territorin e Shqipërisë.

Është bashkautor, së bashku me specialistët e huaj në projektimin e zbatimin në praktikë në terren të triangulacionit shtetëror (arshiva IGU/1954). Nga viti 1961 deri në 1985 shërbeu në shkollën e bashkuar të oficerëve (sot akademia "Skënderbej") si pedagog, shef cikli dhe shef i katedrës së topografisë, me gradë "Major". Gjatë kohës së mësimdhënies dhe drejtimit të katedrës, ing. Myfit Guxholli ka një aktivitet të pasur shkencor e pedagogjik.

Veprimtaria krijuese e shkencore e ing. Myfit Guxholli

Ka përgatitur cikle të plota të leksioneve ushtarake në gjeodezinë e lartë, në gjeodezinë inxhinierike, si dhe leksionet e gjeografisë ushtarake për Akademinë e Mbrojtjes dhe atë "Skënderbej". Në vitin 1986 boton tekstin mësimor "Gjeodezia", të përshtatur për studentët e specialitetit topograf në akademinë "Skënderbej", por dhe për studentë të tjerë të specialiteteve të ndryshme, që studiojnë gjeodezinë, si xhenio etj. Po ashtu, ai është bashkautor i hartave të territorit shqiptar të shkallëve 1 : 25000 - 1: 50000 (projektet në IGU Tiranë). Ing. Myfit Guxholli është autor i dhjetëra artikujve shkencorë, ndërkohë që ka përgatitur

rregullore të ndryshme dhe ka mbajtur referate e kumtesa cilësore në disa simpoziume e konferenca shkencore.

Duke vlerësuar aktivitetin e pasur të tij në vitin 1973, katedra e topografisë e Akademisë Ushtarake "Skënderbej" propozoi që ing. Myfit Guxholli t'i jepej titulli "Docent", por pas ngjarjeve të atyre viteve të "stuhishme", propozimi i asaj katedre u pezullua. Me ndryshimin e sistemit komunist, Myfiti familjarisht përfshihet në proceset demokratike, duke dhënë një kontribut të shquar në fitoren e demokracisë. Ai ka qenë një nga organizatorët e krijimit të Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës (OBVL), së bashku me dr.Ymer Dishnicën, gjeneral Rrahman Parllakun, Liri Belishovën, Edip Ohrin, Skënder Malindin e dhjetëra personalitete të tjera të LANÇ-it e të ushtrisë shqiptare. Për kontributin e tij, kol. ing. Guxholli është zgjedhur zv/kryetar i kësaj organizate që nga themelimi dhe që nga data 1 nëntor 2019 është kryetar i saj, duke punuar me përkushtim për edukimin patriotik të brezave. Për të gjitha këto merita, Kryesia e OBVL-së i ka propozuar edhe Këshillit të Bashkisë që ta shpallë atë "Qytetar Nderi të Pogradecit".

Si e mohoi pushteti komunist kontributin e familjes Guxholli në luftë

Kolonel ing. Myfit Guxholli i përket familjes së njohur pogradecare, që shkriu pasurinë e saj për Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare. Në vitet 1920-1940, pogradecarët lundronin përmes liqenit për në Ohër e Strugë dhe merrnin



mallra që andej me tragetin "Ylli i bardhë". Tragetin, në pronësi të Nevruz Pasho Guxhollit, transportonte misër e grurë, çimento, dërrasa e materiale të tjera ndërtimi. Kur sapo ishte fuqizuar ekonomisht, familja Guxholli më 1930, kishte blerë në Greqi një fabrikë mielli, e cila siguronte miell për qytetin e rrethin e Pogradecit, por edhe për Korçën, Bilishtin e Ersekën.

Në përshtatje me realitetin ekonomik të atyre viteve, Nevruz Pasho Guxholli ishte aksioner edhe në shoqërinë private të sjelljes së dritës elektrike në qytetin e Pogradecit. Dhe jo vetëm kaq, por si një nga biznesmenët e njohur të asaj kohe, krahas fuqizimit ekonomik të familjes, kishte filluar të merrej edhe me politikën provinciale të kohës.

Ai ishte marrë me tregti e njëkohësisht kishte qenë edhe këshilltar në administratën vendore qysh në vitin 1923. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, kjo familje, si dhe gjithë fisi Guxholli, e kundërshtuan pushtimin e atdheut. Për

veprimtari patriotike dhe për qëndrimin e tij kundër okupatorit fashist, Nevruzi, burgoset në Korçë në vitin 1943. Pas kapitullimit të Italisë fashiste arratiset nga burgu së bashku me shokët e tij dhe me armë në dorë i bashkëngjitet Lëvizjes Nacionalçlirimtare, ndërkohë që djemtë e tij, Bexheti, Qemali, Arefiu dhe Myfiti, si partizanë u rreshtuan në krah të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. U burgosën si antifashistë tre vëllezërit, të cilët kishin lënë shkollën dhe ishin lidhur me Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Në Luftën Antifashiste, qysh në fillimet e saj, u përfshi e gjithë familja Guxholli, ndërsa me armë në dorë luftuan tre djemtë e kësaj familjeje. Është i njohur aktiviteti i tyre: Bexheti, që në maj 1943, me çetën e Mokrës e batalionin "Reshit Çollaku"; Myfiti, si kuadër në Brigadën IV S; Qemali, në qytet me grupet antifashiste dhe Arefiu i vogël, korrier me partizanët e Mokrës. Por gjithsesi, edhe kjo familje që shkriu pasurinë për luftën, do të përballej me represionin e pushtetit komunist.

Pas çlirimit, Nevruzi ishte anëtar i të parit këshill vendor në Pogradec, ndërkohë që prej vitit 1946-1947, burgoset për "mospagimin e tatim-fitimit". Do të rehabilitoheshin disi më vonë, kur falë intelektit, zgjuarsisë dhe përkushtimit ndaj atdheut do të dilnin katër oficerë nga kjo familje: Bexheti e djali, Iliri, Myfiti e djali, Artani.

Myfit Guxholli fliste pak për vete, por nuk rreshti së treguari për bashkëluftëtarët e vet, për shokët, miqtë dhe për kolegët veteranë që shpesh mblidheshin së bashku, kujtonin ngjarje, histori, ndodhi dhe plotësonin e saktësonin njëri - tjetrin. Është pjesë e brezit që kryen dhe fituan luftën kundër fashizmit e

nazizmit, duke rreshtuar Shqipërinë në krahun e fitimtarëve botërorë.

Duke marrë në dorë dekoratën e lartë, kolonel Guxholli, me sy të përlotur dhe me zë pak të dridhshëm tha: "Kjo më shumë u përket atyre që ikën dhe ranë si trima në luftën tonë, por unë nuk mund ta fsheh gëzimin dhe fatin që më dha jeta e shansi të jetoj deri në 10 vjeçarin e tretë të shekullit të 21-të, duke mbajtur edhe këtë dekoratë në gjoks. Do ta marr me vete kur të ik, që tua tregoj shokëve të luftës, atje, në botën "pa ushtri"...

Teksa dëgjoje këtë zë veterani, thuaje me vete: Veteranët nuk vdesin kurrë... Dhe në të vërtetë, vetë jeta dhe vepra heroike e tij, e veshin kolonel Guxhollin me pavdekësi.

Gjithësesi, ndarja e tij nga jeta ishte një humbje e madhe për familjen, për të gjithë ne, që mësuam aq shumë nga vepra e tij, jo vetëm për karakterin e pathyer të njeriut të drejtë, por edhe për luftën, sakrificat sublime dhe kontributet e jashtëzakonshme të popullit tonë gjatë Luftës së II Botërore.

Duke u shprehur familjes Guxholli, të afërmeve, miqve e dashamirësve të tij të shumtë, ngushëllimet më të sinqerta, në emër të Kryesisë së OBVL-së shpreh njëkohësisht bindjen se emri dhe vepra e tij nuk do të ndahen kurrë prej nesh!

Lamtumirë koloneli ynë fitimtar!

Flora, historia tragjike e bashkëshortes së Dr.Ymer Dishnicës

*Gjystina (Flora) Sata -Dishnica,
kontributi në luftë i një gruaje në "bije"*



Ajo mbeti dhe kujtohet gjithmonë me emrin "Flora", ish - emri (Pseudonimi) i saj në kohën e Luftës Nacional-çlirimtare. Quhej Gjystina Sata, bij e një familje qytetare shkodrane, me ndjenja të thella patriotike dhe me besim katolik. Kishte lindur në atë zonë, që në Shkodër quhej "Arra e Madhe". Librat që në fëmijëri, ishin dashuria e saj e madhe. Pasionin për romanet, ajo e ruajti gjithë jetën, deri në moshën 90 - vjeçare.

Gjystina (Flora) Sata -Dishnica (1924 -2020), e rritur me edukatën e fortë katolike të familjes dhe shkollës së murgeshave, ishte ndër vajzat e para, që theu këtë traditë të trashëguar ndër breza dhe me dhimbje. U largua nga familja, që në moshën 16 - vjeçare, për t'ju bashkuar idealeve të lirisë së atdheut. Shtysën e parë për përfshirjen e saj në lëvizjen e grupeve komuniste ia dha Qemal Stafa, i cili mbeti për të, personifikimi i njeriut më të pastër dhe më idealist, nga të gjithë sa ajo njohu në luftë. Në vdekjen e tij, ndonëse vetëm qindra metra larg, ajo nuk ishte prezente. E qau dhimbshëm, po atë ditë-natë, në birucën ku e futën dhe e torturuan, menjëherë pasi i vunë prangat atje, në fushën e mbjellë me grurë, ku ata po vraponin për t'ju ikur karabinierëve dhe ku shoku i saj i luftës dha shpirt. Për vdekjen e tij të komentuar, ajo ka dhënë vite më parë, intervistën e saj në TVSH, duke kujtuar me vërtetësi, çdo detaj të kësaj ngjarjeje.

Ndër katër vite lufte për çlirimin e atdheut, ajo qëndroi e burgosur rreth dy vite, në periudha të ndryshme, në dy burgje, në Korçë dhe Tiranë, nga të cilat edhe u arratis. Kontributi i saj në luftë, që nga fillimet e deri në fund, ka qenë i veçantë, ashtu pa bujë e krisma, për vetë pozicionet që ajo ka pasur.

Gjystina (Flora) Sata -Dishnica banoi e punoi, në shtëpinë ku ishte Arshiva sekrete e grupeve komuniste, shtypshkronja dhe një arsenal armësh. Burgun e parë, e përjetoi në Tiranë, ku e kapën dhe e torturuan, menjëhere pas vrasjes së Qemalit. Pas arratisjes nga ky burg ajo doli në ilegalitet, duke përdorur pashaportën me emrin Flora Panariti. Më pas qëndroi në qytetin e Korçës, duke vazhduar aktivitetin ilegal.

Në Korçë u arrestua përsëri dhe përjetoi burgun e dytë. Megjithëse nuk kish mbushur akoma 18 vjeç, duke mohuar identitetin e saj dhe duke insistuar që quhej Flora Panariti dhe jo Gjystina Sata, duroi torturën e urise dhe etjes, si dhe torturat fizike, pa nxjerrë asnjë emër të shokëve apo dokumentave që i kërkoheshin. U dënua me vdekje, në kohën kur akoma vendi ishte i pushtuar nga fashistët italianë, por një urdhër i Duçes, që ndalonte ekzekutimet nën moshën 18 vjeç, e shpëtoi. U arratis nga ky burg pas afro një viti, duke u hedhur me litar nga kati i tretë i godinës.

Në Helmës vazhdoi punën, në shifrën sekrete të Shtabit të Përgjithshëm, ku u njoh edhe me shokun e saj të jetës, Dr. Ymer Dishnicën. Në vitin 1944, në prag të çlirimit, ata martohen, ashtu me "rrobat e luftës", duke pasur bindjen që luftuan për të mirën e vendit të tyre. As mund ta mendonin, që do të përjetonin për dekada persekutimin dhe të cilësoheshin me termin "Armiq të popullit", pikërisht ata dy luftëtarë idealistë, të orëve të para.

Jeta e tyre, pas çlirimit ka kaluar nëpërmjet një sërë tallazesh, në të cilat, kjo grua, jo vetëm nuk iu nda për asnjë çast bashkëshortit dhe shokut të saj të luftës, por në periudha

të veçanta, u përball me trimërinë që e karakterizonte edhe me persona shumë famëkeq të diktaturës. Ne vitin 1950, internohen në qytetin e Beratit, ku jetuan për rreth 44 vite. Ky qytet i kulturës dhe trashëgimisë sonë historike, i trajtoi me dashamirësi dhe respekt. Dr. Dishnica dhe bashkëshortja e tij, fituan respekt dhe dashuri në këtë qytet "shkallë-shkallë". Në dekadat e jetës në Berat, qytetarët, i madh dhe i vogël, shikonin përditë njeriun e mirë dhe intelektualin e mençur që u shërbeu me kujdesin maksimal profesional secilit, çdo individ. Jeta e tyre në Beratin historik, ishte model i një çifti që ndrit dhe shkëlqen, model i një çifti që i janë dedikuar njëri tjetrit, por po aq i janë dedikuar detyrës, e shërbimit ndaj njerëzve. Ndaj i madh dhe i vogël në Berat, shihnin tek Dr. Dishnica dhe familja e tij, një model të paqtë familjeje dhe një devotshmëri të admirueshme. Ata edhe pse nuk morën kurrë ndonjë flet lavdërimi apo ndonjë përgëzim zyrtar, mbetën të "shkruar" meërma të arta në memorijen qytetare beratase.

Gjithsesi, tallazet shoqëroreshin edhe me periudha të qeta. Të dy si çift, me shpirtëgjërësinë, kulturën, humorin që i karakterizone, shumë të kujdesshëm, edhe në atë liri aq të cunguar dhe të kontrolluar frikshëm nga diktatura, gjenin mundësinë të hapnin dyert e shtëpisë së tyre, për një rreth të gjerë shoqëror. Një familje e konsoliduar, me tre fëmijë të respektuar, gjithashtu, prej të gjithëve, Perin, Kozetën dhe Tatjanën. Të dy këta prindër, të zhgënjyer nga idealet e tyre të fillimit, u përballën me shumë peripeci, për të edukuar si duhet fëmijet dhe për të mbrojtur familjen e tyre. U rikthyen

në Tiranë pas 44 vitesh, duke përjetuar më në fund ditët e demokracisë. Ata bënë një jetë bashkëshortore, me një mirëkuptim dhe dashuri të tillë, që shumëkush mund ta kish zili. Gjystina (Flora) e mbështeti fuqimisht dr.Dishnicën në organizimin e drejtimin e Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës (OBVL), nga krijimi i saj më 1994 e deri sa ndërroi jetë më 22.9.1998. Ajo, si dhe fëmijët e saj ndjenë gëzim të veçantë kur Dr.Ymer Dishnica u dekorua nga Presidenti i Republikës Bujar Nishani me Titullin "Nderi i Kombit", më 28 Nëntor 2014.

Gjystina ndërroi jetë, pa asnjë sëmundje, pikërisht në ditën e saj të lindjes, në moshën 96 - vjeçare, (më 7 nëntor 2020) pasi kishte kaluar një pleqëri të bardhë, nën kujdesin e tre fëmijëve të saj. Ajo do të mbetet simbol i një nëne të përkushtuar, bashkeshortes besnike dhe i një "luftëtareje në hije". Gjystina Sata (Dishnica) për kontributin e saj në luftë, u vlerësua, nga Këshilli i Ministrave, në vitin 2004, me rastin e 60 vjetorit të çlirimit të atdheut, me Medaljen "Për kontribut të shquar në çlirimin e atdheut", dhe më pas, me Medaljen e Mirënjohjes "Për kontribut të veçantë në luftë për mbrojtjen e vendit", dhënë nga Ministria e Mbrojtjes. E pyetur në të gjallë se si mbijetoi në gjithë ato shtrëngata dhe stuhi politike, ajo do të thoshte thjesht e qartë: "Kam besuar tek im shoq dhe ai gjeti tek unë bashkëshorten besimtare tek e vërteta.

Ne kemi heshtur, por nuk kemi harruar". Kalvari i jetës së saj, në luftë dhe në diktaturë, nuk mund të përmbliidhet në faqen e një artikulli. Ai meriton të shkruhet në librin e jetës së saj.

Marlin Tushe, krenari shqiptare në SHBA

*Anëtarja më e re e OBVL-s, e antarësuar nga
Shteti i Nju Jorkut në Organizatën e Gjenive të Botës*



Marlin Tushe është anëtarja më e re e Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacional-çlirimtare. Mbesa e patriotit e veteranit të Luftës së Dytë Botërore, dhe ish të burgosurit politik Enver Dajçi, i cili u nda nga jeta pesë vite më parë në SHBA, nën kujdesin e veçantë saj, për shkallën e lartë të inteligjencës është anëtarësuar nga Shteti i New Yorkut në Organizatën e Gjenive të Botës. Marlini, një aktiviste e njohur për komunitetin shqiptar e më gjerë në SHBA, është një e re humane dhe aktiviste e të drejtave të njeriut.

Për punën e kontributin e saj të palodhur patriotik, human e bamirës në dobi të komuniteteve është vlerësuar me Titullin "Ambasadore e Pages" dhe për "Merita të larta Civile" nga Kryekontrollori i New Yorkut Scot Stringer, Assambly Women Anthalia Fernandez si dhe nga Presidenti i Bashkisë Bronx, Ruben Diaz Jr.

Vajza ekselente shqiptare punon në "Montefiore" Hospital në Nju Jork, si koordinatorë e një departamenti shëndetësor. Për punën e saj të shkëlqyer është vlerësuar me tituj e mirënjohje të ndryshme, si "Fytyra e Respektit" etj. Ndonëse 2020, ishte vit i përballjes me pandeminë e rrezikshme Covid-19, për vajzën ekselente shqiptare Marlin Tushe, ka qenë vit i sukseseve të shumta, duke lënë gjurmë edhe në nivel global. Marlini pasi përfundoi studimet për violinë me rezultate të larta në Liceun Artistik Tiranë, ku ishte edhe një ndër aktivistet e flakta të forumit rinor të PDSH, ndoqi studimet e larta në Universitetin e Romës në "La Sapienza".



Është zotëruese e shtatë gjuhëve të huaja, ku përfshihen gjuha italiane, angleze, franceze, spanjolle, greqisht, shqip sigurisht dhe gjuha e vjetër irlandeze - Gaelik, në disa prej këtyre gjuhëve është kualifikuar në Itali, Angli, Francë dhe SHBA. Profili i saj rrezaton bukuri të rallë fizike e shpirtërore, ndërsa mishëron dhe përçon kudo e ngado mirësi, mençuri e vlera të larta njerëzore e intelektuale.

Në Shqipëri edhe pse tepër e re në moshë ka dhënë një kontribut të shquar për fëmijët e të rinjtë pranë Shoqatës së ish të Persektuarve Politikë të Shqipërisë dhe proceseve demokratike në vend si anëtare e kryesisë së forumit rinor të PDSH, po në Tiranë. Deri sa u largua nga atdheu ka punuar si anëtare komisioni nëpër qendrat e votimit si përfaqësuese e PDSH, së bashku me nënën e saj, Mimoza Dajçi. Edhe pse e vogël në moshë së bashku me gjyshin e saj, Enver Dajçi dhe nënën e saj ka marrë pjesë në rrëzimin e bustit të diktatorit Hoxha, si dhe kanë mbështetur për ditë me rradhë familjarisht ato vite grevën e urisë së studentëve tek Qyteti

Studenti.Marlini ka mbështetur dhe ka ndihmuar për mbarëvajtjen e përkujtimores së Konferencës së Bujanit që u mbajt disa vite më parë në New York, ku mes të ftuarve të tjerë i pranishëm ishte edhe ish Kryetari i OBVL, Gjeneral Rahman Parllaku - "Nderi i Kombit". Si misionere e paqes dhe aktiviste e të drejtave të njeriut ka marrë pjesë në disa asamble e konferenca ndërkombëtare në Japoni, Argjentinë, Gjermani dhe në Hagë, ku në vitin 2015 në Gjykatën Ndërkombëtare të Hagës pati rast të asistonte edhe në një prej gjyqeve, kur po gjykohej kriminelin Ratko Mlladiç. Por edhe pse ka vite që jeton e punon në SHBA, ajo kurrë nuk e harron vendlindjen, ka raste që e viziton, por edhe komunikon e shpreh opinionet e saj virtualisht për gjendjen në vend shpesh me miqtë e mikeshat e saj.

Shembuj të tillë pozitivë janë burim frymëzimi për rininë shqiptare dhe na bëjnë të ndihemi krenar për bashkëkombasit tanë jashtë atdheut.

Kolonel Sotir Budina, ish-partizani, ushtaraku dhe veprimtari shembullor

- Në krye të OBVL zgjidhet një personalitet me kontribut të shquar në LANÇ dhe ushtrinë shqiptare
- Sotir Budina është ndër bashkëthemeluesit e OBVL në 18 korrik 1994 me dr.Ymer Dishnicën, Gjeneral Rrahman Parllakun, Skënder Malindin, Edip Ohrin, Hamit Keçin, Tahir Voshtinën, Shaban Reçin, Liri Belishovën, Myfit Guxhollin etj.



Kuvendi i 8-të Kombëtar i OBVL që zhvilloi punimet në sallën e mbledhjeve të Hotel “MONARC” më 22.05.2021, zgjodhi kryetar të kësaj organizate kolonel Sotir Budinën. Ai është ndër bashkëthemeluesit e OBVL në 18 korrik 1994 me dr.Ymer Dishnicën, Gjeneral Rrahman Parllakun, Skënder Malindin, Edip Ohrin, Hamit Keçin, Tahir Voshtinën, Shaban Reçin, Liri Belishovën, Myfit Guxhollin etj.

Për disa vite ka qenë sekretar organizativ i OBVL dhe njihet si një nga veprimtarët me kontribut të shquar në mbarëvajtjen e kësaj organizate.

Ai ka lindur në qytetin e Korçës më 14.03.1926 në një familje patriotike, e cila njihet për kontributin e shquar që ka dhënë për rritjen e ndjenjave patriotike dhe për pjesëmarrjen me armë në dorë në Luftën Nacionalçlirimtare.

Mbas pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste me 1939, shtëpia e Ilo Budinës u bë një nga bazat kryesore të LANÇ-it, ku bëheshin mbledhje, shpërndaheshin trakte, strehoheshin njësitet guerrile, ilegale etj. Mbas çlirimit, Bashkia Korçë ka vendosur në këtë shtëpi pllakën përkujtimore “Kjo shtëpi ka qenë bazë e LANÇ gjatë Luftës së dytë Botërore”.

Nga kjo familje në luftën partizane kanë marrë pjesë katër luftëtarë.

Babai, Ilo Budina ka dalë partizan në vitin 1943. Me krijimin e Brigadës së IV S, ai është caktuar intendent i Batalionit të parë të kësaj brigade, detyrë të cilën e kreu me përkushtim të rrallë deri në çlirimin e vendit.

Nëna, Kostandina Budina, gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare u ka shërbyer në shtëpi me ushqime

ilegalëve të luftës që strehoheshin vazhdimisht në shtëpinë e Ilo Budinës. Për këtë kontribut të çumuar që ajo dha gjatë Luftës së Dytë Botërore, pas çlirimit, si gjithë veteranëve iu dha statusi përkatës dhe shpërblimi




mujor prej 1000 lekësh i Luftës që e mori deri sa ndërroji jetë.

Djali i tyre, Janaq Budina, ish-nxënës i Normales së Elbasanit, në vitin 1943 doli partizan dhe u inkadrua në Batalionin e Çermenikës ku kreu detyrën e Përgjegjës të Rinisë së këtij batalioni. Kur në këtë krahinë, në vitin 1944, u krijua Brigada e 17-te S ai u caktua Përgjegjës i Rinisë së kësaj brigade, deri në çlirimin e vendit. Mbas çlirimit, në vitet 1946-1948, Janaq Budina kreu studimet në Shkollën e Xhenjos në Moskë dhe pas diplomimit ka punuar, fillimisht në Drejtorinë e Xhenios të Ministrisë së Mbrojtjes dhe më vonë shef i xhenios në koorpuset e Korçës e Tiranës, deri sa doli në pension,

SOTIR BUDINA, i frymëzuar me ndjenjat patriotike të familjes së tij, ka marrë pjesë aktivisht në luftën për liri që në vitin 1939 Mbasi mbaroi shkollën Normale të Elbasanit, si i ri antifashist bëhet anëtar i njësitit gueril të qytetit të Korçës dhe me formimin e Brigadës së IV-të S u rreshtua në Batalionin e III-të të kësaj brigade, fillimisht me detyrën përgjegjës rinie kompanie dhe më vonë përgjegjës rinie i këtij batalioni. Si një

nga personazhet realë në librin “COPËZA JETE INVALIDËSH”, (Botim i kryesisë së Degës së Invalidëve të LANÇ, Tiranë), Sotir Budinës i dalin parasysh si në ndonjë film ngjarjet e shtatorit 1943. Në këtë libër janë skalitur ngjarje heroike të guerilasve korçarë, mes të cilëve edhe Sotiri, i plagosur gjatë një përleshjeje masive me armikun. U shërua falë përkujdesjes së mjekut partizan Petraq Progrit, nga dëshmia autentike e të cilit Sotir Budina gëzon edhe Statusin e Invalidit të LANÇl. Duke vlerësuar kontributin e tij, Kryesia e Shoqatës Kombëtare të Invalidëve të LANÇ, me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë, më 28 Nëntor 1912, me vendim të posaçëm nderoi Invalidin e LANÇ Sotir Budina me titullin e lartë “ATDHEU JU ËSHTË PËRJETË MIRËNJOHËS”



Si i ri i dalluar që ishte, në gusht 1944 u zgjodh delegat i Brigadës së IV-të S dhe mori pjesë në Kongresin e I-rë të Rinisë Antifashiste Shqiptare në Helmës të Skraparit. Mbas çlirimit të vendit, Sotiri si ish pjesëmarrës aktiv në LANÇ dërgohet për studime në ish Bashkimin Sovjetik, ku mbaroi me rezultate

të larta shkollën 3-vjeçare të xhenios në Leningrad dhe Akademinë Ushtarake të xhenios “Kujbishev”, 6 vjet në Moskë. Si kuadër ushtarak i përgatitur dhe i pajisur me njohuri të thella të artit ushtarak të kohës, ai mbas mbarimit të Akademisë, në të gjitha funksionet që iu ngarkuan: Shef i Xhenios së Mbrojtjes Bregdetare, Shef i Xhenios së Mbrojtjes Kundërajrore të vendit, Shef i Katedrës së Xhenios në Akademinë Ushtarake dhe më vonë nga viti 1974-1982 për nëntë vjet, nëndrejtor i Drejtorisë së Xhenios e Fortifikimit në Ministrinë e Mbrojtjes, duke punuar me përkushtim dha një kontribut të vyer në përgatitjen xheniere të ushtrisë dhe sidomos në fortifikimin e vendit.

Mbas daljes në pension në vitin 1982 dhe sidomos pas vitit '90 ka mbështetur vazhdimisht proceset demokratike.

Sotir Budina, si bashkëthemelues i Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të LANÇ dhe si anëtar i Kryesisë së kësaj organizate ka dhënë dhe vazhdon të japë një kontribut të shquar për mbarëvajtjen e saj dhe për zgjidhjen e problemeve që kanë veteranët.

Pikërisht në vlerësim të kontributit të tij, Kuvendi i 8-te Kombëtar i OBVL, i mbledhur më 22 Maj 2021, e zgjodhi SOTIR BUDINEN kryetar të Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të LANÇ-it.

Si më shpëtoi dr. Ilir Peposhi nga kthetrat e Covid-19

Nuk qe rastësi që numri i tij në WhatsApp të ishte online non stop, thuajse në 24 orë gjatë Pandemisë Covin-19. Ndaj dhe mirënjohja si shprehja më e bukur e karakterit të njeriut, në rastin tim, si edhe të qindra e mijëra pacientëve që ka shëruar e po shëron i takon dr. Ilir Peposhit, këtij personaliteti që zë vend nderi në historikun e spitalit universitar "Shefqet Ndroqi", ku ai shërben prej vitesh shef i Shërbimit të Bronkoskopisë. Për 15 vjet si mjek Specialist Pneumologë-Bronkopskopi Diagnostike dhe Terapeutike, ai është bërë një ndër emrat më të njohur në këtë fushë të mjekësisë shqiptare

Ndoshta jam i njëmijti, i njëmijëepesëqinti...apo edhe i mbi pesëmijënjëjti pacient që munda të shpëtoj nga kthetrat e Covid 19, falë konsulencës dhe përkujdesjes maksimale të Dr. Ilir Peposhit. Përvoja e gjatë gati 30 vjeçare në gazetari



e shkrimtari më ka mundësuar krijimin e miqësive me dhjetra personalitete të mjekësisë shqiptare, profesorë, doktorë të specialiteteve të ndryshme...Por ditën që rashë në kllapinë e kësaj flame, (8 Mars 2021), kur skaneri më nxori me mbi 50 përqind të mushkërisë së dëmtuar dhe po përjetoja komplikacione, kollë të ashpër dhe temperaturë të lartë, emri i parë që më ra ndërmend ishte Dr.Ilir Peposhi.

I pamundur të komunikoja vetë, im bir, Bledari, ia prezanton gjendjen time Dr.Ilirit në WhatsApp. Dhe menjëherë pasi njihet me analizat e konkluzionet e skanerit dr.Peposhi sjell rekomandimin e parë për javën e parë...Më pas vijoi intensivisht komunikimi i djemve të mi, Bledit e Arlindit me dr.Peposhin, i cili tregoi përkushtim maksimal dhe profesionalizëm të lartë në trajtimin e sëmundjes.... Dhe jo në një apo dy-tri ditë, por plot gjashtë javë. Infeksioni në mushkëri, më shkaktoi edhe uljen e nivelit të oksigjenit e në këto kushte për ditë të tëra u ndodha në terapi intensive duke marrë oksigjen nga dy aparate oksigjenimi, nëpërmjet tubave në hundë. Dikush mund të mendojë se për trajtimin e të sëmurëve me Covid-19 tashmë ka protokolle të gatshme... Ndoshta është edhe kështu, por unë që provova gjendjen e rëndë konstatova me bindje se vetëm një mjek specialist me talent të rrallë e humanizëm të spikatur si Ilir Peposhi bën çudira në raste të tilla.... Nuk qe rastësi që numri i tij në WhatsApp të ishte online non stop thujse gjatë 24 orëve, për më shumë se një vit që zgjati kjo flamë e kohëve moderne.... Ndaj dhe mirënjohja si shprehja më e bukur e karakterit të njeriut, në rastin tim, si edhe të qindra e mijëra pacientëve që ka shëruar i takon dr.Ilir Peposhit, këtij personaliteti që zë vend nderi në historikun e Spitalit Universitar "Shefqet Ndroqi", ku ai shërben prej vitesh si shef i shërbimit të Bronkoskopisë. Për 15 vjet si mjek Specialist Pneumolog & Bronkoskopi Diagnostike dhe Terapeutike, Ai është bërë një ndër emrat më të njohur në këtë fushë të mjeksisë shqiptare.

Në vitin 2017 ka fituar gradën "DOKTOR", duke mbrojtur temën "Vlera e bronkoskopisë në pacientët me tuberkuloz pulmonar bk negativ", me udhëheqës shkencor Prof. Dr. Perlat Kapisyzi. Dhe jo vetëm kaq. Profesionalizmi dhe mendimi i tij i avancuar shkencor ka qenë evident dhe është vlerësuar nga personalitete të njohura në disa konferenca ndërkombëtare, kushtuar pneumologjistë e bronkoskopisë. Personaliteti dhe karakteri i tij në asnjë rast nuk devijoi, por u shpalos dinjitoz në funksion të zhvillimit dhe modernizimit të shkencave mjekësore. Ishte nga të parët që i fali shpirtin dhe zemrën ëndrrës së dëshiruar në vite. Në këtë përditshmëri, ai mbetet një nga figurat më interesante si përfaqësues i elitës intelektuale shqiptare.

Dr. Peposhi ka afro një dekadë e gjysëm në shëndetësi. Në duart e tij kanë kaluar me qindra e mijëra pacientë, të cilët i kanë besuar shëndetin e tyre mjekut pneumolog ku prej shërbimit të marrë kanë qenë mjaft të kënaqur. Humanizmi i dr.Peoposhit ka qenë evident në çdo hap të karrierës së tij. Ai ka qenë njësh me pacientin, i shkrirë në nevojën e tij duke iu gjendur sa herë i lypte nevoja. Vlerësimi për mjekun e talentuar dhe mjaftë të aftë.Dr.Ilir Peposhin, për çfarë Ai ka dhënë në profesionin e tij si mjek dhe si doktor i shkencave është i merituari dhe të tilla vlerësime nuk duhet të mungojnë për profesionistët.

Në këto radhë shprehje mirënjohje, nuk mund të lë pa përmendur gjithashtu edhe interesimin e përkujdesjen e dr.Spiro Vangjelit, mjekut që shërbeu me përkushtim e profesionalizëm në vendlindjen time, Muhurr nga ku gëzon

respektin e bashkfshatarëve të mi. Prej dekadash dr.Vangjeli shërben si mjek dhe si drejtor i Poliklinikës së Kombinatit, Tiranë... Janë me dhjetra bashkfshatarët e mi që jetojnë në kryeqytet, që ashtu si unë të prekur nga covid 19 janë ndjekur nga dr.Spiro deri në shërimin e tyre të plotë.

Përveç dr.Peposhit e dr. Spiros, nuk mund të lë pa i shprehur mirënjohje të veçantë ndihmësmjekut të talentuar Arjan Murataj (Reparti i Kirurgjisë në QSUT), i cili mundësoi injektimin nga tre herë në ditë të medikamenteve të rekomanduara.

Mua më takoi të përballem me këtë armik të padukshëm, fill kur bota kishte hyrë në vitin e dytë të një pandemie të paparë. Një armik që nuk e shihnim me sy edhe pse në një majë të gjlpërës mund të kishte vend për 100 milionë grimca të këtij virusi. Dhe nuk do ta kisha fituar këtë betejë pa patur pranë thujse çdo çast dr.Peposhin, por edhe interesimin e vazhdueshëm të dr. Idajet Dura, i cili nga Spitali Infektiv i Athinës, ku shërben prej vitesh konsultonte analizat e mia dhe më jepte rekomandimet e duhura. Nderim, gjithashtu për kryeinfermieren e mirënjohur të spitalit Covid 1, Merita Ndreu-Sefa që shërben prej 23 vitesh në Spitalin Infektiv në Tiranë, si dhe për Dr.Arben Gjonej nga reparti i ortopedisë në Spitalin e Traumës. Po ashtu, vizita në shtëpi e interesimi i vazhdueshëm i Dr.Ahmet Durakut, nefrolog në QSUT, autor i studimit "COVID -19 godet edhe veshkat".

Respekt dhe mirënjohje të veçantë për këta personalitete të mjekësisë shqiptare që shërojnë jetë njerëzish...

III.


ANALIZA - KRITIKË LETRARE

Halil Rama, ka shkruar dhe promovuar monografi e dokumentarë për artistë të përmasave kombëtare të kësaj treve, si për kompozitorin e tangos shqiptare Muharrem Xhediku, ikonën e artit e kulturës kombëtare Hazis Ndreu, regjisorin dhe aktorin e shquar Skënder Cala, për Lutfi Ndreun - mësues dhe artist, etj, të botuara këto edhe në prestigjiozet e përditshme "Panorama", "Telegraf", "Gazeta Shqiptare", "Rilindja Demokratike", në të përjavshmen kulturore-letrare "Nacional", si dhe në disa portale.

DR. HAJRI MANDRI

Një palë “opinga” për Hrushovin?!

Për romanin fitues të Çmimit të madh të Panairit të Librit 2019, "Dëmtuar gjatë rrugës", me të cilin Besnik Mustafaj u shpall "Autori më i mirë i vitit"



Ditën e fundit të Panairit të Librit 2019, të dielën e 17 Nëntorit, m'u desh të shkoja tri herë në Pallatin e Kongreseve. Dy herët e paradites, mungonte, pasi ishte shitur tri ditët e para, ndërsa në mesditë erdhi i ribotuar romani fitues i këtij panairi "Dëmtuar gjatë rrugës". U ndjeva me fat që e mora me autografin e autorit Besnik Mustafaj. Por më me fat u ndjeva pasi e lexova

këtë roman, vërtetë me fund të lumtur. Personazhi, me fund të lumtur është nëna e autorit. Një fund i lumtur pas një makthi që e kishte pushtuar atë prej tri dekadash se mos një ditë do t'i hapeshin "petët e lakrorit"... Ajo kishte shkelur për herë të parë kur ishte 24-vjeçe në një zyrë të vërtetë të pushtetit "atje ku ndihet si frikë deri në kockë hija e rëndë e shtetit". Siç pohon autori që në krye të herës "është një histori, të cilën ajo e ka mbajtur brenda kokës së vet si një tumor (fjalët e saj) për tridhjetë vjet". Dhe ky "tumor" s'ishte gjë tjetër veçse brenga që i çelën një palë opinga, që ajo u detyrua atë pranverë të largët të vitit 1959 nga më i madhi i partisë së krahinës, t'i qëndiste si dhuratë për Nikita Hrushovin, në vizitën e tij të parë në Shqipëri. Që nga marrja e porosisë prej ish-sekretarit të parë të PPSH të rrethit për të krijuar një palë opinga artistike, që do të përbënin "sekret shtetëror", personazhi kryesor i romanit "do të mendonte me bindje të rrënjosur një herë e përgjithmonë se sidomos zyrat e politikanëve të lartë janë të mbushura me mistere djallëzore, ku njeriu i pamësuar zbulon pafuqinë e vet, duke pësuar në shpirt gjymtime të papërfytyrueshme".

Në thelb, subjekti ka dy pamje: Pamjen gazmore kur pasi iu pëlqyen "opingat artistike" që kasta e atëherëshme ia dhuroi Hrushovit, të cilësuar si "babai i popujve", nëna u bë "Shoqja S" dhe përzgjidhej si politikane e re "yll në ngjitje" në tribunat e mitingjeve ku brohoritej "Rroftë shoku Hrushov", dhe pamjen e zyrtë gjatë gjithë viteve të mëpastajme, kur ajo dyshonte se mos shpallej armike, pikërisht pse kishte krijuar "opingat artistike" për Hrushovin

që ishte shpallur armik i revolucionit bolshevik nga mbrojtësi i flaktë dhe i vetëm i tij, Enver Hoxha.

Përshkrim brilant i lëmshit torturues të lotëve të një nëne

Autori, si rrallëkush tjetër ka ndërtuar profilin e nënës së tij, nëpërmjet dialogjesh me të vjehrrin dhe monologjeve me vetveten, gjatë procesit të thurjes së opingave si "sekret shtetëror" dhe në vijim për frikën se mos pas "tradhtisë" së Hrushovit edhe ajo mund të shpallej armike dhe ta pësonin i biri, vëllezërit dhe gjithë farefisi i saj. Të krijosh një roman kaq të arrirë artistikisht vetëm mbi këtë subjekt është vërtetë një meritë e veçantë e këtij autori, që si askush tjetër përshkruan lëmshin torturues të lotëve që ia kishin zënë lëfytn e hollë të grykës, kësaj nëne fisnike që s'mendote për asgjë tjetër (nëse do ta arrestonin) veçse për të ardhmen e djalit foshnjarak (në djep). Dhe kur u bind se nuk kishte më asnjë rrugë shpëtimi "një zë, që ishte zëri i saj, edhe pse nuk dilte nga goja e saj, zuri të këndonte vajtueshëm: "Nji amanet po jua la:/Kur në mur-o t'më murosni,/Syn' e djathtë t'ma leni jashtë,/Kambn' e djathtë t'ma leni jashtë,/Gjin' e djathtë t'ma leni jashtë:/Se kam lanë djalin e vogël/E kur t'nisi djali gjamën,/Me njan' sy ta shikoj,/Me njan' dorë ta limoj,/Me njan' kambë ta lurtoj,/Me njan' gji ta nergoj". Amaneti i një nane që "opinga artistike" mendonte se duheshin thurur veç për burrin e saj dhe për asnjë burrë tjetër në botë.

"Mrekullia, që duhej të nxirrte Nëna ime nga duart e veta

'vetëm me një grep e pe të bardhë' ishin një palë opinga burrash". Por për të "Fqinjëria e fjalëve SEKRET dhe SHTETËROR krijonte një bashkim tingullor tepër të frikshëm". Madje sipas saj "vetëm zyrat mund të bënin sajime të tilla gjuhësore, që t'i përshkonin veshët dhe trurin si turjela". Pikërisht mbi rrëfime të tilla brilante autori ndërton intrigën për "pyetjet e përsëritura edhe pse të mbetura pa përgjigje si dhe dyshimet e njëpasnjëshme dhe gjithnjë të pasqaruara" që ngadalësojnë tejmas rrjedhën e kohës. Dhe gjithshka "për shkak të atij të mallkuarit, sekretit shtetëror!". Ishte ajo kohë e kobshme kur mund ta haje po të nxirrje sekretin e thurjes së një palë opinga artistike, pasi përbënte "rrezik të madh të gënjehet Partia". Pikërisht në këtë kontekst e paraqet autori marrëdhënien e nënës së tij me Dritën, kushërirën e burrit të saj që vetëvetiu "do ta fusnin shoqja shoqen në skutat më të fshehta të shpirtit". Drita, "e fejuara e damkosur e një armiku të klasës" dhe Selmani, më i arsimuari i zonës që s'pajtohej me qëndrimet staliniste të PPSH janë dy personazhet, marrëdhënia me të cilët, jo vetëm që nuk e zbehin, por përkundrazi e fisnikërojnë profilin e nënës së B. Mustafajt.

Skaneri i një partie që ndërhynte edhe në trillet e fshehta dashurore

Me mjeshtri të rrallë artistike, me një guhë të pasur e mjete shprehëse interesante autori ekzaminon atë parti që "kishte për detyrë të ndërhynte edhe në trillet e fshehta dashurore të anëtarëve të saj", qoftë dhe duke përshkruar

atë hallakatje të pavullnetshme ndër përhitje të nënës së tij që ruajti në shpirt një gjurmë të re malli për të shoqin komunist që partia e kishte dërguar për studime në Tiranë. Ndaj dhe modeli i opingave artistike që i pari i partisë së krahinës ia kishte porositur si "sekret shtetëror", do të ishte modeli që i përkiste vetëm një burri, që në këtë roman paraqitet si babai i autorit. Ato do të ishin opinga "më të bukurat e të bukurave". Ndonëse sipas porositësit, masa e këmbës që do t'i vishte nuk kishte asnjë rëndësi, Nëna ishte zhytur në një makth nga i cili s'po dilte dot.

E mundonte pyetja e tmerrshme për këmbën e burrit të mistershëm, këmba e të cilit futet në çdo këpucë... "I tillë është vetëm djalli e i biri i djallit. Unë s'kam punë me të. Zot i madh m'i ruaj mendtë në kokë!". Ndaj dhe s'u besoi veshëve kur mësoi se opingat që kishte thurur ishin për Hrushovin që kishte zënë vendin e Stalinit në Moskë... Ndaj dhe i shpërtheu një e qeshur e vrullshme, e papërmbajshme kur mësoi nga i vjehrrë se "Hrushovi do të vishej me opinga si barinjtë e Tropojës"! Në fillim ajo "nuk pati ndonjë lëndim në sedër si krijuesja e shpërfillur e dhuratës simbolike për "babanë e popujve", kur nuk e përfshinë në delegacionin që do të shkonte nga Tropoja në Tiranë për ta takuar atë. Por më pas kuptoi se "brenda saj rridhte pavetëdijshtëm një përrua zemërimi, pse krerët e partisë në rreth nuk e kishin marrë me vete në Tiranë". Ato ditë kur pjesëmarrja në mitingje ishte e detyrueshme, prodhuesja e opingave artistike për Hrushovin do të shihte vehten dhe të detyrohej të fliste në mitingun e organizuar në qytetin Bajram Curri. Dhe për sa kohë, tanët e patën mirë me

"babanë e popujve" nëna, ndonëse e njihje fare pak politikën do të ishte më e preferuara e drejtuesve të saj në rreth. Por rrjedha ndryshoi në të kundërtën, kur pas "tradhtisë" së Hrushovit, shoqja Rushe, si ziliqare që ishte do ta kërcënonte se tani do t'i hapeshin "petët lakrorit", ç'ka nënkuptonte se nëna (ose shoqja S e romanit) do të ndëshkohej si hrushoviste (ajo do të burgosej ndërsa do ta pësonte i shoqi komunist dhe tre djemtë e saj). Por autori, edhe në këtë rast ka meritën e përshkrimit të një nëne që "krenohej me bukurinë e saj të jashtme, gjë që ishte e papajtueshme me vijën e partisë, sipas së cilës nuk ishte dukja, por thelbi, domethënë bota e brendëshme, shpirti revolucionar që përbënte pasurinë dhe bukurinë e njeriut të ri".

Koherenca me realitetin objektiv

Nëse ngjarjet i përkasin kohës mënxyrë kur partia porosiste që "lufta e klasave të zhvillohej edhe brenda familjes", autori i sjell ato në koherencë me realitetin objektiv, qoftë edhe kur pohon "Udhëheqësit kishin një gjuhë të caktuar për të folur me njëri-tjetrin e një tjetër gjuhë për të folur me popullin". (A nuk ndodh edhe sot kësaj me klasën tonë politike të dalë bojë!). Apo edhe kur pohon se ka gërmuar gjatë nëpër arkivat e Agjencisë Telegrafike Shqiptare (ATSH) për të gjetur fotografinë e nënës së tij në tribunën e mitingut të organizuar në Tropojë gjatë vizitës së Hrushovit në vendin tonë. Nga ai miting nëna ishte dekoruar me "Urdhrin e Yllit me Pesë Cepa" nga Kryetari i Presidiumit

të Kuvendit Popullor, dekoratë kjo që do ta stresonte e mbante nën ankth gjatë gjithë viteve të mëvonshme pas "tradhtisë" së Hrushovit, kur mendonte se do të hapeshin "protokollet e partisë"! "Në të vërtetë - shkruan autori - ky arsyetim në kokën e nënës sime do të sqarohej më vonë, ngadalë, gjatë përplasjeve të vështira që do të kishte ajo me veten për të ndarë sa më mirë nëse ishte viktimë, apo fajtorë në këtë histori". Është një histori e rrallë mbi të cilën autori ndërthur mjeshtërisht ngjarje e personazhe që na bëjmë të kuptojmë më së miri sistemin e kalbur të diktaturës komuniste. Ndonëse e përshkruan si hamendje të nënës së tij, në të vërtetë është koha kur pas ngjarjesh e arrestimesh të bujshme për tradhti imagjinare e kalime të paligjshme kufiri, qyteti Bajram Curri jetonte dita-ditës me një bombë me sahat në gjë.

Shthurjen dhe dekadencën e atij sistemi autori na e paraqet mjaftë bukur qoftë dhe me profilizimin e personazhit të Vasilikës, që ndonëse e kishte sjellë partia të përhapte të renë e civilizimin në qytetin verior në zemër të maleve, qytetarët thonin: "Na qelbi vendin ajo bishtpërdredhura e dreqit!". Dhe kur për këtë "bishtpërdredhurën" shkon fjala deri tek shoku Enver (nëpërmjet një letre anonime) se ajo "shkonte në shtrat jo vetëm me djemtë më të pashëm të qytetit, qofshin ata beqarë apo të martuar, por edhe me kuadrot e partisë e të pushtetit, pa parë moshën e tyre, si dhe me oficerët e sigurimit në rreth", Udhëheqësi do t'i kërcënonte ato se "puna e madhe dhe delikate e Partisë duhet përqëndruar kësaj here tërësisht tek burrat, për kalitjen e

forcës së karakterit të tyre". Autori që pohon se letrën anonime, bashkë me shënimin e Enver Hoxhës që e ka gjetur në Arkivën Qëndrore të Shtetit gjatë përgatitjeve për shkrimin e këtij romani, argumenton më së miri për këtë "qëndrim krejt të përligjur të Enver Hoxhës që e kishte kuptuar më në fund se nuk kishte mënyrë tjetër veç anonimatit, për t'ua vrarë njerëzve të thjeshtë lepurin e frikës, i cili me ata dhëmbët e tij prerës, po ia hante shpirtin popullit, siç hante lakrat natën në vjeshtë, në kopshtet e fshatarëve. Babai i atij leperi të tmerrshëm ishte hija e Stalinit". Këtë tezë e mbron edhe me pohimin e nënës së tij se "hapi që bëri për t'u përfshirë në politikë, në të vërtetë e kishte hedhur në një greminë ku do të gjente një vetmi të ngulur si tumor i fshehtë, i ngulitur në trurin e saj".

Enigma për "këpucën" me të cilën Hrushovi goditi tribunën e OKB-së

Dhe si për ta përligjur këtë ngulitje, autori përshkruan më pas me realizëm ngulmimin e nënës që ai të gërmonte në Arkivin e OKB-së për këpucën me të cilën Hrushovi paskësh goditur tribunën e institucionit më të rëndësishëm botëror me pretekstin se nuk i kishin dhënë fjalën për një replikë. Autori nuk arinte ta merrte dot me mend se çfarë lidhje shihte nëna e tij midis opingave, që kishte bërë dikur për Hrushovin, dhe këpucës, me të cilën kishte goditur ai tribunën e sallës plenare të Asamblesë së OKB-së, siç ishte bërë e njohur botërisht dyzetepesë vjet më parë (12 tetor 1960)..., kur flitej

për sherret e Hrushovit me kryetarin e asaj Asambleje, Frederick Boland-in, si dhe me kryetarin e delegacionit të Filipineve, një farë Lorenzo Sumulong, i cili kishte thënë se popujt e Europës Lindore, të përpirë nga Bashkimi Sovjetik, nuk gëzonin të drejta civile e as politike.

Pikërisht kjo mungesë lirish të drejtash civile e politike si të drejtat bazë të lirisë njerëzore përshkojnë si fill gjithë romanin "Dëmtuar gjatë rrugës". Autori tregon mjaft bukur se çfarë e bëri nënën të ketë aq frikë nga zyrat e pushtetit. "Nëna" në romanin tim nuk është një personazh që e bën politikën. Ajo vetëm e pëson politikën. Rrjedhimisht, përjetimet e saj janë ato të një personazhi të pafuqishëm përballë politikës. Vetëdija e pafuqisë është dërmuese për njeriun. Në këtë roman unë kam synuar ta tregoj ekzistencën e shqiptarit të thjesht nën diktaturë, jo duke e kërkuar dramën në vatrën e dukshme të dhunës e që ishin burgjet apo internimet, por në atë pjesë të skenës që paraqitej si suksesi i regjimit e ku jetonte shumica absolute e popullsisë", - shprehet Mustafaj.

Autori pasi arrin ta qartësojë nënën për këtë realitet të trishtë, apo edhe për pakon e ardhur pas shumë vitesh nga Munihi me shënimin e postës së Tiranës "Dëmtuar rrugës", ky, mund të konsiderohet vërtetë një roman me fund të lumtur. Me këtë roman të llojit e stilit të veçantë, Besnik Mustafaj është në të drejtën e tij ta lëjë mënjane politikën dhe t'i përkushtohet me gjithë potencialin e talentit të tij prozës. Pasi është vërtetë befasues prezantimi i tij, me këtë roman fitues të Çmimit të madh të Panairit të Librit 2019, me të cilin ai u shpall "Autori më i mirë i vitit".

Dashuria njerëzore dhe plagët sociale në romanin "Anja" të Ahmet Prençit

- *Romani "ANJA", ndër më të shiturit në libraritë e Tiranës, mbart kujdesin e redaktorit Shëfqet Meko e të kritikant të mirënjohur Behar Gjoka*
- *Konceptet filozofike të Ahmet Prençit për vazhdimësinë e jetës, për familjen dhe shtetin e së drejtës, të shprehura aq qartë në romanin "Anja, e bëjnë këtë një vepër letrare që sjell risi në prozën e sotme shqipe. Ligjërime të tilla si "Spërkatja e themeleve me gjak glorifikonte simbolikën e sakrificës njerëzore për shpirtin hyjnor", apo se "Kullat ishin parçmoret e gurta të fshatit përballë luftrave qindravjeçare" dëshmojnë për një autor që njëh mirë historinë dhe traditën e vendlindjes së tij*

Nëse, sipas shkrimtarit të mirënjohur Besnik Mustafaj, me vëllimin poetik të vitit 2016, "Udhë në pasqyrë", poeti Ahmet Prençi" erdhi me një lloj tradite që ka letërsia shqipe, me romanin e tij "ANJA" ai sjell risi në botën letrare, duke befasuar lexuesin e shumtë të tij. Kjo, jo vetëm për subjektin



tepër interesant, por dhe për gjuhën e pasur e mjetet shprehëse në karakterizimin e dy personazheve kryesorë të romanit, Anton Hila dhe Anja Steve.

I pari, besnik i parimit për ta ngrysur jetën në vetminë e tij, ndërsa e dyta, një krijesë e magjishme franko-shqiptare që sjell pak Paris në Drinas, nga ku ngjizet dhe trashëgimtari i tyre me emrin e bukur ARBËR. Kësisoj, "Anja" është një risi në prozën e sotme shqipe, qoftë si subjekt dhe për karakterin e ndërthurjen e personazheve. Se në fund të fundit, edhe Antoni, i cili pas disfatës në dashuri në rininë e tij të herëshme, dhe që në mezin e moshës, kërkonte vetmi të përherëshme, më në fund e ka trashëgimtarin e tij. Kështu, mesazhi që përcjell Ahmet Prençi tek lexuesi është ai i ripërtëritjes së jetës.

Për këtë ai përdor magjinë dhe forma tjera të mbinatyrshme si element parësor të përmbajtjes, temës dhe vendosjes së personazheve.

Një dashuri me "nekrologji" të parashkruar

Si prolog të ngjarjeve të romanit "ANJA" autori vendos disfatën e inxhinierit të talentuar Anton Hila në dashurinë për studenten e fizikës, vajzë e një aktori të famshëm, si dhe dy të rinjtë që e kishin përjetuar shumë keq diktatin prindëror të kësaj ndarjeje. Ndonëse Eli mbeti në mendjen e tij, ashtu e re, e bukur, bjondina dhe elegantja simpatike e shkollës, Antoni, kurrë më, pas saj, megjithë disa flirtime rastësore me femra, nuk mendoi të krijonte familje me ndonjërin prej tyre. Autori e profilizon Anton Hilën, si një enigmë njerëzore mes atij pejsazhi të magjishëm, apo si "një tip i mistershëm", në rrjedhën e ngjarjeve në vitet që kalonin, e kur secili prej tyre (Ai dhe ish - e dashura studente) udhëtonte me pasaportën e vet shpirtërore.

Si djalë i kulturuar dhe bukurosh, aventurat e dashurisë me vajza të bukura ishin një pjesë romantike e jetës së Antonit, ku drama dhe melodrama nuk kuptohen si gjini letrare, por si realitete pagjumësie të bukur...Për ta bërë sa më bindës këtë personazh autori fantazon deri skena për tentativë vetëvrasjeje pas dështimit me Elin, duke i nxjerrë përpara lokomotivës së trenit, lypësin, që pasi i jep dhjetëlekëshin, i rrëfen dramën e tij të dashurisë..., e megjithatë ai e donte jetën. Kësisoj gjejmë në këtë roman portretizime e përshkrime brilante të ngjarjeve e rrethanave, të përjetimeve të dashurisë së dëlirë, por dhe të përjetimeve dramatike, deri sa tek Anton Hila shfaqet franko-shqiptarja Anja Steve, (me nënë shqiptare e me baba francez).

Të skeduar e përshkruara si rrëfime ngjarjesh e episodesh prej më shumë se tri dekadash, autori Prençi, sjell mjeshtërisht realitetin e qytetit të Drinasit ku po ndërtohej një vepër e rëndësishme hidro-energjitike, drejtues teknik i së cilës ishte inxhinieri Anton Hila (ashtu si edhe peisazhin mahnitës të fshatit ku ai ka ndërtuar vilën e ku po kalonte vitet e fundit të jetës së tij). Duke perifrazuar autorin Prençi: "Ndonjëherë në jetë, një takim krejt i rastësishëm mund të shndërrohet në ngjarje të rëndësishme, në një pikë kthese të jetës tënde, e cila mund të ndryshojë gjithçka...". Kështu ndodh edhe me personazhet e këtij romani. Anja që ka ardhur për pushime në qytetin e vendlindjes së nënës së saj "brenda vetes, me instiktet e një princeshe pa oborr mbretëror, ndjente shpalljen e një sfide për princin e panjohur". Ndërsa Antoni, ndonëse vetmitar i deklaruar, trajtohet në roman si "Mbreti në rrjetë".

Nëse për Antonin, dështimi në dashurinë e parë kishte mbyllur shtigjet e një lidhje tjetër afatgjatë, tek Anja, dashuria me Mishelin, të cilit i kishte falur virgjërinë, i përkiste së kaluarës, që nuk duhej bërë pengesë për të ardhmen (Ajo që një ndjenjë e konsumuar dhe e "arkivuar" në muzeun e harresës), për Antonin, ajo erdhi krejt rastësisht si krijesë e magjishme e zbritur nga qielli, enkas për një vetmitar si ai.... Pikërisht, Ai që e kishte konsideruar martesën si burgun shpirtëror që kishte krijuar me vullnetin e vet njerëzimi përmes normave, parimeve, moralit, institucioneve, feve deri dhe tek gjykatat...me Anjën "ra brenda", si i thonë. Dhe në këtë rast, autori fantazon aq

bukur saqë sipas tij: "Po të kishte patur rastin Clinton të njihnte bukurinë franko-shqiptare, të ngjizur aq magjishëm tek Anja, ai me siguri do të kishte dhënë dorëheqjen nga posti i lartë, duke divorcuar edhe vetë Hilarin, për t'u martuar me Anjën"... Dhe s'kish si të ndodhte ndryshe, kur autori Prençi na paraqet në portretin e Anjës vajzën ku ishin bërë bashkë të gjitha: intelijenca, pasioni, bukuria dhe singëriteti.

Ndërsa Anja kërkonte pak Paris në Drinas..., për Antonin, tashmë në mesin e malit të moshës, (që për më optimistët konsiderohet mosha 50-vjeçare), ndërmarrja e një lidhje serioze dhe afatgjatë me një femër, duket si një ftesë për ecje alpine....

Kësisoj, Ahmet Prençi me romanin e tij na afron shumë pranë me personazhet. Ai i përgatit ato për një ngjarje të madhe dhe, sa më pranë saj janë ato, aq më i rreptë është sprovimi i tyre dhe më dramatik përcaktimi. Gjatë atij përjetimi magjik gjatë pesë ditëve në Drinas dhe në plazhin e qytetit bregdetar i ishte shprehur vajzës franko-shqiptare se: "Ti je një krijesë e magjishme Anja! Të dërgoi Zoti tek unë për të më thënë se unë jetoj, se mund të dashuroj përsëri. Ti më binde se jam në gjendje të dua përsëri...". Por, largimi i saj për në Francë, pa i thënë "lamtumirë", do të ishte, siç e shtjellon më tej autori: "Një dashuri me 'nekrologji' të parashkruar".

Teksa syrin e brendshëm të mendjes e qarkullonte herëherës në pyllin e kujtimeve, përfytyrimeve dhe vizioneve për të nesërmen, Anja ia kishte trazuar Antonit psikikën duke prishur krejt ritmin e përditshmërisë së tij...

Letrat e Anjës, risi në prozën e Ahmet Prençi

Mesazhin e ripërtëritjes së jetës autori Ahmet Prençi e përcjell aq bukur nëpërmjet letrave të Anjës, që vijnë në sintezë me dashurinë e saj të zjarrtë për Anton Hilën. Janë letra që përshkruajnë ndjesinë dhe përbetimin e saj për të rritur e vetme trashëgimtarin e ngjizur në Shqipëri, të pagëzuar me emrin Arbër. Pa patur pranë atë që e konsideronte "vetmitarin e përjetshëm", që e dashuroi dhe e dashuronte marrëzisht. Dhe në këtë kontekst autori shtjellon mjeshtërisht filozofinë e tij se "Gjithë dramat e kanë në gjenezën e vet dashurinë e verbër". Siç del në këtë roman befasues, "pa Anjën, inxhineri Anton Hila, ishte uji apo vepra e betontë...Për aq ditë sa ndenjën bashkë, ajo paskësh kaluar nëpër të, nëpër këtë turbinë njerëzore, si një lëng magjik jete, si një erë me oksigjen përtëritës. Kështu, Ahmet Prençi, si një arkitekt i vërtetë ligjërimesh të këndshme, ndërthur dy linjat që të çojnë tek një roman shumë i arrirë dhe mjaft tërheqës për lexuesin. Nëpërmjet një procesi të gjatë e të nderlikuar krijues, ai dëshmon aftësinë për të treguar realitete të perceptuara dhe përjetime si realizim artistik në romanin "ANJA".

Respekti për kohën, është respekt për veten

Një mesazh tjetër që përcillet në romanin "Anja" është respekti për kohën si respekt për jetën. Për këtë mjafton të perifrazojmë sërish autorin Prençi në rrëfimin e lumturisë

pa kufi që përjetuan dy personazhet kryesorë. "Anja gjykoi se vlerën e kohës e japin veprat dhe jo minutat. Me një grusht kohë (aq ishin ditët e marrëdhënies me Antonin) ajo u mbush plot energji dhe pozitivitet, lumturi dhe kënaqësi...Epo, kot nuk paskan thënë, se çfarë sjell minuti nuk e sjell ora. Për herë të parë në Shqipëri ajo kishte provuar dashurinë rrufe, siç ndodh gati në çdo restorant të Nju Jorkut, ku me shikimin e parë zgjedh partneren që të pëlqen, shijon një pije të shpejtë, dhe po aq shpejtë mund të përfundosh duke bërë seks, në kthinat e errta të restorantit, apo në rastet më komode edhe në hotele...E pastaj, secili me vrap në punën e vet, pa ia mësuar as emrin njëri-tjetrit". Në rrëfimin e këtyre ngjarjeve autori i trajton kohën dhe gjeografinë si dy armi që të dashurisë.... Ndërsa aktin e saj final, rritjen pa praninë e Antonit të djalit të tyre me emrin Arbër, autori e lidh aq bukur me faktin që "Në adoleshencën e saj, Anjës ia kishte zgjuar krenarinë për 'gjenin shqiptar', një shkrimtar nga Shqipëria, Ismail Kadare...".

Institucioni i kullës

Një gjetje mjaft interesante e autorit është origjina e personazhit kryesor, nga fshati me emrin Saukull. Ndonëse kishte lindur, ishte rritur e shkolluar në kryeqytet (si edhe jashtë vendit), Anton Hila ishte i dhënë edhe pas origjinës. Vetëm një herë në moshën 20-vjeçare ai kishte qenë në këtë fshat, nga "kishte mësuar sa rëndësi ka fjala e dhënë, sa domethënëse janë marrëdhëniet mes vëllezërve në familjen

tradicionale, kishte fiksuar (memorizuar) mirë gjërat më të shenjta të të parëve tanë: fjalën e dhënë, nderin, besën, mikpritjen, mirënjohjen, besimin, punën, sakrificën, vetëpërmbytjen, ekuilibrin, respektin etj". Si njohës gjer në perfeksion i historisë dhe traditës, autori Prençi e paraqet kullën si simbolin që nuk kishte qenë thjeshtë një vend strehimi apo banimi, por një institucion unik etno-kulturor, një ngrehinë shpirtërore dhe një tempull besimi dhe lirie...

Nisur nga bagazhi jetësor, por veçanërisht në ligjërimin filozofik, autori, sjell një roman që hyn me dinjitet në fondin e artë të letërsisë shqipe. Ligjërime të tilla si: "Spërkatja e themeleve me gjak glorifikonte simbolikën e sakrificës njerëzore për shpirtin hyjnor", apo se "Kullat ishin parzmoret e gurta të fshatit përballë luftimeve qindravjeçare" dëshmojnë për një autor që njeh mirë historinë dhe traditën e vendlindjes së tij. Këto i gjejmë qoftë dhe në përshkrimin e institucionit të "Odës" ku: "...nuk lejoheshin kurrësi fjalët në vesh ose biseda të ngushta që nuk i dëgjonin të gjithë burrat e pranishëm në dhomë. Flitej me radhë dhe dëgjoreshin të gjithë..." Po ashtu, autori na e paraqet personazhin kryesor, si studjues të vëmendshëm të veprës së At Shtjefën Gjeçovit, i cili përmbledh të gjitha normat e sjelljes në Kanunin që mban emrin "Kanuni i Lek Dukagjinit", ku janë të sistemuara një seri dokesh, ligjesh e rregullash të Veriut. Ndërkohë, në kontrast me institucionin e kullës në Malësi, në romanin "Anja" gjejmë arkitekturën e shtëpive në Jug, shtëpi me çati, të tilla që rronin shumë dhe nuk i rrezikonin as rrebeshet e ujit të vjeshtës, as pesha e borës së dimrit, apo e rrasave të gurit.

Intelektuali i virtytshëm që nuk pajtohet me të keqen

Në një tjetër këndvështrim, autori Prençi na e paraqet heroin e veprës së tij, si intelektualin e virtytshëm që s'pajtohet me të keqen. Këtë e gjejmë në rastet kur "Antoni kritikonte pa rezerva nisma e qëndrime të të gjitha palëve, që sipas tij ishin populiste dhe jo efektive për shoqërinë...." Me një frazeologji interesante, në ekzaminimin perfekt që iu bën qeveritarëve të korruptuar, ai sjell krahasime me vende me demokraci të zhvilluar, ku kurrësesi nuk mund të depërtojë në instanca qeverisëse njerëz me të shkuar kriminale. Kjo sipas tij edhe për faktin se "Amerika që është shkalla më e përparuar e lirisë dhe njeriut të lirë, bën kujdes që, para se të zgjedhë Presidentin e vet, kontrollon dhe e bën publike certifikatën shëndetësore të kandidatëve. Jo si në Shqipëri, që një i çmendur mund të bëhet kryeministër, president, deputet etj...". Po në këtë optikë e trajon autori zhvillimin e ngjarjeve kriminale që ndodhin në vendin tonë, si dhe këndvështrimin e tij për dinjitetin njerëzor, të shprehura këto mjaft bukur në profilin e shokut të fëmijërisë, prokuror Sandrit, i cili nuk nguron t'i tregojë ligjin edhe ish-prokurorit të përgjithshëm (Alfons Gurrës), të akuzuar për lidhjen e tij me persona të inkrimunar, nga të cilët kishte përfituar shuma marramendëse.

Plagët e rënda sociale, shtjellohen mjaft artistikisht qoftë dhe vetëm në rrëfimin e Vasilikës, pas krimit makabër të Janit që vret bashkëshorten, grekun dhe vetveten. Autori i jep kështu koherencë veprës së tij edhe në përshkrimin e

marrëdhënieve me shërbyesen e tij, Vasilikën, në shtëpinë ku ishte vendosur përkohësisht në Drinas. Një grua kjo, që ndonëse i ishte përkushtuar familjes, që kishte shërbyer si veterinerë e lartë, kishte përfunduar e braktisur nga djemtë, pas divorcit me të shoqin që e la atë për një vajzë të re. Nëpërmjet Vasilikës ai rrëfen edhe rastin e bashkëshortëve Jani e Margarita në kërkimin domosdoshmërisht të trashëgimitarit që s'po e ngjiznin edhe pas shumë vitesh martesë. Dhe kur Margarita, për të realizuar këtë ëndërr të Janit, tenton një skenë seksi të fshehtë me tregtarin grek, vjen edhe rasti fatal: krimi makabër që kryen Jani duke i vrarë ata të dy si dhe vetveten.

Po në këndvështrimin e ripërtëritjes së jetës gjejmë në roman edhe rrëfimin brilant të rastit të prokuror Sandrit, i cili ndonëse vuante mosngjizjen e një fëmije me bashkëshorten e tij, në adoleshencë kishte lënë shtatzënë bashkëshorten e operativit të sigurimit, e cila e kishte joshur atë në shtëpinë e saj, brenda krevatit bashkëshortor. Janë këto trille magjepsëse që e bëjnë mjaft tërheqës romanin e Ahmet Prençit. Kjo del qoftë dhe në qasjen e autorit për rastet kur: "Jani që vrau Margaritën, por dhe shoku i tij Prokuror Sandri, ishin verbuar nga instituti i trashëgimit dhe i ripërtëritjes gjenetike, që është misioni i çdo çifti dhe finalja e çdo ndërveprimi seksual".

Dilema: Burri apo gruaja?!

"ANJA" është ndoshta romani i parë ku Ahmet Prençi ngre në prozë akuzën ndaj Vatikanit, si dhe ndaj klerikëve të mëdhenj, për poshttrimin që i bëjnë femrës. Kanë peshë të

rëndë pikëpytjet e tij: Pse nuk doli njëherë tym nga Vatikani që të njoftojë zgjedhjen e një Pape femër?!...Apo, pse nuk pati një imam grua?!!!Autori, nëpërmjet fjalës artistike shpjegon se si, "matriarkati kishte vdekur shekuj më parë, ndaj fuqia e burrave shfaqej kudo: në politikë, fe, ushtri".

Po pse feja?!, -shtron pyetjen autori. Pse ky poltron ku ulet Zoti dhe mirësia nuk i kishte dhënë femrës atë që meritonte. Pse kurrë në historinë e Vatikanit nuk u pa një grua përках klerikëve me uniformën e zezë? Pse Vatikani nuk kishte diku në listë një grua në krye!...Ata peshkopë, ata njerëz me fytyra gipsi që vetëm dinë të shqiptojnë bukur fjalën "Amen", kurrë nuk menduan se janë aq të barabartë sa murgeshat e shumta që kishin në krah... Dhe po aq tronditës konkluzioni i autorit se: "Jo vetëm kaq, por edhe shenjtërimin e Nënë Terezës, ata burra me rraso të zezë e bënë pas vdekjes, kur ajo meritonte të shpallej së gjalli shenjtore e mirësisë e paqes njerëzore...".

Edhe në botën myslimane, e njëjta gjë. Pse asnjëherë në botën islame, imam, nuk ka arritur të jetë një femër?! Në këtë mënyrë, si askush tjetër, Ahmet Prençi guxon t'i konsiderojë teoritë fetare si "limonata" për mendjet e dobëta...Konceptet filozofike të Ahmet Prençit për vazhdimësinë e jetës, për familjen dhe shtetin e së drejtës, të shprehura aq qartë në romanin "Anja, e bëjnë këtë një vepër letrare që sjell risi në prozën e sotme shqipe.

Ky roman, ndër më të shiturit në libraritë e Tiranës mbart ekspertizën e redaktorit Shefqet Meko e të kritikut të mirënjohur letrar, Behar Gjoka.

"5 SKENARË..." të Bujar Kapexhiut

Nga pesë skenarët që Kapexhiu ka përmbledhur në këtë libër të llojit e stilit të veçantë, dy komeditë "Edhe kështu edhe ashtu" (1989) dhe "Dy herë mat" (1986) janë bërë filma, ndërsa tre të tjerët ai i vë në dispozicion të krijuesve që kanë dëshirën, pasionin, shijen dhe aftësinë për krijimet e artit komik



Libri "5 skenarë", i Prof. Bujar Kapexhiu, vjen si dhurata më e mirë e këtij fillimviti (2021) për lexuesin e veçanërisht për autorët e rinj të veprave letrare. Një libër nëpërmjet të

cilit autori Kapexhiu, ikonë e artit dhe kulturës kombëtare, u dhuron bujarisht krijuesve të rinj përvojën e tij të suksesshme në shkrimin e skenarëve të filmave artistik.

Botimi i skenarëve letrarë të filmave artistik është një përvojë botërore. Tek ne kjo praktikë ka munguar. Skenari letrar i filmit artistik është një krijimtari e mirëfilltë letrare, plotëson me dinjitet artistik punën krijuese të autorit dhe, së fundi, justifikon një angazhim dashamirës të çdo lexuesi. Ky libër i Mjeshtrit Kapexhiu, përmban skenarët dhe platformat regjisoriale të filmave "Dy herë mat" (kinokomedi), "Edhe kështu, edhe ashtu" (kinokomedi muzikore), "Bixhoz me dekorata" (kinokomedi), "Mozaiku" (kinokomedi) dhe "Pipiruku këngëtar" (skenar për film artistik për fëmijë), të shkruara me mjeshtëri gjuhësore e mjaft të arrirë artistikisht.


Duke na dhënë me detaje elementet e platformës regjisoriale, për shembull te kinokomedia "Dy herë mat", si ideja, konflikti, kompozicioni, trajtimi figurativ etj., te loja e aktorëve do të mësojmë se si e bën Mjeshtri Kapexhiu pantelikën e tyre, si të Ilo Pincit, Sazanit, Kopit, Cukut, Rudinës, Besës, Takut, gruas së Kopit (si dhe të grupit të shahistëve), për lexuesin e sidomos për shkrimtarët që mund të pretendojnë t'i shndërrojnë në skenarë filmi romanet apo novelat e tyre, rëndësi ka stili i përdoruar nga Kapexhiu në përshkrimin e ngjarjeve.

Sot formatimi strukturor i skenarit të filmit ka ndryshuar, por Kapexhiu ruan atë formë me nuanca më të dukshme letrare, siç është shkruar skenari i filmit artistik në ato vite.

Duket si një tregim i gjatë apo novelë, ku shtjellohet subjekti me të gjitha nuancat e përshkrimit të mjedisit, të veprimit dhe dialogut të personazheve. Kjo, thotë Kapexhiu, "për të ruajtur dhe si dokumentacion autentik formën dhe stilin e të shkruarit të skenarit. Quhet skenar letrar, por të jemi të singertë e objektivë që nuancat letrare në skenarin e filmit janë të kursyera, sepse aty ka rëndësi, veprimi, aksioni, filli i subjektit dhe dialogu. Ekspresioni, psikologjia, meditim i personazheve mbetet si detyrë e aktorëve në sheshin e xhirimit nën drejtimin e regjisorit dhe kompozimit të figurës nga operatori. Filmi 'Dy herë mat' tashmë është parë nga mijëra spektatorë në kinema dhe në ekranin e televizorit dhe është shoqëruar me përshtypjet më të mira në vlerësimin artistik për një komedi brilante e me nivel artistik nga të gjithë komponentët."

"Dy herë..." apo "Tri herë mat"

Pakkush e di që filmi komedi "Dy herë mat", që mban autorësinë e Bujar Kapexhiut, fillimisht ka qenë ideuar për "Tri herë mat". Ndërsa flet për komeditë që ka realizuar në vite, e gjithë fytyra i merr një pamje hareje. Duket se humori është argument për të cilin pëlqen të flasë pa fund. "Më pëlqente gjithmonë të bëja humor në shoqëri e në familje, kujton ai. Interpretimi i filmit Dy herë mat ka qenë edhe si një vazhdë e punës sime si regjisor në Estradën e Tiranës. Aty u caktova, sapo mbarova shkollën. Gjatë gjithë këtyre viteve jam marrë me humorin, si me shkrimet, ashtu edhe



me regjinë. Kështu që kur shkova në Kinostudio, fillimisht shkrova një komedi e cila u pëlqye mjaft. Atëherë isha regjisor, piktor dhe skenarist i filmit vizatimor. Mirëpo dëshira ishte që të kaloja regjisor në filmin artistik. Prandaj shkrova skenarin, që në atë kohë titullohej “Tri herë mat”. Por meqë filmi dilte shumë i gjatë, hoqëm një mat dhe e bëmë “Dy herë mat”.

Por unë nuk e kisha menduar që do ta interpretoja vetë rolin kryesor të këtij filmi, e kisha taksur këtë rol për aktorin Agim Qirjaqi. Atë e kam pasur student në Institutin e Arteve dhe më kishte lënë përshtypje të jashtëzakonshme, si një student i rrallë dhe më vonë si një aktor i mrekullueshëm.

Mirëpo kur kërkova Agimin, ai ishte i angazhuar në një film tjetër. Kështu që u vendos që këtë rol ta interpretoja unë. Padyshim nuk është lehtë që edhe të interpretosh edhe të drejtosh. Gjithmonë duhet të kesh një sy tjetër që të shikon dhe të korrigjon. Por kam bashkëpunuar shumë me operatorin

Lionel Konomi, i cili më ka ndihmuar në këtë drejtim dhe ka qenë ai që ka bërë syrin korrigjues gjatë filmit."

Koherenca te "Bixhoz me dekorata"

Mjaft tërheqës është skenari i kinokomedisë "Bixhoz me dekorata", përfshirë në librin voluminoz me 544 faqe të Bujar Kapexhiut. Ndonëse titulli mjaft sinjifikativ është në koherencë edhe me realitetin e sotëm të shoqërisë shqiptare, në parashkrimin që i bën skenarit të kësaj kinokomedie autori na njeh me kontradiktën themelore në këtë subjekt, që është përballja e dy koncepteve për moralin: "Ajo e gjeneralit Taho dhe e nipit, i cili me lirinë e të shprehurit që erdhi me vendosjen e demokracisë, merret me një biznes mjaft fitimprurës, me botimin dhe shpërndarjen e një reviste me përmbajtje erotike". Me mjeshtëri të rrallë autori vë përballë dy personazhe me karakteristika të veçanta e shumë larg nga njëri-tjetri, për sa i përket konceptit se ç'është e moralshme e ç'nuk është e tillë.

Linja tjetër që e bën më tërheqës subjektin dhe i jep karakterin komik ngjarjes është linja e kapterit Xhemal, që shkurt e thërrasin Xhemo dhe kur, me miqësinë e ministrit, rritet në përgjegjësi, në takimet me ushtarakët e NATO-s e thërrasin Xhejms. Dy komshinj, gjenerali Taho, që me të padrejtë, sipas reformës, e nxjerrin në pension të parakohshëm dhe kapteri Xhemo që rritet në përgjegjësi, paralelisht kalojnë në situata gazmore që ndërthuren me njëra-tjetrën duke zbuluar situata komike me të papriturat dhe batutat e zgjedhura humoristike.

Për sa i përket anës kompozicionale, Kapexhiu i vendos

ngjarjet në mjedise të tilla si: Shtëpia e gjeneralit (dhoma e gjumit, dhoma e ndenjes, kuzhina, anekse etj.); Hyrja para pallatit, Sheshi i pallatit, Sheshpushim midis apartamenteve, Repart rrobaqepësie, në Librari, Dyqan tapetesh, Shtëpia e kapter Xhemos etj.; mjedise këto ku zhvillohen dialogë tërheqës mes personazheve Sofika, Riku, Yllka, Tahoe, Piku, Ariani, Qefseri, Viola etj.

Këtu skenaristi përcakton qartë mesazhin dhe qëndrimin ideoemocional që do të jetë i mjaftueshëm vetëm me interpretimin elegant, origjinal e gazmor të aktorëve, si dhe trajtimin regjisorial për gjithçka, ku duhet dora e vëmendja e tij, pa neglizhuar këtu edhe fotografinë dhe këndin e dinamikën e kameras.

Këto elemente i gjejmë edhe në skenarët e kinokomedisë muzikore "Edhe kështu, edhe ashtu", të kinokomedisë "Mozaiku", si dhe në skenarin për film artistik për fëmijë "Pipiruku këngëtar", ky i fundit diçka e re, e parealizuar më parë në artin kinematografik tek ne.

"Pipiruku këngëtar" në dukje ngjan film për fëmijë, por subjekti që shtjellohet në të ngjall interes edhe për spektatorin e rritur. Ky skenar ka një teknikë të kombinuar midis filmit me aktorë dhe filmit të animuar.

Pra, figura reale e aktorit është përballë figurave të vizatuara. Personazhi i filmit të animuar, Pipiruku, tashmë i njohur me tre seritë e tij, ka dëshirë të bëhet këngëtar dhe me ndihmën e miqve të tij Bleta, Milingona dhe Zogu gushëkuq merr rrugën për të arritur në godinën e Televizionit që po përgatit festivalin e këngës. Dhe pasi kalon në situata

të ndryshme plot humor realizon më në fund ëndrrën e tij, pjesëmarrjen në festival.

Botimi i këtyre pesë skenarëve vjen jo vetëm si dëshirë e autorit, për t'i botuar vetëm për vete, për t'i pasur në koleksionin e krijimtarisë letrare, por për të qenë edhe në duart e atyre personave pasionantë, fillestarë që kanë dëshirë të ndjekin rrugën e krijimit të skenarëve për film, siç e quajnë artin e shtatë. Kjo është përvojë dhe një kontribut për të ardhmen e artit kinematografik.

Nga pesë skenarët që Kapexhiu ka përmbledhur në këtë libër, dy komeditë "Edhe kështu edhe ashtu" (1989) dhe "Dy herë mat" (1986) janë bërë filma, ndërsa tre të tjerët ai i vë në dispozicion të krijuesve që kanë dëshirën, pasionin, shijen dhe aftësinë për krijimet e artit komik.

Një personalitet i artit vizual shqiptar në të gjitha kuptimet

Prof. Bujar Kapexhiu, i dekoruar nga Presidenti i Republikës me titujt më të lartë "Mjeshtër i Madh" dhe "Nderi i kombit", është një personalitet i artit vizual shqiptar në të gjitha kuptimet.

Përmendim këtu filmat "Dy herë mat", "Edhe kështu edhe ashtu", "Stola në park", "Tela për Violinë", "Duel i heshtur" etj. Karikaturat e Kapexhiut e kanë shoqëruar gjithnjë aktualitetin dhe kanë kritikuar me zgjuarsi fenomenet e forta negative të jetës në Shqipëri.

Së fundmi, ai vjen me librin e tij më të ri "5 skenarë", me

të cilin përcjell përvojën e vet të vyer me filmin artistik, si skenarist dhe regjisor, karikaturist dhe aktor i mirënjohur shqiptar. Ky libër i Kapexhiut është si një "feste mbi sy" i këtij artisti me vlera shumëdimensionale krijuese dhe argëtuese, i cili përherë mbetet në sytë e publikut i ri dhe i qeshur, i dashur dhe i respektuar, i palodhur, këmbëngulës, energjik dhe befasues, që në dekadat e jetës së tij ka gdhendur dhe vetskalitur profilin unik me emrin: Bujar Kapexhiu.

*"TORAKS", libri i poetit të vlerësuar
nga Kadare, Agolli, Siliqi, Kallulli e Jorgoni*



Shkrimtari Shefki Karadaku, i vlerësuar për poezinë e tij nga shkrimtarët dhe kritikët më në zë, si Kadare, Agolli, Siliqi, Kallulli, në fillimvitin e dekadës së re (2020), një vit para se të ndërronte jetë në moshën 80-vjeçare (më 16 Mars 2021) solli për lexuesin vëllimin poetik "TORAKS" (poezi, vendlindjes & vendlindasve).

Në 91 vjershat (pa titull) që mbushin 201 faqet e këtij vëllimi ndjehet aroma e vendlindjes së poetit, Elbasanit, ku ai u lind, u rrit dhe u formua si shkrimtar. Kësisoj, vendlindja vjen në këtë vëllim si muzë e përjetimeve poetike të Karadkut, i cili si rrallë kush thur vargje për "gjethet ar, që ranë nëpër sukat e Shkumbinit" dhe për "lejlekët që thirrën fort, tek ikin nëpër tokat e Nadirit....". Po në këto përjetime poetike gjejmë edhe "rënkimet e një kumuriye, që do të qëndrojë në atdhe....".

Nëse Shekfi Karadaku është i njohur edhe me baladën brilante për Haxhire Myzyrin, në këtë vëllim, veçmas spikat vjersha kushtuar Nadires, kësaj bukurosheje të magjishme që solli për poetin (bashkëshortin) erën çame dhe gëzimet misterioze të një atdheu të braktisur....Mjafton qoftë edhe kjo për zgjedhje për t'u mrekulluar me poezinë e Karadakut, që është poezi përqëndrimesh dhe me karakteristika shumë të sakta, përsa i përket formës dhe kompozicionit. Kjo duket fare qartë qoftë dhe në tri vargjet e para të kësaj vjershe: "Në vendin tim të artë ku era luan me kajsitë/ Dhe vala e Shkumbinit përplas jehonën e planetit/ Ti solle erën çame o bukuroshe e magjishme...".

Në këtë vëllim poetik, me titull të rrallgjetshtëm "TORAKS", gjen poezi shumë intriguese që të bëjnë për vete që në krye të herës. Mendimin e thellë filozofik të këtij gjeniu krijues e dallon qoftë dhe në vargjet: "....më bien telat e poezisë dhe të forcës/ mbi Elbasan i shoh sesi përpiqen plot alarm/ Mes mbrëmjeve tragjike Shkumbini dridhet, hesht i lodhur...."

Parë në tërësinë e tij, ky vëllim shpalos profilin poetik të një poeti me ndjeshmëri të lartë, me teknika vjershërimi midis traditacionales dhe modernes e postmodernes, me një pasuri të begatë mjetesh dhe teknikash poetike, me struktura vargjesh e strofash të zhdërvjellëta, që e kthejnë formën në një procedim të mesazhit estetik. Aq e vërtetë kjo, sa që nëse edhe një lexues i rastësishëm shfleton librin në fjalë, ai nuk mund ta palosë pa shkuar tek faqja e fundit. Kjo në të vërtetë është një "magji poetike" që diti ta bëjë mjeshtërisht vetëm "magjistari" i fjalës Shefki Karadaku, ai poet dhe njeri i mrekullueshëm që fati ma solli ta njoh nga afër duke u "ulur" butësisht në poltronin e miqve të mi të rallë.

Poezia e këtij vëllimi është poezi e prejardhjes, është poezi e këngës, e ëndrrës, e dashurisë, e dhimbjes, e urisë, e krejt në fund e përjetësisë. Libri fund e krye shpalos ndjesitë e brendshme të poetit në raport me vendlindjen e shndërruar tashmë në muzën e përjetimeve poetike, pa të cilën nuk gjen qetësinë shpirtërore e me të cilën tundohet deri në pafundësi.

Dhe nëse për Petraq Riston, "poeti Shefki Karadaku është një lirik i madh i poezisë shqipe, një zë origjinal që në rininë e hershme", Kostandin Dharmo sjell në vëmendje librin e parë të Shefki Karadakut "Kënga e karrove të drithit" (botuar para pesë dekadash) i cili e ngjiti yllin e tij në konstelacionin poetik shqiptar. Kësisoj, sipas Dharmos, do të drithëronte pena e Karadakut, dhe libri i botuar në mijëra kopje, tirazh normativ n'ato vite, u kthye në një trend poetik, krahas dy-tre vëllimeve të tjerë më të arrirë të autorëve të brezit të tij. "Ai u vendos në Tiranë që kur ishte ende në vitet shkollore

dhe, pas studimeve, filloi punë si redaktor në revistën prestigjioze "Ylli", e cila, për koicidencë të një sensi supersticioz, i kishte zyrat e redaksisë në Rugën e Elbasanit, pranë Urës së Tabakëve. N'asnjë libër poetik, të cilët ai i krijoi dhe i botoi njeri pas tjetrit, nuk mungon Elbasani; Karadaku është ajo kumria që s'e tradhtoi kurrë...", shkruan Konstadin Dharmo në përçjelljen që i bën këtij vëllimi. Dharmo vlerëson gjithashtu fotografitë dhe vizatimet e hedhura me fantazi fine nga vetë autori Karadaku në faqet e këtij libri. Shefki Karadaku me plot të drejtë vlerësohet si një nga gurët e çmuar të gjerdanit kulturor elbasanas dhe mbarëkombëtar. Ai rrjedh nga një familje e hershme elbasanase, patriotike dhe arsimdashëse. Babai i tij, Xhaferr Karadaku, ka qenë jo vetëm një mësues i apasionuar për dekada të tëra, por edhe një korrespondent tepër i zellshëm dhe i vëmendshëm i gazetës "Shkumbini", gazetë e viteve 1921-1922 e qytetit të tij të lindjes, Elbasan. Po me këtë emër, kjo gazetë shpalosi faqet e veta në vitet 1966 - 1990.

Veprimtaria krijuese e shkrimtarit dhe poetit Shefki Karadaku daton shumë herët, qysh në adoleshencën e tij. Me sinqeritetin që e karakterizonte, në fillimet e para të krijimtarisë së tij do të thurte vargjet: "...Unë vij nga qyteti i vjetër me qerpiç/ Me zëra kalamajsh në muzgun vjeshtor/ Unë vij nga kalldrëmi i vjetër i etërve/ Nga kinemaja me filmat pa zë/ Nga shkolla pa xhama/ Unë vij këmbëzbathur".

Poezitë e vëllimit poetik të tij "TORAKS", përshkohen nga nostalgjia e poetit për gjithçka që ndodhet larg, por që, njëherësh, kjo "gjithçka" është, gjithnjë, pranë tij. Malli dhe


dashuria e shprehur me mjeshtëri artistike, me një gjuhë të pasur dhe figuracion të zgjedhur poetik, herë si një trishtim i lehtë, herë si një klithmë e thellë shpirtërore, përshkon si një fill i blertë të 91 vjershat e librit. Çdo poezi e këtij vëllimi, duke qenë mjaft e ndjeshme, është, në të njëjtën kohë, dhe një kyç, me të cilin poeti hap zemrën e tij të pastër e të sinqertë.

"Magjistari" i fjalës shqipe, Shefki Karadaku, është gjithashtu i njohur si një nga prozatorët më të mirë të vendit, me mbi 50 romane e vëllime me tregime. Ai është thesar i pashtershëm në letërsinë bashkëkohore. Lexuesi dhe kritika letrare kanë vlerësuar veçanërisht vëllimin me novela "Arkadia e largët". Këto novela sirtari të viteve 1975-1978, nuk e njohën dritën e botimit kur u krijuan, para viteve '90, por vetëm tani. Janë botuar në vitin 1994 dhe janë ribotuar në vitin 2012 për vetë trajtesën e tyre dhe stilin e tyre të veçantë letrar. Teksa lexon këtë vëllim shumë tërheqës, vetëtimthi të kujtohet krijimtaria letrare e këtij poeti dhe prozatori që shkruan prej pesë dekadash, si romanet "Njëmijë vjet dashuri", "Argonautët", "Vila e magjepsur", "Salamandrat", "Filantropi", "Panegjerikus", "Gjergj Elez Alia", "Sagë mbretërore" si dhe disa novela e vëllime me poezi.

Krijimtaria e Shefki Karadakut është botuar edhe në gjuhë të tjera europiane. Revista letrare gjermane "Literatura Nr. 11" ndërmjet 20 autorëve nga Gjermania dhe vendet e tjera të Europës dhe Ballkanit boton edhe fragmente nga krijimtaria e shkrimtarit shqiptar Shefki Karadaku. Revista është botuar nga shoqëria letrare "Marburg" e Universitetit të Marburgut. Kopjet e saj ruhen në bibliotekën gjermane sipas ISSN.

Vepër shkencore me vlera të jashtëzakonshme etnokulturore

Sfidë e hapur ndaj Akademisë Shqiptare, që në monotoninë e vet përgjumëse ende nuk është kthyer në "gardën kombëtare" të mbrojtjes me "zjarr akademik" të të vërtetave gjithëshqiptare që shpesh mbulohen me mashtrime ulëritëse nga fqinjët tanë.



Pararendja e shkrimit

E lexova me shumë vemendje dhe interes të veçantë librin studimor të Prof. Dr. Fatmir Terziut "Toponimia e Gollobordës: Diskursi i dygjuhësisë dhe derivati i origjinës". Një analizë të mirëfilltë mjaft të detajuar i ka bërë këtij botimi Prof. Dr. Eshref Imeraj, i cili që në krye të pasthënies nxit lexuesin, kur shprehet: "Lexohet me shumë kënaqësi. Kjo është një vepër me vlera të jashtëzakonshme etnokulturore". Por unë do të veçoja vlerat studimore, duke e konsideruar këtë një vepër të rëndësishme shkencore.

Tri dallesat tipologjike

Së pari: Që në fillim, autori trajton bindshëm dhe me finesë marrëdhënien mes gurit dhe zjarrit...duke pëshkruar " ...prodhimin e produktit të lindur prej gurit dhe zjarrit me produktin që në fakt kishte përdorim të dyfishtë, shëndetësor dhe estetik, të katër faktorët janë të pranishëm: toka, riprodhimi primitiv, puna dhe paraja, kombinimet e ndryshme të të cilave përbëjnë historinë e këtij produkti, që u ngjiz si gëlqere, një nga elementët më të rrëndësishëm, pas vetë grurit, baltës, rërës dhe drurit në një proces të ngritjes estetike të një banese. Por që nga momenti i shkuljes së tyre nga toka, deri në formëzimin e fundit të gurit e produktit të fundit të vënies në shërbim të obligimit njerëzor, si produkt i tij pas zjarrit, gëlqerja, vetvetiu sillen në mënyra gati se gjithmonë kundërshtojnë rrënjësisht lidhjen me zjarrin.

Shtëpitë janë të tilla pas së gjithave, por kur zjarri dhe zjarrvënësi nuk kanë arsyen e dhimbjes, natyrisht kundërshtia shkon përtej dhimbjes në të gjitha rrëfenjat, këngët e rrjedhat.

Në këtë kornizë të ardhur nga rrëfenjat guri i skalitur në duart e ustait e mbajti zjarrin në shpirt, në zemër e në tërë udhën e tij të ecjes jetike. Sakaq ustai forcoi dashurinë me gurin."Për analogji, sipas një legjende: kur dibranët e Dibrës së Madhe u vendosën në Tiranë, pas eksodit të 1913-tës, lyen muret e shtëpive dhe të avllive me gëlqere dhe tiranasit u çuditën dhe kujtuan se po i lyenin me qumësht... Jo, ajo ishte gëlqerja që Prof. Terziu e sjell me rëndësinë që ka si element i pazëvendësueshëm në ndërtimtarinë shqiptare, ku gollobërdasit dhe dibranët kanë në histori unike si njerëzit që sikur kanë ndërtuar cepe më cep të Shqipërisë duke vënë "vulën" e qëndresës kombëtare edhe pse gjithmonë nën sulm dhe drejt "detdhedhjes" nga fqinjët e pangopur.

Së dyti: Gjatë vitit që punoja në ish-këshillin e rrethit Bulqizë për 7 vjet (1991-1997) kam shkelur pothuajse në shumicën e fshatrave të ish-komunave Ostren e Trebisht, ndërsa më parë, në shtëpinë e oficerëve Bulqizë (1997-1991), edhe në disa fshtara të Steblevës, madje deri na Draganin majë maleve. Por veçanërisht, në gazetën "Bulqiza" që themelova dhe nxora rreth 90 numëra të saj (1992-1996 në Bulqizë dhe 1015-2020 në Tiranë) kam botuar disa artikuj studimorë të autorëve të njohur nga Golloborda: Hilmi Sadikaj, Velo Cfarku, Agim Bekteshit, Besnik Rama etj, të cilët përveç pozitës gjeografike, pavarësisht dygjuhësisë

argumentojnë se shumica e banorëve të kësaj zone janë shqiptarë autoktonas dhe kjo "dygjuhësi" shpjegohet me tregun dhe etjen për punë të burrave të Gollobërdës historike.

Pa marrë parasysh vëshirësitë e ndërmarrjes së një studimi të tillë në një kohë kur parlamenti i Shqipërisë ka miratuar tashmë ligjin "Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare", në të cilin ka përcaktuar se minoritetet në Shqipëri janë nëntë, përfshirë dhe pakicën bullgare, të cilësuar si të tillë popullsinë e fshatrave të zonës së Gollobordës, Prof. Dr. Fatmir Terziu, nëpërmjet referencave të shumta, ku unë veçoj prof. Kristo Frashëri, prof. Eqerem Çabej, Marin Barleti, Hilmi Sadikaj, arkivat britanike (sidomos mendimtarët e shquar si bizantologu francez Alen Dykelie (Allain Ducellier), dhe historiani anglez Noel Malkolm, etj, është më bindës në këtë kontekst.

Kjo sepse argumenton bindshëm se si lëvizjet dhe pushtimet kanë sjellë ndryshime, jo vetëm në konstrukt, por dhe në ADN-në e popujve, krahinave e njërëzve veçmas në Ballkanin që duke qënë "shesh lufte" shpesh ka përzierë keqas gjuhëtdhe etnitë origjinale.

Mjafton të perifranojmë atë që shkruan në fq. 7: "Se kush janë banorët e një zone të tillë në derivatin e origjinës dhe në diskursin e gjuhës, apo dhe të dygjuhësisë, gjithashtu dhe përsëri për mendimin tim, mund dhe s'mund të përcaktohet nga gjuha që flet dhe shkruan, ndërtimet dhe shenjat e lashta që e rrethojnë aty ku jeton dhe gurët e shkruar nëntokë e mbi tokë.

Këta komponentë popullit të kësaj zone, nuk i mungojnë,

kur vjen fjala e këngëve të mbetura që edhe në gjuhën e grave dygjuhëfolëse këndohet dhe faktohet se "Rosa rosit vo arbanoshka zemja..." (vesa veson në tokën arbërore...) por i mungon dëshmia e shkruar, i mungon madje mjaft arsyeja e gjuhëve të shumta mbi këta gurë, i mungon, ajo që të tjerët në shekuj e bënë sipas rrethanave të tyre për të nxjerrë në pah "orrigjinën" dhe mbi të gjitha dhe "dominimin" e dëshirave të hershme të shtrirjes masive territoriale".

Së treti: Këto teza autori i shtjellon duke sjellë fakte dhe argumenta në tre pjesët e para të kësaj vepre. Në pjesën e parë "Golloborda nga memorja", nga artikulli "Emri, rrjedhat dhe gjuhët", prof. Terziu ka si referencë "Defteri Osman" i vitit 1467, të cilin e solli në vëmendje për herë të parë në këtë drejtim historiani Hilmi Sadikaj (1999), duke theksuar se "kjo krahinë ka qenë e regjistruar me emrin "Dullgoberda ose Dollgoberda". Pra, emri i kësaj krahine vjen nga bullgarishtja e vjetër dhe do të thotë në shqip "kodër (bordo) e gjatë (dollgo). Ky toponim gjendet i pranishëm pjesërisht në emërtime lokale vendesh, si në Trebisht (kodra përballë lagjes Kasaj të fshatit, që quhet "Borda" nga banorët vendas), në Steblevë (në formën Vetarno Bordo), në Rekë (Velebordo) dhe në Vollnisht (Ternino Nebordo) (fq.22). Gjithashtu autori, në pjesën e parë të kësaj vepre na njeh me traditat e shkëmbimit dhe mjeshtëritë, me mjeshtrit duarartë të Gollobordës, me kostumet tradicionale të grave të kësaj krahine si dhe me ritet në dasmat, gëzimet dhe përcjelljet njerëzore.

Studimi me baza shkencore

Pjesa e dytë e librit si zanafilla e studimit na sjell në vëmendjen e lexuesit e sidomos të studjuesve "Vajtimet e Gollobordës", ndërkohë që më pas në artikullin "Trazim kulturash" nguron ta japë përgjigjen shpejt dhe përciptazi. Kjo sipas tij për faktin se, studimi duhet të kalojë së pari në të gjitha pikat ku ravijëzohen ritet familjare, lindja, dasma, lamtumira, mbyllja e rrethit të jetës njerëzore, të gjitha ato që bëhen momentet më të rëndësishme në tërësinë e një treve, ato që shënojnë tranzicionet e saj kulturore më të rëndësishme.

Interes paraqesin për lexuesin edhe ato çfarë shkruan autori për vllahët dhe "jevgjit" e Gollobordës. Mendoj se impresionuese është pjesa e tretë dhe më e rëndësishme e veprës mbi "Toponimet si qasje Etimologjike". Bazuar në toponiminë si kërkim shkencor të emrave të vendeve, origjinës së tyre, kuptimeve, përdorimeve dhe tipifikimeve, prof. Terziu sjell fakte se si mjaft vende të krahinës së Gollobordës kanë marë emërtimet e tyre nga toponimet. Pa u zgjatur, për këtë mjafton të lexojmë artikujt e kësaj pjese të veprës me tituj mjaft intrigues: "Vajtimi i kukuvajkave"; "Guri i lotit"; "Tre lisat"; "Dardha e bekuar"; "Zogu i jargavanit"; "Guri i Xhemos"; "Qershitë e Lamos"; "Raven" u ngjiz nga i Huaji"; "Radec', toponimi që flet qartë"; "Kodra e Shutecit"; "Krasta' emri që rrëfen"; "Arra budallaqe"; "Rebori"; "Smilen"; "Kallogjeri"; "Presllop"; "Dragalicë"; "Truku i Bellavodas"; " etj. Ndërsa për Kështjellën e

Trebishtit, ndër më të njohura e kësaj zone autori shkruan se: "Një nga emrat më të lakuar prej kohësh, që ka ngjizur toponimin më befasues dhe më tipologjik të kësaj treve lidhet me toponimin 'Gradishtë', që do thotë qytezë. 'Gradishtë' quhet vendi në fshatin Trebisht Çelebi, për të cilin hamendësohet se kohë më herët e kanë cekur në shkrimet e tyre Dhimitër Frangu dhe Marin Barleti".

Vështrimin etnokukulturore të autorit për zonën e Gollobordës e ndeshim në pjesën e 4-t të këtij libri "Ballkani përtej 'njëjësit'. Këtu, veç të tjerash prof. Terziu na njeh me vallen pa 'njëjës' "Pajtushka", me origjinën e këngës "72 ditë", ku e gjithë kënga interpretohet kështu: "Shtatëdhjetë e dy ditë/Ka një plagë në zemrën time/Nuk është plagë nga sëmundja/Tashmë është plagë dhe pikëllimi./Merre pushkën dhe më vrit mua/pastaj më thuaj se s'të dua".

Në këtë vepër të rëndësisë shumëdimensionale (studimore, etnokulturore) autori argumenton edhe "Këngët si mesazh unik" si dhe Gollobordën si zonë shumëgjuhëshe.

Ndërkohë, duke u ndalur tek "Rregjistrimi i Tetorit 2020" lehtësisht eidentojmë shqetësimin e autorit për kushtin bullgar në lidhje me marrjen e një date për negociatat nga Tirana që ka të bëjë plotësisht me të drejtat reale të pakicës kombëtare bullgare. Prof. Terziu, jo më kot sjell për lexuesin një artikull të plotë dhe të pandryshuar nga origjinali, thuajse jashtë procedurës së referencimit, të shkruar nga Prof. Dr. Spasse Tashev, me qëllim mosndërhyrjen në disa pika që mund të quhen të plotëkuptueshme në një situatë të tillë.

Është fjala për problemin e mosgjetyes së "originës bullgare" për mjaft nga ata që aplikojnë për pasaportën e këtij shteti, në kushtet e sotme të komplikuar ekonomike, por që vetëm me këtë mundësi ata mund të lëvizin e të punësohen diku në vendet europiane. Dhe konkluzioni i autorit: "Përgjigjja është mjaft kuptimplote, nëse nuk do të ishte kjo pasaportë, ata nuk do të kërkonin të ishin ndonjë lloj minoriteti". Siç shkrova në fillim, mjaft bindëse e bëjnë veprën e Terziut referencat nga arkivat britanike, të sintetsizuara në pjesën e 5-të "Arkivat Britanike për Gollobordën".

Tjetri në këtë vepër tejet dinjitoze

Kjo vepër tejet dinjitoze, me interes të veçantë për lexuesin, mbyllet me pjesën e 6-të "Figurat dhe vlerat". Këtu autori na njeh me personalitete emërndritur në histori të kësaj zone. Ndërsa evidenton origjinën shqiptare të Qemal Ataturkut, Terziu shkruan për Kapitenin e Parë Qazim Kasa - Drejtuesi ushtarak i Prishtinës, për "Piktorin e Popullit" Nexhmedin Zajmin, sidhe piktorët tjerë si, Bajram Mata, Tahir Zeneli, Duro Ibrahimit etj. "... Lexoja kujtimet e Hasan Shahinajt, Dail Halilajt, Ibrahim Allës, Islam Ramës, Fatmir Selimit, Velo Cfarkut, Fidan Markut, Halil Hoxhës etj., dhe ndjehesha kryelartë, komentoja poezitë e dhjetra poetëve të Gollobordës dhe bëhesha letrar ndryshe, shikoja skulpturat e Hamza Halilit, Fitim Sulës, Bashkim Sadikut dhe përhumbeja në to, shikoja filmat dhe skenaret e Esat Musliut dhe s'kisha të ngopur, pastaj shkrimet e studimet e

Hilmi Sadikut, Myqerem Tafaj, Ramazan Hoxhës, Besnik Ramës, Cfetan Maznikut, Kujtim Boriçit, Mehmet Hasanit, Kristaq Trajës..", shkruan autori (fq.145). Prof Terziu vlerëson gjithashtu veprën e Doktor Arif Hasanit - "Qytetar Nderi i Dibrës", të këtij kirurgu duarartë që shpëtoi qindra jetë njerëzish.

Konkluzioni i konkluzionit

Në pjesën e 7-të të librit janë konkluzionet e autorit. "Të dhënat e mbledhura në punën në terren gjatë viteve dëshmojnë se njerëzit e kësaj treve shprehin lidhjen e tyre të origjinës në mënyra të ndryshme. Disa e sqarojnë me një fjali që përcaktohet sipas tyre me shprehjen "mije zborime bugarsko", dhe disa të tjerë me një tjetër që bazohet tek "mije zborime nashincki, nashki". E para shkon ndoshta më larg në vitet kur sundonte dhe dominonte kultura dhe gjuha bullgare në rajon, duke lënë kështu kuptimin e fjalisë së parë "ne flasim bullgarisht" dhe kuptimin e shprehjes së dytë "ne flasim gjuhën tonë, tonën". Dhe kështu kur mbetet zgjidhja nga toponimet kjo e fundit flet më së miri në këtë pikë, po aq sa e para. Pra, hipoteza jonë se toponimet ndikuan në këtë bashkësi në mënyrë të ngjashme në përvojën e identitetit të tij të pakicës është vërtetuar e gabuar. Për të forcuar këtë përfundim, komuniteti i Gollobordës që nuk kanë të njëjtën fe si bullgarët dhe maqedonasit duhet të ekzaminohet",-shkruan prof. Terziu.

Ndërkohë ai sqaron lexuesin se puna kërkuese e këtij

studimi është e një natyre skematike. Ai nuk pretendon se botimi është një përpjekje për të shterruar këtë temë, as nuk mendon "se kontrastet kulturore, sociale dhe historike të theksuara midis efektivitetit tjetër të madh kulturor të traditës Gollobordës janë të gjitha aq sa absolutja e dukurive kulturo-sociale është ekstremisht komplekse, dhe larmia e faktorëve që i përcaktojnë ato shkaktojnë që ato të ndryshojnë shumë gjatë zhvillimit të tyre, nganjëherë ndryshimet i bëjnë ato të duken plotësisht të kundërta. Sidoqoftë, në thelb kontrastet që kam theksuar ekzistojnë. Idetë e përshkruara në këtë punë dhe faktet mbi të cilat ato bazohen mund të mbështeten nga një dokumentim i plotë dhe sistematik në shënimet e mbajtura nga rrëfimet, por duke pasur parasysh natyrën e punës kam preferuar të shtoj disa elementë plotësues. Ata merren me një temë themelore të tyre, por mbajnë disa aspekte themelore të pikës së parë të Gollobordës dhe do t'u interesojnë lexuesve që kujdesen të hyjnë më thellë në këtë temë". Parë në një këndvështrim të përgjithshëm, Prof. Dr. Fatmir Terziu trajton gjerësisht në këtë vepër madhore fenomenin shoqëror të transkulturimit dhe rëndësinë e tij në Gollobordë.

Të "ripërtypësh" qetësisht tezat e guximshme që hedh Fatmir Terziu në librin e vet mbi Gollobordën, këtë krahinë me tradita historike në vetë ekzistencën kombëtare shqiptare, duhet që librin to lexosh dhe rilexosh, sepse ka shumë kuptime mes rreshtave. Sikurse thamë më sipër pa marrë të mirëqënë faktin që Terziu i thotë të gjitha në këtë vepër studimore me "tezat e një doktorature" universitare,

autori hap për diskutim akademik një çështje të mprehtë shqiptare: kush jemi dhe cila është pjesa jonë më ekzistenciale. Shqipëria duke qënë "kërthizë" e gadishullit më të trazuar të kontinentit evropian, natyrisht ka shumë për të thënë dhe sqaruar duke konfirmuar devizën se autoktonia shqiptare jo vetëm që nuk diskutohet, por studime të mëtejshme do të kristalizojnë të vërtetën e "turbulluar nga koha". Studimi i Fatmir Terziut nga Londra është një sfidë e hapur ndaj vetë Akademisë Shqiptare, që në monotoninë e vet përgjumëse ende nuk është kthyer në "gardën kombëtare" të mbrojtjes me "zjarr akademik" të të vërtetave gjithëshqiptare që shpesh mbulohen nga mashtrime ulëritëse nga fqinjët tanë.

Autori meriton përgëzime jo vetëm për guximin hulumtues, por edhe për dritën që hedh mbi një krahinë të harruar dhe nënvleftësuar nga regjimet dhe administratat qëndrore shqiptare. Në fund të fundit Shqipëria është një dhe mbetet një unison ballkanik me vitalitet që po testohet sërish në kohë lirie.

Atdhe - dashuria në prozën dhe publicistikën e Shefqet Mekos

Libri "I tillë jam", me redaktor Ahmet Prençin, vlerë e shtuar në fondin e letërsisë shqipe. "Shefqet Meko kontribuon në disa portale online si dhe ka përkthyer e botuar në shqip librin "Çuditë e Amerikës" dhe përmbledhjen e vet publicistike "Unë ikanaku shqiptar". Libri "I tillë jam" është i pari i autorit si përmbledhje e krijimeve letrare në vite. "Më mirë vonë se kurrë" perifraxon ai shprehjen e urtë popullore.

Më 16 nëntor 2012, pikërisht me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, Gazeta "Dielli", kjo zëdhënëse e denjë e diasporës shqiptare të Amerikës, do të botonte reportazhin e gazetarit të mirënjohur Shefqet Meko, me titullin sinjifikativ "PËR FLAMURIN TONË: DY RRËFENJËZA". Këtë reportazh të shkruar me një stil të veçantë, që bart dhe përçon shpirtin atdhetar të shqiptarëve,

si edhe dhjetra tregime, skica e recensione, autori Sh.Meko e ka përmbledhur në librin e tij "I TILLË JAM... ". E lexova me një frymë këtë libër të mikut e kolegut tim të nderuar (që nga fillimi i viteve "80-të) dhe u magjepsa me bukurinë e fjalës dhe me mjeshttrinë e artit të shkruarit nga ana e tij. Një tufë tregime të frymëzuara nga jeta studentore e viteve 80-të, ku gëlon energjia rinore...

Ajo që më bëri më shumë përshtypje është guximi i këtij autori për të dalë jashtë skemave të letërsisë së realizimit socialist, edhe në atë kohë kur për këtë qasje mund t'iu drejtoheshe me vetëdije dyerve të burgut. Por Shefqet Meko, ashtu si edhe në titullin e librit, në të gjithë tregimet, si edhe në publicistikën e tij është vetvetja. I tillë është ai edhe në kritikën letrare "Rikosheta poetike e Ahmet Prençit", në tregimin e jetuar "Dy dibrane në Dallas" apo edhe tek "Rënia e burrave" (Esse në ndërrim vitesh).

Shefqet Meko është vetvetja edhe në këtë libër

E kam ndjekur krijimtarinë e Shefqet Mekos, thujse që në fillimet e saj. Edhe në këtë libër me tregime, skica dhe shënime publicistike, sjell natyrshëm, jo vetëm shqetësimin e ligjshëm të emigrantit për tranzicionin e tejzgjatur shqiptar të tri dekadave të fundit (si tek tregimi "Maskarada e tranzicionit"), por edhe jetën studentore, si dhe aromën e vendlindjes, me të veçantat e saj.

Në sinkron me titullin deklarativ e vetpohues, "I tillë jam", Shefqet Meko është vetvetja në këtë libër me 19



tregime dhe 10 skica, esse e reportazhe letrare. Në tërësinë e tyre ato bartin dhe përçojnë formimin dhe psikologjinë e autorit, ku ndjenjat e mëdha njerëzore, ato që formojnë ashtin e individit, si krenaria për familjen e fisin - materializim i rrënjëve të thella dhe i luftrave për mbijetesë, vijnë si testament i atdhedashurisë.

Mjafton për këtë qoftë dhe mesazhi që percjell tregimi i parë "Një grusht dhe", kur ndërsa gratë e fshatit pëshpërisnin se "Tani iku fukarallëku për Shanon e Selmanit... Selmani ka vënë pasuri", ky kurbetli i kthyer pas disa vitesh, i surprizoi bashkëfshatarët, kur nga kutia e mbështjellë me bezen e mëndafshhtë zbuloi misterin që ajo fshihte: grushtin e dheut mëmë që e shoqëroi në tokë të huaj....Dhe aty ai i kishte të gjitha: grurin dhe këngën, jataganët dhe dyfekët... Këtë motiv, atdhedashurinë e zjarrtë e gjejmë edhe në tregimet "Shoku i tim eti", "Vdekja përtej Atlantikut" si dhe në reportazhin "Një amerikan në kërkim të 'rrënjëve' shqiptare". Figuracioni, si gjuha e prozës është fare i dallueshëm në këto tregime. Për ta kuptuar këtë, mjaftojnë qoftë dhe këto perifrazime nga tregimi "Shoku i tim eti": "...njerëzit me besim janë të papërballueshëm", "Përbuzja sjell vetëm urrejtje"; "Jeta është një libër që duhet

shkruar..." perifrazime këto që mund të konsiderohen edhe si shprehje të qarta filozofike të autorit. Pas disa vitesh, tashmë i detyruar të mërgojë nga atdheu, si mjëra e mijëra të tjerë, Sh.Meko, ndihet i larguar vetëm fizikisht. Shpirti i ndjeshëm prozaik i tij është këtu, në metropolin shqiptar, Tiranë, në malet, luginat, fushat dhe lumenjtë e vendlindjes. Aty ku realisht dhe simbolikisht mbeten vlerat e mëdha njerëzore, që janë lënda e parë e qasjeve të tij ndaj prozës së shkurtër..atje ku një at' përcjell tek bijtë mesazhet e historisë dhe të heronjve për të mos u harruar kurrë..atje ku një nënë përcjell tek bijtë ngrohtësinë e vatrës familjare dhe amanetin për të mos u tjetërsuar... Ndaj dhe sjell për lexuesin lajtmotivin se "Fitimtarët shkruajnë historinë", sintetizuar ky në përfundimin që nxjerr nga rrëfimet e babait, pastaj nga historia që na mësohej në shkollë, nga filmat dhe dokumentarët...Dhe pas dilemës se, a thua gjithshka ishte propagandë, autori vjen në konkluzionin se: "Në fakt propaganda na ishte bërë 'bukë e djath', por që lufta ishte fituar nga partizanët që ishin në një front kundër të njejtit armik, me Anglinë dhe Amerikën, kjo ishte e vërtetë si dielli që lind e perëndon çdo ditë".

Tregime që vijnë si fllad i freskët në prozën e sotme shqipe

Proza e sotme ecën në disa shina. Zgjedhja e tyre, është sa prirje e brendëshme, aq edhe shtytje e vetëdijshme. Në këtë qasje, ndonëse të shkruara në vitet "80-të, tregimet e Sh.Mekos, vijnë si fllad i freskët në prozën e sotme shqipe.

Kështu, në tregimet me titull "Darkë në konvikt" e "Zarfë i hapur", autori është atje ku një dashuri e humbur të grish për ta ruajtur si hajmali, për të mos lënë asnjë filiz të jetës të vyshket...

Sepse kjo qenka natyra e ndërlikuar njerëzore, qënka fatthënia e tyre. Kështu, nëse tek "Darkë në konvikt", vjen me një urim për një jetë që sapo kishte buisur atje në Kalanë e Dodës (Urim ky krejt i veçantë i shokëve natën e ndrrimit të viteve për studentin e veterenarisë, Vehapin që kishte marrë nga mali i Korabit hijen e rëndë, mendimin e thellë dhe heshtjen e gjatë), tek "Dasma e motrës" veçojmë dashurinë e vëllait të mirë që therorizohet për motrën e vet. Kjo edhe për faktin se "dalja e një vajze nga shtëpia që u lind dhe u rrit është moment sublim dhimbjeje, keqardhjeje dhe nostalgjie". Këtu autori duket se jeton midis kujtimeve të së shkuarës, dallgevë të së sotmes dhe ëndrrave për të nesërmen.

Ndërsa tek tregimi "Natë vere", përveçse një romancë të bukur dashurie mes dy intelektualëve të rinj, madje dhe "pantomimat e dashurisë", autori evidenton edhe konceptet arkaike të asaj kohe kundër ngjizjes së një fëmije nga çifti ende i pamartuar, duke na i paraqitur më në fund ata "të çliruar nga bota e djajtë vrastare, në emër të 'dasmës me nder", pasi kumton subjektin e tregimit "Rastësi" del në përfundimin se duke dashuruar njerëzit arrijnë të prekin dhe të besojnë në gjëra që më parë i quanin si të paarritshme, transmetojnë lumturinë e tyre tek njeriu që dashurojnë dhe kështu lumturia e secilit bëhet akoma më e madhe.

Dy veçori të librit "I tillë jam"

Duke e analizuar në tërësinë e lëndës të përfshirë në 500 faqe, si veçori të parë të librit të Shefqet Mekos "I tillë jam", do të nënvizojë nostalgjinë e tij për gjithshka që ndodhet larg, por që njëkohësisht ai është ditë e natë afër tij. Në këtë lëmë ai nuk është i vetmi. Që nga Serembe tek Shiroka, malli për mëmëdheun ka qenë një klithmë e brendshme, e shprehur në vargje të drejtpërdrejta, siç e gjejmë edhe në poezinë e Sh.Mekos "Vargje për nënën", botuar në portalin "Fjala e lirë" të Fatmir Terziut. Malli si një trishtim i lehtë, përshkon gjithë linjën e tregimeve, dhe pse jo edhe të publicistikës letrare të autorit.

Si veçori e dytë dhe risi në krijimtarinë e tij, do të shquaja vëmendjen ndaj historisë dhe figurave të saj të panjohura. Ndriçimi i disa figurave të vendlindjes dhe bëmat e tyre, që autori i sjell në këtë libër me tone epike është një synim serioz që edhe brenda gjinisë së prozës së shkurtër, të zbulohen aspekte të mbetura jashtë vëmendjes së studimeve. Në këtë qasje autori është pranë shtratit të rrëfenjave popullore dhe asaj të traditës, të cilat kanë qenë mesazherët e parë të historisë së luftrave dhe të heronjve.

Të dy këto hulli e kanë çuar vetvetiu autorin ndaj një proze e publicistike letrare të thjeshtë, konkrete, por ku është gjithashtu i pranishëm edhe figuracioni që është gjuha e prozës. Duke zgjedhur këtë formë, Shefqet Meko duket se niset nga dëshira që të prekë edhe atë mërgimtarin që don të mbajë në mendje e të përsërisë me vete dy vargje të

përmallshme, edhe intelektualin që në emigracion është i detyruar të "harrojë se çfarë ka qënë në vendlindje, por të shikojë se ç'mund të bëjë mirë në Amerikë" siç shënon diku autori.

Sinqeriteti është një tipar tregues i Shefqet Mekos. Ai beson tek e vërteta dhe misioni i së mirës në jetë. Duke qënë se autori më së shumti ka qënë gazetar dhe hulumtues i jetës, që për fatin e tij shtrihet në dy shekuj, dy regjime madje edhe në dy kontinente, siç e pohon edhe vetë, në disa raste nuk i shmanget dot ndonjë skematizmi apo gazetarizmi, që natyrshëm janë instiktivisht pjesë e procesit krijues. Kjo duket për shembull kur vë përballë krijimet e viteve 80-të, dhe dy tregimet që janë shkruar në "ikjen amerikane", ku Shefqet Meko sa më shumë jeton në Amerikë, aq më mallshëm kthen kokën në Shqipëri. Ndërkohë kur vjen tek publicistika dhe eseja, Meko flet fuqishëm, shprehet rrjedhshëm dhe të rrëmben me mendimin dhe analizën e vet. Duket se publicisti ka akumuluar dhe "do të flasë". Kështu dy shënimet-ese "Ku ta gjej një burrë" dhe "Himni Im dhe i Asaj", janë "qëndisje publicistike" sa të bukura aq edhe të mendimta, që pas leximit të bëjnë të marrësh frymë thellë dhe natyrshëm thua: "Kështu mendoj edhe unë".

Libri "I tillë jam" ka një përvojë jete, ka drama dhe mbresa rinie, ka mllefe dashurie dhe zhgënjime jete, por ka edhe një mesazh optimist: jeta është e bukur. Shefqet Meko sikur do të jetë mesazher i kësaj "stileme" njerëzore, që nuk se është se ai e thotë i pari, apo zbulon surpriza, por me sinqeritet rrëfen që të dëgjohet në "korin" e madh letrar shqiptar. Ndërkohë, ajo

që më entuziazmon si lexues e si krijues, është diçka e veçantë që duket tek disa krijues si Shefqet Meko që vijnë nga "Shkolla e Dakës": durimi dhe pritja, jo padurim dhe rrëmbim, sinqeritet krijues, jo "arrogancë letrare", ndaj edhe autori që flas, vjen në të 60-tat e veta me librin e parë me një "koktej" krijimtarie letrare dhe publicistike. Kjo të bën të besosh se pas një "maturimi" letrar, mund të presim edhe botime të tjera dhe më të mira të Shefqet Mekos. Si mik i tij dhe dashamirës i plejadës së shkrimtarëve dhe krijuesve shqiptarë, vërtet uroj që kështu të ndodhë.

Libri "I tillë jam" është redaktuar me përkujdesje, përkushtim shoqëror dhe përgjegjësi krijuese nga shkrimtari i njohur Ahmet Prençi (poet dhe autor i romanit "Anja)". Unë besoj se ky botim është padyshim vlerë e shtuar në fondin e letërsisë shqipe.

Shefqet Meko kontribuon në disa portale online si dhe ka përkthyer e botuar në shqip librin "Çuditë e Amerikës" dhe përmbledhjen e vet publicistike "Unë ikanaku shqiptar". Libri "I tillë jam" është i pari i autorit si përmbledhje e krijimeve letrare në vite. "Më mirë vonë se kurrë" perfrazon ai shprehjen e urtë popullore.

Metamorfoza e negociatave për çështjen e detit

Çështja e paqenë e detit në optikën e Shaban Muratit



"Patriarku" i analizës diplomatike dhe i politikës së jashtme shqiptare, Shaban Murati, i vlerësuar si i tillë nga Prof.Dr.Aleksandër Meksi, ish-kryeministër i qeverisë së parë Demokratike të Shqipërisë (1992-1997), e konsideron çështjen e detit si një nga dosjet më enigmatike të marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Greqisë.

Në situatën e konfuzionit

politik, diplomatik, teorik dhe dokumentar, të disa segmenteve të diplomacisë shqiptare, edhe 11 vjet pas vendimit historik të Gjykatës Kushtetuese, analisti i mirënjohur me përvojë 50 vjeçare në fushën e politikës së jashtme, ka sugjeruar hartimin dhe shpërndarjen me urgjencë të një qarkoreje juridike, ku të rifreskohet kujtesa e diplomatëve tanë me qëndrimet bazë juridike, historike dhe kombëtare të vendimit të Gjykatës Kushtetuese të 15 Prillit 2010. Kjo sipas tij, për faktin se me këtë vendim të kushtetueses shqiptare, "çështja e detit" është dosje e mbyllur në planin ligjor, politik, historik e diplomatik.

Në librin e tij "Çështja e paqenë e detit, një intrigë diplomatike greke apo shqiptare", studiuesi e diplomati Murati, bazuar në dokumentacion të pasur, jep për herë të parë një analizë diplomatike të plotë të kësaj çështjeje në gjithë harkun kohor të zhvillimit të saj deri në ditët tona. Në kreun e I: "Enigma e nxitimit diplomatik", ndër të tjera autori evidenton si problem të parë, ngutjen e diplomacisë shqiptare që të plotësonte menjëherë kërkesën e Greqisë për hapjen e bisedimeve për detin, në një kohë që Greqia e kishte neglizhuar këtë çështje për dhjetra vite me radhë dhe nuk e kërkoji kurrë, që nga rivendosja e marrëdhënieve diplomatike në vitin 1971.

"Ajo që bën më shumë përshtypje nga studimi dhe analiza e dinamikës së bisedimeve diplomatike mes dy shteteve, është nxitimi i pazakontë i palëve për të arritur dhe mbyllur bisedimet me një marrëveshje", shkruan Murati në librin e tij të promovuar në praninë e dhjetra personaliteve të botës akademike, diplomatike e juridike.

Parë nga ky këndvështrim ai konkludon se sa çështë i

paqartë motivi i nxitimit të diplomacisë greke, aq është i errët qëllimi e ngutja nga diplomacia shqiptare. Madje sipas Muratit, ambasador nga më të mirët e vendit tonë dhe kërkues i palodhur i mendimit të ri diplomatik shqiptar: "Në këtë nxitim, jo vetëm u shkelën procedurat, ligjet dhe Kushtetuta e Shqipërisë, por në planin profesional, diplomatik, shkencor dhe administrativ, nuk u përcaktuan dhe as u morën parasysh as parametrat më minimale, që kërkon një diplomaci serioze e një shteti serioz". Kështu ka ndodhur edhe gjatë procesit diplomatik të negocimit të marrëveshjes së anuluar të detit (2008-2009), të shpallur nul nga Gjykata Kushtetuese.

Në optikën e tij, "Vështirë të gjesh në historinë e diplomacisë shqiptare dhe të shtetit shqiptar çështje dhe dosje delikate, që të jenë negociuar me kaq mendjelehtësi dhe mungesë profesionalizmi, sa bisedimet me Greqinë për çështjen e detit". Pikërisht që të mos përsëriten ato gabime, ambasadori Murati kërkon që refleksionet dhe mësimet që nxirren nga gabimet e negociatorëve të para 11 viteve (të qeverisjes së PD), të shërbejnë si një instrument profesional për diplomacinë aktuale shqiptare. Në këto konkluzione, ai mbështetet mbi burime serioze, nga arkivat e Ministrisë së Jashtme të Shqipërisë e të Italisë, arkivin e Akademisë Diplomatike të MPJ të Shqipërisë, Arkivin Qëndror të Shtetit, por dhe në referencat të autorëve të mirënjohur, si Arben Puto, Ksenofon Krisafi, Beqir Meta, Luan Malltezi, Myslim Pashaj, Romeo Gurakuqi, Erl Murati, Andon Andoni, etj.

Këto burime të dhënash, bibliografia e pasur dhe referenca të përfaqësuesve diplomatikë, shkencor e publicistik, vendas

e të huaj kanë shërbyer si bazë e analizës së mirëfilltë edhe në katër kapitujt tjerë të librit: "Metamorfoza e objektit të bisedimeve", "Bisedime me sindromën e Shën-Naumit", "Një udhëkryq artificial diplomatik" dhe "Shtojcë-me disa dokumente kryesore për kufijtë e Shqipërisë me Greqinë". Duke mos pretenduar kurrësesi studimin në detaje dhe analizën perfekte të kësaj vepre, në koherencë të plotë me aktualitetin politik dhe diplomatik të marrëdhënieve dypalëshe Shqipëri-Greqi, shpreh bindjen se kjo vepër duhet të shërbejë si referencë bazë në negociatat shqiptaro-greke si dhe në zhvillimet më të fundit të marrëdhënieve shqiptaro - ruse.

Botimi i ri i diplomatit dhe publicistit të mirënjohur Shaban Murati, që analizon marrëdhëniet dypalëshe me Greqinë dhe specifikisht "paktin detar" u promovua në kulmin e debatit politik për këtë çështje. Libri i dedikohet kryesisht negociatave dhe marrëveshjes së 9 vjetëve më parë, të cilën autori e përkufizon si një "gabim diplomatik".

"Gjithë procedura e ndjekur në bisedime, gjithë dinamika e dosjes së detit, të lë shijen ose të jep përfundimin që aty ka pasur një bashkëfajësi apo një intrigë diplomatike të të dyja palëve", - shprehet Murati. Siç nënvizon Prof. Dr. Aleksandër Meksi, edhe në këtë vepër Sh.Murati sjell një kontribut të ri në shkencën e mendimit diplomatik, me një guxim profesional dhe novacion mendimor të një niveli të lartë. Kjo duket fare qartë, në konkluzionin për çështjet e sovranitetit shtetëror dhe të integritetit territorial, që sipas tij janë ndër më të vështirat në procedurat dhe në artin e

negocimit dhe mbi të gjitha kanë si karakteristikë të përbashkët kohën e gjatë të zhvillimit të tyre. Ai sjell në vëmendjen e diplomacisë aktuale shqiptare dhe të opinionit publik shembullin tipik në bisedimet për çështjen e kufijve detarë mes Rumanisë e Bullgarisë dhe Kroacisë e Sllovenisë, që kanë zgjatur të dyja mbi 25 vjet dhe ende nuk janë mbyllur.

"Çështja e paqenë e detit një intrigë diplomatike greke apo shqiptare" dhe negociatat ka ngacmuar reagimin e shumë diplomatëve të tjerë dhe historianëve të pranishëm në promovimin e këtij libri, që dhanë opinionet e tyre nga duhet të nisin këto bisedime. Prof. Dr. Ksenofon Krisafi, ish-anëtari i Gjykatës Kushtetuese, Sokol Sadushi dhe botuesi i njohur, Mehdi Gurra (ALSAR) e vlerësuan librin e Muratit si një kontribut të vlefshëm në hapësirën diplomatike. Ndërkohë, Ambasador Çlirim Çepani, konkludon se burimet e mëdha naftëmbajtëse të zbuluara në detin Jon, vunë në lëvizje diplomacinë greke dhe lobet pro-greke ose "kalin e Trojës".

Referuar veprës së ambasador Muratit, historiani i njohur Prof.Dr. Pëllumb Xhufi është shprehur se politika shqiptare ka punuar për ta heshtur apo për ta fshehur axhendën shqiptare në marrëdhëniet me shtetin grek. Libri "Çështja e paqenë e detit: një intrigë diplomatike greke apo shqiptarë", botuar në shqip dhe në anglisht, në brendësi publikon edhe dokumente të ndryshme nga arkivi i Ministrisë së Jashtme për marrëdhëniet Shqipëri-Greqi që nga viti 1967.

"Kritikë" për kritikët letrare të Shpendi Topollajt

*Në 74-vjetorin e ditëlindjes shkrimtari mjaft
produktiv e cilësor vjen me librin "Pesha e dinjitetit"*



Publicisti, poeti, prozatori, dramaturgu e kritiku i mirënjohur letrar Shpendi Topollaj, erdhi në 74-vjetorin e ditëlindjes së tij (14 shkurt 2021) me një bilanc mjaft të pasur. Në korpusin e tij krijues bëjnë pjesë më shumë se 60

vepra, ndër të cilët: dy drama, shtatë romane, tre novela, tetë libra me tregime, një monografi dhe disa libra me kritikë letrare.

Nisur nga mosha, po të konsiderojmë fillimet e krijimtarisë së tij kur ishte 14 vjeç, i bie që Shpendi Topollaj të ketë shkruar për çdo vit të jetës së tij nga një libër, por padyshim produkti i tij letrar, i përket tri dekadave të fundit. Ndër botimet e tij, shënojmë librin "Lirikat e Zemrës" - poezi (përkthyer në italisht) më 1996. Duke qenë i pranishëm thuajse çdo javë në shtypin e kohës ("Telegraf", "Fjala", "Nacional", "Veterani", etj) me profilet e personaliteve të shquara të luftës, ushtrisë, artit e kulturës dhe sidomos me kritikën letrare të disa librave të autorëve të njohur, Topollaj është ndër më të njohurit e lexuesit shqiptar.

Për të dhe krijimtarinë e tij, janë botuar librat voluminozë "Të shkruash në liri - Shpendi Topollaj: poeti, prozatori, kritiku, njeriu" (2014), "Liria e të shkruarit" (2009); dhe "Kur mendja bashkohet me zemrën" (2020). Ai është vlerësuar shumë lart për cilësitë e tij të rralla artistike, tematikën e zgjedhur dhe mesazhet që përcjell, nga penat tona më të njohura. Në një nga librat e tij, "Ishte koha kur...", gazetari Kostaq Xoxa duke folur për të shkruan: "Autori i palodhur dhe i talentuar i letrave shqipe të kohës së pasdiktaturës, Shpendi Topollaj, të befason me prodhimtarinë e tij aq të shumëllojshme në gjinitë letrare më të larmishme: në poezitë, në tregimet, në novelat, dhe në romanet e tij; në kritikën letrare, në zbulimin e thesareve të lashtësisë dhe veçanërisht të mitologjisë greke; në

reportazhin artistik, në pasqyrimin dhe portretizimin e figurave të nëpërkëmbura nga një sistem totalitar gjysmë-shekullor...".

Ndërkohë, për të mos i mbetur "borxh" Kostaq Xoxës, këtij korifeu të publicistikës shqiptare, Topollaj, në librin e tij të fundit "Pesha e dinjitetit" (Kritika letrare) shkruan: "Pas vitit 90-të Kostaq Xoxa ishte nga të parët që u angazhua me guxim në përpjekjet për shembjen e komunizmit në Shqipëri. E përkrahu si idealist i vërtetë demokracinë dhe aspiratën tonë evropianiste si gazetar e publicist, sidomos te gazeta "55", ai shkëlqeu me penën e tij të mprehtë, duke shfaqur si pak kush mospajtimin e tij me atë ideologji që i solli aq dëme dhe vuajtje shqiptarëve. Stigmata e tij plot llogjikë dhe tërësisht e mbështetur në fakte dhe të vërteta të pa mohueshme, synonte të sqaronte dhe ndërgjegjësonte lexuesit dhe asnjëherë ai nuk denigronte ndokënd....". (fq.178).

Me librin e tij me kritika letrare "Pesha e dinjitetit", Sh.Topollaji vjen, jo vetëm si lexues, por edhe si studjues e vlerësues i zellshëm i krijimtarisë së disa autorëve të njohur shqiptar. Duket fare qartë kjo te kritika letrare me titull "Dashuria e Lasgushit dhe përjetësimi i saj nga Ismail Kadare" (Rreth romanit "Ikja e shtërgut", si pjesë e librit të Kadaresë "Përballë pasqyrës së një gruaje", në të cilin qëndrojnë bashkë tre romane të shkurtër, ku veç atij të titullit, dhe "Kalorësi me skifter", është përfshirë dhe një tjetër me titullin "Ikja e shtërgut" që i kushtohej dashurisë poetike të Lasgush Poradecit me bukuroshen Ana G). Në

këtë rast Shpendi Topollaj, duke u kalamendur mes rreshtave, kujton shprehjen e M. Nekse për rëndësinë që ka në krijimin e veprës letrare "Ngjeshja e skajshme e materialit...". Ai shkruan se "Në pak faqe, gjeniu ka thënë aq shumë. Dhe pa të lodhur e sforcuar fare. Përkundrazi, ndihesh i çlodhur, i lehtësuar dhe i ripërtërirë shpirtërisht...Sidomos me shtjellimin mjeshtëror të asaj historisë olimpike të poetit tonë magjik, Lasgush Poradeci".

Sh.Topollaji ka spikatur me kritikën letrare edhe në vlerësimin e veprës së gjenit të letrave shqipe Dritëro Agolli, i cili sipas tij "pati gjithë jetën si devizë gjithçka, pra edhe njerëzit, edhe natyrën, edhe të mirën, edhe të vërtetshmen, edhe të bukurën, madje edhe dashurinë e shihte me syrin e mprehtë të një vrojtuesi serioz e të pashoq, karakteristikë kjo që s'ju nda kurrë poetit tonë të shquar". Për të arritur në këtë konkluzion Shpend Topollajit i mjaftojnë qoftë dhe disa nga titujt e librave të Dritëroit me poezi si "Në rrugë dola", "Hapat e mia mbi asfalt", "Udhëtoj i menduar", "Pelegrini i vonuar" dhe do të bindesh për këtë. Po kështu edhe titujt e cikleve poetike: "Udhëtoj me njerëzit", "Udhëtoj me shqetësimet", "Udhëtoj me poetët".

E kemi parë Shpendi Topollajin të ligjërojë aq bukur në takimet promovuese të librit "Një legjendë në kufirin midis dy kohëve", kushtuar gjeneralit legjendar Rrahman Parllaku - Hero i Popullit dhe "Nderi i Kombit", apo edhe për librat serial shumë voluminozë "Skënderbegasit ndër vite" të autorëve Kujtim Boriçi e Maksim Fejzulla, nga ku ka marrë vlerësime jo vetëm për elokuencën, por pikësëpari për peshën

e mendimit të tij dhe gjykimin me objektivitet për vlerat ideore e artistike të këtyre botimeve serioze.

Mendimin e kualifikuar të autorit Sh.Topollaji e gjejmë edhe në vlerësimet e tij për veprat e shkrimtares së nderuar Vilhelme Vranari (duke evidentuar edhe burrin e saj plot humor dhe energji, Fitim Haxhiraj); të këngëtarit të ëmbël të dashurisë Zyhdi Morava; të Petraq Kotes, këtë shkrimtar që na i sjell të gjalla baladat (Rreth tregimit "Ngjarje ndër Muzakë"); të Dashamir Uruçit që vë dhimbjen e shpirtit në vargje (Rreth librit poetik "Në dritë të vetëtimës") etj.

Tek "Pesha e dinjitetit", kritiku letrar Topollaj shkruan për librin me kujtime të Saimir Malokut "Si mbijetova në ferrin komunist", duke e vlerësuar atë për të vërtetat rrënjëthënëse, që jo vetëm të trondisin, por edhe të vetëdijësojnë për kuptimin e vuajtjeve trupore e shpirtërore të njeriut të ndershëm gjatë luftës për mbijetesë. Parë nga kjo optikë, ai e vlerëson autorin e këtij libri me kujtime si një shembull të rrallë në kundërvënien ndaj diktaturës komuniste.

Në fokusin e kritikës letrare të autorit Topollaji është edhe libri "Biri" i Flutura Açkës -nënës shkrimtare me lotin e dhimbjes sa bota. "Në të gjithë morinë e krijimtarisë time me kritika letrare, më ka ndodhur që pas leximit të ndonjë libri, të kem pohuar se jam tronditur. Por nga libri i nënës -shkrimtare Flutura Açka, kushtuar ikjes në moshën më të bukur të Birit të saj, nuk e kam aspak për turp të deklaroj se kam vajtuar. E kam larë me lot çdo faqe të tij. Më është copëtuar shpirti dhe gati kam ulëritur: 'Përsa jeta është kaq e padrejtë?!', shkruan ndër të tjera Topollaj.

Në librin "Pesha e dinjitetit" ai shkruan për sagën e Lukaçëve, (vlerësim për një ekspozitë pikturë dhe skulpturë në qytetin e Durrësit), nisur nga një eveniment i bukur, kur në të njëjtën ekspozitë, paraqiten veprat e tre autorëve: gjyshit Nelo Lukaçi, djalit Romir dhe mbesës Leopoldina, që sikurse e thotë edhe emri i saj, që vjen nga gjermanishtja e vjetër, po tregohet mjaft guximtare. Pjesë e librit "Pesha e dinjitetit" është edhe vlerësimi i veprës së Dritan Çokut "i cili ngre zërin për nevojën e ndërhyrjes konservuese dhe restauruese të objekteve të tilla që ai i sheh si elemente që na ndihmojmë të ecim në korridore të errëta, në tunelet pa fund të shekujve të shkuar". Vlerëson kështu autori veprën e qytetarit beratas të sintetizuar në albumet e tij "Sahat Kulla e Kavajës", botim i vitit 2016 dhe "Kishat e Kalasë së Beratit", me bashkautor Genci Samimin, botim i vitit 2019. Për shkrimtarin dhe kritikun letrar Sh.Topollaj, këto ishin botime lluksi, respektivisht të "Ymeraj Print Fier" dhe asaj "Pegi", por kuptohej menjëherë se brenda tyre përmbanin vlera të vërteta rreth historisë, arkitekturës, teknikës së ndërtimit, simboleve, arkeologjisë dhe restaurimit.

Për vetë misionin e kritikës letrare, me librin "Pesha e dinjitetit" Shpend Topollaj kryen mjeshtërisht funksionin e ndërmjetësuesit mes lexuesit dhe veprës letrare të disa autorëve të njohur. Lënda e këtij libri me kritika letrare është vlerësimi i librave të dhjetra autorëve të njohur, nisur nga arti i të shprehurit të gjykimit në procesin e tyre krijues. Mjafton për këtë të lexojmë kritikën letrare "Një roman i Shefik Myftiut me shumë të papritura" (fq.93); "Delo Isufi -

poeti që i këndon aq bukur dashurisë" (fq.91); "Një studim me vlera të mëdha shkencore i Vilhelme Vranari" (fq.115); "Dy fjalë rreth 'librit "Ahu në mes të pyllit" (fq.121); "Diçka në vend të hyrjes për 'Romancën me letra dashurie" (fq.124); "Pse e shkrova librin 'Esse rreth shprehjeve mitologjike" (fq.139); "Për Halil Ramën dhe veprën e tij" (fq.143) etj. Për këto vepra, Topollaj e ndërton dhe zhvillon kritikën letrare jo vetëm mbi bazën e përshtypjeve individuale dhe mbresave nga leximi i tyre, por duke evidentuar ekskluzivisht vlerat ideore dhe letrare si dhe mesazhet që ato përcjellin tek lexuesi.

Në botimin "Pesha e dinjitetit" autori Topollaj ka përfshirë edhe profilin e Bashkim Koplikut, duke e vlerësuar si njeriun dhe politikanin me integritet të lartë, si dhe të njeriut të thjeshtë të vlerave të mëdha, Miftar Dedja.

Shpendi Topollaj nuk ka rreshtur së kryeri dhe detyrat shoqërore, si anëtar i kryesisë së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve në Durrës, nënkryetar i shoqatës kombëtare "Skënderbegasi", kryetar i degës së kësaj shoqate në Durrës, anëtar i kryesisë së shoqatës të miqësisë Shqipëri - Rusi, nënkryetar i degës së SHKUR - it, sekretar i shoqatës së intelektualëve në Durrës, anëtar i këshillit kombëtar të OBVL, etj.

Së fundmi ai është zgjedhur kryetar i Bordit drejtues të teatrit "A. Moisiu", është shpallur "Ambasador për Paqen", i është dhënë titulli "Noble Peace Personality Award" nga World Parliment For Peace, dhe njëkohësisht është zgjedhur


nënkryetar i Federatës së Paqes Universale dega Durrës. Pas viteve nëntëdhjetë, fillon të shkruajë dhe botojë krijimtari të mirëfilltë letrare, thuajse të të gjitha zhanreve të letërsisë, si poezi, tregime, novela, romane, publicistikë, kritikë letrare, drama etj. dhe qindra e qindra artikuj të shkruar e botuar nga ai, në shtypin e kohës, gjë që e bën të njohur kudo.

Shumë nga librat dhe krijimet e tij janë përkthyer në disa gjuhë të huaja, janë botuar jashtë shtetit dhe janë vlerësuar nga kritika e specializuar dhe lexuesit. Në nëntor të vitit 2015 nga ana e Lidhjes dhe Shkrimtarëve dhe Artistëve të Rusisë i është akorduar çmimi "Pushkin" me motivacionin "Për bukurinë e fjalës dhe të mendimit".

Koha kur shkriheshin akujt në librin e Kamber Farukut

- *Krimet e komunizmit meritojnë një monument kujtëse që të mos na përsëritet kurrë më e kaluara e Tonton-Makutëve enverianë*
- *"Jemi një shoqëri në zgjim. Ta bëjmë përtëritjen nga pesha e diktaturës me guxim. Misioni për të demaskuar deri në fund, me fakte diktaturën u takon trimave, atyre që nuk kanë frikë nga varret dhe hijet e së kaluarës. Të shërojmë njerëzit e gjymtuar, të shërojmë plagët. Të gjallët meritojnë respekt. Na takon ne që e nisëm, ta çojmë deri në fund demokratizimin dhe dekomunistizimin e vendit"*

Nëse do t'i përmbahemi vlerësimit që Kamber Faruku i bën gazetarit dhe shkrimtarit sovjetik Ilia Ehreburg, duke evidentuar gjuhën, stilin dhe përmbajtjen e reportazhit të tij "Si e njoha unë Amerikën", botuar në 1947, një lexues i vëmendshëm, në të njëjtin vlerësim do të arrinte edhe për



librin e tij "Kur po shkriheshin akujt". Por, nëse Ehremburgu lejohej ta krahasonte SHBA-në me një njeri me trup gjigand, por me kokë të vogël, dhe të botonte një reportazh aq të drejtpërdrejtë dhe realist, Kamber Faruku, ndër gazetarët më kurajozë të kohës, do të haste vështirësi të panumërta në ushtrimin e profesionit, i ndodhur nën tryshninë e pothuajse gjithë nomenklaturës komuniste, përfshirë edhe ish-sekretarët e parë të komitetit të PPSH-së së Dibrës. Por gjithsesi, i vënë në sprovën e së vërtetës ai, falë inteligjencës së spikatur dhe penës së tij të mprehtë arriti t'iu bëjë ball me dinjitet sfidave të asaj kohe skëterrë.

Libri i tij "Kur po shkriheshin akujt" në pjesën e parë "Shënime dollapi", përmbledh përjetime dhe asosacione të ngjarjeve më kryesore që rrodhën vrullshëm gjatë vitit 1990, si pararendëse të legjitimitimit të pluralizmit politik në Shqipëri.

Në këto ditarë, përveç analizave të mirëargumentuara të zhvillimeve aktuale, ai bën retrospektivë nga e kaluara e largët për të sjellë në vëmendjen e lexuesit ato kohë kur në vendin tonë kishte pllakosuar skamja e varfëria e tejskajshme. Kështu ai e josh lexuesin të mësojë për ngjarje

të kohës së luftës kundër nazifashizmit, kur "Kishte raste që në të njëjtën shtëpi rrinin në kate të ndryshme armiqtë e njëri-tjetrit".

Në të njëjtën linjë i trajton edhe ngjarjet e mëvonshme autori, kur sjell një rast nga Prodani, kur "vogëlushët nuk donin që ne të shihnim mjerimin që i kishte pllakosur", ndërsa xha Ibrahimit, vëllait të Aliut që kishte shoqëruar E.Hoxhën në Prodan më 1943, i dukeshin brekushet e zeza, që kur hapeshin ishin të shpuara vrima-vrima. Në fokus të gazetarit të mirënjohur janë zhvillimet kobndjellëse të kohës së kolektivizimit të bujqësisë, kur fshatarët, pasi dorëzuan "vullnetarisht" tokën, sistemi i detyroi të dilnin ciplak në shi e në borë. Por dhe ajo e tufëzimit të bagëtive që e la fshatarin edhe pa një lugë shëllirë. Ka edhe mjaftë raste ku autori sjell shembuj konkretë se si organizatat bazë të partisë ishin shndërruar në fole të sundimit, thashethemeve, misticizmit dhe "paragjyqeve" politike..

Në këtë libër gjejmë sarkazmën e thellë të autorit për fshatarët që do t'u kërciste luga në sahan, si në rastin, kur ai i detyruar do të shkruante e botonte kronikën "Drejt Prrenjasit" (me shënimin e tij në ditar) "me t'u dhimsë vetja!". Dhe po me këtë kurajë K.Faruku evidenton në librin e tij edhe gazetarë, të cilët iu drejtuan natyrës së llustrës për të marrë rrogën, duke sjellë shembullin e reportazhit "Qumështi i tufëzave", botuar në "Zëri i Popullit" më 28 qershor 1986, ku gjenden përshkrime si te përralla e Andersenit "rrobat e reja të mbretit". K. Faruku konkludon dhe argumenton se me shkrime të tilla gazetaria jonë e zhvilloi publicistikën

me gjini të reja si "Kur e zeza bëhet e bardhë", "Lexo e ngopu" apo "Hi syve". Këto përfundime të publicistit, diplomatit e politikanit Kamber Faruku janë në koherencë me realitetin e sotëm, kur edhe 30 vjet pas këtij tranzicioni të tejzgjatur, ka kalemxhinj që iu bëjnë llustra pushtetarëve më të korruptuar e më të inkriminuar të rajonit të Ballkanit. K.Faruku, pasi analizon shkaqet që çuan në kolaps të plotë ekonominë shqiptare, ndër të tjera konkludon edhe për faktin se mendja e njerëzve, prej varfërisë së tejskajshme, ishte bërë si eshkë dhe merrte flakë urrejtje.

Portretizimet, testi i saktë i profesionalizmit të gazetarit

Libri "Kur po shkriheshin akujt", ka ngjarje e fakte interesante nga pothuajse të gjitha zonat e Dibrës: Muhurri, Luznia, Katër Grykët, Lura, Reçi e Dardha, Kalaja e Dodës, Çidhna e Kastrioti, Sllova e Shumbati, Shupenza e Golloborda, Bulqiza etj. Përshkrimet brilante të bukurive natyrore, si dhe portretizimi gjer në detaje i ish - zyrtarëve të nomenklaturës komuniste, sidomos i ish- sekretarëve të komitetit të PPSH të rrethit Dibër, e bëjnë mjaftë tërheqës këtë libër. Pjesa e portretizimit të një gazetari natyrisht është testi i saktë i profesionalizmit të tij. Këtë ai e jep në mjaft personazhe të spikatur, të njohur e të panjohur shumë për publikun e gjërë dibran e jodibran. Është gjë e bukur se optika e tyre përfshin personalitete të kohrave, moshave e profesioneve të ndryshme si: Dine Hoxha, Tafe Kaziu, Ali

Lika, Murat Kaloshi, Halit e Haxhi Lleshi, Sali Berisha, Azem Hajdari, Anton Çeta, Safet Zhulali, Mirush Mati, Arif Mata, Adrian Skuka, Besa Mera, Rexhep Hoxha, Lavdrim Shehu, Astrit Kuka e dhjetra të tjerë që të mbeten në mendje me detajet që ai ka dhënë për jetën dhe veprën e tyre (qofshin këta personazhë negativë apo pozitivë).

I drejtëprdrejtë është K.Faruku edhe në pjesën e dytë të librit, kur nuk nguron që nëpërmjet portretizimit të fytyrave të disa ish - eksponentëve të PD-së (viti 1991) bën profetin për ardhmërinë e tyre politike. Ja çfarë shkruan autori Faruku për një rast takimi me lidërsipin demokrat në vitin 1991:

"-Prisni te kjo zyra, do ta njoftoj Doktorin,-na tha një sekretare. Kur u futëm te zyra, aty ulur në një kënd, qëndronte Aleksandër Meksi....Pasi e mësoi se kemi ardhur nga Dibra dhe duam të takojmë Doktorin, shkëmbeu dy-tri fjalë me Mirushin (Mati) dhe heshti, sikur nuk kishim se çfarë të flisnim më. Me një kostum të thjeshtë ngjyrë hiri të errët dhe me jelek klasik me cepa, me një kapele me strehë të rrasur në kokën e tij tullace me flokë të rrallë anash, me mustaqet si furçe teli dhe fytyrën shumë të zeshkët, me trupin e shkurtër dhe të mbushur e rondokop, nuk e di pse, Meksi më ngjante me kallajxhinjtë, të cilët vinin në anët tona nga Përmeti dhe thërrisnin: Kallaisim bakra! Bakra për të kallaisur!". Portretizime të tilla "të kripura", K.Faruku bën edhe për të ndjerin Gramoz Pashko në rastin kur e kishin thirrur në një mbledhje qeverie si zëvendëskryetar i komitetit ekzekutiv pluralist të rrethit, për të dhënë llogari se pse Dibra nuk pranonte të zbatohet ligji famëkeq 7501 i ndarjes së tokës për frymë!

Kur gazetari vesh mantelin e historianit

Sa shumë emra, sa shumë vende dhe histori, sa shumë negativitet dhe pozitivitet, dashuri dhe mirënjohje për to, ka derdhur autori, gazetari i mirënjohur, Kamber Faruku, brenda faqeve të këtij libri. Në një topografi dhe gjeografi që nga Bulqiza, Okshtuni, Klenja, Gjorica, dhe pse jo, gjer në Lurë e Kala të Dodës, Tiranë, Prrenjas e Laç.... Të rrethuar me trimëri nga jehona e kohërave, por të thjeshtë, të thjeshtë deri në madhështi vijnë e ulen pranë nesh, me fakte, me ngjarje, me jetët e tyre përmes faqeve të këtij libri.

Autori K.Faruku që provoi të jetë një publicist i suksesshëm dhe tejet kompetent si redaktor i gazetës lokale "Ushtima e maleve" për gati 15 vjet, me shkrime nëpër gazetat e ndryshme të vendit, me këtë libër, ai pa frikë ka veshur edhe mantelin e historianit. Vetë libri, në pjesën më të madhe të tij të sugjeron, data, ngjarje, personazhe dhe histori që do të jenë burim referencash për të ardhmen. Leksiku i pasur, fjalët e shprehjet frazeologjike të rralla dibrane e bëjnë këtë libër edhe një pasuri gjuhësorë e mjaft tërheqës për lexuesin. Mjaftë interesante janë përshkrimet që K.Faruku u bën takimeve të tij elektorale të kohës kur ishte kandidat i Partisë Demokratike për deputet në zgjedhjet e para pluraliste të 31 Marsit 1991.

Janë përshkrime brilante që ekzaminojnë saktë gjendjen e rëndë ku e kishte katandisur sistemi socialist fshatin shqiptar dhe ndikimin e politikës mashtruese në indo-ktrinimin e thellë të malësorëve të varfër.

Analiza të mirëfillta në sensin diplomatik

Si diplomat (K.Faruku në vitin 1994 filloi punë në MPJ në Tiranë, si sekretar i parë i ambasadës shqiptare në Maqedoninë e Veriut - në atë kohë FYROM, ish- Republika Jugosllave e Maqedonisë, dhe nga shtatori deri në dhjetor 1997, me largimin e ambasadorit, u caktua i ngarkuar me punë (a.i.), bën analiza dhe arrin në konkluzione të drejta, si për kohën pas çlirimit, kur përplaseshin superfuqitë SHBA dhe BS për hegjemoni e kur "Shqipëria mbeti si gomari mes dy atllarëve dhe hëngri aq shumë shkelma, sa vetëm më 14 dhjetor 1955, mundi të ulet në kuvendin e kombeve", ashtu edhe për vitet e mëvonshme kur "zgjodhëm disa teza 'të mira' nga klasikët e M-L dhe pastaj bëmë një zhvillim krijues të marksizmit", ekperimente bajate këto që e çuan Shqipërinë në buzë të greminës më 1990.

Dhe po në sensin diplomatik gjejmë në këtë libër analiza të mirëfillta për kohën kur "Shqipëria, si subjekt demokratik në Europë, duket se u prish punë forcave shoviniste në Ballkan", ndërkohë që sipas tij, diplomacia shqiptare rrinte si një iriq i mbledhur në kundërshtimin e saj apokaliptik. Janë analiza të kohës kur "Slllobodan Millosheviçi është bërë një politikan i errët, një nacionalist histerik, që po luan me popullin e vet si buburreci me bajgën"...dhe kur "Jugosllavia i ngjan një laraske, që kakaris si e bardhë, por ngjyrën e ka të zezë"..

Pasi analizon edhe zhvillimet në botën arabe, kur në ringun e përbaljes kishte dalë diktatori Sadam Hyseini, diplomati dhe publicisti i mirënjohur K.Faruku arrin në

përfundimin se "Një popull bie në mjerim, kur u beson verbërisht udhëheqësve, vetëm se ata e trazojnë në ndjenjat dhe emocionet nacionaliste". (A nuk është ky përfudim në koherencë edhe me zhvillimet aktuale në vendin tonë, kur ekranet e televizioneve janë tejmbushur me kronika e debate për influenza të tilla?!)

Dimensioni intelektual e njerëzor i K.Farukut

Ajo që jep më së miri dimensionin intelektual e njerëzor të K.Farukut është fjala e tij (që nuk u lejua ta mbante të plotë në një takim të datës 29.06.1991 në sallën e kinemasë Peshkopi, kur kishin ardhur të deleguar Azem Hajdari e Napolon Roshi. Publicisti e politikani kurajoz, këtu, midis të tjerash do të shprehej: "Jemi një shoqëri në zgjim. Ta bëjmë përtëritjen nga pesha e diktaturës me guxim. Misioni për të demaskuar deri në fund, me fakte diktaturën u takon trimave, atyre që nuk kanë frikë nga varret dhe hijet e së kaluarës. Të shërojmë njerëzit e gjymtuar, të shërojmë plagët. Krimet e komunizmit meritojnë një monument kujtese që të mos na përsëritet kurrë më e kaluara e Tonton-Makutëve enverianë. Të gjallët meritojnë respekt. Na takon ne që e nisëm, ta çojmë deri në fund demokratizimin dhe dekomunistizimin e vendit. Siç thotë dijetari i shquar Visental: Liria nuk vjen nga qielli, për të luftohet çdo ditë". E perifrazova këtë pjesë nga libri "Kur po shkriheshin akujt" për të sjellë në vëmendjen e lexuesit mesazhet aktuale që

përcjell kjo vepër shumëdimensionale e Kamber Farukut për kohët që jetojmë.

"Kur po shkriheshin akujt" është një libër racional, emocional, dokumentar, arkivor që të bën ta marrësh diku një laps nga ato që shumë herë i kemi harruar përballë dehjes që na kanë bërë tastierat e kompjuterave dhe të celularëve dhe të shkruash diçka, mbase edhe shumë. Të shkruash për t'u bërë më tej një urë modeste e dobishme dhe e bukur mes kësaj vepre dhe publikut që e ndjek me shumë respekt, padurim dhe kureshtje çdo vepër që ai bën. Të bën që para se t'ia japësh mesazhin atyre që do e lexojnë këtë vepër të Kamber Farukut, të marrësh shumë për vete, bash si ata çirakët që kanë një kod të përbotshëm të marrjes së zanatit nga ustallarët.

Vepra krijuese e Dr.Hajri Mandrit në tri dimensione

Poeti, dramaturgu dhe studjuesi i shembëlltyrës në folklor dhe letërsi, në proces të mbrojtjes së titullit "Profesor i asociuar".

Dr.Hajri Mandri është pedagog në "Albanian University", Tiranë, ku kryesisht jep lëndët: pedagogji dhe shkrim akademik.

Në botimet e fundit ka kontribute të çmuara në pedagogjinë speciale, ku më evident ky kontribut shfaqet te libri i tij shkencor "Tiflopedagogjia".



Para tre dekadash, në konkursin kombëtar të teatrove të njësive të ushtrisë, si metodist i punës kulturore në ish - shtëpinë e ushtarakëve të divizionit të Bulqizës, për t'iu përshtatur tematikës, zgjodha për të konkuruar me dramën "Bregdrinasit". Autori, Hajri Mandri, ishte i njohur për kohën, pasi kishte botuar edhe drama të tjera. Madje, drama e tij "E fejuara", e inskenuar nga trupa amatore e pallatit kulturës Bulqizë, pati një numër rekord shikuesish.

Për interpretimin e arrirë artistik dhe veçanërisht për faktin se drama "Bregdrinasit" kishte si subjekt historinë e "gjeneralit me shajak", Elez Isuf Ndreu, trupa e shtëpisë së kulturës të divizionit të Bulqizës zuri vendin e parë në rang kombëtar.

E solla në vëmendje të lexuesit këtë fakt për të evidentuar një talent të "fshehur" të Dr.Hajri Mandrit, atë të dramaturgut. E dëshmon këtë talent qoftë edhe vetëm drama "Bregdrinasit", me paraqitjen impozante dhe burrërore të Elez Isufit, që rrezatonte ngjashmëri me heronjtë antikë. Ngritja në art e aktivitetit të tij atdhetar, është një vlerë e shtuar për dramaturgun Mandri. Nëpërmjet dialogimit të personazheve, heroit kryesor Elez Isufi dhe bashkëkohësve të tij, Sufë Xhelili, Osman Paci etj, vjen jehona e asaj kohe të largët kur kryengritësit dibranë mbrojtën me stoicizëm trojet e tyre kundër pushtuesit serb. Fjala artistike në dramën e Hajri Mandrit e sjell "gjeneralin e veshur me shajak" në të njëjtën nivel të atdhetarisë së gdhendur me gërma të arta në historinë tonë kombëtare. Mandri ka meritën e ngritjes në art të këtij biri besnik të atdheut, luftëtar i shquar për çlirimin dhe bashkimin e trojeve shqiptare. Kësisoj, dramaturgu H.Mandri,

që para tri dekadash, e shihte këtë përzgjedhje si një mundësi e mirë që drama e tij të mund të ndikonte në edukimin atdhetar të shoqërisë shqiptare, ndërkohë që krijoi dhe botoi në revistën "Teatër" edhe dramat "Mjeku i ri", "Në rrjedhën e jetës" dhe "Joana".

Model i ri vjershërimi dhe....

Hajri Mandri, fillimet e veta letrare i ka në poezi. Që kur ishte gjimnazist në Peshkopi dhe më vonë pas mbarimit të studimeve të larta, si mësues i letërsisë në shkollat e Bulqizës (dhe si drejtor i pallatit të kulturës të qytetit minator), ai do të ishte fitues i disa konkurseve letrare të degës së Lidhjes të Shkrimtarëve dhe Artistëve të Dibrës. Gjithsesi, poezia e tij do të bëhej e njohur pas viteve '90 kur ai do të botonte vëllimet poetike "Prag mijëvjeçari" e "Zjarret e ditëve". Në të dyja vëllimet dallohet poezia liriko-filozofike. Këto veçori të poezisë së tij i ndeshim qoftë dhe vetëm tek vjershërimi i porosisë së babait: "M'u zgjuan ca fjalë të kyçura në zemër/ M'i tha babai që nuk është më sot/ M'i tha e iku pa m'i ngopur sytë/ Duke më lënë një det me mall të ngrohtë...."

Në këto dy vëllime H.Mandri krijon një model të ri vjershërimi në problematikë dhe në mjeshtërinë letrare, gërsheton natyrshëm vlerat tradicionale të poezisë me mënyra të reja të shprehjes poetike. Në përgjithësi në poezinë e tij mbizotëron natyra lirike, si te "Kroi i Verës": "Mos ma prishni Kroin e Verës/ Kroi i Verës pikon mjaltë/ Tek ai krua, ajo hije/ Mrizon ëndërra prej fëmije/ Vijnë kujtimet më mbajnë

gjallë,/ Kroj - leitmotiv i rrallë/ Mos ma prishni Kroin e Verës/
Musht e mjalte në buzë e kam.....".

Lirika është mbizotëruese edhe në disa poezi të tjera të Mandrit, por më evidente ajo është tek ajo me titullin "Lirikë":
"I rashë hënës me një grusht/ Hëna shkau dhe ra n'humnerë/
Atë natë ishte gusht/ Binte shi dhe frynte erë.../ Desha, që
veç unë e ti/ Ta sundojmë tërë errësirën/ Qënia jote qe magji,/ Lumë nishonte natyrën".

Ndërkohë konstatojmë se lirika në poezinë e këtij poeti shfaqet si vazhduese e vlerave më të mira të poezisë lirike shqipe, si psh tek poezia e titulluar "Ti më pret...": "Mos më ndal sonte në rrugë/ Eshtë e shtunë, ajo më pret/ Vijëzon në ballë një rrudhë/ Dhe nga sytë, loti i shket.../Nuk ka forcë që më ndal sonte/ Ti ditëlindjen ke në fshat/ Po t'mos vijë ai merak nëne,/ Të shqetëson, s'të lë rehat!".

Dhe duke e vështruar në tërësi krijimtarinë poetike të H.Mandrit mund të konkludojmë se ajo është bartëse e tipareve moderne që shfaqen në sistemin letrar shqiptar, ndërkohë që thjeshtësia e komunikimit, mesazhet universale dhe shprehja e hapur e ndjeshmërisë janë shtyllat e forta ku mbështetet poezia e tij.

...Shembëlltyra në folklor dhe në letërsi

Në krijimtarinë e tij, Hajri Mandri është mbështetur thujtë tërësisht në traditën folklorike shqiptare. Librin "Shembëlltyra në folklor dhe letërsi" e ka shkruar fillimisht si tezë për shkallën "Master", me titull pune "Shembëlltyra në tregimet

alegorike dibrane". Por kësaj teze iu përkushtua për vite të tëra deri sa arriti të marrë titullin "Doktor i Shkencave" në Studime Letrare.

Siç është shprehur udhëheqësi i kësaj teme, Prof. Dr. Shaban Sinani: "Studimi i Hajri Mandrit, për qëllimin që u hartua, mund të mjaftohej edhe vetëm me një paraqitje panoramike-anatomike të formave të ligjërimit me shembëlltyra në tregimet alegorike dibrane, në të folurit me rrotulla të Kosovës, në kallëzimet popullore të viseve të tjera veriore të Shqipërisë, që përbëjnë dukuri folklorike me përhapje tejet të gjerë deri në ditët e sotme".

Duke e rilexuar tashmë si një monografi që u drejtohet studiuesve, lexuesve me interesa në fushë të letërsisë, folklorit, etnografisë, ligjërimeve gjuhësore, jo thjesht për ta paraqitur me dinjitet para një komisioni specialistësh, vlerat e këtij libri mund të çmohen në një kontekst më të gjerë. Analiza gjuhësore e studimit "Shembëlltyra në folklor dhe letërsi" hedh dritë jo vetën në pasqyrimin dhe dokumentimin e vlerave folklorike të Dibrës dhe krejt Verilindjes, por edhe për çështjet që lidhen me fushat e onomastikës, krijimtarinë popullore folklorike, dialektologjike etj.

Ky studim paraqet frymëzim shpirtëror jo vetëm për studiuesit e sotëm të folklorit shqiptar, por edhe për gjuhën shqipe dhe popullin shqiptar në përgjithësi, sepse aty pasqyrohet historia, mendësia popullore, doket, ritet, besimet etj. Përveç synimit për të qenë një ndihmesë në studimin e tipologjisë dhe karakteristikave të veçanta të mjeteve kohezive në gjuhën shqipe, punimi është motivuar dhe mbështetur edhe

nga një qëllim tejgjuhësor. Më shkoqur, autori synon për të vënë në qendër veprën e mbledhësve të folklorit, si përfaqësues të prirjes realiste kombëtare në letërsinë shqiptare, që bosht të krijimtarisë së vet pati vlerat dhe vyrtetet njerëzore të njëmendëta dhe të përhershme, që shqiptarin e djeshëm dhe të sotëm, pa se i lidh vazhdimësia e traditës, e urtësisë, e virtytit moral, por edhe tragjiciteti, ky shoqërues i përhershëm i ekzistencës së tij, i cili ka përcaktuar edhe kalitjen e shpirtit të tij të qëndresës.

Mjafton që duke lexuar këtë botim shkencor, mund të arrijmë në përfundimin se Dr.Hajri Mandri është tashmë nga ata personalitete me kontribut të rëndësishëm që u ofron studentëve njohuri parësore për një dukuri të pastudiuar, vetë bartësve të fundmë të ligjërit me shembëlltyra një mënyrë të interpretuari të stilit të tyre të folurit, specialistëve të letërsisë e të folklorit një varg problemesh të nevojshme për të gjykuar drejt për gjuhën, folklorin, letërsinë dhe marrëdhëniet midis tyre dhe mbi teoritë e evolucionit të zhanreve dhe të figuracionit; studiuesve të një niveli më të lartë formimi tema të hapura që presin njerëz të zellshëm dhe të formuar për t'u shpënë më tej.

Punime dhe kërkime të tilla gjuhësore-folklorike, të bëjnë të besosh se potencialet intelektuale shqiptare, kanë një fuqi depërtuese dhe analizuese të trashëgimisë sonë kulturore, në baze të se cilës qëndron gjuha dhe folklori, këto vlera të thesarta të mbijetësës triumfale të kombit tonë. Dr. Hajri Mandri me punën e vet konkrete, provon se është vërtet një potencial intelektual në botën akademike shqiptare.

Publicistika dhe prirjet letrare e artistike të Isuf Rashës



Në publicistikë, letërsi, art dhe kulturë, pasioni sjell talentin. Këtë e provon më së miri edhe trashëgimia publicistike, letrare dhe artistike e Isuf Rashës. Ndonëse nuk është ndonjë autor i njohur, në labirintet e laboratorit të tij krijues, (të shprehur në formë ditari) gjen dhjetëra artikuj problemorë, poezi, skica etj., (disa të botuar në gazetën lokale

"Ushtima e maleve", por shumica të pabotuara) ku reflektohen fakte historike, por edhe shqetësimi për mbarëvajtjen e punëve në ish-kooperativën bujqësore të Zall Dardhës së tij të largët. Ndonëse e donte dhe dashuronte jetën, ai iku për në botën e

përtejme para 20 vitesh, duke lënë pas një trashëgimi të pasur dokumentare. Mjaftojnë dhjetëra ditarët e lënë në dorëshkrim (nëpër blloqe a fletore), për të kuptuar punën e tij të thelluar studimore, duke përshkruar në detaje fakte e ngjarje historike të Zall Dardhës me histori të lavdishme, për toponiminë, për Simpoziumin e organizuar në Zall Dardhë nga zona e Reçit dhe Dardhës me rastin e 75 vjetorit të pavarësisë etj.

Nëse do të njohësh një njeri, lexo ditarin që ka lënë. Nëse dëshiron të njohësh një periudhë kohore historike, lexo ditarët dhe shtypin e kohës. Ditari tregon se je njeri i rregullt, i vëmendshëm, parashikues, optimist, krahasues, dhe vizionar. Një nga të rrallët njerëz me botë të madhe shpirtërore është Isuf Rasha. Këtë e thonë ditarët e tij, që fatmirësisht bashkëshortja Hyrie dhe gjashtë djemtë e tij, i kanë ruajtur si sytë e ballit. Ditare shumë të thjeshtë, të vegjël, blloqe të vegjël, me një shkrim të imët, por me kaligrafi, që flasin shumë.

Për vlerat e rralla dhe profilin krijues të I.Rashës flasin bashkohës të tij, personalitete të mirënjohura, si Prof.dr.Petrit Bara, Dine Kaca, Ismet Avdia, Xhelil Cibaku, Isuf Xhediku, Muharrem Gjoka, Shuaip Methasani, Shaqir Çerpja, Nazmi Shira, av.Hasan Bara, etj.

Studiues bashkëkohor

Intelektuali erudit I.Rasha, pa iu larguar profesionit të llogaritarit (si një nga kontabilistët më të njohur të kohës që jetoi, sa që kur viheshin në vështirësi autoritete të rrethit e angazhonin në nxjerrje bilancesh të ekonomive kryesore),

angazhohet në studime serioze, në funksion të rritjes së vlerës së ditës së punës. Të tilla janë studimet për rritjen e efektivitetit nëpërmjet projekteve të sistemit të tokave, drenazhimeve, tarracave etj., - procese këto për të cilat sipas një vendimi të qeverisë së asaj kohe, financoheshin nga shteti. Studime të tilla si dhe ai për rritjen e rrezes së bukës, të botuara në shtypin e kohës kanë patur jehonën e duhur, jo vetëm në qarqet intelektuale të Dardhës, Reçit, Çidhnës e Lurës, por pothuajse në gjithë rrethin e Dibrës.

Në këto studime (të botuara dhe të pabotuara) si edhe në kronikat, skicat apo esetë (që dëshmojnë publicistikën e tij) reflektohet bota shpirtërore e një intelektualit të mirëfilltë që në çdo aspekt të imponon qasje të reja, metoda efektive në funksion të zgjidhjeve të problemeve, të ndërtimit dhe përkufizimit të koncepteve për strategji zhvillimore, planifikim strategjik, menaxhim efektiv të projekteve, gjithnjë në koherencë me realitetin objektiv.




Kryellogaritari i një ekonomie bujqësore provinciale, jo vetëm i kishte të koleksionuara, por edhe të mirëstudiuara revistat "Shkenca dhe jeta" dhe "Bujqësia", por do të ishte udhërrëfyes në aplikimin e metodologjisë së punës shkencore,

duke mundësuar një ambientim të ri në studime, një cytje drejt përvetësimit të njohurive bashkëkohore dhe aplikimit të tyre në praktikën e përditshme, në sektorë të tillë, si pemëtaria, blegtoria, bletërritja (gjuetia, parashikimi i motit e infermiera) apo deri dhe te projektimi e ndërtimi i rrugëve të ndërmjetme mes fshatrave të Dardhës etj. Me fjalë të tjera, I. Rasha ishte intelektual bashkëkohor, i cili edhe në kushtet e rrethanat e izolimit total, në një ekonomi provinciale, hartonte dhe zbatonte projekte që konsistonin në doza optimale të materialeve teorike, për t'i dhënë rëndësi punës praktike, nga e cila krijonte bazamente të qëndrueshme për vepra po të qëndrueshme, disa prej të cilave i hasim edhe sot pas më shumë se tri dekadash, si blloku i pemëve (sipër shtëpisë së tij), apo dhe ndonjë rrugë ndërlidhëse fshatrash....

Poezia...

Jo më në Zall Dardhën e largët, por ndoshta edhe këtu në Tiranë, metropolin shqiptar, rrallë mund të gesh një bibliotekë aq të pasur si ajo që i la trashëgim familjes së tij Isuf Rasha.

Pikërisht, intelektual bashkëkohor që kishte lexuar (e madje konspektuar), Tolstoin, Shekspirin, Dostojevskin, Uilliam Folkner, Çarls Dikens etj., dalëngadalë, nëpërmjet leximeve, përjetimeve e asosacioneve, do të formonte profilin e tij letrar. Jo vetëm kaq. Nuk është rastësi që në arkivën e tij personale gjejmë koleksionin e të gjitha numrave të revistës "Nëntori", si dhe shumicën e nr. të gazetës "Drita", nga ku ai, jo vetëm lexonte letërsinë e kritikën letrare bashkëkohore, por edhe mësonte



rreth stilistikës të të shkruarit letërsi. Ndonëse krijimtarinë e tij nuk e publikoi, nuk është rastësi që atë e ruajti me fanatizëm në "sepetet" e familjes, me bindjen se një ditë ajo do të "zbulohej", e madje do të gjente dritën e botimit.

Brenda "arsenalit" të tij krijues, mjafton qoftë edhe poezia (e lënë në dorëshkrim "RREBESHET E SHKUARA MË NUK KTHEHEN", për të konkluduar në peshën e fjalës, gjuhën e pasur e mjetet shprehëse brilante të një poeti të talentuar. Ligjërimin e tij poetik e gjejmë të sintetizuar qoftë edhe në vargjet: "Dikur në këto brigje që zënë dielli/Errësira kishte bllokuar edhe qiellin/ Errësira, skamja, padituria/ U duk sikur në këto male kanë zënë rrënjë..." Qoftë edhe vetëm në këto vargje tingëllon e bukur fjala poetike e Isuf Rashës. Më tej në vargjet: "Ngado që ngjitem në maja të larta/ Ngado që shkel buzë kufirit/ Zemra më gufon me afshin e pastër/ Rrofsh në jetë të jetëve O Shqipëri!...", duket sikur shkelim në sinorët poetikë të Isuf Rashës që janë më të bukura se rudinat e Korabit. Na sjell kështu ai një shpirt të madh poetik, gati parajsor që të magjeps....

Vepra e qenësishme e piktorit autodidakt

Një shpirt poetik i derdhur edhe në telajo....Një pikturë mbresëlënëse e një piktori autodidakt, që ndonëse e diktuar nga ideologjia sunduese e regjimit në të cilin ai punoi, i ka rezistuar kohës. Dhe për vetë faktin se shumica e punimeve të Isuf Rashës janë të skalitura në xham, gjithkush do të mendonte se ai ishte piktor i një stili të veçantë. Kështu, duke pikturuar në xham portrete e peizazhe të natyrës ai krijoi individualitetin e tij krijues edhe në gjininë e pikturës.Dhe ndonëse për të pikturuar peizazhe apo portrete të çfarëdolloj, ndjehej disi i pavarur, kishte dhe raste kururvejohej, e në këto rrethana venitej disi shpirti i tij krijues. Madje, kur donte të hidhte në një pikturë në xham portretin e ish diktatorit komunist E.Hoxha, (jo se e donte shpirtërisht, por për të shpëtuar nga intrigat që i thurnin ziliqarët e kohës skëterrë) këtë nuk mund ta bënte kurrsesi pa lejen e komitetit të PPSH të rrethit (!)

Ndoshta edhe rrethanat ia "diktuan" Isuf Rashës ushtrimin e talentit të tij në pikturë. Se pikërisht në një periudhë kohore, kur qe ndëshkuar padrejtësisht nga kupola me masën e përjashtimit nga administrata e ish-kooperativës bujqësore, për të mbajtur familjen do të "prodhonte" dhjetëra piktura në xham, të cilat do t'ua shiste bashkëfshatarëve, që aq shumë i kërkonin për të zbukuruar me to shtëpitë e tyre. Ndodhte kështu, pasi në peizazhet e portretet e pikturuara nga I.Rasha dominonte filozofia humaniste që nënkuptonte marrëdhënien e tij shpirtërore me njeriun, me njerëzimin, me natyrën, me

botën që na rrethon. Pikërisht në ato rrethana spikat një perceptim i ri i këtij piktori autodidakt, kur ky talent i veçantë arrin të vetëpërcaktohet dhe të kultivojë dhuntitë e tij, me të cilat mund të mbizotëronte fatin e paracaktuar dhe të dominonte natyrën duke e modifikuar.

Kur shikon punimet e tij artistike, (të ruajtura me fanatizëm nga bashkëshortja, djemtë e vëllai i tij) qoftë në pikturë, qoftë në grafikë, sheh mjaft peizazhe nga mjedise të origjinës së tij, pra nga Zall Dardha, kjo perlë e natyrës shqiptare. Në këto punime ku dominojnë lulet dhe natyra e qetë, duhet thënë se lidhja e tij me vendlindjen është një lidhje emocionale...është edhe një krenari për historinë e lavdishme të Dardhës dhe bukuritë mahnitëse të natyrës së saj.

"Shkenca dhe Jeta", revista më e dashur e Isufit

Isufi lexonte shumë. Ai ishte i abonuar në shtypin e kohës (jo në atë partiak, por në shtypin letrar e shkencor). Lexonte gazetat "Drita", "Zëri i Rinisë", etj. Por revista më e dashur për Isufin ishte revista "Shkenca dhe jeta".E lexonte me vëmendje këtë revistë sepse tek ajo gjente nga vetja e tij, gjente përvojë, kërkime shkencore. Një herë postieri nuk ja solli revistën në fshat. Isufi u mërziq shumë. Ai e ripagoi postierin që ta blinte revistën në Peshkopi dhe t'ia sillte.

Revistat i mbante koleksion, i shfletonte herë pas here, nxirrte shënime, dhe këto shënime i vinte në praktikë. Shikonte emisione shkencore në televizor, emisione sport-

ive e kulturore. Dëshira e tij e madhe për të zgjeruar horizontin kulturor ishte e jashtëzakonshme.

Thënë shkurt: Isuf Rasha, ishte një nga ata "meteor" të heshtur, një nga ata qindra e qindra shqiptarë, që në një sistem të mbyllur dhe të kontrolluar dhunshëm nga lart-poshtë, talentin, pasionet, ëndrrat dhe çmenduritë krijuese" i mbajtën për vete, i ruajtën si thesarë shpirtërorë në etazhere dhe sëndyqe druri, me shpresë dhe besim se një ditë dikujt do t'i duheshin, dikujt do t'i zgjonin kureshtjen dhe interesimin intelektual, për të parë fuqinë e dritës në errësirë. Isuf Rasha ishte një, por sa shumë të tjerë "fjetën" me blloçka dhe mendime nën jastëk, me shpresën e madhe të lirisë që do të vinte. Më duket se duke shkruar për Isuf Rashën, kam shkruar edhe për ata poetë e krijues "të panjohur", që prehen diku në galaksi, duke "soditur" nga lart e larg. A nuk është koha për monumentin e "krijuesve të panjohur"?!

Filozofia popullore dibrane në rrëfimet e Sakip Camit



Në harkun kohor të tri dekadave të fundit, përveç dhjetra veprave me poezi, publicistikë e monografi letrare, publicisti dhe poeti i njohur Sakip Cami, ka botuar edhe dy libra të të njejtit profil, në të cilët rrëfëhet mjeshtërisht filozofia popullore dibrane. "Rrëfime popullore dibrane" (2006) dhe "Dibra nëpërmjet këngëve dhe tregimeve të popullit" (2010) janë dy libra

të vyer që përcjellin tek lexuesi visare të Dibrës. Në këto dy libra gjen mishërim sentenca "Atdheu nis nga familja". Mjafton për këtë qoftë dhe kushtimi i dy vëllimeve prindërve

të tij, Ukë A.Cami dhe Razie Cami (Hasa), nga goja e të cilëve (siç shprehet vetë autori) ka dëgjuar shumicën e këtyre rrëfimeve.

Në këto rrëfime, ndonëse përçohen nga alegoria therëse, s'është e vështirë të dallosh mirëbërësinë e bujarinë e dibranëve, autoritetin moral e shpërtëror, traditën e mikëpritjes, por dhe zgjuarsinë, inteligjencën dhe mençurinë e dibranëve nëpër shekuj. Këto cilësi, më mirë se askush tjetër i ka mbledhur, perceptuar dhe pasqyruar realisht në këto dy libra, dibrani i mirë dhe i talentuar Sakip Cami, autor i disa librave me poezi, monografi, publicistikë, fabula e satira. E ka bërë këtë, duke qëmtuar e hulumtuar nëpër dasma e morte, në kuvende, në ceremoni fejesash e lindjesh, ku shpaloset mençuria e famshme, po dhe ajo që quhet "alegoria dibrane". Dallohen fare qartë këto, qoftë dhe vetëm në rrëfimin me titull "Gjëmon Korabi or babë", ku përçohet ideja se mali më i lartë i atdheut tonë gjëmon vetëm kur ka luftë të madhe me shumë krajl!.. Më tej, rrëfimi me titull: "O Muharrem Aga, shyqyr që të vdiq baba", në pak rreshta sinteizon ligjin e jetës, barazinë e gjallesave para Zotit, si në fragmentin: "...jetën e ka në dorë Zoti, por po të kishte shpëtue baba i Bajraktarit, na të tjerët nuk kishim ma vend prej baballarëve tanë. "E patë, Muharrem Aga e shnoshi babën në Austri, ndërsa ju na leni me vdekë", do na thoshin..."

Gjejmë në këto rrëfime gjithashtu ballafaqimin me vështirësitë e jetës, por dhe guximin e trimërinë për përballimin e tyre. Kjo më së miri konstatohet në rrëfimet me titull: "Me këto para që punoj e fitoj unë ushqehem, laj borxhet e jap

pare me fajde"; "Asgjë nuk vjen nga oxhaku", "Kush ka kohë të pijë kafën time" etj.

Një vend të veçantë në këto dy vëllime zë filozofia popullore e përçar nga goja e burrave të mençur e të urtë dibranë. Mund të veçojmë filozofin popullor Dine Hoxha, të cilin e kanë quajtur Dekan i "Universitetit të Dibrës", "Sokrati i Dibrës", "Profesori i alegorisë dibrane", sepse atë e njihje mbarë Shqipëria.

Vetë mbreti Zog e kishte këshilltarin e vet. Ai ishte nga Muhurri, i konsideruar si "Djepi i urtësisë së Nëntë maleve të Dibrës", pikërisht pse lindi e rriti burra të tillë të shquar si Dine Hoxha e paraardhësit e tij Kurt, Nel e Hazis Hoxha. Filozofia e këtij mendje kandarfloriri jepet qoftë dhe në rrëfimin me titull "Dine Hoxha dhe latifondisti francez". Është koha kur një pronar i madh tokash nga Franca vjen në Shqipëri për të takuar Dine Hoxhën që ta pyeste për mend lidhur me shqetësimin e tij që konsistonte në sekuestrimin e qindra hektarëve tokë pronë e tij, nga qeveria franceze. Dhe përgjigja e Dine Hoxhës ishte: "Dëgjo or mik, mos u ngatërro me qeverinë për punën e tokës. As me qeverinë dhe me asnjë njeri. Sakllam, sakllam, çdo njeri ka të vetat vetëm dy metra katror tokë, ndërsa ti ai i ke, apo s'i ke nuk e di!".

Sipas etnologut të njohur Mark Tërta, është mjaft domethënëse formula e mirënjohur e proverbiale që thotë se "Mendja", "Urtia" ka le në Dibër... Fjala dhe kuvendi i dibranit shquhet për mendjemprehtësi e lakonizëm, për peshë mendimi, për sinqeritet e dashamirësi, por dhe për këmbëngulje e qëndresë imponuese, bindëse. Më mirë se

kudo tjetër këtë e ndeshim tek libri i S.Camit "Dibra nëpërmjet këngeve dhe tregimeve të popullit". Aty gjejmë "Mesele dibrane", "Histori", "Rite, zakone dhe traditë". "Tregime brenda dhomës dibrane"...gjejmë historinë e Dibrës nëpërmjet këngëve të vjetra popullore, por dhe nëpërmjet dokumentave.

I kompozuar kësisoj "Dibra nëpërmjet këngeve dhe tregimeve të popullit" është një sintezë e mençurisë, urtësisë dhe filozofisë dibrane. Ai është i mbushur plot me visare të çmuara. Me mjeshtri të rrallë, Sakip Cami ka ngritur në art odën dibrane që është quajtur "Universiteti i Dibrës", atëhere kur në Shqipëri nuk kishte as shkolla fillore.

Madje siç shprehet recensenti, Hajri Mandri në parathënjën e këtij libri: "Mendimi filozofik dhe mendimi estetik, në odat e Dibrës, transmentonin që nga e kaluara e herëshme, mesazhet përmes një forme origjinale. Këto janë rrëfenjat (tregime), ose siç u thotë populli "meseletë", të cilat, për nga gjuha, kompozicioni, simboli dhe alegoria, humori dhe ironia, hiperbolat dhe litotat, u shndrruan në një platformë komunikimi për dibranët ose në një "shkollë" ku shpaloseshin idealet socialestetike, qëndrimet moralizuese e didaktike, rreth jetës e vdekjes, rreth familjes e integritetit të saj".

Pikërisht mbi këtë shtrat ndërtohen dhe librat e S.Camit "Rrëfime popullore dibrane" dhe "Dibra nëpërmjet këngëve dhe tregimeve të popullit", ku brenda një tematike shumë të gjerë dhe të larmishme rrëfëhet tradita, historia dhe heronjtë e Dibrës, por dhe ngjarje të ditës, të lidhura ngushtë me politikën, ekonominë e sjelljen e njerëzve në rrethana të

caktuara. Në këto rrëfenja gjejmë fjalën dhe kuvendin e dibranit të shquara për mendjemprehtësi e lakonizëm, për peshë mendimi, për sinqeritet e dashamirësi, por dhe për këmbëngulje e qëndresë imponuese, bindëse.

Si askush tjetër, Sakip Cami në këto dy libra reflekton zgjuarsinë dibrane, maturinë e burrave të mençur te Dibrës, dashurinë për njerëzit, sakrificat, patriotizmin e shumë veti të tjera të çmuara.

Pesha e mendimit liriko-filozofik në poezinë e Hamdi Skejës

*Poezi kushtuar dashurisë njerëzore dhe shpresës,
në koherencë me realitetin e sotëm. Hamdi Skeja është
një djalë i veçantë, dinamik, energjik, i drejtpërdrejtë, i
ndjeshëm, patriot, i talentuar në fushën e tij,
por mbi të gjitha një familjar shembullor. E kemi
lexuar shpesh në rrjete sociale, në intervista,
radiofonike apo edhe në studio të televizioneve të
ndryshme, ku spikat mënyra e të thënit të gjërave troç.
Një djalë që të lë pa fjalë, sepse vet fjala e Hamdiut,
s'ka vend bosh për ta komentuar më gjërë.*

Kur poezia e një autori kalon ekspertizën e redaktorëve e të kritikëve të njohur, ajo padyshim zë vendin e merituar në letërsinë shqipe.

Kështu ndodh me poetin Hamdi Skeja, i cili në tre vëllimet e botuara në harkun kohor të shtatë viteve të



fundit, ka patur redaktorë dhe recensentë, pena të njohura si Mentor Hoxha, Dr.Fejzulla Gjabri dhe Pëllumb Gorica. Nëse në vëllimin e parë "Ekstre-mume", gjejmë sinonime të një shpirti të trazuar, ku mund të veçojmë soditjen dhe mishërimin e autorit me ndjesinë, tek libri i tretë, "Nga drita e saj", evidentojmë lehtë vijimin në stilistikën e librit të dytë "Flakërima shpirti".

Poezia e tij është një mënyrë e veçantë e organizimit të ligjërimit shpirtëror, që na jep marrëdhënien vetjake estetike të individit ndaj vetës dhe mjedisit shoqëror dhe natyror. Më evidente, kjo në vargjet e poezisë "Merri o det": "...O det i paqes, o ulërimë pa zël/ Sonte mëkatet e heshtura/ Merri dhe fundosi se s'më duhen më/ Janë ca ndjenja që duhen të vdekura".

Poeti Hamdi Skeja krijon universin e vet nëpërmjet procesit krijues. Mjafton për këtë tematika mjaft e larmishme e vëllimit "Nga drita e saj", ku ky univers shpaloset me peshën e rëndë të fjalës poetike që mbartin poezi të tilla si ato me titull: "Ajo, diellëza nën diellin e Prespës", "Diej që zhuriten", "Heshtjet dhembën", "Në

kufirin e heshtjes" etj. Kështu, në katër vargjet e poezisë së parë: "Ajo, gatuar diell me duar mirësie/ Me sy plotë shkëlqim, rreze e artë/ Hyjneshë plot nur e sharm bukurie/ Bukuri Prespe me shikim të zjarrtë", lirika filozofike shquhet për shkallën e lartë të meditim; ajo përgjithëson në mënyrë figurative.

Po në këtë poezi, katër vargjet e strofës së fundit: "Bashkë u njohëm rastësisht, ashtu mrekullisht/ Aty ku linde ti, lindi edhe Sterjo Spasse/ Liqeni me plot nektar dashurie, çuditërisht/ Kuptoj:-edhe ti, sa dashuri që paske", nëpërmjet mendimit të figurshëm dhe ndjenjës së figurshme i krijohen lexuesit asociacione emocionale, kuptimore.

Më tej në vargjet e poezisë "Zemra rreh nga larg me mall": "Tashmë zemrën ma mori, nuk pres t'ma rikthej/ Le ta mbajë për vete, t'i bëj dy zemra/ Në natën e errët kërkoj atë, po nuk e gjej/ Ajo vjen si zan mali vetëm në ëndrra", konstatojmë pasqyrimin figurativ të ndjenjës, si veçori kryesore e artit të fjalës. Ndërkohë tek poezia "Rrëfim syve": "Sonte do u rrëfhem syve të tu/ Se ty nuk kam ç'farë të të rrëfhem/ Ti, ah ti nuk kuptove që të du'/ Shikimit t'ëmbël do dëfrehem", është shkalla më e lartë e ligjërimt lirik..është mendja e tij, që s'gjen prehje, bën kërkime...

Poezia e Hamdi Skejës është gjithashtu në bashkëkohësi me realitetin e sotëm. Përjetimet e tij shpalosen në poezinë "A ka më shpresë", ku pasi konstaton se "Shpresa mes nesh ka një humnerë", në një varg tjetër shprehet se

"Shpresa është udhëtare e ëndërrimtarit"...Këto veçori të poezisë së Hamdi Skejës evidentohen edhe në vlerësimet e disa personaliteteve të artit e letrave, të vendosura si ekstrakte në fund të librit "Nga drita e saj", botim i "M&B", një nga shtëpitë botuese më të suksesshme të dekadës së fundit.

Poeti Hamdi Skeja duket se tërheq vëmendje me vargjet e veta.Kështu, nëse Marjana Kondi e vlerëson poetin Skeja për faktin se ai, femrën e shikon si dritë e jetës dhe në tërësinë e tij këtë libër si vërtetësi e shkruar me një pasion dhe dashuri të stuhishme letrare, që i ka munguar penës shqiptare", Sonila Meço shprehet se "206 km e ndajnë shpirtin e poetit nga ai i dashurisë që pluskon mbi një mrekulli natyre dhe ndërsa lexon poezitë të ngjan se çdo metaforë të mbërrin në secilën nga 206 kockat e trupit.

Përkim hyjnor si çdo kod numerik, që çkyç misterin e asaj që ndodh kur një burrë dashuron me shpirt një grua". Për të arritur në këtë vlerësim, Sonilës i kanë mjaftuar qoftë dhe katër vargjet e poezisë "Ndjenjë gjeografike": "Marr metrin të mat ndjenjën tonë / Gjeografisht del 206 km nga vendi im/ Sa afër, sa larg, sa herët, sa vonë/ Gjashtë orë ndodhesh larg shpirtit tim...". (Poeti Skeja ka lindur në Ploshtan të Kalasë së Dodës, rrëzë malit të Korabit, dhe nga aty e gjer në Prespë ka llogaritur gjeografikisht 206 km).

Në të njëjtën linjë, edhe Xhoi Jakaj, e vlerëson poezinë e Hamdi Skejës për një përdorim të gjerë figuracioni, ku

ndër këto figura spikat metafora, e cila gjen një gërshetim, një shkrirje me vetë poezinë e tij.

Autori Hamdi Skeja është një djalë i veçantë, dinamik, energjik, i drejtpërdrejtë, i ndjeshëm, patriot, i talentuar në fushën e tij, por mbi të gjitha një familjar shembullor. E kemi lexuar shpesh në rrjete sociale, në intervista, radiofonike apo edhe në studio te televizioneve te ndryshme, ku spikat mënyra e të thënit gjërave troç. Një djalë që të lë pafjale, sepse vet fjala e Hamdiut, s'ka vend bosh për ta komentuar më gjerë.

IV.

KOHË PËR T'U KUJTUAR...
NË VETËN E PARË

Ndërsa po përveçoja fillesat e mia
në publicistikë, mendova të bëj një sentencë
që t'i përshtatej gjendjes sime të kësaj kohe:
“Mos thuaj kurrë ç'të bëj me këtë lloj jete,
por si ta bëj më të bukur!”.

E që ta arrish këtë duhet ta çmosh
çdo ditë të jetës, ajo nuk të vjen dy herë.

Kështu ka ndodhur edhe me mua...

AUTORI

Katër ngjarje kulmore në "sitën" e kujtesës

Kur i jam afruar kapitullit të fundit e libri po më zvarget nëpër duar, në kujtesë më vërviten shumë ngjarje e episode të këtyre gjashtë dekadave. Por, nëse do të më duhej për një mëtim analizues të përcaktoja katër ngjarjet apo pikat



kulmore të jetës sime, ato do duhej të për zgjidheshin me "sitën" e mirë të kujtesës, siç thonë furrtarët.

Dhe ja, teksa e "vras" mendjen, si të tilla veçoj: formimin tim gjuhësor-letrar, formimin kulturor, publicistikën dhe angazhimin në politikë.

Për formimin gjuhësor e letrar...

Nga largësia e viteve, kujtoj fare mirë zellin si nxënës i fillores, kur mësuesi i paharruar i klasës së parë Hajredin Greva, më mësoi abc-në dhe më dhuroi si "peshqesh" kaligrafinë perfekte të shkrimit të dorës, të perfeksionuar edhe më tej nën përkujdesjen e mësuesit të klasës së katërt, të të paharruarit Haziz Kurti.

Fillimisht nga mësues Hazizi, dhe në vitet e mëvonshme edhe nga mësuesit e gjuhës e leximit letrar: Gjyzel Hasani, Gëzim Baboçi e Agim Serani në tetëvjeçare, si dhe ata që më inkurajuan e nxitën talentin letrar, mësuesit e letërsisë në të mesmen, Aqif Doku e Lavdrim Shehu, mbaj mend se si për zgjidheshin hartimet, vjershat e esetë e mia për t'i recituar para klasës e për t'i afishuar në këndin letrar të shkollës. Nga këto krijime, Hysni Bruçi, një tjetër mësues i talentuar, që falë këtij talenti në vitin 1968 emërohet redaktor letrar i gazetës lokale "Ushtima e Maleve", për zgjodhi dhe botoi në këtë gazetë dy vjershat e mia, që atë vit, kur isha veçse 10 vjeç, botim ky që më lumturoi pa masë dhe nxiti më tej fantazinë tim krijuese. Ai që ma injektoi dëshirën për të shkruar e lexuar që mësues Xhepa, (Rexhep Hoxha),

njëkohësisht edhe regjisor amator i aktiviteteve të shumta kulturore që zhvillonte shkolla dhe shtëpia e kulturës Muhurr. Gjithmonë kam menduar se mënyra më e mirë për të pohuar ose mohuar është qasja ndaj shembujve. Së paku kjo më duket më e fisme sesa vërdallosja nëpër citate apo huazimi i ideve të të tjerëve, që s'është hiç më pak se sa plagjiaturë. Në këtë kontekst, me modesti do të kujtoja ato vite të fëmijërisë sime, kur mësues Xhepa më nxirrte në skenë, jo vetëm për të recituar vargje nga "Nënë Shqipëri" e të madhit Dritëro, por edhe për të luajtur në skeçe me të ndjerët Dine Doda e Rifat Kbeji, në shfaqje estrade, jo vetëm në Muhurr por edhe në takimet zonale në Peshkopi, kur përherë fitonim vendin e parë.

Ndërkohë do të veçoja shoqërinë e fisme, pa interes të viteve shkollore me bashkëmoshatarët e mi: Liman Berisha, tre Shefqetët (Mikli, Xhani e Tanushi), Haki e Xhelal Xhanin, Hazbie Sinën e Hasie Tanushin, Aqif Miklin, Demir Ramën e Femi Ballën, Flutura Kurtin e Meribane Hoxhën, Llan e Zyber Çikun, Liman e Vebi Rinën, Ibrahim Dodën e Marie Balliun, Maliq Lleshin e Basri Zhuzhin, por edhe më të mëdhenjtë në moshë si Avni e Rustem Xhani, Dalip e Selim Mëziu, Mirushe Lala, Vaide Rama e Davë Mëziu. Veçanërisht mblidheshim bashkë për të konsultuar teoremat e gjeometrisë e ushtrimet e algjebrës, të shpjeguara aq mirë nga mësuesit tanë të matematikë-fizikës: Bashkim Gazidede e Skënder Murrja, Mentor Domazeti, Qemal Dishi, Sami Doda e Sinan Tanushi.

Në kujtesën tonë kanë mbetur të pashlyera pasdarket e shumta të viteve '70 - '80-të, kur mblidheshim në shtëpitë e

Selman Xhanit, Hysni Miklit, Mudë Lalës, Halit e Myrteza Miklit, Medi e Tahir Mëziut (të parët që arritën të blejnë nga një televizor bardhë e zi të asaj kohe "Iliria", Adriatik" e "Lura"), ku ndiqnim me interes të jashtëzakonshëm filmat serialë "Oktapodi", "Në çdo kilometër", "Ne zhelanët", "Skllavia Izaura", "Herkuli" etj., e ku në shumë raste na zinte edhe gjumi të shtrirë në qilimat e odave të mëdha të këtyre shtëpive me kryefamiljarë bujarë e zonja shtëpie fisnike.

Më shumë se katër dekada pas këtyre viteve, kur po iu kthehem kujtimeve e përjetimeve të mia, është njëra që m'u duk se është më e thekur dhe parashikuese, të cilën kam dëshirë ta sjell në memorie. Ka qenë fillim qershori i vitit 1974, kur mësuesi i algjebërës dhe gjeometrisë, Sinan Tanushi, për të përmirësuar imazhin dhe për të dalë sa më mirë nga një kontroll i ekipit të Ministrisë së Arsimit në pragun e provimeve të lirim të vitit 1974, ndonëse isha në klasën shtatë, insistoi që të futesha një vit para afatit në ato provime...Dhe sado që përpiqem të jem modest, nuk i shpëtoj dot nostalgjisë së asaj kohe qoftë edhe kur kujtoj emocionet e dhënies së komandës: "Pionierë, në luftë për çështjen e partisë e të popullit të jeni gati" dhe përgjigja në kor: "Gjithmonë gati", tre vjet radhazi, për çdo mëngjes para fillimit të mësimit, pasi kishim bërë gjimnastikën e mëngjesit, kur isha përzgjedhur si i tillë nga ish drejtori brilant i shkollës, dishepulli i dijes dhe kulturës kombëtare, Xhemal Berisha, në rolin e komandantit të çetës së pionierëve të shkollës 8-vjeçare "Nexhat Agolli". Sërish, duke zhveshur petkun e modestisë, më duhet të kujtoj orët e lëndës së historisë, kur mësuesi virtuoz. Xh.Berisha (njëherësh

edhe drejtor shkolle), pasi e kishte shpjeguar vetë lëndën me atë mënyrën e tij brilante, do të më nxirrte për çdo rast mua që t'ua përsërisja shoqeve e shokëve të klasës.

Përkushtimi ndaj kulturës

Një kurs regjisure pranë shtëpisë Qendrore të Krijimtarisë Popullore në Tiranë, në vitet 1979-1980, që ma mundësoi Hysni Bruçi, ish-inspektor i kulturës në komitetin ekzekutiv të rrethit Dibër, më shërbeu jo vetëm për t'u njohur e miqësuar me personalitete të artit e kulturës së atyre viteve, si regjisorët e aktorët e mirënjohur Vangjel Myzeqari, Kosta Kamberi e Agim Bajko, por edhe për të mësuar prej tyre mjeshtërinë e krijimit të një platforme regjisoriale për pjesë teatrale apo estrade. Pa mburrje, këto njohuri do t'i jetësoja në vitin e mëpastajmë si përgjegjës i shtëpisë së kulturës në Muhurr, ku me grupet artistike të saj, në të cilët qenë angazhuar aktorë e këngëtarë amatorë si: Fadil Doda, Agim, Antike e Kimete Berisha, Fatmir Kurti, Mejreme Çiku, Farie Sula, Kapllan Rama, Sadik Dida, Xhafer Kaleshi (e ndonjë tjetër, të më falë që s'po ia kujtoj emrin) inskenuam pjesë teatrale e të estradës, konkurruam dhe fituam çmim të parë në takimet zonale në Selishtë e Peshkopi.

Janë vërtet të paharruara interpretimet dinjitoze të Fatmir Kurtit në rolin e fshatarit, që mashtronte kuestorin me shportën e vezëve e të Kapllan Ramës në rolin e kuestorit të mashtruar, te komedia "Në kuesturën italiane të fshatit", ashtu si dhe interpretimet e tyre në skeçet e paroditë, ku

stigmatizoheshin fenomenet negative të kohës, si ryshfetet e parazitizmi, nga të cilat gajaseshin qindra spektatorë që mbushnin sallën e shtëpisë së kulturës. Ato vite, ne në të shumtën kohës ishim bashkë, pranë njëri tjetrit, me një çiltërsi për t'u pasur zili. Vatra e kulturës ishte "shtëpia që na bashkonte jo vetëm bashkëfshatarët e mi muhurrakë, por edhe jabanxhinjtë, inxhinierët e gjeofizikës së Tiranës, Osman Lika, Mond Shahini e Maks Husi, si dhe mësueset e ardhura këtu nga Tirana, Rajmonda Gorenca, Sanie Valisi, etj.

Për të thënë të vërtetën për shumë nga jabanxhinjtë intelektualë vatra e kulturës konsiderohej si shtëpi e dytë sepse aty jo vetëm vinin gati të gjithë, por se kishte revista, libra, disa instrumente të thjeshta muzikore, si fizarmonikë, gërrnetë etj. Të ardhurit në fshat ishin frekuentuesit më të mirë të mbrëmjeve tematiko-dëfrimi që organizonim shpesh, si dhe në kampionatet botërore e europiane të futbollit, që këtu ndiqeshin në mënyrë spontane dhe të dukej diçka e organizuar. Duke e shtrydhur kujtesën për ngjarje, episode e personazhe, nuk mund të lë jashtë saj instrumentistët virtuozë popullorë Sadik Dida e Nazmi Rama, rapsodët e mirënjohur Fadil Doda e Agim Berisha e veçanërisht ata që i dhanë emër Muhurrit në rang kombëtar, vëllezërit kërcimtarë Gani e Hamit Rama, që shkëlqyen deri në Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës me grupin e Dibrës.

Brenda shtysës për një vlerësim real e objektiv të ngjarjeve, episodeve e personazheve të asaj kohe, nuk mund të lë pa përmendur piktorin autodidakt mjaft të talentuar Islam Voka, jo vetëm si skenograf e disenjator, ndër më të

mirët e rrethit të Dibrës, por edhe për drejtimin që i bëri shtëpisë së kulturës Muhurr në vitet e mëvonshme.

Le të shërbejnë këto radhë edhe si homazh për të ndjerin Qamil Mëziu, që si i pari teknik i riparimit të radiove e televizorëve, që bërë mbështetësi kryesor i veprimtarive të shtëpisë së kulturës, me foni të improvizuara prej tij, por që ndikonin dukshëm në cilësinë e tyre.

E ndërsa sjell në memorie ato kohë vërtet të arta të rinisë sime për një metaforë, më vjen përqasja me lumenjtë, Drini e Murra, që përshkojnë fshatin tim dhe ku unë që pesë vjeç mësova notin. Ato mund të rrjedhin në shtratin që e kanë hapur vetë prej shekujsh, por edhe mund të futen në shtratin që ua hap njeriu. Në jetë gjithkush përpiqet ta hapë këtë shtrat. Pak a shumë kështu më ka ndodhur edhe mua. Punoja dhe ëndërroja të hapja "shtratin" e rrugës sime, jetës sime me kufizimet që në ato kohë edhe nuk e dinim sa të tmerrshme ishin. Edhe në ato kohë intriga dhe xhelozia ishin midis njerëzve. Këto intriga më larguan nga funksioni i përgjegjës të shtëpisë së kulturës Muhurr, kur sapo kisha arritur sukseset e para. Unë kisha ëndrra, sistemi kishte kufizime, por ne sërish punonim. Kështu kujtoj se me përkrahjen e insistimin e aktorit e regjisorit të njohur dibran Stefan Roçi, që ishte para meje përgjegjës i shtëpisë së kulturës Muhurr, kisha kontribuar edhe në ngritjen e funksionimit e vatrave të kulturës në fshatrat Rreth-Kale, Vajmëdhej e Hurdhë Muhur. Pasi humba punën tek shtëpia e kulturës në vendlindje, me shumë përpjekje, mezi zura vendin e punonjësit socialkulturor në minierën e mermerit, falë mbështetjes së ish-drejtorit të saj Hekuran

Domi, të cilin, sigurisht, që nuk e zhgënjeva. Në ato vite, jeta sikur ishte më e lehtë dhe më e thjeshtë. Kjo nuk është thjeshtë nostalgji, por një ndjesi e vërtetë ose perceptim real i asaj kohe. Duke parë dhe analizuar ngjarjet nga largësia e viteve, më duhet të pranoj se shkaku ishte mbivlerësimi që kishim për mundësitë tona, por që në të vërtetë ishin mundësi reale. Brenda këtyre mundësive, falë dhuntisë dhe talentit tim, por dhe ndihmës së pakursyer të drejtorit të bibliotekës së Peshkopisë, Ylvi Shehu dhe drejtorit të arkivit të rrethit Dibër, Luan Kaba, arrita të krijoj një bibliotekë dhe një zyrë arkivore model në minierën e mermerit, po ashtu edhe vatrën e kulturës, që për atë kohë ishte moderne dhe mbahej si stolia më e bukur e asaj qyteze minatore. Veprimtaritë këtu do të kulmonin me montazhin muziko-letrar dhe koncertin festiv që organizuam në 20-vjetorin e kësaj miniere.

Ndoshta edhe nga rastësia, pjesëmarrja në ato veprimtari festive e ish drejtorit të Minierës së Kromit "Todo Manço", të nderuarit Thanas Deda, i cili i emocionuar pohoi se veprimtari të tilla cilësore nuk zhvilloheshin as në qytetin minator të Bulqizës, "fjala" e tij tek organi i emërtesës, do të ndikonte që po atë vit të shpërngulesha për në këtë qytet, me misionin fisnik të metodistit të punës kulturore në shtëpinë e kulturës së ushtarakëve të divizionit, që përfshinte tre rrethe: Burrelin, Bulqizën dhe Librazhdin.

Nuk jam aq tendencioz sa t'i përflas, sepse di mirëfilli që çdo njeriu t'i jap vendin që meriton në bashkëpunimin dypalësh, por për atë kohë, si të tillë qenë Demir Rusi (shef i shtëpisë së kulturës së ushtarakëve) dhe Hajri Mandri (drejtor i

kinoklubit "Minatori" të Bulqizës), bashkëpunim ky që kulmoi me përzgjedhjen dhe inskenimin e dramës "Bregdrinasit", kushtuar Gjeneralit me shajak, Elez Isufi, me autorësinë e Hajri Mandrit. Me këtë dramë u paraqitëm dhe zumë vend të parë në takimin kombëtar të teatrove amatore të ish- shtëpive të ushtarakëve. Në këtë arritje të asaj kohe kanë vendin e tyre aktorët amatorë: Naim Muça, Lime Murra, Mirela Peti, etj., si dhe skenografi Azem Teta.

Tridhjetë vjet më vonë, ndërsa ishim ftuar nga mësuesja e letërsisë Fabjona Shahini (Isaku) në një takim me talentet e reja të shkollave të Bulqizës, bashkë me mikun tim, bashkudhëtar të këtyre katër dekadave, poetin e dramaturgun Hajri Mandri, u mrekulluam me inskenimin që i kishin bërë dramës "Bregdrinasit", e cila ruan origjinalitetin prej vitesh. Interpretuesit e vegjël të kësaj shkolle, i kishin qëndruar besnik linjës së patriotizmit që ajo përçon te shikuesit. Ishte një befasi e bukur që sërish konfirmon se kur punon me pasion, dhe hedh në letër dritën e shpirtit tënd, ajo të kthehet bukur si një ylber pas një shiu pranvere...

Në median e shkruar...

Ndërsa po përveçoja fillesat e mia në publicistikë, mendova të bëj një sentencë që t'i përshtatej gjendjes sime të kësaj kohe: Mos thuaj kurrë ç'të bëj me këtë lloj jete, por si ta bëj më të bukur! E që ta arrish këtë duhet ta çmosh çdo ditë të jetës, ajo nuk të vjen dy herë... Kështu ka ndodhur edhe me mua... Ndërsa kisha shkruar e botuar me dhjetëra



reportazhe, skica, kronika e fejtone në gazetën lokale "Ushtima e Maleve", në fillim majin e vitit 1992, kur Bulqiza sapo ishte shpallur rreth më vete, më shkrepri në mendje që të themeloja gazetën periodike me të njëjtin emër.

Dhe pse të mos e bëja?! Përvoja nuk më mungonte, përderisa kryeredaktori i "Ushtima e Maleve" Velo Cfarku dhe redaktorët e nderuar Kamber Faruku, Fadil Meha, Abdurahim Ashiku e i ndjeri Garip Troci, më kishin mbajtur afër për vite të tëra, duke më mësuar deri dhe sekretet e planifikimit të faqeve, redaktimin e korrekturën e materialeve. (Asokohe gazetatat shtypeshin në shtypshkronja me plumb, dhe jo si në këto modernet e sotme digjitale, dhe materialet shkruheshin në makina shkrimi e jo me kompjuter, ndërsa për internetin as që mund të

imagjinohej). Por një shkollë gazetarie më vete për mua ka qenë edhe bashkëpunimi i ngushtë me pena të mprehta të gazetarisë shqiptare, si: Qemal Sakajeva, Namik Dokle, Nadire Caka, Shefki Karadaku, Dilaver Baxhaku, Selami Spahiu Xhevdet Shehu, Irfan Velçani, Tomor Peza, Shefqet Meko, Demokrat Anastasi, etj., në harkun kohor të viteve '80-'90, kur botoja artikuj problemorë, por edhe reportazhe e skica letrare në gazetatat e asaj kohe si: "Zëri i Rinisë", "Bashkimi", "Puna" e "Luftëtari", si edhe më vonë (1992-1996) si korrespondent i Radio "Tirana" për rrethin e Bulqizës, i atashuar nga kolegu e miku i ngushtë, ikona e gazetarisë sportive Defrim Methasani, që më kishte



Halil Rama dhe Defrim Methasani

njohur me gazetaren e redaktoren e spikatur Zamira Koleci, e cila më mbështeste e më jepte gjithë hapësirën e nevojshme në këtë radio mjaft të ndjekur në atë kohë. Kështu, natyra ime optimiste i vinte në gjumë rreziqet e pritshme... Dhe nuk thonë kot se "Fillimi i mbarë është gjysma e punës". Sapo e hodha si ide në rrethet intelektuale e krijuese të Bulqizës të saposhpallur rreth më vete (deri atëherë në juridiksionin e Dibrës), piktori Azem Teta bëri logon "BULQIZA", që u pëlqye nga i ashtuquajtimi kolegji i gazetës. Pastaj nisëm me vrull punën, bashkë me Hajri Mandrin, Sakip Camin e Meleq Beqirin dhe me mbështetjen e kryetarit të këshillit të rrethit Bulqizë, Bashkim Lami e të deputetit të zonës Safet Zhulali, ish-ministër i Mbrojtjes që bëri dhe përshëndetjen e radhës, të cilën e botuam në vendin e editorialit, më 5 maj 1992 nxorëm numrin e parë që u mirëprit nga publiku.

Me rubrika të larmishme: ekonomi & sociale, traditë & kulturë & letërsi & art, etj., botuam 56 numra në mënyrë periodike për çdo muaj, deri në fund të '96-tës, për ta rihapur sërish pas 19 vitesh (2015 e në vazhdim), tashmë si ide e projekt i shoqatës "Bulqiza" në Tiranë, me mbështetjen e Edmond Isakut si drejtor i saj, njëherësh themelues dhe drejtor i TV "Bulqiza". Gazeta vazhdon të botohet online: www.gazetabulqiza.com dhe ka hyrë me dinjitet në tregun mediatik shqiptar.

Ndërkohë që përgatisja dhe botoja gazetën mujore "Bulqiza", gjatë viteve 1992-1996, punova si shef i administratës së këshillit të rrethit, në kabinetin e ish-

kryetarit Bashkim Lami, i cili e drejtoi këtë rreth në një situatë tejet të vështirë të problematikave të shumta, varfërisë e papunësisë, të trashëguara nga e kaluara dhe të krijuara edhe në atë fillim tranzicioni të tejzgatur.

Gjithë sekreti i jetës së jetuar, pa e përfillur vuajtjen, besoj se është aftësia që, për asnjë çast, të mos biesh prë e mendimeve mosbesuese tek aftësia që, për asnjë çast, të mos biesh prë e mendimeve të zymta, pesimiste... Kur sapo mbyllej viti i mbrapshtë '97, (kujtojmë rebelimin që shkaktoi tumori i piramidave, që kishte lëshuar metastazat pothuajse në çdo familje) unë, pasi kisha lënë te "VEFA" 250 mijë lekët nga shitja e apartamentit tim në qytetin e Bulqizës, familjarisht jetoja në një banesë tejet të papërshtatshme, afër Breglumit të Tiranës. (Me kalimin e viteve atë banesë e shndërrova në vilë dykatëshe, të hipotekuar sipas ligjit), miku im Bejdo Malo kishte nisur botimin e gazetës së përditshmes "BULEVARD".

Më ftoi edhe mua në stafin e saj si gazetar e redaktor i politikës. Punuam bashkë me gazetarët e njohur Agim Deva, Xhuli Boja, Luli Progni, Ilir Bushi, Xhevair Osmani e ndonjë tjetër, duke nxjerrë në treg një gazetë që për nga shitja dukej si më e preferuara. Por nuk e pati jetën të gjatë, pasi e gllabëroi e famshmja "Albania" e Ylli Rakipit. E ndërsa gjithë kolegët e mi u atashuan menjëherë në stafin e saj, unë ngurova, duke qëndruar muaj të tërë në pritje, derisa ma mbushi mendjen i ndjeri Sokol Olldashi, ish-zv/kryeredaktor i saj.

Pa ia mohuar të drejtën vetvetes që nga largësia e viteve

të ripohoj apo të qortoj atë që kam thënë e bërë në kohën që po analizoj, në një kapitull kryesisht kujtimesh të një libri si ky, mendova se është një shenjë e mirë singeriteti, nëse do sjell diçka të veçantë nga ato që kam shkruar e botuar në shtypin e kohës. E pikërisht në këtë këndvështrim, po sjell si të veçantë vitin 1998 që do të mbahet mend si viti i Kushtetutës.

Si një nga gazetarët aktivë të atij viti, nga kryeredaktori i gazetës të madhe "Albania", Lutfi Dervishi, m'u besua të pasqyroj me objektivitet gjithë opinionet për projekt kushtetutën. Me bindje mund të them se atëherë më shkrepì një yll fati. Qe fat për mua të njihja nga afër e të intervistoja personalitete të spikatura të jurisprudencës shqiptare, si konstitucionalistin Rustem Gjata e juristët e mirënjohur Kudret Çela, Spartak Ngjela, Ardian Nuni, Qazim Gjonaj, Avni Shehu, Kreshnik Spahiu etj., (intervista këto, që po t'i mbledh e rishkruaj mund të botoj me to një libër të veçantë, duke bërë edhe oponencën time, tashmë si jurist e avokat, dhe duke e ballafaquar me problematikën që sollën amendimet e vitit 2008, 2016 e 2021), të cilët në faqet gazetës, thuajse çdo ditë ishin oponentë të projektit të kushtetutës. Dhe, ndonëse opinionet e oponencat e tyre qenë nga më të ndryshmet, unë gjithnjë kam menduar se vendit gjithsesi i duhej një Kushtetutë moderne, e standardeve të larta demokratike.

Kjo edhe për faktin se kishte dhe nga ata që na pandehnin ne në gjendjen e Zululandit, siç thoshte Konica, që mendonin e shfaqeshin hapur në publik, se mjafton që Kushtetuta të plotësojë disa parametra të njohur që ne ta marrim e ta

shijojmë si simite të furrës. Tani, nga distanca e kohës, edhe në pozicionin e juristit e të avokatit, mund të them se Kushtetuta e '98-ës ka pasur përgjithësisht një rol pozitiv, sado që nevoja për rishikim, për disa amendamente është bërë çdo ditë e më e dukshme, e për këtë jam krenar që dhashë kontributin tim gjatë gjithë atij viti me artikujt e intervistat e botuara në "Albania".

Dy vjet më vonë, tashmë reporter i politikës në të përditshmen "Rilindja Demokratike", e them me bindje se më shkrepri sërish një yll fati. Pikërisht, pasditen e 28 tetorit 2000, kur sapo kisha festuar me familjen 40-vjetorin e ditëlindjes, me ftesë të federatës panshqiptare "VATRA" të Amerikës, që ma kishte mundësuar kolegu im Beqir Sina, u nisa për të asistuar si vëzhgues në zgjedhjet presidenciale Bush-Al Gore të atij viti.

Dy javë nga më të paharruarat e jetës sime, ku pata rastin të takoja ish-kryetarin e kësaj federate, Agim Karagjozi, një patriot i madh e intelektual erudit, si dhe personalitete të tjera të diaporës shqiptare në Nju Jork, Jonuz Ndreun, apo dhe mërgimtarët e rinj, Mal Berisha me shokë, që sapo kishin formuar një degë të PD-së në SHBA.

Përvojën e atyre dy javëve e kurorëzova me editorialin (me bashkautor Beqir Sinën) me titull: "Sot flet historia: Bush apo Algor", që u botua ditën e zgjedhjeve presidenciale të SHBA më 7 Nëntor 2000, në të përditshmen "Bota Sot", e cila vetëm në Nju Jork botohej në tirazhin 38 mijë kopje (botohej dhe vazhdon të botohet edhe në Zyrë, Zvicër e në Prishtinë).

Më vonë, për 13 vjet punova si reporter i politikës e si redaktor i rretheve dhe i sektorit të arsim-kulturës në gazetën

e përditshme "Rilindja Demokratike", ku bashkëpunimi me kryeredaktorët Astrit Patozi e Bledi Kasmi, si dhe me kolegët gazetarë të njohur: Sami Neza, Shemsi Peposhi, Artur Kopani, Zef Lleshi, Mujë Buçpapaj, Ramiz Gjini, Migen Demirxhi, Brikena Kamenica, Ndrekë Gjini, Rexhep Polisi, Drita Çokaj, Dorina Azo e Kreshnik Mersinllari, ishte vërtet një përvojë e vyer në publicistikën time.

Pas më shumë se shtatë viteve që jam larguar nga kjo gazetë, kur po u kthehem kujtimeve e përjetimeve të mia, diçka të veçantë kam dëshirë ta sjell në vëmendje.

Ishte gjysma e parë e vitit 2001, kur bashkë me gazetaren Mimoza Picari, intervistonim Ridvan Boden, si ish-kandidat i PD-së për kryeministër, tre herë në javë në TV Shijak. Me gjithë alternativat bindëse të Bodes, që unë të nesërmen e intervistës në TV Shijak i zbardhja e i botoja në "RD", kam pasur bindjen se në atë kohë manipulimesh zgjedhore (kur u shpik edhe i famshmi DUSHK i Lushnjës), PD në opozitë nuk mund t'i fitonte ato zgjedhje e kështu edhe Bode nuk do të bëhej kryeministër. Në fushën e gazetarisë, krahas botimit të opinioneve, reportazheve e dossierëve në gazetatat e përditshme "Panorama", "Gazeta Shqiptare", "Koha jonë", "Telegraf", "Dita", "Standard" e në të përjavshmen kulturoro-letrare "Nacional" (të themeluar e drejtuar me kompetencë e profesionalizëm nga miku im, Mujë Buçpapaj), një përvojë më vete është drejtimi si kryeredaktor prej 18 vitesh, i gazetës periodike "VETERANI", botim i Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të LANÇ, në të cilën kam përcjellë për opinionin publik fakte e ngjarje të dëshmuara



NDERI I KOMBIT, Rrahman Parllaku dhe Halil Rama

nga personalitete të spikatura si gjeneral Rrahman Parllaku-Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit, Liri Belishova, Edip Ohri, Myfit Guxholli, Skënder Malindi, etj.

Madje kjo gazetë, më ka shërbyer si burim frymëzimi, lëndë dhe dokumentacion kryesor për librat e mi: "Një legjendë në kufirin e dy kohëve" (me bashkautor Sakip Camin), "Testamenti i atdhedashurisë", "Memoria historike e kombit" e "Në panteonin e vlerave".

Si më "rrëmbeu" politika?!

Të gjithë jemi robër të kohës që jetojmë. Thyerjen e parë të besimit se jeta do të ecte në normalitetin e zakonshëm dhe se pakënaqësia e pesimizmi do të vinte duke u zbehur, e pata në gushtin e vitit 1991. Shtëpia e Kulturës e Ushtarakëve Bulqizë ku punoja si metodist kulture, u mbyll (nga reformat e saponisura të sistemit të ri pluralist) e mua m'u desh të rikthehesha në fshatin tim të lindjes, Muhurr, pa asnjë shpresë për të ardhmen. Por siç thotë një shprehje e urtë "E keqja dhe e mira, të vijnë kur nuk i pret!". Pikërisht në një prej atyre ditëve të trishta, më telefonon nga Bulqiza miku im i ngushtë Hajri Mandri dhe më thotë: "Kthehu urgjent se të kemi emëruar sekretar të komitetit ekzekutiv pluralist të qytetit!" U shastisa nga kjo e papritur e këndshme... I deleguar nga Tirana kishte ardhur Maqo Lakrori, i cili kishte miratuar edhe emrin tim për këtë pozicion të ri, si përfaqësues i PSD-së. Kjo ishte së pari befasi e atij viti për mua. Nuk jam aq tendencioz sa t'i përflas miqtë, sepse di mirëfilli që çdo njeri ka të drejtë të ndryshojë bashkë me kohën, por sinqerisht nuk e prisja këtë të mirë nga Mandri, i cili ende pa u krijuar PSD në Bulqizë, më kishte propozuar mua si përfaqësues të saj në komitetin ekzekutiv të këtij qyteti, ndërsa vetë ishte emëruar sekretar i komitetit ekzekutiv të rajonit Bulqizë. Kështu, dashur pa dashur, miku im i mençur e i vyer H.Mandri, si bir i një familje të madhe dibrane, në atë zheg përvëlues (jo vetëm të motit, por edhe të politikës) më tërhoqi sërish në Bulqizë, duke më imponuar që bashkë me dr.Skënder



Shaqir Rexhvelaj, Teodor Laço, Halil Rama

Bucin, inxh.Afrim Çengën, inxh.Hashim Devën e Destan Prençin të krijonim degën e Partisë Socialdemokrate për Bulqizën. Nga afër njihja vetëm njërin prej udhëheqësve të qendrës së kësaj partie, Lisen Bashkurtin, me të cilin më kishte takuar miku ynë i përbashkët Baftjar Rusi, në kohën që ishte sekretar i komitetit të rinisë të rrethit Dibër.

Nga kjo hyrje spontane në Partinë Socialdemokrate, tri vite më vonë, do të gjendesha me eksponentë të njohur të kësaj partie, të kryesuar nga politikanët e njohur Teodor Laço, Arian Starova e Shaqir Rexhvelaj, të cilët drejtuan grupin e shkëputur nga PSD, që mbështeti Projektkushtetutën e 94-ës, për të krijuar një vit më vonë (1995) Bashkimin Socialdemokrat. Nga ajo kohë, Laço do të më evidentonte, nga një takim intelektualësh të qytetit të Bulqizës, për të më tërhequr në Tiranë, fillimisht në pozicionin e shefit të organizimit të BSD (parti kjo që në 2002 ndryshoi emrin në BLD-Bashkimi Liberal Demokrat, duke arritur deri dhe krijimin e një grupi parlamentar) dhe më vonë anëtar Kryesie e deri nënkryetar i kësaj partie, funksion që e mbajta deri në



Halil Rama, Shaqir Rexhvelaj, Arian Starova

janar 2015, kur fitova statusin e nëpunësit civil në bashkinë e Tiranës. Ndonëse është e vështirë t'i ndaj përjetimet e mia politike nga ato letrare, po kuturis ta bëj këtë, sepse e di që çdo njeri i letrave, kur hyn në politikë, ka mall për atë kohë kur nuk ishte i dyzuar dhe i kushtëzuar për të bjerrur dëshirat nëpër rravime të largëta.

Laço, një personalitet i letrave dhe i politikës më besoi "arsenalin e tij krijues" në këto fusha për afro dhjetë vjet (1995-2005), duke qenë i pari lexues i tyre, e duke ia kompjuterizuar jo vetëm fjalimet, por edhe tregimet, romanet e dramat e tij të shkruara në këtë harkor (si: "Valsi i hënës", "Mjegull", "Gropas '67", "Bashkëjetesë me kohën" etj). Kjo kohë shërbeu vërtet si një shkollë për formimin tim si letrar e publicist, por edhe për afirmimin në politikë, ashtu si edhe bashkëpunimi i mëvonshëm intensiv me politikanin, diplomatin, politologun e shquar Arian Starova e me personalitetin e kulturës e të politikës shqiptare Shaqir Rexhvelaj. Ndërsa kuturis në këtë "livadh" të stërmadh

të politikës, ku politikanët aktualë të të dyja krahëve kanë humbur dukshëm besimin e qytetarëve për shkak të lidhjeve të dyshimta me krimin e korrupsionin galopant, gjithnjë e më shumë më tërheq Muhurri, fshati im i lindjes, tashmë me vila dy e trikatëshe, me fasada të suvatuara e të lyera me ngjyra të ndryshme. Shtëpia e fëmijërisë më tërheq me një forcë magnetike të pamenduar kurrë...

Zemra më rreh për vendlindjen time, ku tani kanë çelur lulet e kumbullave e kajsive, që janë edhe të stolitura me të bardhë dhe nisin të formojnë frutin, duke shpërndarë petalet mbi barin e mezhdave si një pjalm dëbore. E ndërsa kuturis kësisoj, sërish mendja më fluturon tej rrëzë Runjës e matanë saj në pllajë, kur në fëmijërinë time, bashkë me shokët e shoqet mblidhnin lule zoje... atje te Kroj i Zi e në gryka të thella malesh, në thepisjet e të cilave dukej se gremiseshin fatthënat për t'u copëtuar e thërmuar nëpër thepa gurësh ose për t'u prehur qetësisht përfund malit... Atje ku ngjyrat feksnin ose mugeshin, me të gjitha ngjyrimet e ylberit. Shpjegimi im për lumturinë e njeriut më shtyn drejt supersticionit, drejt Zotit... Kam qenë vetëm 10 vjeç kur u krye masakra mbi institucionet e kultit, kur përrjetoja me dhimbje prishjen e Teqesë së Çikut e të Xhamisë së Tanushëve...

Ky trishtim më vinte edhe si thirrje e brendshme e origjinës sime si stërnip dhe nip i klerikëve të famshëm të Reçit e Dardhës, Sheh Ymerit, Sheh Velisë e Selman Hoxhës... Dhe ja, tani pas gjysmë shekulli, gëzohem i gjithi kur shoh në vendlindjen time, të ringritura edhe më madhështore këto objekte kulti dhe bashkëfshatarët e mi që i janë rikthyer



besimit në Zot. Në këto refleksione, nuk i sjell dot nëpër mendje gjithë të mirat që kam bërë në jetë, sa njerëzve ua kam ndryshuar rrjedhën e fatit pas ndërhyrjeve këmbëngulëse për një të drejtë punësimi a studimi në master e doktoraturë, për një vizë në Amerikë, Gjermani e Greqi, për t'i botuar një artikull një veterani, sa herë kam dhënë borxh dhe kur e kanë harruar të ma kthejnë, nuk ua kam kujtuar, sa herë e kam ndezur harenë nëpër festa familjare. Tani që po i kujtoj, po mëtoj t'i lë të shkruara. Kjo mund të tingëllojë si mburrje, si autolëvdatë. Ndoshta mund të gjykohet kështu edhe prej unit tim të dytë, që më qorton. Ngasja për t'i kujtuar ka një origjinë tjetër: dëshira për të shpjeguar lumturinë. Dhe atëherë më vjen në mendje "Behari i vogël i një Forsajti" i Gollsuorthit, paçka se si ogur s'më pëlqen...



Dekorimi me titullin "MJESHTËR I MADH"



Publicisti dhe shkrimtari i talentuar, mjaft produktiv dhe me një përvojë të gjatë, Halil Rama, është dekoruar nga Presidenti i Republikës Ilir Meta, me titullin "Mjeshtër i Madh". Ky titull i lartë iu dha autorit të 17 librave monografikë në një manifestim të shkëlqyer festiv të komunitetit artistik të Zall Dardhës, më 18 shtator 2020, me prezencën e autoriteve vendore dhe elitës intelektuale dibrane.

Nga Dr. Hajri MANDRI





“Për kontributin e shquar si shkrimtar, skenarist e publicist i cili në veprimtarinë e tij të gjerë ka pasqyruar më së miri historinë, kulturën, traditat e cilësitë identifikuese të shumë viseve shqiptare, veçanërisht të trevës së Dibrës, si dhe vlerat e shumë figurave të shquara të kombit shqiptar”



Publicisti dhe shkrimtari i talentuar, mjaft produktiv dhe me një përvojë të gjatë, Halil Rama, është dekoruar nga Presidenti i Republikës Ilir Meta, me titullin "Mjeshtër i Madh".

Ky titull i lartë iu dha autorit të 17 librave monografikë në një manifestim festiv të komunitetit artistik të Zall Dardhës, më 18 shtator 2020, me prezencën e autoriteve vendore dhe elitës intelektuale dibrane: "Për kontributin e shquar si shkrimtar, skenarist e publicist i cili në veprimtarinë e tij të gjerë ka pasqyruar më së miri historinë, kulturën, traditat e cilësitë identifikuese të shumë viseve shqiptare, veçanërisht të trevës së Dibrës, si dhe vlerat e shumë figurave të shquara të kombit shqiptar" (motivacioni i dekoratës).

Jo pa qëllim ishte përzgjedhur Zall Dardha për të vlerësuar shkrimtarin dhe publicistin Halil Rama, si dhe artistët më në zë të kësaj treve Liri Rasha, Qerim Sula, Sherif Dervishi, Sahje Poleshi, Xhelal Imeraj, Neshat Ndreu, etj. Kjo për faktin se Halil Rama, ka shkruar dhe promovuar monografi e dokumentar për artistë të përmasave

kombëtare të kësaj treve, si për kompozitorin e tangos shqiptare Muharrem Xhediku, ikonën e artit e kulturës kombëtare Hazis Ndreu, regjisorin dhe aktorin e shquar Skënder Cala, për Lutfi Ndreun - mësues dhe artist, etj, të botuara këto edhe në prestigjiozet e përditshme "Panorama", "Telegraf", "Gazeta Shqiptare", "Rilindja Demokratike", në të përjavshmen kulturore-letrare "Nacional", si dhe në disa portale.



Në 17 librat e tij, Halil Rama prezantohet si mjeshtër i profilit, duke krijuar personazhe si shembëllyra që të mbeten në kujtesë. Tërë publicistika e tij është në një linjë vetëpërmbushëse, ku autori me mjeshtëri di të përveçojë protagonistë të veshur me detaje që vetëm syri i mprehtë dhe mendja pjellore i shpërfaq aq mjeshtërisht. Në monografinë "Muhurri, histori dhe personalitete", (me 712 faqe në 17 kapituj) si dhe në librat e shkruara dekadën e

fundit nga ky autor, zbulohet thelbi i marrëdhënieve njerëzore. Jetët e personazheve realë, janë të mbushura me pasione dhe emocione të pandalshme, drejt sfidës së jetës, drejt suksesit. Shkrimi i tij depërton thellë në shpirt dhe zbulon botën delikate të intelektualëve dibranë, kukësiyanë, durrsakë, shkodranë etj, në strukturën e tyre si njerëz të matur që veprojnë në kontekst duke marrë prej tij, maksimalisht suksesin. Ashtu siç është edhe vetë në jetë autori Halil Rama, personazhet realë që përshkruan në librat dhe esetë e tij, janë karaktere që bartin dashuri dhe buonsens, veti të qenësishme inteligjence.

Në fushën e të shkruarit dhe në disa institucione ku ka punuar, evidentohet këmbëngulja dhe vullneti i tij për të studiuar, për të mbledhur burimet parësore, për të mësuar nga përvoja e tjerëve që është pjesë e stilit të punës kërkimore të tij. Halili e formoi personalitetin e tij, jo vetëm në praktikën krijuese voluminoze por edhe me studime të integruara formale universitare për drejtësi, (duke fituar edhe titullin "Avokat") çka i ka dhënë një surplus në interpretimin e dukurive shoqërore dhe ngjarjeve pikante të historisë.

Ai i vendos intelektualët që nuk jetojnë dhe ata që jetojnë dhe kontribuojnë ende, secilin në vendin dhe piedestalin e merituar. Dashuria dhe ngrohtësia me të cilat i mbështjell ata, janë shprehje e humanizmit dhe shpirtit patriot, demokrat e liridashës të autorit.

Lexuesi mund të shijojë drejtpërdrejtë nokturnet dhe romantikën që shpërfaqen në librat e H.Ramës (për



gjeneral Rrahman Parllakun, Liri Belishovën, Muharrem Xhedikun, Skënder Calën etj) shkruar me një stil të rrjedhshëm, që ngjajnë me një ese të gjatë liriko-epike, si një databazë e plotë e vlerave të tyre, duke plotësuar harmonishëm tablonë gjigande të njerëzve të ditur, të urtë e patriotë.

Veçanërisht libri i tij, "Muhurri, histori dhe personalitete", lexohet këndshëm nga përdorimi me mjeshtëri i mjeteve gjuhësore dhe stilistike, ngjytimeve emocionale që fitojnë ngjarjet dhe personazhet, nën talentin dhe profesionalizmin e Halil Ramës. Ai sjell jehonën e vendlindjes së tij të bukur dhe të dashur, si shembëlltyrë e jehonës që vjen nga e shkuara tek e sotmja dhe na zgjon të gjithëve e na thërret, për më shumë humanizëm, dashuri e dinjitet.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Rama, Halil
Fluturon shqipja mbi Korab;
reportazhe, portrete,
kritikë letrare/ Halil Rama;
red.Shefqet Meko. -Tiranë;
M & B, 2021
296 f. : me foto ; 14 x 20.7 cm

ISBN 978-9928-353-12-2

1.Letërsia shqipe 2.Reportazhe 3.Kritika, interpretimi
821.18-92
821.18.09
